

Ali Xhiku

NGA  
**ROMANTIZMI**  
**RRJEDHAVE**  
TE  
**REALIZMIT**

8SH(09)


XH 70

UNIVERSITETI I TIRANËS «ENVER HOXHA»  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

Ali Xhiku

NGA  
ROMANTIZMI  
RRJEDHAVE  
TË  
REALIZMIT

(ÇËSHTJE TE DREJTIMEVE NË HISTORINË E  
LETËRSISË SHQIPTARE 1836—1939)



SHTËPIA BOTUËSE E LIBRIT UNIVERSITAR  
TIRANE

## H Y R J E

Detyra më e parë e historisë së letërsisë së një populli është, sigurisht, të studiojë dhe të vendosë në kohën e vet jetën dhe veprën e shkrimtarëve që e kanë krijuar atë letërsi, të vështruar kronologjikisht e në lidhje të ngushtë me rrethanat historiko-shoqërore e ideologjiko-kulturore, që kanë përcaktuar brendinë e saj. Krahas këtij konceptimi, që ka krijuar traditë e i ka qëndruar kohës, praktika të tjera e ndërtojnë historinë e letërsisë, duke studiuuar lindjen e zhvillimin e tipave revere thelbësore të saj në rrjedhat e kohës, të ideve e temave më të rëndësishme, të gjinive dhe llojeve të përpunuara prej saj etj. Megjithatë, një histori e letërsisë nuk mund të jetë gjër në fund e plotë, në qoftë se nuk arrin të vëjë në dukje e të përgjithësojë anët e përbashkëta dhe ndryshimet më kryesore të qëndrimeve botëkuptimore e estetike, nga të cilat janë nisur shkrimtarët për të realizuar pasqyrimin artistik të problemeve themelore të kohës së tyre. Rrethanat politiko-shoqë-

rore të një periudhe historike të caktuar krijojnë tek shkrimtarët në mënyrë të pashmangshme qëndrime të afërta ose të kundërtat botëkuptimore, vlerësimë po të tilla për ngjarjet dhe njerëzit, koncepte estetike të ngjashme, ose përkundrazi, të ndryshme, praktika krijuese që mund të kenë tipare të përbashkëta ose të jenë shumë të dalluara nga njëra-tjetra. Prandaj është e domosdoshme që historia e letërsisë të jetë e shoqëruar me vështrime të gjera mbi ato tipare të veprave letrare, të cilat i bashkojnë a i ndajnë në grupe të veçanta.

Shumë teoricienë dhe historianë të letërsisë, që e konceptojnë atë si pasqyrim artistik të jetës shoqërore, vazhdojnë ende diskutimet mbi nocionet që i emëtojnë këto dukuri, në të cilat dallojnë, në njëren anë, rrymën, ku përfshijnë të gjitha krijimet që vlerësojnë jetën shoqërore të nisura nga qëndrime të njëjtë ose të ngjashme botëkuptimore e, për pasojë, trajtonjë pak a shumë të njëjtën problematikë ideore, dhe, në anën tjetër, drejtimin, që formohet mbi përpunimin edhe estetik të pikëpamjeve filozofiko-sociale të një rryme të caktuar.

Ne do t'i mbahemi termit «**drejtim letrar**», sepse pikat e takimit dhe prirjet e përbashkëta në qëndrimet filozofike, në përjetimet estetike e në praktikat e pasqyrimit artistik në krijuimtarinë e një grupi shkrimtarësh, të kushtëzuara nga rrethana të caktuara historiko-shoqërore, shfaqen si të tilla, pavarësisht nëse janë ose nuk janë përpunuar teorikisht. Nga ana tjetër, dukuritë letrare shpesh i kapërcejnë kufijtë e një vendi dhe përhapen në vende të tjera, sepse shoqëritë kombëtare përkatëse herët a vonë ndeshen me probleme të njëjta, sigurisht në rrethana të papërsëritshme, me veçori origjinale në jetën ekonomike, politike e ideologjike.



Drejtimet letrare, të cilave u përkasin veprat e shkrimtarëve të traditës, në përgjithësi janë përcaktuar nga historiografia jonë letrare. Hera herës ajo është përpjekur të krijojë edhe përfytyrime të përgjithshme për disa tipare dhe për rrugët e zhvillimit të tyre. Por po të përjashtojmë disa nga studimet e prof. Rexhep Qoses, sidomos veprën e tij «**Historia e letërsisë**

**shqipe — Romantizmi»,** botuar në Prishtinë më 1984, punimet e tjera, gjer tani të pakta, kanë synuar të përvijojnë veçoritë e ndonjë prej drejtimeve të letërsisë sonë, romantizmit në radhë të parë, që mbetet dukuria më e studiuar. Duke qenë punime të vogla, kumtesa e artikuj shkencorë, ato, natyrisht, kanë shtruar vetëm disa teza, në ndonjë rast të diskutueshme, të cilat do të prisnin të shtjelloheshin e të argumentoheshin më tej.

Drejtime të tjera të letërsisë sonë, sentimentalizmi e realizmi janë trajtuar më pak, shpesh në udhë e sipër, tek shqyrtohesin vepra të shkrimitarëve të veçantë ose probleme të tjera teorike. Sigurisht, realizmi ka tërhequr më shumë vëmendjen e studjuesve, po në ndonjë rast shfaqja e tij është identifikuar vetëm me zgjerimin e tematikës, sidomos të tematikës shoqërore, me thellimin e qëndrimeve demokratike dhe të fryshtes kritike të letërsisë së zhvilluar pas Shpalljes së Pavarësisë.

Në anën tjetër, studimet tona nuk janë marrë ende sa duhet me drejtimet letrare si dukuri têrësore, që i afrojnë krijimet e shkrimitarëve të ndryshëm dhe njëkohësisht vënë në dukje dallimet midis tyre; për pasojë ato nuk mund të merreshin me zbulimin e atyre shtresave të letërsisë së një periudhe, që janë vënë në themel të zhvillimeve të mëvonshme letrare. Ecuria e drejtimeve letrare, marrëdhëniet dhe ndryshimet që i karakterizojnë, po ashtu, vetëm sa janë përvijuar dhe nuk janë analizuar gjërësisht.

Kështu është vepruar edhe në tekstin «Historia e letërsisë shqiptare», botim i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë (1983), i cili nuk u kushton veçse disa paragrafe çështjeve të drejtimeve të shfaqura në udhët e zhvillimit të letërsisë shqipe të traditës.

Po s'mund të ndodhë ndryshe përdherisa na kanë munguar monografi të plota për autorët e letërsisë sonë. Edhe tani të tillë monografi për të gjithë ata nuk i kemi, po sidqoftë, shumë probleme të veprës së shkrimitarëve të veçantë janë sqaruar, duke krijuar kësisoj mundësitë për të shtruar çështje të një natyre më përgjithësuese, që synojnë të hedhin dritë mbi prirjet themelore të zhvillimit të proceseve letrare, të cilat bashkojnë ose ndajnë përfaqësuesit e tyre në drejtime të ndryshme.

Prandaj gjykuam se është detyrë e historiografisë sonë letrare të studiojë nga afër drejtimet e saj, vështruar si dukuri që kanë pasur tiparet e veta në lindjen, formimin e zhdukjen

e tyre. Sigurisht, problemet që dalin në studime të kësaj *natyre* janë të shumtë e mjaft të ndërlikuara; ato nuk mund të zgjidhen në mënyrë shterruese nga një monografi e vetme; për to duhet puna shumëvjeçare e historianëve të letërsisë shqiptare.

Drejtimet letrare, si rregull, kanë lindur në ato vende, ku proçeset e zhvillimeve shoqërore kanë mbartur prirje, të cilat po në atë periudhë në vende të tjera ose kanë qenë *embryonale*, ose nuk ishin njohur ende. Përhapja e tyre ka qenë një fenomen tepër i ndërlikuar, që nuk i përjashtonte ndikimet me një kahje, po edhe të ndërsjellta. Prandaj, për zbulimin e tipareve të përbashkëta të letërsisë së një vendi me dukuritë analoge të letërsisë së një ose disa vendeve të tjera, për të ndriçuar veçoritë origjinale të tyre, mund dhe duhen bërë krahasime. Por kjo metodë do përdorur me shumë kujdes, duke u nisur gjithnjë nga brendia e asaj letërsie, që është bërë objekt studimi, tiparet themelore të së cilës janë përpunuar si të tilla e jo ndryshe në varësi prej kushteve të caktuara historiko-shoqërore të vendit.

Nëse ndikimet që janë shfaqur me përhapjen e drejtimeve letrare nga një vend në tjetrin shndërrohen në të vetmin këndvështrim për studimin e tyre, nëse shtrirja **in extenso** e koncepteve e praktikave të caktuara artistike konsiderohet si vendimtare në historinë e letërsisë botërore, siç veprohet në shumë raste të studimeve komparativiste, atëhere me siguri do të merren nëpër këmbë e do të fshihen veçoritë kombëtare të letërsisë së një vendi, do të ngrihet kulti i të ashtuquajturave «letërsi të mëdha», dhe historia e letërsisë botërore do të kthehet në një grumbull modelesh dhe ndikimesh. Rolin vendimtar të kushteve historiko-shoqërore të secilit vend e provon fare mirë, veç të tjera, edhe fakti që një drejtim letrar, natyrisht me karakteristika të vetat, rishfaqet në një vend tjetër, kohë më vonë nga periudha kur lindi së pari. Kështu p.sh., romantizmi në Shqipëri në përgjithësi u zhvillua vite më pas nga periudha e lindjes dhe e lulëzimit të tij, pra, kur në letërsinë përparimtare europiane ishte konsoliduar drejtimi realist. Po kështu në historinë e letërsisë sonë, siç dihet, nuk u zhvillua klasizizmi, sepse ai nuk iu përgjegj prirjeve kryesore historike të shek. XIX. Në rast se shkrimitarët tanë të Rilindjes Kombëtare do të krijonin sipas frysës së klasicizmit, ata nuk do të pasqyronin dot problemet që u ushtronte koha, do të binin në një epigonizëm të thjeshtë, dhe do t'i bënin një shërbim të keq letërsisë e kulturës sonë në përgjithësi.

Zbulimi i tipareve që i afrouan e ndanë shkrimtarët e periudhës së Rilindjes Kombëtare dhe të viteve të Pavarësisë do të kryhet duke u nisur nga **brendia e veprave** më të rëndësishme të krijuara në atë kohë. Disa vepra kanë mbetur pa iu nënshtruar shqyrtimëve të veçanta, për arsyen se nuk janë njohur e studjuar sa duhet, se, megjithëqë u botuan, nuk ndikuan fort në jetën letrare e përgjithësisht shpirtërore të kohës; më në fund sepse nga pikëpamja e objektit të këtij studimi nuk sjellin të dhëna të reja që ngrenë peshë. Disa momente të veçanta të tyre, që janë theksuar tashmë nga historiografia letrare e që kanë të bëjnë me synimin shkencor të punimit, do të vihen në dukje, sipas rastit e rëndësisë, në kapitullin që do të merret me përfundimet e përgjithshme.

Punimi do t'ua kushtojë gjithë vëmendjen shkrimtarëve më me zë, talenteve më të fuqishme e të spikatura, autorëve që rrahin shtigje të panjohura e të palëvruara gjer atëherë, vepra e të cilëve mbarti në mënyrë më të qartë, të përqëndruar e nga shumë anë tendencat më të dukshme e më thelbësore të zhvillimit të letërsisë sonë. Ai do të trajtojë gjithash tu edhe dukuri të tjera që shkonin ndesh me prirjet përparimtare të saj.

Kjo sprovë nuk merr përsipër të realizojë analiza të plota të krijimtarisë së të qjithë shkrimtarëve e epokave historike që shqyrton. Një punë e tillë nuk mund të përballohej dhe, nga pikëpamja e argumentit të këtij studimi, aë do të syno jë kryesisht **sintezën**, nuk është as i nevojshëm. Ngjashmëritë në tematikë, në problemet e shtruara e në mënyrat e zgjidhjes së tyre, afër itë në pikëpamjet politike e qëndrimet botëkuptimore të autorëve etj., pra elementët që përbëjnë fryshtë e përgjithshme të veprave dhe krijojnë prerjen që na intereson, drejtimin letrar, do të jenë objekti kryesor i këtij studimi. I cili do të merret në një masë të caktuar, sa herë që është e domosdoshme, edhe me çështje të formës së praktikave krijuuese. Sigurisht, përkatësia e krijimtarisë së një shkrimtarit të viteve të Rilindjes e të periudhës që pasoi në drejtimet letrare nuk është asnjëherë e përcaktuar në mënyrë të prerë, ashtu siç nuk janë të prerë me thikë kufijtë midis mbarimit të një drejtimi e fillimit të drejtimit tjetër. Po kjo nuk do të thotë se relativiteti i përkatësisë dhe i kufijve e bën të pamundur dallimin e prirjeve të përgjithshme të veprës së një autori apo të krijimtarisë letrare të një periudhe; ai tregon në mënyrën e vet vështirësitë që duhen kapërcyer për shtjellimin e pro-

blemit, me tē cilin do tē merremi dhe, nga ana tjetër, dikton ndryshime nē metodën që do tē ndiqet nē punë e sipër.

Pjesa e parë e studimit, që do tē bëjë fjalë pér natyrën e letërsisë arbëreshe, do tē përpigjet tē ndriçojë disa karakteristika kryesore, që ndeshen thuaçse nē tē gjithë shkrimtarët më tē shquar tē saj. Kështu do tē veprohet edhe kur trajtohen dukuritë sentimentaliste e realiste tē letërsisë sonë. Pér disa përfaqësues tē tjerë tē periudhës së Rilindjes Kombëtare do tē ndalemi nē mënyrë tē veçantë pér dy arsyen: së pari, sepse, e krahasuar me poezinë arbëreshe, vepra e tyre i zgjeron motivet nē mënyrë tē dukshme dhe krijon kështu më shumë çështje që duan sqaruar; së dyti, sepse krijimtaria e disa prej poetëve tē asaj kohe, megjithëse përgjithësisht i është mbajtur një drejtimi, përmban njëherazi edhe prirje tē qarta që u takojnë drejtimeve tē tjera. Nga ana tjetër, romantizmi, që sundoi gjatë epokës së Rilindjes Kombëtare, vazhdoi tē shfaqej mjaft i gjallë, po natyrisht duke fituar tipare tē reja, nē veprën e disa autorëve tē viteve '20-'30. Në raste tē tjera, si tek Ndre Mjeda, përsëri do tē jetë e nevojshme tē ndalemi veçanërisht, pasi pér drejtimin letrar tē veprës së tij janë shfaqur pikëpamje që mund e duhet tē diskutohen.

Punimi që paraqesim mbetet, padyshim, një sprovë, e cila s'mund t'u shpëtojë mungesave e dobësive tē natyrave tē ndryshme. Po tē ketë arritur tē shtrojë disa çështje me tē vërtetë tē genësishme tē rrjedhave historiko-letrare e tē ketë mundur t'i zgjidhë ato, goftë edhe pjesërisht, ky studim shpre-sojmë se do tē sjellë ndihmesën e vet.

## **VËSHTRIM MBI PERIUDHAT HISTORIKE**

Një histori e letërsisë kërkon që rrrethanat politiko-shoqërore, në të cilat janë përfthuar etapat e saj më të rëndësishme, të përshkruhen në mënyrë të plotë, duke përfshirë në to shumë të dhëna edhe të karakterit ideologjik, historik, kulturor, letrar etj. Ndërsa në një studim, që ka si qëllim të tregojë se në ç'drejtime u grupuan veprat letrare në periudhat e dhëna historike, do ngulur këmbë më fort në pasqyrimin e prirjeve kryesore të zhvillimit politik e shoqëror, mbi bazën e të cilave u shfaqën disa tipare të përbashkëta të brendisë së krijimeve letrare të kohës, u përpunuani qëndrime të afërtë ideologjike e estetike në vlerësimin e ngjarjeve e të njerëzve dhe sollën, nga ana e tyre, ngjashmëri në mënyrat e pasqyrimit artistik të realitetit.

Mospërpushja relative që vihet re shpesh midis kufijve kohorë të epokave historike dhe periudhave të zhvillimit të drejtimeve letrare është e natyrshme, madje e pritur; ajo nuk

Borgjezia tregtare ishte më e fuqishme, po gjithnjë për shkak të interesave të saj ekonomike, nuk donte të hynte në konflikt të hapët me regjinin feudal turk. Kontradiktat me të ajo kërkonte t'i zgjidhte me kompromise<sup>1</sup>, që synonin të mënjanonin gjendjet shpërthyese revolucionare. Borgjezia e mesme tregtare dhe zejtare nxori përfaqësuesit më të shquar revolucionarë, që u vunë në udhëheqje të Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare. Me ideologët e vet ajo shprehu më mirë se çdo shtresë tjetër shoqërore edhe interesat e masave të gjera popullore; ajo përpunoit platformën politike të lëvizjes.

Qëndrimi i feudalëve ndryshonte në përputhje me interesat politike që krijuar në ato kohë. Shtresa e pronarëve të mëdhenj feudalë, për nga vetë natyra e saj klasore, ishte e lidhur me shumë fije me pushtuesin e huaj dhe nuk e donte shkëputjen nga perandoria osmane; përfaqësues të saj të vencantë, të lidhur më fort me tregun, kërkonin shumë-shumë realizimin e disa reformave modernizuese, të cilat do të lehtësonin e do të nxisin veprimtarinë ekonomike. Rreziqet imediate të copëtimit të Shqipërisë, që domosdo preknin interesat e tyre, i nxisin hera-herës çifligarët dhe tregtarët e mëdhenj të bashkoheshin me Lëvizjen e Rilindjes; madje në sajë të fuqisë së tyre ekonomike dhe të ndikimit që ushtronin ende në shtresat e fshatarësisë, ata merrnin në duar edhe drejtimin e saj. Ashtu siç qe, e paformuar si duhet, heterogjene, dhe, në një pjesë të saj, e ardhur nga deklasimi i shtresave të caktuara të feudalëve, borgjezia shqiptare, nuk ishte në gjendje të dilte hegjemonë në krye të Rilindjes.

Në përgjithësi, në vitet e Rilindjes kontradiktat midis fshatarësisë e feudalizmit, midis këtij e borgjezisë mbetën në rrafsh të dytë. Po në thelbin e vet, Lëvizja e Rilindjes përmبante edhe një kahje të qartë antifeudale. Shumë shtresa të feudalëve shqiptarë, në një mënyrë a në një tjetër, përbënën mbështetjen shoqërore të pushtimit të huaj. Duke e luftuar këtë pushtim, ishte e natyrshme që Lëvizja e Rilindjes binte ndesh edhe me feudalizmin. Rilindësit ishin për një Shqipëri republikane, borgjeze e demokratike. Megjithëse në programin politik të Rilindjes nuk u shtrua çështja agrare, masa fshatare hera-herës i drejtoi armët edhe kundër feudalëve, sidomos kur bashkëpunimi i tyre me pushtuesit bëhej i hapët. Përfaqësuesit më përparimtarë të Rilindjes e kuptuan se feudalizmi ishte një forcë sociale regresive; Shqipërinë e ardhshme ata

1) Historia e Shqipërisë, V. II, Tiranë 1984, fq. 103,

e përfytyronin pa feudalët, si një shtet që në shumë anë do të krijonte mundësi pér një jetë më të mirë pér popullin, tek i cili shihnin, sidomos në periudhën e fundit të Lëvizjes, forcën vendimtare pér triumfin e lirisë e të pavarësisë së atdheut.

Duke synuar krijimin e shtetit shqiptar, që do të përfshinte të gjitha trojet e banuara historikisht prej shqiptarëve, Lëvizja e Rilindjes kërkonte një ndryshim të thellë, një përbërje revolucionare në statusin politik të atdheut, që në ato kohëra ishte një provincë e perandorisë osmane. Rilindja vlerësonë drejt rrezikun e madh që përbën pér tërësinë tokësore të Shqipërisë shtetet shoviniste fqinje, si dhe fuqitë e mëdha evropiane, që qëndronin pas tyre. Ajo iu kundërvu me guxim këtij rreziku duke fituar, në luftë e sipër, një karakter të qartë jo vetëm antiosman, po edhe antiimperialist e antishovinist. Me këto qëndrime, me ngjarjet e saj të mëdha historike, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, kryengritjet e viteve 1910-1912 që përfshinë gjithë vendin, Lëvizja e Rilindjes krijoj situata të thella revolucionare, të cilat shpunë në Shpalljen e Pavarësisë.

Rilindësit tanë ishin, siç i përcakton shoku Enver Hoxha, «... një plejadë e tërë njerëzish të shquar të mendimit përparrimit shqiptar dhe të aksionit, njerëz me aftësi të një organizimi të përsosur luftarak, politik, propagandistik, ideologjik dhe diplomatik»<sup>1</sup>.

Ata e kuptuan se një nga shkaqet e gjendjes shumë të vështirë të vendit, ishte prapambetja e thellë kulturore e ideologjike e masave të gjera të popullit. Prandaj ata ia hynë punës pér përpunimin e mendimit të ri shqiptar, që kishte në themel idetë iluministe. Po do theksuar fort, se këto ide nuk vinin në vendin tonë si një jehonë e largët e iluminizmit francez, të njobur e të studiuar thellë nga rilindësit tanë. Sigurisht, prej kësaj ideologjie ata mësuan, po ditën njëkohësisht të përpunonin në mënyrë origjinale ato pikëpamje, që u shërbenin çështjes kombëtare dhe emancipimit të popullit. Prandaj iluminizmi ynë fitoi thekse të veçanta vetjakë, që kishin të bënin në radhë të parë me argumentimin e plotë e të gjithanshëm të idesë atdhetare, të domosdoshmërisë historiko-politike pér krijimin e shtetit të pavarur shqiptar.

Rilindësit e kuptonin thellë se çështja fetare ishte mjaft komplekse, se politika e identifikimit të kombit me fenë që ndiqnin Porta e Lartë, Patrikana e Stambollit dhe armiqjtë e tjerë të Shqipërisë, të mbështetur edhe nga qarqe të caktuara

1) Enver Hoxha, **Për shkencën**, II, Tiranë 1985, fq. 163.

borgjeze e feudale, grekomanësh e turkomanësh, përbënte një rrezik serioz për lëvizjen kombëtare. Për mënjanimin e këtij rreziku rilindësit tanë ndoqën rrugën më të drejtë. Ato nuk menduan kurrë të shfrytëzonin antagonizmin fetar të shqiptarëve të krishterë ndaj turqve osmanë. Një politikë e tillë, në kushtet e Shqipërisë në shek. XIX, do të ishte me pasoja tepër të rënda pér bashkimin e të gjithë shqiptarëve, shumicën e të cilëve pushtuesi osman, me kohë, kishte arritur ta kthente në fenë e vet. Prandaj rilindësit u kapën fort pas konceptit të shqiptarisë, që duhej të qëndronte mbi të gjitha fetë, luftuan ashpér kundër identifikimit të kombit me fenë, duke kritikuar njëkohësisht, mbi baza iluministe, dogmën fetare të të gjitha llojeve. Në pozitat e ateizmit ata në përgjithësi nuk arriten dot, po fanatizmin fetar e goditën ashpér, duke e konsideruar si një nga armiqtë më të rrezikshëm të çështjes kombëtare. Për suksesin e luftës që ndërmorën kundër përçarjes fetare, rilindësit u ndihmuani shumë nga fakti që ndjenja fetare e shqiptarëve, historikisht nuk kishte qenë fort e ngulitur dhe kurrë nuk kish arritur të errësonë ndërgjegjen e kombësisë. Në rrëthanat ideologjike të lëvizjes pér çlirimin kombëtar, rilindësit hodhën parullën më të drejtë që kërkonin ato vite: «Feja e shqiptarit është shqiptaria»; ajo kishte një brendi shumë të qartë atdhetare. Rilindësit shihnin të evokimi i historisë së shqiptarëve një nga mënyrat më të përshtatshme pér afirmimin e mëvetësisë së kombit shqiptar. Kur propaganda intensive e armiqve të shumtë të Shqipërisë e shtrembëronte keqas historinë, me synimin që të «argumentonte» se shqiptarët «nuk kishin» një të kaluar të tyre, se atyre u «mungonin» traditat nacionalë, se «qenë të ardhur» në këto troje, etj., rilindësit zbuluan me forcë të veçantë periudhat e shkuara të jetës së bashkatdhatarëve, duke u nisur nga lashtësítë pellazgjike-ilire pér t'u ndalur në mënyrë të veçantë në epokën famëmadhe të Gjergj Kastriotit. Në ato vite kthimi në histori ishte, në radhë të parë, një nevojë e domosdoshme e jetës politike; ai tregonte autohtoninë e shqiptarëve në tokat ku rronin, vitalitetin dhe aftësitetin e tyre pér të ngritur e mbrojtur shtetin kombëtar. Historia u shërbente rilindësve pér të theksuar gjithashtu, se gjendja e Shqipërisë ishte e imponuar nga një pushtim i gjatë e i egër, se shqiptarët po kallonin kohën më të rëndë të jetës së tyre, që nuk duhej të lejohej më. Më në fund historia, sidomos epoka e Skënderbeut, u shërbente rilindësve pér t'u dhënë bashkatdhatarëve një shembull të ndritur të mundësive të tyre realizuese në luftën

liridashëse, për krijimin e shtetit të pavarur, që do të arrihej medoemos po të sigurohej bashkimi politik midis tyre. Të parët e shqiptarëve, në kushte të vështira për ta, nën udhëheqjen e Skënderbeut e kishin realizuar këtë bashkim; përtërëtja e tij, në rrethana të tjera, konsiderohej me të drejtë nga rilindësit si një kusht i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve politike të Lëvizjes Kombëtare.

\* \* \*

Në të tilla rrethana ishte krejt e natyrshme, qëjeta shpirtërore e vendit të karakterizohej nga pakënaqësia e thellëndaj pushtimit turk e prapambetjes së madhe të shkaktuar prej tij, nga ëndërrimi për ta parë të lirë atdheun sa më shpejt që të ishte e mundur, për të krijuar një botë të re shqiptare, të përparuar e demokratike. Për mendimin rilindës, që u krijuar si kundërvënie e fuqishme ndaj ideologjisë obskurantiste të imponuar nga pushtimi i gjatë dhe nga institucionet e feve të ndryshme, realiteti politik shqiptar i atyre viteve duhej të zhdukej medoemos, për t'ia lënë vendin krijimit të shtetit të pavarur në trojet e banuara prej shqiptarëve që prej kohërave më të lashta. Mënyra e athershme e jetesës, thellësish e prapambetur në shumë anë të saj, duhej të flakej në emër të një jetese të emancipuar në çdo pikëpamje, të lirisë së personalitetit e luftës kundër paragjykimeve, në emër të krijimit të një njeriu të ri, atdhetar të flaktë në radhë të parë, po edhe me një botë të pasur shpirtërore me të gjitha virtytet, të aftë të ndjejë e të kuptojë bukurinë kudo ku ajo shfaqej, në natyrën e atdheut, në dashuri e sidomos te puna e palodhur, gurra e të gjitha të mirave materiale e shpirtërore. Premisat e një jete të tillë mendimi rilindës i gjente të gjalla te shqiptari i thjeshtë, në historinë e tij shumëshekulllore, prej nga buronte një frysë e qartë optimizmi, bindja e patundur se fitorja e lirisë ishte e afërt. Sigurisht, nota të zhgënjamit nuk munguan të shfaqeshin, ato kishin shkaqet e tyre, po ndërkad, nuk u bënë kurrë sunduese, madje edhe në ato raste kur flitej për çastet më tragjike të historisë e të realitetit shqiptar. Jetës shpirtërore të epokës së Rilindjes i duhej medoemos të frymëzohej nga besimi iluminist për mundësitet e plota të krijimit të një bote të re shqiptare, karakteri racional i së cilës

do të shfaqej së pari në fitoren e lirisë kombëtare. Realizimi i saj kërkonte prej shqiptarëve atdhetarizëm të zjarrtë, bindje të thellë në domosdoshmërinë e luftës kryengritëse, harrimin e vvetveta, flakjen e çdo lloj egoizmi.

Këto tipare të mendimit përparimtar përpunuani në letërsinë e atyre kohërave\*, siç do të mundohemi të provojmë, një brendi të qartë romantike, me karakteristika po aq të qarta origjinale. Gjatë epokës së Rilindjes, letërsia për shumë arsyesh ishte fusha më e zhvilluar e jetës shpirtërore. Rilindësit shihnin në të mjetin më të përshtatshëm për transmetimin e mendimit të përparuar tek shtresat popullore. Ata e kthyen poezinë e krijuar prej tyre, sigurisht pa e instrumentalizuar, në një tribunë të vërtetë, që ndikonte thellë në gjendjen shpirtërore të kohës.

Në letërsi u trajtua në radhë të parë problemi kombëtar, e lidhur ngushtë me të, edhe shumë çështje historike, filozofike, etike, për të arritur në vitet e fundit të Rilindjes në përpjekjet që të pasqyroheshin diferencimet sociale e rrjetdhojat e tyre në mendësinë e klasave të ndryshme shoqërore.

\* \* \*

Sundimi shumëshekullor e kishte lënë Shqipërinë në një prapambetje të thellë ekonomike e kulturore, e cila vështirë-

---

\*) Për shkak të prapambetjes së madhe të vendit, kolonitë shqiptare jashtë atdheut, siç dihet, luajtën një rol të pazakontë për botimin e veprave të romantizmit tonë. Rol i veprimitarisë së kolonive ka qenë i ndjeshëm edhe për zhvillimin e shumë drejtimeve të tjera të jetës intelektuale shqiptare. Po megjithatë këto vepra nuk mund ta siguronin mbijetesën e tyre pa auditorin që u krijuat për to në Shqipëri. Nga kjo anë, siç do ta vemi në dukje edhe më poshtë, letërsia arbëreshe ishte mjaft e kufizuar për shkak të gjuhës së saj arkaike.

Që një vepër të arrijë të mbijetojë duhet të tërheqë vazhdimisht lexues të shumtë të shtresave të ndryshme shoqërore. Këtë kusht të domosdoshëm, krijimtarisë së Naimit e poetëve të tjerë rilindës, nuk mund t'ia plotësonin në shkallën e duhur shqiptarët e kolonive, por brezat e shqiptarëve që në kohën e botimit të saj, jetuan në trojet e tyre. Këtë kusht vazhdojnë ta realizojnë lexuesi i Shqipërisë së sotme dhe bashkëatdhetarët e tij patriotë kudo që jetojnë.

sonte mjaft plotësimin e detyrave imediate që duhej të përballonte në ato kohë të para shteti i ri e i brishtë shqiptar. Nga motet e turbullta 1912-1920, trojet shqiptare, megjithë sakrifcat e shumta të popullit, dolën të gjyntuara për shkak të politikës imperialiste të Fuqive të Mëdha. Pas shumë tallazesh, në Kongresin e Lushnjes, nëpërmjet një akti kushtetues, u përcaktua sovraniteti i plotë i shtetit shqiptar dhe u krijuan organet e tij të larta.

Në vitet që erdhën më pas (1921-1924), shoqëria shqiptare u ndesh me probleme të tjera, të njoitura edhe më parë, po ende të pashtuara për zgjidhje, për shkak të rrethanave politike që vazhdonin të mbanin në plan të parë luftën përmbrojtjen e tërësisë tokësore të vendit. Si u vendosën përfundimisht kufijtë e u krijuat shteti shqiptar, u ashpërsuan më shumë e dolën në pah kontradiktat ekonomiko-shqërrore, u krijuan grupime politike që mbajtën qëndrime të kundërtë ndaj çështjes së demokratizimit të jetës sociale.

Pas Shpalljes së Pavarësisë, dalngadalë nisi të copëzohej prona cifligare dhe, për pasojë, klasa e latifondistëve cifligarë po dobësohej. Sigurisht, bejlerët edhe pas rënies së fuqisë së tyre ekonomike vazhduan të bënин pjesë në klasat sunduese të vendit, po nuk imponoheshin dot më vëçse si një kastë nëpunësish spekulatorë, që u bënин hosana autoriteteve shtetërore. Edhe tregtarët e mëdhej humbën monopolin e tregtisë së jashtme dhe, ose ranë në pozitat e bejlerëve, ose investonin kapitalet e tyre në prodhimin industrial, që njohu në ato kohëra një farë zhvillimi dhe shpuri në rritjen e forcimin e borgjezisë industriale. Kjo e fundit e ndjente se penëgohej fort në zhvillimin e saj prej synimeve të bejlerëve, rreshperëve e nëpunësve të lartë, që, nëpërmjet grupit reaksionar të A. Zogut, përpinqeshin të vendosnin një regjim diktature të ngritur mbi bazën e institucioneve juridike turke.

Protestat dhe përpjekjet e armatosura të fshatarësisë kundër shfrytëzimit të egër të cifligarëve, kërkesat e tyre përzgjidhjen e çështjes së pronësisë mbi tokën, rritja e lëvizjes së klasës punëtore, e cila, megjithëse ishte ende e vogël dhe heterogjene në përbërjen e saj, hyri në luftën greviste kundër shfrytëzimit kapitalist, të gjitha këto, bashkë me intensifikimin e lëvizjes për demokratizimin e organeve shtetërore si dhe krijimin e organizatave demokratike, shpunë në vitet 1921-1924 në thellimin e krizës shoqërrore, që solli fitoren e revolucionit demokratiko-borgjez dhe përbysjen e cifligarëve nga pushteti politik.

LIBROTEKA E BRETHIT

ANTRAKASTRI

NR. 44026

Thellësisht e interesuar për t'u çiruar nga shfrytëzimi i çifligarëve, fshatarësia ishte forca kryesore lëvizëse e këtij revolucioni, i cili u udhëhoq nga borgjezia demokratike shqiptare; klasa, që nga pikëpamja politike, mbetej më e përgatitura. Në krye të saj ishin intelektualë borgjezë përparimtarë si Fan S. Noli, i cili u bë kryeministër i qeverisë së dalë nga revolucioni, si edhe patriotë demokratë e revolucionarë si Bajram Curri, Avni Rustemi, Halim Xhelio etj.

Revolucioni i Qershoret ishte një lëvizje e gjerë popullore që përfshiu të gjithë vendin, e drejtar kundër sundimit reaksionar të çifligarëve dhe mbeturinave feudale; ajo luftoi me armë në dörë për transformime demokratike në jetën shoqërore të kohës.

Po megjithë përkrahjen e fuqishme të masave të gjera popullore, Revolucioni i Qershoret u shtyp. Forcave demokratike u mungonte uniteti dhe përvaja e duhur, u mungonte vendosmëria për të luftuar fort çifligarët e për t'iu kundërvënë ashpër përfaqësuesve të bejlerëve liberalë e borgjezëve konservatorë, të cilët u bashkuan përkohësisht me revolucionin të nxitur nga interesa të ngushta politike, po tradhtuan shpejt qëllimet e tij dhe u hodhën në krahët e reaksionit. Shumë nga drejtuesit e revolucionit, vetë F. Noli, vepruan me lëkundje të madhe, nuk realizuan me konsekuençë programin antifeudal, shkaktuan zhgënjime të thella në masën e fshatarësise, humbën domosdo mbështetjen e tyre dhe lejuan kështu të krijohen mundësítë për ndërhyrje nga jashtë, për fitoren e forcave kundërrevolucionare, që sollën në fuqi regjimin reaksionar të A. Zogut. Për ta lehtësuar sundimin e vet, ky regjim i bëri disa lëshime borgjezisë kombëtare, shpalli disa ligje financiare që ia lehtësuan fitimet, rritën fuqinë e saj ekonomike dhe e kthyen atë, së bashku me çifligarët e bajraktarët, në mbështetjen kryesore shoqërore të monarkisë zogiste.

Ai zhvillim industrial që njoju vendi në vitet '20-'30, sado i kufizuar që ishte, i dha shkas rritjes së klasës punëtore, në të cilën bënin pjesë shumë fshatarë, zejtarë e tregtarë të vegjël të proletarizuar. Rrënim i vazhdueshëm i shtresave të mikroborgjezisë së qytetit, në kushtet e krizës ekonomike dhe të depërtimit gjithnjë e më të madh të kapitalit të huaj, i armiqësonte ato me regjimin e Zogut dhe i largonte nga ndikimi i borgjezisë. Përmes luhatjeve të tyre të zakonshme, këto shtresa anonin nga klasa puntore.

Shfrytëzimi i egër, varfërimi i përgjithshëm i vendit, rritja e qëndresës popullore, të gjitha këto lanë gjurmë në zhvillimin

ideologjik e politik të klasës punëtore. Në vitet '20 lëvizja punëtore mbetej ende spontane, ajo kishte nevojë të domosdoshme krijimin e një organizate revolucionare që do të vihej në udhëheqje të saj. Shkëndijat e para u shfaqën në fund të këtyre viteve, kur në Korçë u arrit të krijohej Grupi Komunist (1929), i përbërë nga disa celula. Gjatë viteve '30 u shtuan grevat e punëtorëve, u zgjerua lufta e tyre kundër punëdhënësve kapitalistë. Për të kapërcyer shkëputjen që vihej re midis lëvizjes punëtore, që sa vinte e rritej, dhe lëvizjes komuniste, ndikoi mjaft veprimtaria e Ali Kelmendit, i cili udhëzonte në ato kohëra komunistët të hynin e të thellonin punën e tyre në radhët e klasës punëtore, për formimin e saj me idetë revolucionare, për ta bërë të ndërgjegjshme për rolin që i takonte të luante në jetën shoqërore. Të viteve '30 janë shoqërítë punëtore të organizuara nga komunistët, të cilët me rritjen e veprimtarisë antizogiste e antifashiste, zgjeronin lidhjet midis tyre, krijonin celula e grupe të tjera komuniste dhe përpinqeshin për edukimin politik të njerëzve përparimtarë, punëtorë e fshatarë. Komunistët përbënin krahun revolucionar të lëvizjes së Fierit. Ata vërtet nuk arriten t'i jepnin asaj një program të qartë politik, po megjithatë treguan se përfaqësonin forcën politike më aktive të vendit<sup>1)</sup>. Ndërkaq opozita borgjeze antizogiste ishte e paftë të ndërmerrte veprime të organizuara kundër regjimit.

Megjithë reaksionin e egër zogist, lufta e klasës punëtore për të fituar të drejtat e saj nuk pushoi, përkundrazi, ajo erdhë duke u dendësuar, e mbështetur gjithnjë e më fort në lëvizjen komuniste, përpara së cilës dilte si detyrë themelore të shtrihej më tej në të gjithë vendin, të zgjeronte bashkëveprimin midis organizatave. Kësaj detyre iu përgjigj Grupi Komunist i Korçës, ku, që nga viti 1936, vepronte shoku Enver Hoxha. Kur rreziku fashist ishte bërë imediat, Grupi Komunist i Korçës punoi për të ngritur popullin në luftë për demokracinë kundër imperialistëve dhe sidomos kundër fashizmit italian, që përbënte rrezikun e drejtpërdrejtë për pavarsinë e Shqipërisë.

\* \* \*

Qëndrimet e klasave të ndryshme ndaj problemeve të shumta të jetës shoqërore dhe lufta midis tyre u pasqyruan

1) Historia e Shqipërisë, vell. III, Tirana 1984, fq. 382.

në rrymat ideologjike që shprehën pikëpamjet e veta në shtypin e kohës.<sup>1</sup> Rryma zogiste, me përfaqësuesit e saj të mbiqajtur «të vjetrit», mbronte me zell monarkinë, luftonte ashpër kundër pikëpamjeve demokratike e komuniste, kundër zhvillimit të arsimit e kulturës, duke parë në to rreziqe për rendin ekzistues.

Të ashtuquajturit «të rinj» ishin për «oksidentalizimin» e vendit, për disa reforma në të mirë të borgjezisë, të cilat nuk do të prekin thelbin e regjimit zogist. Të pakënaqur nga «të vjetrit», «baballarët e kombit», ata kérkonin që në drejtim të shtetit të vinin përfaqësues «të kulturuar» të borgjezisë. Nën shembullin e fashizmit, «të rinjtë» kérkonin një «diktaturë të ndritur», që sipas tyre do të forconte unitetin kombëtar, në emër të të cilit ata i kundërviheshin luftës së klasave dhe mendimit revolucionar. «Oksidentalizimin» e vendit e kérkonte edhe rryma e «neoshqiptarizmës». E mbështetur në filozofinë e O. Kontit, E. Durhamit, F. Niçes etj., «neoshqiptarizma» pretendonte që shoqëria shqiptare të zhvillohej nëpërmjet përpunimit e përhapjes së një sistemi kulturor edukativ, që do të realizonte një «rend kolektiv» të «solidaritetit shoqëror». Për «neoshqiptarizmën», ndryshimet në shoqëri duhej të vinin jo nga krijimi i raporteve të reja ekonomiko-shoqërore, jo nëpërmjet dhunës, të cilën ata e mohonin, po përmes studimit e ndryshimit të koncepteve e mendësive. Me këto pikpamje përfaqësuesit e «neoshqiptarizmës» luftonin kundër lëvizjes e ideve komuniste, të cilat i quanin të panatyrrshëm për psikologjinë e shqiptarëve.

Rryma klerikaliste, sidomos ajo katolike, që ndër më aktivet e më të egrat në luftën kundër pikëpamjeve demokratike e komuniste. Duke e veshur veten me petkun e bartësit të vlerave nacionale, kleri katolik ishte në fakt kozmopolit, vinte fenë mbi kombin, ishte për një shtet teokratik, kundër çdo përparimi që, sipas tij, nuk durohej dot prej formimit psikik të shqiptarëve. Kleri katolik himnizonte primitivizmin, mbronte pronën private, të cilën e quante «hyjnore», luftonte me të gjitha mënyrat lëvizjen revolucionare. Hera-herës kleri katolik mbante «qëndrime kritike» ndaj rendit zogist, që diktoheshin nga koniunkturat e krijuara në marrëdhëniet e regjimit me Italinë fashiste, së cilës i shërbente. Edhe klerikët e feve të tjera mbrojtën rendin në fuqi dhe luftuan ashpër kundër të gjitha pikëpamjeve përparimtare.

---

1) Më hollësishët shih: Viron Koka, **Rrymat e mendimit politiko-shoqëror në Shqipëri** në vitet "30 të shek. XX, Tiranë 1985.

Komunistët dhe elementët e tjerë përparimtarë i shprehën pikëpamjet e tyre në organet «Bota e Re», «ABC», «Rilindja», natyrisht në atë masë që lejonte censura zogiste. Komiteti i Çlirimit Nacional botonte jashtë vendit gazeten «Liria Kombëtare», ndërsa grupi i komunistëve shqiptarë të Lionit nxirrte gazeten «Populli».

Mendimi përparimtar që batohej në këto organe, sidomos në revistën «Bota e Re», i kushtoi vëmendje të veçantë kritikës kundër pikëpamjeve antidemokratike e qëndrimeve intelektualiste borgjeze, luftës ndaj prirjeve fashiste e botëkuptimore fetare-klerikaliste.

Komunistët e njerëzit përparimtarë ngrinin probleme jetike të shoqërisë shqiptare të atyre viteve, luftonin kundër mbeturinave të theksuara feudalë dhe tregonin mjerimin e rëndë të masave të popullit, argumentonin nevojën e zhvillimit kulturor të vendit, të emancipimit të gruas etj. Ata demaskonin shfrytëzimin kapitalist, fajdexhinjtë parazitarë, shprehnin simpati të thella demokratike në polemikë të ashpër me pikëpamjet e intelektualëve zogistë «neoshqiptarë», që përbuznin popullin. Në luftë me ta e me ihtarët e «diktaturës së ndritur», komunistët përhapnin tezat marksiste mbi rolin e madh që luajnjë idetë përparimtare, kur ato përvetësohen nga populli, që e bën vetë historinë e tij. Në mënyrë të tërthortë mendimi përparimtar fliste pér një botë e jetë tjetër, të cilat ndonëse nuk përfytyroshin qartë, do të ngriheshin mbi bazën e një shoqërie pa klasa shfrytëzuese, ku punëtorët e fshatarët do të jetonin në mirëqenie, me nivel të lartë kulturor dhe arsimor. Çështja si do të krijohej kjo shoqëri, nuk u shtrua hapur pér shumë arsyë, po pér mendimin përparimtar ishte e qartë se ajo nuk do të realizohej nga një grusht intelektualësh që do të oksidentalizonin vendin, as nga «diktatura e ndritur», «mëshira hyjnore», nënshtimi e moskundërshtimi. Krijimi i rendit demokratik popullor kërkonte përmbysjen shoqërore, revoltën, kryengritjen.

Sidoqë nuk u shtjellua në mënyrë të plotë, kjo pikëpamje, si dhe të gjitha qëndrimet e tjera të rrëymës demokratike revolucionare ndikuani gjallërisht në botëkuptimin e të rinjve dhe intelektualëve demokratë, të shkrimtarëve përparimtarë që krijuan në ato vite.

\* \* \*

Qëndrimet e kundërta politike, shoqërore e filozofike që shfaqeshin në jetën shpirtërore të viteve 1912-1939, bëheshin shkas që në letërsi të lindnin drejtime të reja letrare. Romantizmi përparimtar fitonte të tjera tipare; në themel të tij qëndronte pikëpamja se realiteti ekzistues ishte thellësish i padrejtë, antinjerëzor e si i tillë duhej të luftohej pa mëshirë. Krahas krijimtarisë realiste, në vitet '30 romantizmi përparimtar shprehte prirjet revolucionare të kohës.

Polarizimi i romantizmit në dy kahje të kundërta, që kishte nisur të dukej në vitet e fundit të Rilindjes, thellohet në mënyrë të ndjeshme. Romantizmi reaksionar fitonte terren në përpjekjet që bënte borgjezia dhe kleri për të krijuar iluzionin se rendi i vendosur i shkonte për shtat psikologjisë shqiptare dhe mbi bazën e tij mund të ndërmerrreshin reforma që do të oksidentalizonin vendin, synimi i fundit i pikëpamjeve të tyre politike.

Romantizmi njohu edhe zhvillime të tjera; parnasi e simbolizmi, në ato përmasa që u shfaqën, i dhanë trajtë një tendencë formaliste, e cila i kishte burimet në mendësitë mikroborgjeze e në ndikimet që depërtonin në letërsinë e kohës.

Në rrethanat politiko-shoqërore e në përgjithësi të jetës shpirtërore të kohës, shfaqja e drejimit sentimental në praktikat e krijimtarisë letrare, siç do të përpinqemi të provojmë, ishte një dukuri e përligjur në të gjitha pikëpamjet. Me traditat demokratike të romantizmit rilindas sentimentalizmi ushqeu në mënyrën e vet zhvillimet realiste, të cilat vinin duke u theksuar, sidomos në prozë dhe krijonin prirjen më përparimtare të letërsisë së atyre viteve; ajo vërtet nuk arrinte të konsolidohej plotësisht, po e saturuar me notat e romantizmit revolucionar, të shfaqura qartë në krijimtarinë e shkrimtarëve të rinj të viteve '30 nën ndikimin e ideve komuniste, përvijonte rrugët e zhvillimit të ardhshëm të letërsisë.

**ZHVILLIMET ROMANTIKE  
NË HISTORINE E LETERSISE  
SHQIPE**

Fillimet e letërsisë së re artistike shqiptare janë në krijimtarinë e Jeronim de Radës, që botoi në vitin 1836 një kryevepër, poemën «**Këngët e Milosaos**». Ajo dhe krijimet e tjera të De Radës, Darës, Serembes e shkrimtarëve të tjerë, përbëjnë një nga shfaqjet kryesore të lëvizjes arbëreshë të Rilindjes sonë Kombëtare, e cila dha kontributë të ndjeshme edhe në rrafshin politik e kulturor-shkencor. Nivelet e ritmet më të larta të zhvillimit të Italisë, qoftë edhe të Jugut të saj, në krahësim me prapambetjen e thellë ku e kishte hedhur Shqipërinë pushtimi i gjatë i huaj, takimet më të hershme të arbëreshëve me idetë iluministe, pjesëmarrja e tyre e gjerë në Rizorxhimenton italiane dhe, sidomos, jehona e ngjarjeve politike në Shqipëri, ndaj të cilave arbëreshët ishin shumë të ndjeshëm, këto ishin shkaqet që bënë të mundur lindjen e një krijimtarie të pasur letrare, e cila i pati rrënjet e veta në mallin e zjarrtë pér trojet e të parëve, në përpjekjet e shumanshme pér ta parë një ditë të lirë atdheun e lashtë, në këmbënguljen e admirueshme pér ruajtjen e gjuhës, të këngëve e dokeve të trashëguara nga shekujt.

Të gjitha fushat e veprimtarisë së arbëreshëve në të mirë të çështjes kombëtare kishin tipare të përbashkëta me punën që bënин atdhetarët rilindës në Shqipëri e në kolonitë shqiptare të vendeve të tjera. Ata dhanë ndihmesa të vyera në përpunimin e qëndrimeve politike të lëvizjes së Rilindjes, në studimet mbi historinë e gjuhën e popullit shqiptar, në zhvillimin e folkloristikës e të gazetarisë shqipe etj.

Veprimitaria e arbëreshëve të Italisë shprehu në të gjitha mënyrat e mundshme domosdoshmërinë historike që kish nisur të realizonte Shqipëria e atyre viteve, luftën e shumanshme pér arritjen e pavarësisë kombëtare.

Kjo tendencë politike dhe pasojat ideologjike e psikologjike që rridhnin prej saj e prej statusit të veçantë nacional të arbëreshëve, më në fund, prej gjendjes së tyre social-ekonomike në shoqërinë italiane, përcaktuan brendinë e poezisë që ata krijuan, e cila, në ato rrethana, nuk mund të ndiqte udhë të tjera, veç atyre të drejtimit romantik\*.

\*) Megjithëse u njoh nga shumë rilindës të shquar, krijimtaria poetike e arbëreshëve, pér disa arsyen nuk u përhap shumë në Shqipëri. E privuar edhe nga mundësitë pér të hedhur bazat e gjuhës letra kombëtare, sidoqë më e hershme dhe e kultivuar nga talente të fuq objektivisht nuk mund të themelonte letërsinë e re shqiptar tyre shumë komplekse e kreua vepra e Naim Frashërit.

## «MOTI I MADH» DHE EVOKIMI I TIJ NË LETËR- SINË ARBËRESHE

Në një pikëpamje, vepra e Jeronim De Radës dhe e Gavril Darës së Ri është pasqyrimi poetik i historisë tragjike të Shqipërisë, sidomos i historisë së «Motit të madh», siç e quanin arbëreshët shekullin XV. Ideja e fuqishme atdhetare e asaj vepre shfaqet pikërisht në evokimin e jetës shqiptare të këtij shekulli, të luftërave famëmëdha të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit në mbrojtje të lirisë së atdheut. Pothuajse të gjitha poemat e De Radës, poema e Darës së Ri dhe krijime të autorëve të tjerë arbëreshë, këtë temë trajtojnë. Të shohësh në këtë prirje tematike të letërsisë arbëreshe vetëm qëndrimin e njohur të romantikëve, të cilët në përgjithësi adhuronin dhe rikrijonin në veprat e tyre historinë e popujve, sidomos mesjetën, kjo nuk do të ishte aspak e mjaftueshme. Po nga se vinte kjo këmbëngulje në trajtimin e temës historike prej poetëve arbëreshë? Në fund të fundit, a nuk mund ta shprehnin qëndrimin e tyre atdhetar edhe përmes aktualizimit të tematikës, siç bëri në të vërtetë Serembja? Natyrishq që ata mund të shpreheshin edhe nëpërmjet një tematike më aktuale, po, me sa duket, De Rada me shokë niseshin nga bindja se evokimi i së kaluarës së popullit të tyre ishte mënyra më e mirë për afirmimin e të drejtës që ai kishte për të jetuar i lirë. Dhe duhet thënë se e kishin drejt. Një histori si ajo e bashkëatdhetarëve të tyre, thellësisht tragjike, ishte jetëshkrimi i një populli që megjithatë, kishte mundur të mbijetonë. Ata ngulnin këmbë në mendimin se, përderisa shqiptarët kishin një të tillë histori madhështore, përderisa ata qenë në gjendje, veç të tjerave, përmes kujtimit të «Motit të madh», të gjurmëve të pashlyeshme, që ai kishte lënë në psikologjinë e popullit të ruanin mëvetësinë kombëtare, meritonin të jetonin të lirë në atdheun e tyre të stërlashtë. Duke e menduar poezinë të lidhur ngushtë me fatet politike të atdheut, romantikët arbëreshë u dhanë shumë pas rikrijimit poetik të momenteve historike, në

të cilat populli kishte shfaqur në mënyrë shpërthyese forcën e tij jetike; më i rëndësishmi, më madhështori nga këto momente ishte pa dyshim shekulli XV. Që romantikët arbëreshë nuk i këndonin kësaj epoke si një kohe të përenduar, që s'kthehej dot më, këtë e provoi fare bukur jo vetëm veprimitaria e tyre patriotike, po njëkohësisht edhe këmbëngulja në evokimin e shndërrimin e saj në një shembull për shqiptarët bashkëkohës, që rrezyatonte një besim të thellë e të patundur në përtëritjen e heroikës së atyre viteve.

Ka edhe një arsyesh tjetër që shpjegon faktin se në letërsinë arbëreshe tema patriotike u trajtua krejtësisht përmes evokimit të së kaluarës. Arbëreshët e lexonin shumë letërsinë e botuar jashtë mbi Shqipërinë. Ata njihnin, për shembull, Barletin, veprat e Pukëvilit, c'kishte shkruar Bajroni për Shqipërinë etj. Madje Rodota (1763), Keta (1777), patën shkruar për kohën e Skënderbeut. Të gjitha këto krijonin tek ata një vizion mbi Shqipërinë e shekullit XV. Poetët arbëreshë nuk e kishin parë atdheun, i cili jetonte në shpirtin e tyre përmes historisë, tregimeve, përmes këngës së popullit. Sigurisht, aktualitetin politik të Shqipërisë, zhvillimin e ngjarjeve ata e ndiqnin me vëmëndje të tendosur, duke qenë edhe vetë në disa raste, ndër protagonistët e tyre, po jetën shpirtërore të shqiptarëve e njihnin kryesisht përmes historisë, përmes këngës së popullit e tipareve shpirtërore të gjyshërvë të tyre, të cilët jetonin me të kaluarën e lavdishme dhe me mendimin se trojet, ku ishin vendosur, s'mund të bëheshin kurrë të afërtë për ta e për nipërit.

Për poetët arbëreshë këto qenë shtigjet që i çonin atje dhe u bënin të mundur rikrijimin e prirjes së përgjithshme shpirtërore aktuale të popullit shqiptar. Por, a kanë qenë të mjaf-tueshme këto shtigje? Sigurisht që po, pasi në kohërat kur ata jetuan, herë pas here Shqipëria ziente nga lëvizjet e fuqishme kryengritëse, të gjitha zërat kushtimtarë të së kaluarës buçis-nin dhe tendosnin fort gjendjen shpirtërore të shqiptarëve, të cilët, për shumë arsy, por sidomos për shkak të krenarisë së ligjshme kombëtare të formuar ndër shekuj, gjatë një jete të vështirë plot luftëra e përpjekje, po lëviznin, po ngrihen në kundër pushtimit me një hov të ri.

Le të shikojmë tanë për së afërmi si e kanë përfytyruar Shqipërinë e shekullit XV poetët arbëreshë. Në shtruarjen dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje duhen mbajtur parasysh dy faktorë: së pari, në përgjithësi poetët arbëreshë e kanë pasur të vështirë të pasqyronin drejt e saktë atë epokë, për shkak të formi-

mit të tyre të përgjithshëm botëkuptimor, por edhe të njohjes së pamjaftueshme të historisë së asaj periudhe; së dyti ata qenë romantikë dhe domosdo e vështruan epokën në fjalë përmes koncepteve që ushqenin romantikët.

Ishte një prirje e theksuar e romantikëve që të evokonin, të rigjallëronin njerëzit e kohërave të shkuara, jetën, zakonet, bukurinë e këtyre kohërave, duke evidentuar në mënyrë të veçantë ato që i dallonin nga bashkëkohësit. Romantikët përfytyruan sidomos mesjetën, të cilën shkrimtarët klasicistë e përbuznin dhe e quanin si një epokë, kur njerëzimi kishte rënë në letargji të thellë. Sipas klasicistëve, kulturën e mesjetës e karakterizonte injoranca e plotë, jetën morale — barbaria, kurse mendimin — paragjykimi e fanatizmi. Ndërkaq romantikët, ashtu si dhe për shumë çështje të tjera, mbajtën një qëndrim krejt të kundërt në vlerësimin e mesjetës. «Le të qe natë mesjete, — thoshte F. Shegeli, — ajo ishte një natë që shkëlqente nga yjet»<sup>1</sup>). Për romantikët, mesjeta e prirjet e saj intelektuale e shpirtërore, ishin tërheqëse, poetike, ato nxitën fort imagjinatën e tyre.

Evokimi i së kaluarës, si një tipar dallues i këtij drejtimi letrar, nuk pati të njëjtën përhapje dhe nuk mori të njëjtat karakteristika në letërsinë e vendeve të ndryshme. Kështu, disa romantikë, si Skoti e ndonjë tjetër u tërroqën më shumë nga ndeshjet dhe luftërat feudale të mesjetës; të tjerë, si Ulandi, nga legjendat e pasura, që u krijuan në këtë epokë, ndërsa Hygoi prirej më fort nga ekzalimi i tipareve morale të njërzve të asaj kohe. Sidoqoftë, një gjë ishte e përbashkët për të gjithë: romantikët mbetën larg kuptimit të rolit të vërtetë historik që luajti mesjeta në zhvillimin e njerëzimit. Përfytyrimet e tyre mbi këtë epokë ishin shpesh të sipërfaqshme, tiparet e saj ngatërrorëshin në veprën romantike, ktheheshin në konvencione dhe u nënshtroheshin hera-herës arbitrarisht ideve të autorëve.

Letërsia e Rilindjes sonë Kombëtare, po në mënyrë të veçantë poezia arbëreshe, u mor gjerësisht me evokimin e mesjetës së vonë shqiptare, me epokën e Skënderbeut, kur populli ynë organizoi një qëndresë të pashembullt ndaj vëershimit osman. Po qëllimet që ndiqnin romantikët arbëreshë në evokimin e mesjetës, në thelb ndryshonin mjaft nga synimet e shumë prej romantikëve evropianë. Siç vihet në dukje me të drejtë

1) Cituar sipas P. Van Tieghem, *Le romantisme dans littérature européenne*, Paris 1969, f. 264

në tekstin «Historia e letërsisë shqipe» (1959), «vendin që zë kjo tematikë (është fjala për tematikën historike — A. Xh.) në poezinë arbëreshe, nuk e shpjegon prirja e zakonshme romantike nga e kaluara mesjetare dhe nga një botë pasionesh të fuqishme, plot ngjyra lokale, po kryesisht dëshira për të ngritur lart krenarinë kombëtare të bashkatdhetarëve, duke ringjallur me anë të artit një periudhë të lavdishme të historisë së tyre, për të ndezur flakën e atdhedashurisë dhe urrejtjen më të madhe ndaj skllavëruesit turk»<sup>1</sup>.

Ky ndryshim është i dukshëm dhe përbën një nga tiparet më të rëndësishme origjinale të romantizmit arbëresh, të krejt letërsisë së Rilindjes sonë, në përgjithësi. Po ndërkojë, si romantikë që ishin, poetëve tanë u linte mbresa të thella e të fuqishme edhe jeta morale e asaj kohe. Në të vërtetë, ata nuk interesoheshin edhe kaq, që të gjykonin nëse ishte e vërtetë ajo jetë që rikrijonin në veprat e tyre. Për ta, ashtu si për gjithë romantikët, kufijtë midis reales dhe imagjinares ishin të tejdukshme; në poezinë e tyre imagjinarja zinte një vend shumë më të gjerë se realja. Kështu poetët arbëreshë, kryesisht përmes përfytyrimeve, u dhanë tërësisht pas së kaluarës, u turrën drejt saj me aq dëshirë, duke gjallëruar luftën liridashëse të atyre kohërave, njerëzit, virtytet, pastërtinë shpirtërore, passionet e fuqishme, idealet e larta, mendimet fisnike. Në këtë udhë ata krijuan një botë tjetër shqiptare, që vihej përballë aktualitetit shqiptar e që përputhej me idealet e tyre social-estetike.

Po në ç'menyrë e përfytyronin poetët arbëreshë Shqipërinë e shekullit XV? Në radhë të parë, Shqipëria e veprës së tyre, është Shqipëria e shqetësuar pér liri, e tendosur në mbrojtje të saj, vendi që e ka shndërruar sakrificën në të vetmin mjet që i siguron ekzistencën. Në mes të kaq betejave, ajo vazhdon të jetojë, pérherë e më vitale, pérherë e më krenare; tragedjedia e fateve të saj është madhështore. Heronjtë e poezië arbëreshe e ndiejnë fort, në çdo hap të jetës, pulsin dhe frymëmarrjen e atdheut; intimja, vetjakja, herë më lehtë e herë përmes lëkundjesh e vuajtjesh, kalon gjithmonë në plan të dytë, shpesh sakrifikohet krejtësisht, kur pérpara heronje qëndrojnë të mprehta detyrat që kanë ndaj atdheut.

Heroika e jetës është aspekti themelor, nëpërmjet të cilit e shohin poetët arbëreshë shekullin XV. Heronjtë e poezië arbëreshe jetojnë intensivisht me ngjarjet e mëdha të kohës,

1) Historia e letërsisë shqipe, vell. II, Tiranë 1959, fq. 54.

të gjithë ata janë mbrojtës dhe hakmarrës të lirisë, me sjelljet dhe veprimet e tyre ata vetë realizojnë lirinë në kuptimin e saj më të qartë e më konkret. Heronjtë e poezisë arbëreshe ndryshe nuk e kuptionin dot të jetuarit. Sidoqë janë njerëz fort të ndjeshëm e të pasionuar, hera-herës sentimentalë, ata dinë të dallojnë, midis pasioneve të tyre, si më të parin e më të fuqishmin pasionin e lirisë. Për të vdes Milosaoja, për të sakrifikohet Serafina, për të bien në një vdekje legjendare Nik Peta e Pal Golemi.

Nota të një dhimbjeje të thellë vihen re në përfytyrimet e poetëve arbëreshë për Shqipërinë e shekullit XV. Dhe janë të natyrshme, po të mbahet parasysh se ata pasqyruan tragjedinë shqiptare të atyre kohërave të stuhishme. Në ndonjë rast, poetët arbëreshë, vuajtjet e atdheut i konceptojnë në mënyrë fataliste, si një nëmë, si një mallkim:

*Kombi i Arbit i përcarë,*

· · · · · · · · · · · ·

*Eshtë i vetmi komb fathumbur<sup>1</sup>*

Shumë vdekje ndodhin në shtjellimin e veprave të poetëve arbëreshë, të gjithë heronjtë përfundojnë tragjikisht. E me-gjithatë në asnjë rast lexuesit nuk i transmetohen ndjenja pasive të humbjes, të rënies morale, të fatalitetit të pashpresë.

Notat e dhimbjes nuk duan të thonë në asnjë mënyrë se në poezinë arbëreshe eshtë e mjegullt perspektiva e atdheut. Eshtë e vërtetë se në krahasim me Naimin, për shembull, poetët arbëreshë nuk u morën shumë me përvijimin e përfytyrimeve që ata kishin për të ardhmen e Shqipërisë po do të ishte absurde që, duke u nisur nga kjo, të arrihej në përfundimin se ata druheshin të mendonin për kohët që do të jetonte atdheu i tyre. Po të mos kishin besim në të ardhmen, ajo punë që kryen poetët arbëreshë për evokimin e shekullit zulmëmadh, do të ishte e pakuptimtë. Nga ana tjetër në pikëpamjet që shprehen, po edhe në vetë përbajtjen e krijimeve të tyre, ushton thellë besimi i patundur se bashkatdhetarët do të

1) Jeronim De Rada, *Vepra Ietrare* 1, përshtatur në gjuhë të sotme nga Andrea Varfi, Tiranë 1987, f. 272. Edhe këtej e tutje citimet nga kjo vepër do të janë të këtij botimi.

dinin të përsëritnin lavdinë e kohërave të para, se ata vettë do të mund të fitonin, në mes të një deti armiqsh, lirinë e humbur.

Malli i pashuar për atdheun e lashtë është një tjetër arsy, që shkakton notat e dhimbjes. Në të gjitha krijimet e De Radës, Darës së Ri, Serembes, kjo ndjenjë përbën një nga përjetimet më të thella, ajo është vokacioni i pérhershëm i tyre.

Vargjet e Darës:

*Mori bijë, bijë e Lalës;  
Moj e bukur, e meritur  
Pse më sjell ndër mend të shkuarën?*<sup>1</sup>

(Kënga e sprasme e Balës)

sintetizojnë në mënyrë mjeshtërore atë mall, që ka qenë nga momentet më themelore të fryshtimit të poetëve arbëreshë. Kudo në veprat e tyre ndihet thellë shkrirja e plotë shpirtërore e heronje me tokën mëmë, me natyrën e saj. Për ta është i dashur çdo grusht dhe, çdo gur i saj, në atë tokë janë rritur, kanë dashuruar, vuajtur, luftuar, për të janë gati të japidet.

Bashkimi i forcave njerëzore të të gjitha krahinave të Shqipërisë çmohej jo vetëm si një ndër tiparet themelore të jetës politike të Shqipërisë së shekullit XV, por edhe si faktori vendimtar që përcaktoi fitoret e lüftës së popullit kundër osmanëve. «... nga ai bashkim i shenjtë, — thotë Dara, — lindi fuqia, që për njëzet e pesë vjet theu forcën e turqve dhe përpriu njëren pas tjetrës ushtritë e zotit të madh, ndërsa Evropa e përmbysur tmerrohej, sa i dëgjonte emrin»<sup>2</sup>. Për këtë bashkim përpiken heronjtë e poemave «Serafina Topia», «Kënga e sprasme e Balës», atë kërkojnë me forcë heronjtë lirikë të vjershavë patriotike të Zef Serembes.

*Bir, krushqia që ne bejmë  
kërkon të lidhë krejt vllerësit,*

1) Gavril Dara (i Riu), «Kënga e Sprasme e Balës», përshtatur në gjuhën e sotme nga Shaban Demiraj, Tiranë 1965 fq. 23. Edhe këtë e tutje citimet nga kjo vepër do të janë të këtij botimi.

2) Gavril Dara (i Riu), *Kënga e spasme e Balës*, Parathënje të arbëreshëvet, Tiranë 1965, f. 15-16.

*që mbi dhe i ndau fati,  
se arbëreshi shpirt e di;  
që bashkimi ynë i dëbon  
shpellanikët e uritur.*

(Serafina Topia, f. 232)

thotë plaku Dukagjin në këngën e parë të poemës «*Serafina Topia*».

Poetët arbëreshë i mëshonin nevojës së krijimit të unititetit midis shqiptarëve dhe, me të drejtë, e konsideronin atë si një prej detyrave më kryesore të Lëvizjes së Rilindjes sonë kombëtare. Aludimi i krijimtarisë së tyre te ky problem kaq aktual është krejt i qartë.

Duke trajtuar këtë ide, mbështetet që përbën një nga aspektet themelore të përbajtjes së poemës «*Serafina Topia*». Me këmbëngulje të veçantë De Rada përsërit herë pas here në poemë mendimin se martesa e Serafinës me Nik Dukagjinin, do t'i shërbente bashkimit të shqiptarëve, krahinave të Jugut dhe të Veriut. Në feudalizëm martesat kanë shërbyer si një lloj kurorëzimi i aleancave midis familjeve të veçanta feudale dhe i fuqizimit të tyre kundër të tjerëve. Me prehtësi De Rada thekson në veprën e tij, se në themel të këtyre lidhjeve martesore qëndronin përgjithësisht interesat ekonomike dhe politike. Në mënyrë të tertiortë, po shpesht edhe të drejtpërdrejtë, poeti godet separatizmin feudal, që pa dyshim, përbënte një pengesë serioze në realizimin e atij uniteti që ishte aq i nevojshëm pér Shqipërinë e shekullit XV. Edhe Skënderbeu i shfrytëzoi lidhjet martesore. Ai vetë u martua me vajzën e kryefeudalit Gjergj Arianiti. Nga kjo pikëpamje, De Rada ka pasqyruar në veprën e tij një fenomen real të asaj periuadhe. Po më tej ai nuk u shty dot. Separatizmin feudal, Gjergj Kastrioti nuk mundi ta kapërcente në mënyrë përfundimtare; objektivisht ai nuk mund ta bënte një gjë të tillë. Rreth tij u grumbulluan ata krerë feudalë, të cilët e kuptionin se pushtimi osman sillte me vete shkatërrimin e tyre, prandaj ndoqën rrugën e qëndresës ndaj invadimit të huaj. Veç kësaj, Skënderbeu në organizimin e qëndresës u mbështet fort në shtresën e komandantëve ushtarakë, të cilët i shpërbiente herë pas here pas përfundimit të betejave. Po kyçi i suksesit të Kastriotit duhet kërkuar, pa dyshim, në përkrahjen e sigurt që gjeti ai te masat e gjera të popullit, në shpirtin e tyre patriotik e luftarak. Merita e tij historike, pikë-

risht këtu qëndron. Vetëm nëpërmjet unitetit liridashës të popullit, ai mundi të mposhtë, sa qe gjallë, të çarat, që i shkak-tonte egoizmi i feudalëve të mëdhenj, të cilët shpeshherë i vinin shkopinjtë nën rrota luftës qërimtare.

Le të vimë tani te një çështje tjeter, te mënyra si e kanë pasqyruar poetët arbëreshë jetën shqiptare të shekullit XV. Tek merresh me këtë çështje, bie në sy shpejt ajo që kemi shënuar më lart, shpërpjesëtimi midis fantazisë dhe faktit real historik. Pa dyshim, fantazia ze një vend shumë më të gjerë dhe kjo ishte fare e zakontë për poetët romantikë. Përmes saj poetët arbëreshë e kanë përshkruar jetën shqiptare të kohës së Skënderbeut të idealizuar në shumë pikëpamje. Në përgjithësi, në tërë krijimtarinë e De Radës, konfliktet shoqërore të kohës pasqyrohen në mënyrë të sipërfaqshme. Në zbeh-tësinë e tyre ka ndikuar edhe arti i poetit, mënyra e tij e preferuar për të thënë pak e për të sugjestionuar shumë, e cila në shumë raste, dashur pa dashur, ka sjellë një farë errësire dhe vështirësi në ndjekjen e subjektit. Po ky shkak nuk është themelor.

Në poemën «*Serafina Topia*», De Rada ka vënë në dukje përçarjen feudale, po pa u ndalur gjatë në të dhe, sidomos, pa mundur të zbërthejë deri në fund shkaqet e shfaqjes së saj. Edhe në këto raste konfliktet janë veshur gjithnjë me një rrobë etike. Për kontradiktat midis feudalëve dhe fshatarëve as që bëhet fjalë. Përgjithësisht personazhet e dalë nga populli janë fort të rrallë në krijimtarinë e De Radës; në ato të pakta raste kur flitet për ta, marrëdhëniet e tyre me zotërit janë përshkruar vetëm si harmonike. Pikërisht në këto karakteristika, në thjeshtësinë e sjelljes së Serafinës, Bozdarit, Milosaos e të tjerëve, studiuesit kanë parë një shfaqje të ndikimit që ka pësuar De Rada nga poezia e Homerit. Mund të jetë edhe kjo një arsy, po sigurisht që nuk është e vëtmja dhe aq më pak më e rëndësishmja. Për krijimin e përfytyrimeve të tillë mbi marrëdhëniet midis shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare të shekullit XV në poezinë e De Radës kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë e, në radhë të parë, qëndrimi i vetëdijshëm ekzaltues, që mbajtën të gjithë poetët e Rilindjes sonë Kombëtare ndaj epokës së Skënderbeut, duke dashur, për synime të qarta politike, ta kthenin atë në një mjet frymëzimi për bashkë-kohësit; së dyti, De Rada ushqente iluzionin se vetëm mbi baza morale kristiane mund të krijohej një shoqëri e drejtë e harmonike; së treti, prirjet demokratike të poetit shfaqen edhe në «demokratizimin» e karakterit dhe të sjelljes së personazheve të shumtë që përfaqësojnë aristokracinë.

Sido që të jetë, De Rada i njihite aristokracisë një rol përcaktues në rrjedhjen e ngjarjeve. Është e vërtetë se një pjesë e saj ka qenë udhëheqëse e qëndresës shqiptare të shekullit XV, po nga ana tjetër, populli, si forca vendimtare e kësaj qëndrese nuk është pasqyruar as në krijimtarinë e De Radës dhe as në atë të Darës së Ri. Forcat lëvizëse të ngjarjeve të mëdha të atyre viteve mbeten të pazbuluara si në veprën e De Radës, ashtu edhe në atë të Gavril Darës së Ri. Roli historik i figurës së Gjergj Kastriotit nuk u kuptua në mënyrë të plotë prej tyre dhe as që mund të kuptohej. Ata jetuan në një kohë, kur historiografia kritike mbi Gjergj Kastriotin dhe kohën e tij hidhte ndonjë hap të parë. Kjo mungesë krijonte për poetët arbëreshë vështirësi objektive. Nga ana tjetër, vetë autorët, ashtu siç ndodhë me tërë shkrimitarët romantikë, nuk i morën fort parasysh konsideratat shkencore, të cilat, edhe ashtu, qenë të varfra. Prandaj, përshtypjet që fiton lexuesi për periudhën e Skënderbeut nga veprat e poetëve arbëreshë, nuk i jepin atij mundësi të krijojë përfytyrime të sakta mbi të. Por të gjykohen veprat e poetëve arbëreshë vetëm nga kjo anë, do të ishte gabim i rëndë. Ato duhen vlerësuar në radhë të parë si përpjekje e sukseshme për t'iu përgjigjur njérës prej detyrave më të rëndësishme të Rilindjes: gjallërimi, forcimi, shpërthimi, të ndjenjës nationale, krenarissë dhe dinjitetit kombëtar të popullit. Në vetvete ky qëllim përbën një karakteristikë shumë të rëndësishme për romantizmin shqiptar që është pasojë e drejtpërdrejtë e patosit themelor të tij, e patriotizmit, e tabanit ideologjik e shpirtëror, mbi të cilin ai lindi. Idealizimi i periudhës së Gjergj Kastriotit në letërsinë arbëreshe dhe në gjithë letërsinë romantike rilindëse, veç të tjerash, duhet parë edhe si pasojë e këtij patosi themelor të saj.

**Figura e Skënderbeut** nuk zë një vend vërtet të dukshëm në krijimtarinë e poetëve arbëreshë, madje as në këngët që njohim prej poemës «**Skënderbeu i pafan**»<sup>1</sup> të De Radës. Heroi kombëtar shfaqet në skena krejt të rralla, po megjithatë ma-

1) Mjerisht këtë vepër nuk e njohim të plotë. Nga parathënia e saj, hartuar nga autorë, dimë se poema është kriimi që De Rada i kushtoi më shumë kohë; ai e shihte «**Skënderbeun e pafan**» — siç shprehet vetë — «si vepër... të caktuar për përtëritjen e kulturës sonë dhe të fatit tonë» (Vepra letrare, 2, f. 6). Jo vetëm prej këtij pohimi, po sidomos nga brendia e pjesëve të botuara, del qartë se De Rada e kishte konceptuar poemën si një vepër në të cilën donte të realizonte artistikisht historinë shqiptare të shek. XV e, përmes saj, të gjitha pikëpamjet e tij mbi botën e jetën.

dhështia e tij ndihet e fuqishme. «Moti i madh» dhe Gjergj Kastrioti për poetët arbëreshë ishin një binom i pandarë, ajo epokë dhe ai emër për ta ishin sinonime. Studiuesit kanë vënë në dukje se «autori (është fjala për De Radën, — A. Xh.) me titullin e veprës do të thotë se Skënderbeu ishte një e i pandarë nga shekulli i tij, dhe ky shekull është i pafat, sepse turqit, me gjithë qëndresën heroike të shqiptarëve, e pushtuan më në fund Shqipërinë. Këtu poeti që në titull bën fjalë për një hero alias shekull të pafat. Në «Sarafinën» flet për «Arbrin e Nëmür». Ndoshta në kokën e poetit lëvrin ideja e fatalitetit, e së thënës»<sup>1</sup>. Kuptimi i vërtetë i atyre viteve konvergonte si në një fokus në veprën dhe në figurën e Gjergj Kastriotit, kampionit dhe simbolit të lirisë, protagonistit të asaj epoke tragjike. Edhe ato të pakta skena ku përshkruhet, ndihet qartë drama që ai jeton. I tradhtuar nga shumë krerë feudalë, vetëm përballë hordhive më të mëdha të kohës, pa asnje ndihmë prej fuqive evropiane, ai nuk mund të përfytyrohej ndryshe: «O, sa orë hareje shpresso ai dhe s'pati kurrë! (J. de Rada Vepra letrare 1, f. 221). Skënderbeu për poetët arbëreshë ishte një figurë idolatrie të vërtetë. Për ta, mënyra më e mirë për të shprehur adhurimin ndaj saj ishte, me sa dukej, që të flisnin pak e në raste të rralla për të. Ai vizatohet me disa të hequra të shpejta të penelit, po gjithnjë në mënyrë të atillë, që krijon menjëherë ndjenjën e madhështisë së tij:

*Por çë ngjau? Kush i prapsi,  
T'dehur vrerit, t'ndezur gjakut?  
Pse ato vet'lla të egërsuara  
Shpejt u ulën gjithë turp!  
Mbreti u duk e i vërejti  
Dhe, pa fol', ku desh, i pru.*

(Kënga e sprasme e Balës, f. 48)

Në ndryshim të dukshëm nga Naim Frashëri, që e ka vizatuar në mënyrë më të plotë figurën e heroit, në poezinë arbëreshë Gjergj Kastrioti është më fort një figurë simbolike, që mishëron shpirtin luftarak e të panënshtuar të popullit. Në përshkrime të tjera, që do të zbulonin në mënyrë më të imët personalitetin e Gjergj Kastriotit, pikëpamjet e prirjet e tij shpirtërore, De Rada dhe Dara i Ri nuk hynë. Cilat të kenë

<sup>1)</sup> Muzafer Xhaxhiu, *Studime dhe artikuj kritikë*, Tiranë 1975, f. 73.

genë arsyet e një qëndrimi të tillë? Kësaj pyetjeje vështirë t'i jepen përgjigje të sigurta. Është e pabesueshme që ata të jenë druajtur, se mos arti i tyre nuk do të qe në gjendje të krijonte te lexuesit përfytyrime të gjalla, të plota dhe emocionuese, ashtu siç do të dëshironin ata, për figurën e heroit. Ndoshta do të mbeteshim më afër të vërtetës, po t'i mbaheshim pikëpamjes se De Rada dhe Dara nuk e kanë përshkruar hollësisht figurën e Gjergj Kastriotit, sepse ajo kishte kaluar tanimë në legjendë, ishte bërë, pra, pjesë integrante e botës shpirtërore të shqiptarëve, ishte kthyer, siç vumë në dukje, në shprehjen më të koncentruar të epokës, prandaj, duke pasqyruar atë epokë, ata mendonin se kishin pasqyruar edhe figurën e Skënderbeut. Duhet thënë se edhe në këngët populllore arbëreshe mbi heroin, në shumë prej tyre, ai nuk është personazhi qëndror<sup>1</sup>.

1) Dhimitër S. Shuteriqi, Nëpër shekuj letrarë, Tiranë 1973, fq. 31.

## 2. HEROI — PROTAGONIST I TRAGJEDISË SHQIPTARE TË SHEKULLIT XV, BARTËS I IDESË KOMBËTARE, I PERSIATJEVE DHE NDJE- NJAVA TË THELLA.

Heronjtë e poezisë arbëreshe ndryshojnë nga vepra në vepër nga autori, në autor, po sidoqoftë, në një pikëpamje ata bashkohen plotësisht: në qëndrimin e prerë e pa mëdyshje kundër pushtimit të Shqipërisë, në luftën e tyre për të mbrojtur lirinë e atdheut. Milosaoja, natyrë e prirë drejt një jete idilike, Bozdari, njeriu i pasioneve të fuqishme, shpesh kontradiktore, Nik Peta, i riu që në çdo veprim udhëhiqet nga bindje të thella, secili në mënyrën e vet, e ka bërë njësh jetën me fatet e atdheut. Vitaliteti i tyre, sidomos i Bozdarit, Nik Petës e Pal Golemit, shfaqet më qartë se kudo në betejat, ku ata shquhen si luftëtarë me trimëri të rrallë.

Heroi lirik i poezisë së Serembes heronjtë e De Radës janë në konflikt me shoqërinë e kohës ose me aspekte të vëçanta të saj. Ajo është e shurdhur, madje armike për shumë ndjenja ku ata gjejnë ç'ka më të bukur jeta. Në mënyrë të turbullt, Serembja e sheh hendekun që e ndan nga koha e tij. Ai e ndjen tëhuajsimin e saj po vetë s'është në gjendje t'i kuptojë deri në fund shkaqet që e ndajnë shpirtërisht nga ajo; vuan thellë, kërkon të zhbirojë në labirintet e shpirtit të vet, po prej të gjitha këtyre pëlecat trishtimi i pafund, që e shtyn poetin të krijojë bindjen se goditet vazhdimi i shkaqet që e ndajnë shpirtërisht nga forca e verbër e fatit, kundrejt të cilit jo vetëm ai, po të gjithë njerëzit, janë të pafuqishëm. Sidoqë u rropat për ditët e tij halle-shumë e gëzimpaka, sido që u kap fort pas tyre, pasioni i tij i thellë nuk u realizua ose mbeti i pakuptuar. Temperament sentimental, po jo fort i thellë, heroi lirik i Serembes priret pas dashurisë, po dështon në të; hidhet në mistikë, po çastet

e ekstazës që i shkakton ajo janë të shkurtra, revolta e tij ndaj ambientit shoqëror është e pafuqishme; të gjjejë një lloj komunikimi me të, edhe këtë nuk e bën dot. E të gjitha këto ndodhin me atë që dikur kishte dashur «të ndreqjet botën», që i pëlqente kaq shumë lufta, përpjekja, siç thotë vetë poeti në vjershën «Fytyra ime». Në shpirtin e heroit të Serembes ziejnë herë pas here pasione të fuqishme, të cilat mjerisht, nuk shkaktojnë veç vuajtje, trishtim, zymtësi, një depresion të rëndë shpirtëror. Fatkeqësitë e shumta ia kanë fashitur vullnetin, një gjendje gati përhumbjeje sundon në disa çaste tërë qenien e tij. Ngaqë s'është i aftë të kuptojë sado pak shoqërinë, heroi i Serembes parapëlqen më mirë t'i largohet, të jetojë jashtë saj, vetëm me dashurinë. Megjithëse, si e vumë në dukje e ndien greminën që e ndan prej shoqërisë së kohës, ai nuk arrin të kuptojë se pikërisht në të, në përpjekjen për të kapërcyer atë greminë, nëpërmjet mohimit të shoqërisë aktuale, gjendet kuptimi i jetës, gëzimi, pasioni, lumturia. Endrra e njobur romantike është e vakët në përfytyrimet e tij, përpjekjet për të krijuar një jetë tjetër shoqërore më të mirë janë mezi të ndjeshme. Në këtë mes, nuk ka shumë rëndësi nëse përfytyrimet e heroit të Serembes do të ishin ose jo pranë udhëve më të drejta, që do të shpinin në krijimin e kësaj bote. Të gjithë romantikët qenë shumë larg këtyre udhëve, po èndërrimi për të do t'ia shmangte atë trishtim aq të thellë, atë vetmi dërrmuese, që e shpie shpesh në nota të ndjeshme pesimizmi.

Bota mbeti e pakuptueshme për heroin e Serembes, po megjithatë ai kurrë nuk shkoi deri në mohimin e saj; vuajtjet e tij ai nuk i kuptoi si esencë të jetës, e cila për të mbeti e bukur, e dashur. Triumfit të vdekjes s'i këndoi kurrë, sidoqë, i detyruar nga fatkeqësitë e shumta, i kthehet në ndonjë rast varrit dhe e quan si qetësinë e shumëpritur. Hidhërimet e tij të pa-fundme, heroi i Serembes nuk i përgjithësoi, nuk i quajti ato si fatalitet, prej të cilët, njeriu, për shkak të natyrës së tij, nuk mund të shpëtojë. Serembja, nëpërmjet heroit të tij lirik, shprehu në mënyrë shumë të singertë, ato që ndjente ai vetë, përgjithësisht reagimin e tij shpirtëror ndaj vuajtjeve, që s'i ndanë kurrë.

Është po ai Serembe, që, kur merret me temën e atdheut, krijon një hero me mendje kaq të kthjellët, të vendosur deri në fund, shumë krenar, thellësishët të bindur në fitoren e lirisë, jo vetëm të popullit të tij, por të gjithë njerëzimit. Heroi i vjershave «Për liranë e Venetisë», «Detari» etj. shquan për kuptimin e thellë, që i jep jetës. Ai e sheh çdo gjë qartë, e di se

nëpërmjet luftës, duke e harruar veten, krijohen realizimet e mëdha. Është po ky Serembe, me natyrë thellësisht melan-kolike, e që e ka të vështirë të ndeshet, që shpërthen në një zemërim fisnik në vjershën «Vrull», kur sheh se lëvizja kombëtare akoma nuk është ngritur në atë shkallë siç e dëshironë zemra e tij e zjarrtë. Një gjendje padurimi, gati nervoze, thekset e qortimit ndaj bashkatdhetarëve, që ende s'po ngrihen në një luftë vendimtare, përshkojnë këtë vjershë, e cila është ndër më të goditurat në tërë poezinë e Serembes.

Është po ai Serembe, i cili e kuption në mënyrë shumë naivë shoqërinë dhe nuk arrin dot të krijojë, qoftë edhe nëpërmjet ëndrrës, siç ndodh zakonisht te poetët romantikë, një botë tjetër të kundërt me botën ekzistuese, që i ka të ndritura perspektivat e atdheut, rrugët e arritjes së lirisë së tij, që është plot shpresë e besim në realizimin e tyre.

Po nga se vijnë këto qëndrime të ndryshme shpirtërore të heroit lirik të poesisë së Zef Serembes? Ka shumë arsyë, të cilat duhen kërkuar në biografinë e poetit, në jetën e tij të mbushur me fatkeqësi nga më të rëndat, në formimin e botë-kuptimit të tij përgjithësisht kristian, në temperamentin melan-kolik etj, etj. Me këto qëndrime zë fill një kontradiktë, nga e cila kanë vuajtur përgjithërisht rilindësit tanë. Ndërsa u përgjigjet shin kërkeseve, që shtronte epoka pér çështjen kombëtare, ata nuk arriten, pér shkaqe që mund të merren me mend lehtë, të njihnin pikëpamjet më të drejta pér jetën e shoqërisë e ligjet e zhvillimit të saj. Sidoqoftë, pér romantikët arbëreshë, ashtu si pér gjithë poetët e letërsisë së Rilindjes sonë Kombëtare, synimi pér kapërcimin e gjendjes së atëhershme të vendit, nevoja e ngutshme e zgjidhjes së kontradiktës midis popullit tonë dhe pushtuesit të huaj, ishin krejt të qarta, prandaj dhe imagjinata e tyre nuk qe e mjegulluar; ajo merrte trajta shumë konkrete, ravijëzonte lirinë e ardhshme të Shqipërisë. Romantikët arbëreshë i shihnin përgjithësisht drejt edhe rrugët që do të shpinin në realizimin e pavarësisë së atdheut, prandaj tek e shtronin këtë problem në veprën e tyre, krijonin heronj, që dinin të kryenin, herë në mënyrë të vendosur e herë përmes udhëve më të mundimshme, detyrat e tyre në jetë. Ky përbën një nga tiparet origjinale të heroit romantik të letërsisë arbëreshe, të letërsisë së Rilindjes Shqiptare në përgjithësi. Ndërkajq, heronjtë e poesisë arbëreshe, nga pikëpamje të tjera shfaqin tipare, të cilat janë të përbashkëta pér krijimet e natyrës romantiqe. Milosaoja i poemës homonime, po edhe Bozdari në poemën «Serafina Topia» janë heronj tipikë romantikë; të

dy ata janë pér një kohë fare të harruar pas ndjenjës, të dy dashurojnë thellë, pastër, pa marrë parasysh asnjë paragjykim, i çdo lloji qoftë ky. Të dy ata, si dhe heronj të tjerë të veprës së De Radës, si Serafina, Frosina, Paraïdhja, Radavani etj., kalojnë përmes shumë vuajtjesh, të cilat shpesh shpien në përfundime tragjike. Ata vuajnë se jetojnë në një ambient, që shumë mundime e pasione të tyre nuk i kupton, vuajnë se janë pér një jetë tjetër e cila do ta kishte të domosdoshëm pasionin. Te figurat e Milosaos dhe të Bozdarit janë më të theksuara prijet e qëndrimet subjektiviste, që e shpien Bozdarin, këtë temperament shumë të ndjeshém, në veprime të vrullshme, pér të mbushur boshllékun që i shkakton humbja e dashurisë. Megjithatë, pér heronjtë e romantikëve arbëreshë mbetën të huaja shfaqjet e egocentrizmit të theksuar, mbeti i huaj mohimi absolut i botës e i jetës, i gjithçkaje që kishte krijuar njerëzimi në shekuj. Sido që vazhdimisht kërkonin e gërmionin në labirintet e shpirtit të tyre, heronjtë e letërsisë arbëreshe nuk e konsideronin kurrë veten kërthizë të botës; qëndrimet e tyre subjektiviste nuk u shndërruan në një urrejtje të verbër ndaj jetës, e cila i mundonte aq shumë disa nga heronjtë romantikë.

Në veprën e De Radës sidomos, heronjtë janë shpesh pre e një fati të përcaktuar qysh më parë. «... shqetësimi i nuses, — shkrante De Rada në shënimet me të cilët shoqëron këngët e poemës «Skënderbeu i pafan», — në mes shpresave të gë-zueshme duke pasur edhe ngrohtësi nga qielli, qëndroi si një parandjenjë pér të treguar se sa i brishtë është në fund çdo fat njerëzor». (Vepra letrare 2, f. 371). Ideja e predistinimit, që është fort e ndjeshme në këtë vepër, shfaqet pikërisht në jetën e personazheve, të cilët, në shumë raste, paralajmërohen, kryesisht përmes èndrrave, po edhe nga engjejt e fantazmat pér ngjarjet, përgjithësisht të hidhura, që i presin. Shumica e heronjve të letërsisë arbëreshe janë njerëz të vetmuar, pa të afërt, ose me të afërt që nuk i kuptojnë dhe, dashur pa dashur, u nxjerrin pengesa në realizimin e pasioneve. Të tillë janë Bozdari, Mara, Serafina; i tillë është heroi lirik i poezisë së Serembës. Vetminë e tyre ata kërkojnë ta shmangin përmes ndjenjës që i rrëmben furishëm, po që njëkohësisht u sjell andralla, u shkakton një trishtim të thellë, që e thekson akoma më shumë vetminë. «Gjithnjë i vetëm» mbetet heroi i Serembës; kështu mbetet derisa vdes në mënyrë tragjike Bozdari, që është ndoshta një nga figurat, që i afrohet më shumë heroit të letërsisë romantike evropiane. I panjeri, Bozdari kapet fort

pas jetës nëpërmjet dashurisë së tij për Serafinën. Po, siç ndodh shpesh në poezinë romantike, për Bozdarin kjo dashuri, më shumë se gjësim, i sjell vuajtje të rënda. I rrallë në trimëri, i thellë në ndjenja, ai shpërthen hera-herës në një zemërim të papërbajtshëm, pa qenë në gjendje të kuptojë pasojat e veprimeve të veta. Jeta e tij kalon nëpër shumë rreziqe, në beteja shpesh vdekja i kalon pranë, e megjithatë zëmra i mbetet përherë delikate. Rrallë e shohim të gjëzuar, po gjithnjë të vuajtur, e prapëseprapë mendja e krahu s'i mpihen kurrë, urrejtja për armikun s'i fashitet; ai mbetet gjithnjë i zoti në krye të detyrave të tij luftarake. Natyrë komplekse, e zjarritë, ai kërkon një mënyrë për të ngushëlluar veten nga humbja e dashurisë, për të mbushur zbrazëtinë shpirtërore që e mundon. Sa është i aftë në kryerjen e detyrave, si komandant ushtarak, aq i pazot është të harrojë edhe për një çast dashurinë për Serafinën, që s'i shqitet kurrë. Veç mendjes e krahit të tij, ai s'i detyrohet kurkujt; krenaria e tij është e thellë, po megjithatë ajo nuk e shtyn kurrë në narcisizëm. Bozdari mbetet gjithnjë njeri i vërtetë, shumë i apasionuar, hera-herës i rrëmbyer, po me një zemër fisnike, i gatshëm për të ndihmuar të tjerët, që s'e duron për asnje çast fyeren, nëpërkëmbjen e nderit nga kushdo qoftë. Ai kaloi një jetë të pasur në ndjenja, në ngjarje e në pasione, të cilat nxjerrin vazhdimi i pah natyrën e tij kontradiktore. Sentimental në përgjithësi, në zemërim e sipër ai nuk ngurron të japë urdhër për të shkuar në shpatë qindra robër; njeri që, siç thoshte vetë, i urrente lakmitë e çastit, që kërkonte vetëm dashuri të thellë e të pastër për një kohë jepet pas erotizmit, që bëhet shkak përfundin e tij tragjik. Karakteri i tij, ngjarjet që kaloi në jetë, të gjitha këto e shtynin drejt fundit fatal. Figura e Bozdarit është shumë më e pasur se ajo e Milosaos, që mbetet më shumë një figurë idilike, me një jetë më pak intensive. Natyrë lirike, Milosoja i shfaq tiparet e karakterit të tij kryesishët nëpërmjet shqetësimeve të dashurisë. Shpiru i tij priret më fort pas natyrës, pas gjëzimeve familjare, më shumë se i thellë dhe i zjarrte në dashuri, ai është i embël, i këndshëm. Bukuria e hijeshia e vashës, natyra me bukuritë e saj, këto krijojnë botën shpirtërore të Milosaos. Fatkeqësitet që i erdhën një pas një, kujtimi i së emës së vdekur, që gjithnjë e kishte qortuar se po harronte detyrat e tij, e tronditën, po megjithatë ai mbeti përsëri një temperament sentimental.

Kiske të drejtë Markianoi, kur e cilëson Serafinën si një kriesë të përsosur, të kërkuar e të gjetur në çipat më të

imët të zemrës. De Rada në poezinë e tij u tregua mjeshtër për zbulimin e dridhjeve më të holla të psikologjisë së personazheve. Vetëm në këngën që hap poemën, ku përshkruhet lindja e dashurisë midis Serafinës e Bozdarit, pasqyrohen disa çaste të gëzimeve, që ndien vajza e dashuruar, përndryshe, në gjithë poemën Serafina është figura e një gruaje që jeton një dramë kapitëse shpirtërore. Ajo është natyrë shumë më komplekse nga Rina dhe, në përgjithësi, nga të gjitha figurat e grave të krijuara prej romantikëve arbëreshë. Interesat e saj janë të gjera, reagimi ndaj ngjarjeve dhe njerëzve është shumë i thellë. Serafina është tepër delikate, e brishtë, e pasionuar, po njëkohësisht edhe një karakter i vendimeve të prera i qëndrimeve vetëmohuese; e aftë të ndjejë bukurinë kudo që shfaqet e sidomos në dashurinë e saj, po njëherazi grua që di të përballojë privacione të rënda shpirtërore; njeri që nuk përbuz punët më të zakonshme, por edhe një mendje e fuqishme meditative. E tillë është Serafina, prej së cilës vezullon bukuria shpirtërore e fizike, kriesa më e dashur e poetit të Makit. Po le të ndjekim për së afërmni dramën e saj. Dashuria për Bozdarin që i lindi ashtu njëherësh, siç ndodh në poezinë romantike, iu bë shkak përvuajtje të mëdha, po një karakter si ai i Serafinës, vetëm përmes të tilla vuajtjeve mund të jetonte: një karakter si ai i saj nuk është përf një jetë të qetë, të amullt; një shpirt si ai i Serafinës do të kërkonte patjetër emocione të shumta, të ndryshme. Ashtu si gjithë heronjtë e romantizmit arbëresh, ajo është njeriu që i urren paragjykimet, po që e kuption se ato luajnë një rol ende të ndjeshëm në jetën psikologjike dhe morale. Thellë në shpirt Serafina e ndien veten të aftë t'u kundërvihet këtyre paragjykimeve. shpirtërisht ajo u ndesh me to. Madje, duke dashuruar Bozdarin, birin e një familjeje armike me të sajën, ajo ngadhënjen mbi to. Po, ndërkohë, Serafina ishte e bindur se kjo nuk qe e mjaf-tueshme. Sipas saj, lufta kundër paragjykimeve, për triumfin e ndjenjës së vërtetë, që do të udhëheqë jetën shpirtërore të gjithë njerëzve, në kushtet kur përcarja, mosmarrëveshjet, dizharmonia sundonin akoma midis tyre, nuk duhej të kalonte përmes udhës së kundërshtimit, të revoltës, por nëpër një udhë tjetër të kundërt, atë të sakrifikimit të ndjenjave, sado të bukura, të thella e njerëzore qofshin ato. Përmes vuajtjeve, sipas Serafinës, mund të arrihej te «e vërteta e amëshueshme». Natyra fetare e mendimeve të Serafinës është fare e qartë. Sjellja, mendimi e bindjet e saj ranë ndesh me një zemër thellësisht të ndjeshme, të aftë përf një dashuri të zjarrtë, dhe

pikërisht këtu duhet kërkuar e gjetur shkaku i dramës, të cilën vasha, me vetëdije e kthen në një qëllim moral, madje në virtut, në shenjë të parë të personave, që kanë mbi vete një barrë të rëndë; të kthejnë njerëzit në udhën e «së vërtetës» së hyjnisë.

Siqështë vënë në dukje, heronjtë romantikë të letërsisë arbëreshe vijnë në përgjithësi nga shtresat e aristokracisë, të rrallë janë ata që vijnë nga shtresat e vegjelisë, si Rina e sidomos heroi lirik i poezisë së Serembës. Po megjithëse janë pinjollë familjesh aristokrate, heronjtë e De Radës, pothuajse nuk kanë asnjë tipar, që të kujton prejardhjen e tyre klasore, ata janë krejt të thjeshtë dhe marrëdhëniet që krijojnë me personazhet, të cilët vijnë nga shtresat e popullit, janë marrëdhënie dashamirëse. Në to pozita shqërore as që ka të bëjë fare; në mes tyre sundon një atmosferë mirëkuptimi e harmonie të plotë. Shpesh heronjtë e letërsisë romantike ishin plebejanë. Hygoi, sidomos në prozën e tij, dallohet për krijimin e heronjve të tillë.

Parimi i njohur estetik i shumë prej romantikëve evropianë, sipas të cilët shëmtimi i jashtëm i njeriut është shprehje e një bukurie të rrallë shpirtërore dhe e një force të veçantë morale, nuk u ndoq nga romantikët arbëreshë. I ndikuar nga estetika klasiciste, De Rada ngulite këmbë për të kundërtën; ai mendonte se bukuria fizike nuk mund të mos qe veshje e bukurisë së brendshme shpirtërore, ajo shkonte njësh me virtutin. Jo vetëm heronjtë e De Radës, po në përgjithësi të krejt poezisë arbëreshe, dallohen, veç virtuteve të tyre, edhe nga bukuria e jashtme fizike. Ironia dhe qëndrimet kryene të që vihen re ndonjëherë te heroi i letërsisë romantike evropiane, përpjekja për tu veçuar në çdo mënyrë nga të tjerët, e shndërruar në qëllim në vetvete, nuk kanë lënë asnjë gjurmë në karakterin e heronjve romantikë të letërsisë arbëreshe.

Tek merresh me studimin e këtyre heronjve, është e pamundur t'i shmangesh një problemi të veçantë, që ka të bëjë me shkallën e ndikimit të frysës bajroniane, e cila, për veprat e romantizmit evropian, ka qenë një nga tiparet themelore të përbajtjes së tyre. Po ç'është kjo frysë, ç'është ajo që studiuesit e kanë quajtur bajronizëm?

Pol Van Tigem, një nga njohësit e thelluar të romantizmit, vëren se: «Ato çka ishin në fund të shekullit paraprirës (është fjala për shekullin XVIII — A. Xh.), romani i Rusoit dhe «Rrëfimet» e tij, poemat osianike, «Verteri» i Gëtes, një thirrje për zhvillimin dhe shprehjen e lirë të mendimeve dhe ndjenjave

**intime, gjithnjë** në kundërshtim me konformizmin shoqëror dhe moral, të tilla qenë për brezat e romantikëve, duke filluar nga viti 1815, poemat e Bajronit, shumë më shpërthyese e më të **guximshme**<sup>1)</sup>. Pa dyshim, ndikimi i veprës së Bajronit ka qenë shumë i thellë në letërsinë romantike evropiane. «Çajd Haroldi», «Manfredi», «Don Zhuan», u kthyen pothuajse në manifeste të krimtarisë së romantikëve. Në qoftë se epigonizmi ishte i përhapur në letërsinë romantike të disa vendeve, burimi i tij duhet kërkuar edhe në ndikimin e gjerë që ushtroi Bajroni me talentin e tij të fuqishëm. Bajroni ishte poeti tipik romantik, vepra e tij u shndërrua prej romantikëve në një shembull imitim, madje në një objekt idolatrie. . . Ndoshëta është e vështirë të gjesh një shkrimitar tjetër në letërsinë e shekullit XIX, vepra e të cilit të ketë pasur kaq përhapje dhe jehonë, sa ç'pati poezia e Xhorxh Gordon Bajronit.

Në një pikëpamje, bajronizmi mund të konceptohet si prirje e veçantë shpirtërore e një njeriu, që karakterizohet nga një temperament i çuditshëm dhe shumë kontradiktor, që ndien forca për të dashur gjithçka në botë, po që ka një zemër të plagosur e të zhgënja nga padrejtësia shoqërore, një natyrë që priret gjithnjë nga rreziku, e etur për hakmarrje, një shpirt gjithnjë melankolik, por edhe i ekzaltuar e entuziast, gjithnjë i hidhëruar e rrallë herë i gjëzuar. Në mes tipareve të frysës bajroniane studiuesit kanë vënë re, si ndër më themelorët, subjektivizmin më të theksuar, qëndrimin egocentrik, një prirje të ngulitur thellë për t'i gjykuar ngjarjet dhe njerëzit gjithnjë përmes dispozitiveve vetjake shpirtërore, për ta kthyer unin në të vetmen masë të gjëra. Bajronizmi nuk ishte thjesht pasioni për lirinë, sinjeriteti më i thellë, përbuzja ndaj rrezikut, por edhe një paaftësi pothuajse e çuditshme për t'i dalë ndesh vetvetes, prirja e vazhdueshme për të kthyer subjektin në një masë verifikimi për drejtësinë dhe vërtetësinë e të gjitha ngjarjeve e të sjelljeve të njerëzve. Të gjitha këto nuk mund të mos bëhen shkak që, në këtë karakteristikë të romantizmit, të shfaqeshin qëndrime egocentrike e anarkiste. Shumë prej këtyre tipareve, të cilat sapo i zumë në gojë, u integruan në mënyrë më të plotë ose më të pjesshme në karakteristikat e heroit romantik. Nga analiza që i është bërë gjer tanë poezisë arbëreshe dhe heroit të saj, është vështirë, që të flitet përgjurmë të thella të frysës së bajronizmit në të. Asaj atmosfere

---

1) Paul Van Tieghem, *Vep. cit.*, f. 245, 1969,

melankolike, që përbajnjë veprat e De Radës e të poetëve të tjërë arbëreshë, notave të tragjizmit që i përshkojnë shpesh ato, burimet u duhen kërkuar gjetë. Në gjendjen aktuale të atdheut, në mallin e pashuar për të, në vetëdijen se në trojet ku banonin ishin të huaj, e jo në të ashtuquajturin «pikëllim botëror», që karakterizonte përgjithësisht romantizmin evropian, i cili përbajtjen botëkuptimore psikologjike e shprehu domosdo në shumë vepra romantike, po në mënyrë të veçantë në veprat e Bajronit.

Nga ana tjetër, poetët arbëreshë nuk u bënë bajronidë. Fryma e poezisë së Bajronit, pa dyshim, qe e njohur për ta, po sunduese në veprën e tyre ajo nuk mund të bëhej. Pasqyrimi i aspiratës kombëtare që qëndronte në themel të romantizmit arbëresh, ashtu si edhe të krejt letërsisë së Rilindjes sonë, kërkonte që heronjtë e saj të mbartnin një frymë të theksuar luftarakë, besimin e patundur në fitoren e afërme të lirisë. Ajo kërkonte prej tyre të dinin të vetëmohoheshin, të shkelnin mbi egon, mbi ndjenjat dhe pasionet vetjake. Nga poetët arbëreshë koha kërkonte që të kapeshin fort pas problemit nacional, pas krijimit të heronjve, gjendja shpirtërore e të cilëve të përcaktohej nga dashuria dhe sakrifica për atdheun. Heronj që shihnin çdo gjë me skepticitëm e përbuzje nuk u krijuan dhe nuk mund të krijoheshin prej poetëve arbëreshë; po nga kjo natyra romantike e veprave të tyre nuk humbet gjë.

Subjekti i shumicës së krijimeve të poetëve arbëreshë është vendosur në shekullin XV, në epokën e qëndresës madhështore të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, kundër vërvshimit të hordhive osmane. Nuk është aspak e nevojshme të përsërisim arsyet, që i shtynë romantikët arbëreshë të vepronin kështu, po ndërkaq ky fakt, nga ana e tij, nuk lejonte që ata të kapeshin fort pas trajtimit të problematikës shoqërore, ku do të krijoheshin mundësi për t'u shfaqur tiparet e frysës bajroniane.

Por do të ishte e padrejtë të mohonim krejtësisht disa tipare të kësaj frysme në poezinë arbëreshe. Brendia e veprës së Bajronit krijoji, si të thuash, një lloj doktrine, të cilën thua jse të gjithë romantikët e gjetën të afërt për botëkuptimin dhe predispozitat e tyre shpirtërore. Sigurisht, mungesa e plotë e gjurmëve të ndikimit bajronian në poezinë e Naim Frashërit, nuk e ka prekur aspak karakterin romantik të saj. Thelbi i qëndrimit romantik të Naimit shfaqet në mohimin që i bën tjetës feudale të saj, dhe në përfytyrimin e një Shqipërie të re,

të lirë, demokratike, të përparuar. Šido që poezia e Bajronit ushtroi një ndikim të gjerë, ajo nuk u shndërrua në një *conditio sine qua non*, për të shprehur prirjen romantike në veprën letrare. Natyrisht, ka pasur arsyë që, në një pjesë të veprave të romantizmit shqiptar, në poezinë e Naimit, të Çajupit e të disa autorëve të tjerë rilindës, nuk u ndien fare ndikimet nga poezia e Bajronit. Naimi, Çajupi etj. jetuan e krijuan në një periudhë kur romantizmi evropian e kishte jetuar kohën e vet, prandaj jehona e frymës bajroniane vinte tashmë e pafuqishme. Po nuk është kjo më e rëndësishmja. Naimi, Çajupi e të tjerë, e kuptionin thellë se popullit të tyre i duhej një poezi, heroi i së cilës të dallohej së pari për shpirtin e tij kryengritës, për dashurinë e tij për popullin dhe lirinë e atdheut. Me zhbirime të pafundme në labirintin e subjektit të heroit, me përshkrimin e pasioneve të tij, kontradiktave shpirtërore etj., me të gjitha këto Naimi, Çajupi nuk u morën, jo se nuk qenë në gjendje të bënин një gjë të tillë (në ato raste, kur përshkruan ndjenjat e tyre vehtiakë, ata provuan fare mirë të kundërtën), po pse qenë të angazhuar tërësisht në krijimin e një poezie, që do të pasqyronte çështjen nationale dhe do t'i shërbente asaj.

Letërsia arbëreshe, e zhvilluar më parë (poema «Milosao», një nga kryeveprat e saj, është botuar në vitin 1836, domethënë disa dekada para se Naimi të niste veprimtarinë e tij krijuese), në një vend ku domosdo kontaktet me romantizmin evropian ishin më të mundshme e më të shumta, në disa aspekte të saj ka njojur ndikime nga vepra e Bajronit. A ishin këto ndikime të drejtpërdrejta, apo erdhën përmes pikave të takimit, që letërsia arbëreshe pati me romantizmin evropian në tërësi, kjo është një çështje që nuk zgjidhet lehtë. Sidoqoftë, ajo nuk ka shumë rëndësi, ose të paktën pret për t'u shtruar e zgjidhur në punime të tjera krahasuese më të imta. Këto ndikime shfaqen në karakterin e disa personazheve. Le të kujtojmë në këtë rast Bozdar Stresin, luftëtarin e devotshëm, burrin e rrallë në trimëri, dashnorin e apasionuar, krenarin e zemëruar, që vuan thellë në shpirtin e tij, viktimë e forcave të verbëta e fatale; le të kujtojmë gjithashtu Serafinën, që me vuajtjen e saj kërkon të mundë të gjitha padrejtësitë e paragjykimet sociale, fatin tragjik të Frosinës, e të tjera personazhe të poemave të De Radës. Është një prirje e zakonshme në poemat e De Radës tendosja e pandërprerë e subjektit, që krijon në to një intensitet të veçantë dramatik. Zgjidhja e konflikteve në të gjitha poemat e De Radës shpesh është e paracaktaur nga forca të verbëta, për të cilat vetë heronjtë janë të ndërgjegj-

shëm se shpejt a vonë do të veprojnë. Subjekti në vetvëte, kuptuar si rrëfimi i marrëdhënieve midis personazheve dhe i vazhdimësishë së ngjarjeve nëpër të cilat ata kalojnë, në kriji-met e De Radës pérthyhet vazhdimisht, shpesh arbitrarisht. Në të ndërfuten këngë të veçanta, ngjarje që shkëputen nga linja kryesore e subjektit, madje edhe poema të tëra. Në subjektin e veprave të De Radës ngjarjet zënë pak vend, dhe në përgjithësi, poeti nuk tregon kujdes të veçantë për to. Botës së brendshme shpirtërore të heronjve, ndjenjave, pasioneve, dramave të tyre, këtyre aspektave ua kushton poemat e tij De Rada, ndërsa ngjarjet që përcaktojnë formimin shpirtëror të heronjve, përfytyrohen në mënyrë të atillë, që të vënë më mirë në dukje tiparet e karaktereve të konceptuara me kohë prej poetit. Ishte e zakonshme në metodën krijuese të romantikëve, sidomos në procedurën që ndiqnin ata në krijimin e heronjve, që të vepronin me ta në një mënyrë mjaft të lirë, të prirë fort pas përshkrimit të natyrës shpirtërore, pavarësisht se sjelljet dhe veprimet e tyre mund të qenë kontradiktore, të pamotivuara plotësisht dhe jo shumë bindëse. Shkaqet e asaj mënyre, me të cilën ata krijonin personazhet e veprës së tyre duhen kërkuar në pikëpamjet romantike, sipas të cilave ndjenja Bajëشتë e vëtmja udhëheqëse në jetën e njeriut. Poemat e Bajronit luajtën në këtë mes një rol shumë të ndjeshëm<sup>1</sup>.

\*

\* \* \*

Një ndër karakteristikat themelore të botëkuptimit dhe të psikologjisë së shkrimtarëve klasicistë, ka qenë «epërsia e ar-

1) Në veprën e tij «**Historia e letërsisë shqipe**» II, (Prishtinë 1984 f. 64-67), R. Qosja i gjen më të gjera lidhjet e poeziës së De Radës me atë të Bajronit. Sipas tij, De Rada ka mësuar edhe prej Bajronit të fusë në veprat e veta personazhe me emra orientalë. Shumë nga heronjtë e De Radës, ashtu si ata të Bajronit e të Lamartinit, shquhen me cilësi, sjellje e veprime që nuk kushtëzohen prej zakoneve dhe mentalitetit të një mijedisi konkret. Personazhet kryesore të De Radës janë enigmatikë si ata të Bajronit, heqin shumë fatkeqësi, sepse nuk mund t'u përshtaten kushteve shoqërore në të cilat jetojnë.

Skenat e ethshme, titanizmi epik bajronian, elipsizmi i gjuhës, ëndrrat që parathonë të ardhshmen, thekson R. Qosja, tregojnë gjithashtu lidhjet e poeziës së De Radës, me poezinë romantike, posaçërisht me poezinë e Lamartinit dhe të Bajronit.

shyes», mbi ndjenjën, mposhtja e kësaj të fundit në emër të triumfit të «arsyes», që shpeshherë mishërohet te detyra ndaj shtetit. Në jetën shpirtërore të heronjve të veprave klasiciste, dilema, lëkundja midis ndjenjës dhe detyrës, përfundon gjithnjë në një lloj ekuilibri të shpirtit, që nuk lejon shpërthimin e ndjenjave dhe pasioneve. Doemos, kjo i shpinte shkrimtarët klasicistë në pranimin e jetës ashtu siç qe, në pajtimin e plotë me të, pavarësisht nga plagët e saj të shumta. Pikëpamja este-tike e klasicistëve, sipas së cilës e bucura nuk ndryshon në kohë dhe se në bazë ka harmoninë, ishte refleks i drejtpërdrejtë i qëndrimit politik që ata mbanin: monarkia absolute shënonë etapën më të lartë e më të përsosur të organizimit shtetëror. Kjo pikëpamje politike, si edhe ndjekja e racionalizmit filozofik, nuk mund të mos i shpinte veprat klasiciste në zgjidhje aprioristike të problemeve që shtronin, në një lloj analogjie në konceptimin e personazheve, në krijimin e disa klishevë, që konvergonin në tri unitetet e njobura. Pasqyrimi i përpjekjeve për krijimin e një shoqërie të re, shpesh nuk ka vend në letërsinë klasiciste; aty sundon predikimi për përsosjen morale, nëpërmjet mposhtjes së ndjenjave dhe pasioneve, synimi drejt virthytit kristian.

Ndryshe ndodh në letërsinë romantike. Shkrimtarët romantikë e shndërruan lektisjen pas ndjenjës në një mënyrë për të sfiduar mënyrën borgjeze të jetesës e cila, sipas tyre, po e përthante njeriun, po e bënte cinik. Racionalizmi i ashpër që e vyshkte botën shpirtërore të njeriut, për romantikët ishte një shenjë e sigurt e degjenerimit të shoqërisë borgjeze, bazën e së cilës e përbën të fituarit me çdo kusht, me çdo mjet, duke shpërfillur pa mëshirë ndjenjat dhe virthyet morale. Një letërsi si ajo klasicistja që, sipas romantikëve, fetishizonte «arsyen» dhe përpinqej të përshkruante mposhtjen e ndjenjës dhe të pasionit, ishte e papranueshme. Prandaj në veprën e romantikëve roli i «arsyes», si drejtuese kryesore dhe e vetme e shpirtit dhe e psikologjisë të njeriut, nis të zvogëlohet; ndjenja bëhet e vetmja masë e gjérave, i vetmi tipar që dallon një shoqëri me të vërtetë humane. Për shkrimtarët romantikë, ndjenja, të dhënët pas saj, është mbështetja më e sigurt e jetës njerëzore. Madje, mendimi mund të fitonte vlerë vetëm në qoftë se bashkohej me ndjenjën, jashtë së cilës ai nuk mund të ekzistonte. Kollrixhi, romantiku i njobur anglez, më 1801 shkruante se një mendim i thellë mund të kuptohet vetëm nga një njeri me ndjenjë të thellë. Në kundërshtim me shkrimtarin klasicist, që hyn në jetën reale, i udhëhequr nga «arsyeja» e

shëndoshë, burim i qetësisë shpirtërore, për romantikun ekzistojnë vetëm ato fenomene, që mund të ekzaltojnë ndjenjat e tij, të tjerat janë antinjerëzore, të papranueshme, që duhen luftuar. Dashuria, pasioni për bukurinë e gruas, sipas shkrimtarëve romantikë, është ndjenja më e thellë, me të vërtetë njerëzore, një pasuri e vërtetë shpirtërore, pa të cilën jeta e njeriut nuk ka asnë vlerë, nuk ka asnë kuptim. Pa dyshim, dashuria, si gurrë frymëzimi, ka qenë gjithnjë fort e gjallë në letërsinë e pothuaj të gjitha epokave dhe vendeve, po në veprën e romantikëve, përshkrimi i saj në të gjitha vibracionet, merr rëndësi të veçantë në kuadrin e kundërvënies së fuqishme të ndjenjës romantike ndaj racionalizmit të klasicistëve. Po kjo kundërvënie nuk kishte vetëm shkaqe thjesht letrare; ajo përbante një domethënie të thellë ideore, sepse, siç e vumë në dukje, ndjenja për shkrimtarët romantikë përbente një antipod ndaj shoqërisë aktuale, një tregues të rëndësishëm të shoqërisë së ardhshme.

Në poezinë arbëreshe përshkrimi i ndjenjës së dashurisë zë një vend shumë të gjerë, në mënyrë të veçantë në veprën e Zef Serembes. Vjershat që trajtojnë motivin e dashurisë, bashkë me ato që trajtojnë motivet filozofike, përcaktojnë në një shkallë shumë të ndjeshme personalitetin e tij poetik. Dihet se romantiku arbëresh i këndoi një dashurie që e jetoi vetë, e cila u shndërrua në një burim hidhërimesh për jetën e tij të shumëvaujtur:

*E kur fatin tim kujtoj,  
Derdh un'lot e pshertoj;  
Plag' e rëndë s'hiqet dot,  
Që më bëre ti qëmot<sup>1</sup>.*

Kjo është një ndër shkaqet që vjershat e Serembes me motivin e dashurisë dallohen për një sinjeritet me të vërtetë prekës. Që këtej rrjedh ajo notë elegjiake, që, me përjashtime të rralla, karakterizon në tërsi lirikën e tij erotike. Ideali për vajzën e dashur ka trajta shumë konkrete, sepse poeti gjithmonë e kërkoi dashurinë në tokë, midis njerëzve, në jetën e bashkëfshatarëve të tij. Prandaj përfytyrimet e Serembes e bashkëfshatarëve të tij.

1) Zef Serembi «Vjersha», përshtatur në gjuhën e sotme nga Ziaudin Kodra, Tiranë, 1962, f. 35 Citimet e tjera nga kjo poezi do të janë të këtij botimi.

për të dashurën qëndrojnë larg çdo konvencioni estetik dhe afrohen e janë fare të ngjashme me karakteristikat e vashës së këngëtarit popullor. I edukuar e i brumosur me normat etike të popullit, Serembja nuk e shihte dashurinë vetëm në aspektin hedonistik, përkundrazi, ashtu si edhe këngëtari popullor, ai kërkonte të mbështetej te dashuria si te një forcë jetëdhënëse, e shikonte si burim lumturie, madje si të vetmin burim të lumturisë, e konceptonte si një impuls të fuqishëm shpirtëror që frysmezon guxim e kurajo. Dashuria e poetit është e thellë, fisnike, që s'pranon asnjë lloj aventure, që i reshetet çdo lloj sensualizmi. Kjo nuk do të thotë se dashuria është vetëm platonike, ajo nuk konceptohet prej tij si diçka gati-gati hyjnore. Larg voluptetit, larg frysmez libertine, ajo mbetet gjithnjë e natyrshme, tokësore. Për poetin, vajza është si një trinitet, ku shfaqet bukuria fizike, kthjelltësia shpirtërore e morale, si dhe mundësia e krijimit të një familjeje të pastër e të qëndrueshme:

*Kushedi tek ti a foli  
 malli zemrën a ta ndolli?  
 Me gjith'zemër un'të dua  
 se fort më pëlqeve mua.  
 Ti me mua, vashëz, eja,  
 se të dua si vehteja  
 Tok të rrojmë te ky dhe,  
 si në zi e në hare.  
 Tok të rrimë në rini  
 tok edhe në pleqëri.*

(Kënga e mallit të parë, f. 23)

Në përfytyrimet poetike të Serembes, bukuria dhe gjiltërsia e vajzës nuk vishen me ndonjë kurorë hyjnore, të paprekshme; ato i shërbejnë një shfaqjeje të zakonshme të jetës së përditshme:

*Për natë, tash që u mbledha në shtëpi,  
 Te dera jote si bilbil këndo.  
 O faqemollë, o vash'me synë e zi,  
 Ta shkoj jetën me ty un'dëshiroj.*  
 .

(Më të bukurës që është në Strigar, f. 41).

Në këtë udhë të të konceptuarit të dashurisë, Serembja krijon përshkrime sa të thjeshta aq edhe të gjalla, të cilat janë një veshje krejt spontane dhe thellësisht e frymëzuar e ndjeknave që jetonte vetë poeti:

*E prerë, e holl' si kumbull, drejt më rri:*

*Kur ecën, shkon si zogë e mbasë më,*

*I ndan flokët në mes dhe rrëthas vë,*

*Gërshtetin që i shkëlqen krejt në të zi,*

*I feks balli që rrëze drite zë,*

*Si gryka e detit n'agim'n e ri.*

(Fytyra e asaj, f. 103)

Në poezinë e Serembës me motivin e dashurisë, ndjenja është elementi themelor, asaj i nënshtrohet çdo vëzhgim tjetër poetik; ndjenja, përshkrimi fort i pasionuar i saj, bën që në lirikën e tij të dashurisë, të mos ketë vend për shfaqjen e qëndrimeve thjesht moralizuese.

Zef Serembe kreu një odise të tërë në kërkim të dashurisë, ai e shndërrroi atë shpeshherë në të vetmin realitet të botës, e vërteta e të cilit qëndronte, sipas poetit, në mundësitë që krijon, që edhe njerëzit e vuajtur e fatkëqij të mund të gjëzojnë një cak qetësie e lumturie.

Shumë vuajtje e mundime të rënda shpirtërore përshkruhen në këto vjersha të Serembës, aq sa nuk mund të mos arihet në përfundimin se poeti më tepër se dashurisë si të tillë, i këndon dhimbjes që shkakton humbja ose mohimi i saj:

*Vashë, syt'm'i përvëlove,*

*unë të desha, ti më zbove.*

*Je si një tufan që shkrep,*

*Flaka jote më rrëmbeu,*

*kurm e shpirt më dogji e preu.*

*Shkove e zjarri që më le*

*më bën hi, më fut në dhe.*

(Këngëtari dhe bilbili, f. 98)

Sidoqë nuk e koncepton tragjikisht dashurinë dhe nuk e quan atë si një fatalitet, i cili i shkakton vetëm dhimbje atij që bie në grackën e saj, prapë një depresion i rëndë shpirtëror i përshkon thellë këto vjersha. Gëzimi i poetit tretet shpejt, që në përplasjen e parë të ëndrrave të tij me realitetin e shurdhër dhe atëhere pëlçet hidhërimi i pafund e i pashpressë. Që këtej shpërthen një frymë pesimiste trishtimi, shpeshherë me të vërtetë mbytëse. Duke e konsideruar dashurinë si realitetin unik të botës, duke e quajtur atë si të vetmen rrugë që siguron lumturinë, si të vetmen urë që shpie gjer në mbijetesë, për Serembernështë krejt e natyrshme ta quajë humbjen e saj si një katastrofë të pandreqshme, pas së cilës vdekja eshtë i vetmi ngushëllim:

*O vashëz faqekuqe, qysh aherë  
Unë po qaj me lot e me dënesë,  
Se pa ty e ndjej veten krejt të mjerë,  
Nuk di ç'është paqa dhe rroj pa shpresë,  
Dhe vetëm varri do të jetë i lehtë,  
Kur i harruar do të jem në jetë.*

(Më të bukurës që eshtë në Strigar, f. 41)

Domosdo, në këto raste poezinë e Serembes e mbulojnë mjegullimi e ngjyrat e errëta, bota e tërë vjen e humbet konturet, përmasat, çdo gjë hyn në tymnajë, bëhet opake, poeti mposhtet tërësisht ngajeta. Vegimi i së dashurës që vdiq larg, e gjallëronte vetëm për një çast poetin, që ishte plotësisht i ndërgjegjshëm për karakterin efemer të fanitjes që përfjetonte:

*Një yll i bukur m'u shfaq,  
S'ish një yll, po ish një vashë,  
  
Po ti, vashë, s'më dëgjon, se lart  
Tani më rri! Dhe ty  
Unë kot të flas, këndoq e qaj,  
Duke pritur me dëshirë,  
Të më vish në ëndërr, o mall.*

(Elegji, f. 79, 81)

E kaluara, vetëm ajo, kujtimet e saj që janë të lidhura gjithnjë me figurën e së dashurës e ngazellejnë, përndryshe e sotmja e ndrydh poetin, ajo nxin krejt për të:

*Ahere kjo botë  
Ish si dashuria për mua; i zhytur  
Unë rrija në atë gëzim të madh.  
Gëzimet dhe hareja më ranë  
Te lumi që m'i mori.*

(Elegji, f. 79).

Dashuritë e fuqishme, pasionet fatale, mbushin edhe poezinë e Jeronim de Radës. Milosaoja dhe Rina, Bozdari dhe Serafina, Vantisana dhe Monusku, Miloshini dhe Agata, Gavrila dhe Gjakoviti, të gjitha këto cifte kalojnë nëpër shumë vuajtje, që shpesh nuk vijnë për faj të tyre. Në veprat e De Radës dashuria gjithnjë përfundon tragjikisht. Në mënyrë të veçantë, kjo bie në sy në poemën «*Skënderbeu i pafanë*», ku veprojnë një mori personazhesh, të cilat janë vizatuar në shumë aspekte dhe sidomos në pasionet e tyre të thella të dashurisë. Që në këngën e parë të poemës, është dhënë dashuria e Vantisanës, motrës së prijesit turk Gjibraltar, me Monuskun, luftëtar në ushtrinë e të vëllait. Kënga e dytë e librit të parë, gjithashtu merret me përshkrimin e dashurisë midis Serafinës e Bozdarit. Motivi rishfaqet prapë në këngën e katërt, ku flitet për dashurinë e Violeta Oderizit me të riun turk Algazil. Përsëri në librat e tjerë të poemës, ky motiv do të jetë ndër më kryesorët. Pothuajse gjithë personazhet, ata që zumë në gojë më lart e tjetër si Frosina, që dashuron heshturazi e plot pasion Skënderbeun, Goneta, e cila shikon në dashurinë e saj për Astirin, të vetmen fije, që e mban lidhur me jetën, Gavrila dhe Gjakoviti, që të gjithë vuajnë thellë, kalojnë në shumë brenga, përfundojnë në vdekje tragjike për shkak të dashurisë së tyre. Kështu Vantisanën e kafshon një qen i tèrbuar, Goneta vdes, pasi merr vesh vdekjen e të dashurit të saj, Astirit; ndërsa Frosina, e mbyllur prej kohësh në haremin e djalit të sulltanit, kur merret vesh dashuria e saj për Skënderbeun, dënohet të vdesë e copëtuar prej një luani. Për t'i shpëtuar këtij fundi të tmerrshëm, ajo hidhet në liqen.

Cilat të kenë qenë arsyet e një qëndrimi të tillë nga ana

e poetit? Do të jetë gabim, po të mendohej se De Rada, i ndikuar prej veprave të disa shkrimtarëve romantikë evropianë, do ta ketë konceptuar gruan si një qenie që nga natyra e saj bëhet shkak vuajtjesh e tragedish fatale. Përkundrazi, për De Radën dhe jo vetëm për të, por pér të gjithë poetët arbëreshë, gruaja është një kriesë që fisnikëron dhe forcon shpirtin e të dashuruarit, burim i vërtetë lumturie. De Rada nuk e mendon dashurinë si një mëkat që shton mundimet e njeriut mbi këtë botë, të cilat, sipas tij, edhe kështu janë të tepërtë.

Po atëherë cilat kanë qenë shkaqet, që e shtynin t'i përfundonte ashtu, vetëm në mënyrë tragjike, dashuritë e thella e pasionante, që përshkruan në poemat e tij? Nuk është e lehtë të zhbirosh në këto shkaqe, po sidoqoftë një prej tyre duhet të ketë qenë bindja e poetit se dashuria, realizimi i së cilës të shpie vetëm në krijimin e lumturisë personale, nuk mund të mos binte ndesh me dramën që jetonte atdheu, e cila qe aq e thellë, aq e rëndë, saqë myllte çdo shteg për triumfin e ndjenjës e të pasionit. Nga ana tjetër, koncepti i De Radës për dashurinë është në të njëjtat ujëra me mendimet që përgjithësisht mbanin romantikët. Për ta, dashuria ishte diçka hyjnore, që bekohej nga zoti, ajo ishte jo vetëm një pasion i papërmbaratur, por njëkohësisht edhe një virtyt<sup>1</sup>. Një dashuri e singertë nuk mund të mos ishte njëherazi e pastër, fisnike, edukuese. E tillë siç qe, ajo nuk mund të mos binte ndesh me jetën, që vlonët nga pasionet e egra për pushtet, për para, nga ligësia, vesi, bataku. Nga kjo ndeshje, dashuria e virtuti dilnin pothuajse gjithnjë të dërrmuar, njerëzit që i mbartnin hiqnin shumë, pasioni i shpinte në një fund fatalisht tragjik. Vetëm moralisht ata fitonin. Dashuria, për romantikët, i takonte së ardhmes së buktur, një e ardhme për të cilën ata vetë shpeshherë ishin skeptikë.

Dihet gjithashtu, se romani «Vuajtjet e Verterit të ri» i Gëtes, me përhapjen dhe ndikimin që ushtroi në ato kohëra kur doli, u shndërrua në një ushqim shpirtëror për të gjithë romantikët që gjenin te pasioni i Verterit një nga shenjat më të para të njeriut të shoqërisë që ëndërronin.

Si shumë romantikë, De Rada mendonte se poezia, duhej të gjente frymëzim, veç të tjerave, në vuajtjet e jetës së njeriut, së cilës i turret vazhdimisht fati i egër.

1) Paul van Tieghem, vep. cit. fq. 241.

*Për sa kohë që fryshtimi i gjallë të jetë  
do t'këndo vargje t'dhimbshme e mundimet  
me t'cila Fati s'e lë njerinë të qetë.*

(Vepra letrare 1, f. 200)

Ishte fare e natyrshme për një pikëpamje të tillë, që ta përshkruante edhe dashurinë më fort në trishtimet që shkaktonë, se sa në bukurinë e në gëzimet e saj, të cilat, sipas romantikëve ishin fatalisht ditëshkurtëra.

Më në fund, disa hollësi, tashmë të njohura të jetës së poetit kanë luajtur pa dyshim një rol fort të ndjeshëm për qëndrimet që mbajti ai ndaj gruas dhe dashurisë.

Brishtësia e «*Milosaos*» gërshtohet më pas me prirje të theksuara meditative etike që shfaqen sidomos në poemën «*Pasqyrë e një jete njerëzore*», ku theksohen më tej notat e dhimbjes; një tis i vazhdueshëm trishtimi shoqëron kudo protagonistët, fara e humbjes, e tragjikes shfaqet shpejt, që në çastet e lindjes së dashurisë midis të rinxve. Shumë më i formuar si artist, De Rada tani, pa e cënuar aspak natyrën lirike të poezisë së vet, ka ardhur duke e pasuruar atë me thekse epike, që synojnë të përgjithësojnë kohën, ngjarjet dhe njerëzit.

Në poemën «*Pasqyrë e një jete njerëzore*» poeti e ka zgjegruar mjaft vizionin për njeriun e thelbin e jetës së tij. Tani dashuria mund të mposhtet, vërtet pa u marrë nëpër këmbë e me dhimbje të thellë, po sidoqoftë, mund të mposhtet në emër ndjenjash të tjera po aq të thella. Shpirtërisht, De Rada kurrë nuk pajtohet me humbjen e saj, po ai nuk e quan dashurinë si të vërtmen ndjenjë për të cilën vlen të jetohet. Njeriu, sipas De Radës, mund dhe duhet të jetojë, edhe kur për të është shuar dashuria, burimi i lumturisë; ai mund dhe duhet të jetojë edhe pa qenë i lumtur: vlera e jetës së tij nuk qëndron në sigurimin e lumturisë vetjake, atë e mbushin e i japin kuptim një varg shqetësimesh të tjera më të rëndësishme.

Duke folur për figurën e Serafinës, studiuesit janë të mendimit se ajo e sakrifikoit dashurinë për hir të interesave të bashkimit të krerëve e krahinave të Shqipërisë, në të mirë të luftës kundër pushtuesit turk. Vetë De Rada, që e ka rimarrë Serafinën edhe tek poema «*Skënderbeu i pafan*» në argumentin e këngës së dytë të librit të katërt, shkruante: «Në martesën e Dukagjinit me të bijën e Topiajve që kremluar vllamia e Shqipërisë së Epërme dhe asaj të Poshtme». (Vepra letrare, 2, f. 371).

Pa dyshim, kjo pikëpamje është e drejtë; megjithatë do theksuar se arsyet, që e shtynë Serafinën të sakrifikojë dashurinë e saj, janë më komplekse. Në vendimin që ajo mori për t'iu nënshtuar dëshirës së prindërve, ka ndikuar edhe forca e jetës zakonore të atyre kohërave, po në mënyrë të veçantë botëkuptimi i saj, që i impononte bindjen, përuljen, në emër të «harmonisë» midis njerëzve, të «mirëkuptimit» e «paqes» midis tyre. Ajo ishte poeteshë, pra, sipas De Radës, e paraçaktuar që me mendimin, sjelljen e fatin e saj, të udhëhiqte të tjerët në rrugën e së mirës, të harmonisë, qoftë edhe duke ecur mbi ndjenjat më të thella. Në krijimin e figurës së Serafinës shfaqet edhe një herë fare qartë prirja e zakonshme e poetëve romantikë për të kërkuar kontrastin, dramën. Nga ana tjetër, vitet, në të cilat i vendos De Rada subjektet e poemave të tij, ishin në vetvete një dramë e madhërishme, që nuk mund të mos shkaktonte drama të dhimbshme në fatet e njerëzve që i jetuan. Shpirtërisht poeti nuk e miraton veprimin e heroinës së tij, ai e quan vashë të lindur për të mos qenë e zonja e fatit të vet, madje, në ndonjë rast, edhe besërrreme. De Rada, artisti i madh i ndjenjës, nuk mund të mos provonte një dhimbje të thellë tek e bënte heroinën e tij të sillej ashtu siç u soll. Që këtej, veç të tjerash, lind pastaj ajo ndjenjë trishtimi, ajo notë tragjizmi, që s'i ndahet poemës gjer në fund. Më tej, në arsyetimet për këtë veprim të heroinës së poemës, është e vështirë të shtyhem.

Edhe te poema «**Kënga e sprasme e Balës**», kryevepra e Gavril Darës së Ri, subjekti ka në themel një histori dashurie, dashurinë midis Nik Petës e Marës, bijës së Kaurrit, princit të Lalës. Ndryshe nga veprat e Jeronim De Radës, në poemën e Darës kjo ndjenjë është pëershkuar në mënyrë më të thjeshtë. Dara nuk para i ndërlikon personazhet e situatat. Lëkundjet, përsiatjet shpirtërore te heronjtë e tij janë kapërcyer, ata vendosin në përgjithësi shpejt për fatet e tyre, pengesat që u dalin në realizimin e dashurisë i kalojnë gjithashtu shpejt e me vendosmëri.

Episodi i këngës III, («**Kënga e hënëzës**»), në të cilën plaku Darë e qorton Nik Petën, që ka rënë në dashuri me Marën, një vashë të huaj, dhe arsyetimet e Nikut për të, e shtyjnë studiuesin të shikojë se mos vallë në këtë poemë shfaqen ndikime të klasicizmit. Po për të dhënë gjykime sa më të sakta për këtë çështje, është e nevojshme të ndjekim nga afër diagun midis plakut Darë dhe Nik Petës. Në qortimet e Darës bie në sy shqetësimi, se vllastari i Petajve kërkon të martohet

me një vajzë nga një vend i huaj, sundimtarët e të cilët u përmbyssën të gjithë prej turqve dhe tanë kanë rënë në një gjumë të rëndë. Vitet që ka mbi shpatulla e bëjnë plakun të druhet nga kjo dashuri, jo vetëm sepse vajza është e lindur në një vend të huaj, por edhe sepse është irritur mes pekulesh, e adhuruar nga njerëz të këqij, të cilët sipas tij, nuk mund të mos kenë ndikuar në karakterin e saj. Kjo e huaj nuk ka të krahasuar me:

*Gratë tona me nder rritur;  
S'kërkojn'fushëzat me lule  
As nuk duan flladnë e hollë,  
Por veç dimrit i gëzohen,  
Tmerri i pyjeve u pëlqen  
Edhe deti që gjëmon;  
Për ato jan'dasmë luftrat  
Prandaj syresh lindin trimat.*

(Kënga e sprasme e Balës, f. 35)

Pikërisht për të gjitha këto virtute të gruas shqiptare, Dara këshillon:

*Dushku i Petës, këtu kthehu  
E nga rrënya e dheut tënd  
Mblidh burbuqe e trëndafila:  
Gjetkë s'gjen èndë të mirë,  
Pse të zu ty zekthi i huaj?  
Ndërsa bota errësohet,  
Harro kezën... ja, t'vret sytë  
Zbardhëllimi i shpatavet'.*

(Kënga e sprasme e Balës, f. 35)

Nga fjalët e Darës del fort qartë se plaku është i shqetësuar, jo vetëm ngaqë djali është dashuruar pas një të huaje, por edhe ngaqë i dhënë pas dashurisë, mos po harron vringëllimën e shpatave dhe britmat e luftës. Plaku nuk e pranon dot këtë dashuri, ajo shkonte ndesh me zakonet e vendit, prandaj Niku duhet të heqë dorë, në qoftë se nuk do që të marrë mbi vete zemërimin e miqve të tij.

Le të ndjekim edhe arsyetimin e Nikut:

*Iu gjegj Niku buzëqeshur  
 E i tha: «Në luftë shpesh  
 Vajtur kam e shumë herë  
 Thembrat t'ikurve u kam shkelur;  
 Dita gjithë djersë e nderit  
 Përher'më shkëlqeu mbi ushtë,  
 Veç lëvdimeve u jem ruajtur;  
 Tek ky gjii kumbon një zë,  
 Një zë i fort', veç unë e ndjej,  
 Vetëm n'vrasje gjithmon' zemra  
 Do më shkojë? Dhe, kur ngirë  
 Prehet kordha, faj do quhen  
 Të kthiellat mendime?  
 Po ta them: Un' dua një vashë,  
 Dua një vash'të mir', të ndershme,  
 Që është flakë e nuk më shuan;*

(Kënga e sprasme e Balës, f. 36)

A mund të besohet që në këto arsyetime të Nikut, poeti të ketë dashur të shprehë kundërshtitë midis paragjykimit dhe mendimit të çliruar prej tij? Kjo hamendje zor të qëndrojë, pasi fjalët e plakut Darë nuk janë paragjykime, në to ka shumë të vërteta. Niku, siç thotë vetë, kurrë nuk ka harruar detyrën e tij, dhe «mendimeve të kthjellta» të dashurisë ai u kushton kohën midis betejave. Dhe vërtet, dashuria e tij e thellë për Marën, jo vetëm që nuk e pengoi të luftonte në betejën e Valkalit (1465) e të jepte atje jetën, por edhe nuk i ngjalli kurrë as më të voglën lëkundje, asnje çast harrimi e përhumbjeje. Nikun kurrë nuk e mundoi ndonjë dilemë; për të shpata, detyra është e shenjtë; por kjo nuk e pengoi që të dashuronte me të gjitha forcat e shpirtit të tij Marën e mirë e të bukur. Prandaj është e vështirë të pranohet, që në poemën «Kënga e sprasme e Balës» është i pranishëm konflikti midis detyrës e ndjenjës, është vështirë pra, të flitet për ndikime të dukshme klasiciste në të. Po atëhere, si duhen shpjeguar të gjitha këto momente të subjektit, që kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve? Pas shumë gjasash në to, nuk duhet parë gjë tjetër, veçse një prirje e rëndomtë romantike, prirja drejt dramatikes, drejt kontrasteve të fuqishme, qëndrimeve fataliste. Po të shtojmë këtu, si një arsyе tjetër, ndikimin që duhet të ketë ushtruar mbi veprën e Darës poezia e De Radës, atëhere janë të kuptueshme ato momente të subjektit, për të cilat bëmë fjalë më sipër.

Për Gavril Darën e Ri dashuria ndaj atdheut, me karakterin sublim të saj është e tillë, që nuk lejon asnje ndjenjë tjetër të hyjë në konflikt me të, prandaj për poetin nuk mund të shtrohej ndonjë kundërvënie midis detyrës ndaj atdheut dhe ndjenjës. Në të vërtetë, ai nuk e shtron, dhe nga kjo poema nuk humbet gjë; përkundrazi, ajo mbetet një nga krijimet më të fuqishme të letërsisë sonë të Rilindjes për patosin e saj patriotik, për karakterin kushtimitar, për forcën e rrallë të fjalës artistike.

Siq është pranuar përgjithësisht, romantizmi rizbuloi epo- set kombëtare, po edhe poetët kalorsiake. Nga kjo pikëpamje mundet që episode të shkëputura të poemës e disa tipare të karakterit të Nik Petës të kujtojnë tipare të eposit kalorësiak. Po kjo nuk do të thotë se në konceptimin e figurës së Nik Petës, shfaqen të thella ndikimet prej eposit kalorësiak. Një krahasim i shpejtë midis figurës së Nik Petës dhe figurës së kalorësit të mesjetës, nxjerr në shesh ndryshime të mëdha. Qëllimi i vetëm i sjelljes së një kalorësi të albave, është të fitojë zemrën e një dame të fisnikërisë aristokratike, sepse vetëm kështu ai mund të meritojë titullin e kalorësit. Një figurë e tillë nuk mund të vihet në asnje mënyrë krahas madhështisë morale të Nik Petës apo të Pal Golemit. Në qoftë se në disa prej veprimeve të Nikut, si nisja e tij në vise të tjera për të fituar lavdi, ndeshja me Pal Golemin për shkak të Marës dhe të tjera si këto, vihet re një lloj ngjashmërie me veprimet e figurave të eposit kalorësiak, këto kanë të bëjnë më tepër me dëshirën që kishte vetë Dara, për ta paraqitur poemën si «krijim» të rapsodit Balë. Për ta bërë sa më të «besueshëm» mistifikimin e tij, Darës ia donte puna, që t'i jepte poemës disa tipare, që të kujtonin krijime të shekujve XV dhe XVI.

Në pajtim me frymën e letërsisë romantike edhe ndër romantikët arbëreshë ndjenja e dashurisë shihej si një shfaqje e përhershme e natyrës së njeriut, gjithmonë e fuqishme dhe e thellë, në prirjen e vet burim lumturie, madje shpesh i vetmi burim i lumturisë, por ndërkokë edhe shkak i vuajtjeve të rënda, i tragjedive fatale, i trishtimit e i melankolisë, të cilat vinin sidomos nga ndeshja e saj me realitetin, me ambientin. Dashuria për romantikët arbëreshë ishte gjithmonë një ndjenjë thellësisht fisnike, që s'kishte të bënte fare me erotizmin, ajo pastronte shpirtin e të dashuruarve, i bënte ata më të pasur, më të kthjellët, ishte e vetmja udhë që shpinte në krijimin e familjes si një organizëm thellësisht njerëzor, që, sipas tyre, miratohej e bekohej gjithnjë nga zoti. Pikëpamjet e disa ro-

mantikëve, që e quanin martesën një lloj hipokrizie shoqërore, që lirinë absolute të dashurisë e konsideronin më të moralshme se martesën, e cila, për ta, ishte një farë skllavërie, të gjitha këto nuk lanë as më të voglën gjurmë në mendimin romantik të poetëve arbëreshë.

Me temperamentin e tyre kritik, romantikët shihnin në martesën borgjeze një kontratë, që ishte krejt e huaj për dashurinë e vërtetë. Edhe Sheli, në krijimet e tij të para, e quante martesën si një lidhje të kundërt me dinjitetin e njeriut, që e detyron atë të hiqet sikur e dashuron, edhe atëhere kur ai nuk ndjen më asgjë. Po në disa raste këto pikëpamje i shpunë disa prej romantikëve në qëndrime nihiliste ndaj familjes.

Për romantikët arbëreshë, ashtu si për shumë romantikë evropianë, gruaja ishte një kriesë ëngjëllore, e përsosur, e çiltër dhe e thellë në ndjenja, e fortë në brishtësinë e saj. Burim bukurie shpirtërore e fizike, gratë që përshkruanin në poezinë e tyre romantikët arbëreshë, ishin të denja për pasionet e fuqishme, që ngjallnin në zemrën e të dashurve. Në poezinë e De Radës, në ményrë të veçantë figurat e grave, me përrash-tim të Rinës, kanë edhe shumë shqetësimë të tjera veç dashurisë; që venë gjer në flujimin e lumturisë së tyre për fatet e atdheut, për fatet e të afërmve të tyre; ato interesohen për probleme të rendit filozofik, moral etj. Domosdo, sfera e veprimtarisë së tyre është në përgjithësi e ngushtë, brenda caqesh të kufizuara e në radhë të parë brenda familjes, po sidoqoftë romantikët tanë nuk e trajtuan kurrë gruan si qenie të seksit të bukur a të dobët, për të cilën dashuria është kufiri *non plus ultra* i ëndrrave të saj; përkundrazi, në disa krijime të Serembës e të De Radës, ajo konceptohet si një qenie komplekse, e denjë për të luajtur një rol me të vërtetë të rëndësishëm në jetën shoqërore.

Për romantikët arbëreshë ishte krejtësisht i huaj qëndrimi i disa prej romantikëve evropianë, që e konsideronin gruan si një kriesë ferri, si një djall që sjell vetëm të këqija, si një qenie fatale, shkak tragjedish të rënda. Për ta, gruaja mbeti gjithmonë një kriesë gati-gati hyjnore, mishërimi më i plotë i bukurisë, i pastërtisë shpirtërore e morale. Përfytyrimet e romantikëve arbëreshë për gruan qenë fare të afërtë me përfytyrimet e popullit dhe pikërisht në këtë afërsi duhet kërkuar e gjetur shkaku kryesor që ka mënjanuar në mendimin e praktikën letrare të romantikëve arbëreshë shumë prej koncepteve të romantikëve evropianë. Dashurinë dhe familjen e ngritur mbi

të, romantikët arbëreshë, ashtu si dhe populli në këngën e tij, nuk i ndërlikonin, por i shihni si një shfaqje të zakonshme e krejt të natyrshme të jetës njerëzore. Në ndonjë rast, siç ndodh, për shembull në disa krijime të Zef Serembes, figura e gruas mistifikohet në një farë mënyre, po, përgjithësisht, poetët arbëreshë nuk u shtynë në meditime të shumta mbi natyrën e dashurisë e të gruas. Ata i kushtuan vërtet një vend të gjerë ndjenjës në përgjithësi, dashurisë në veçanti, por zakonisht nuk u dhanë e nuk u harruan pas saj, sepse e kuptuan drejt që përpara tyre dhe letërsisë që po krijonin, qëndronin çështje shumë më të prehta, zgjidhja e të cilave kishte të bënte me fatet e mëtejshme të kombit shqiptar.

## TROJET E TË PARËVE DHE NATYRA E TYRE.

Eshtë një e dhënë shumë kuptimplotë, që në afro 1100 vargje të poemës «Milosao», rrëth 200 prej tyre merren me përshkrimin e natyrës. Gavril Dara dhe Zef Serembe gjithashtu, në krijimet e tyre i kushtojnë një vend të gjërë natyrës.

Shkrimtarët romantikë, këta njerëz që s'pajtoheshin dot me shoqërinë e kohës, me mënyrën e saj të jetesës, me mendësinë, që sundonte në aktualitetin borgjez, përpinqeshin me të gjitha mënyrat ta thellonin greminën që i ndante ata nga realiteti, të shkëputeshin prej tij përfundimisht, për të krijuar një botë të tyren, me karakteristika të tjera intelektuale, morale, shpirtërore. Ky qëndrim do t'i shpinte diku romantikët, të cilët turreshin të etur në gji të natyrës, që ishte dhe një ndër arsyet kryesore që i shtynte drejt vendeve ekzotike.

Tek kërkon të shprehë tallazet e shpirtit të Serafinës, vuajtjet e saj të pafundme, De Rada i drejtohet natyrës:

*Fushash bulkhet tertiérinin  
edhe prehje s'mund të gjenin  
as edhe natën, . . . . .  
N'erë zogjtë e barit ftohtë,  
sikur të ndjenin ç'andralla  
kishtejeta, sa cicrisnin.*

(Serafina Topia, f. 252)

Vetëm në natyrë Serembja kërkon e gjen shembelltyrën e qenies së tij:

*Dhe qëndrova si trungu që rri  
Në pyllin përkundrejt  
Diellit: i zi qëndrova*

*Rrojta si guri i lumi,*  
*Që s'pyet se kush e çan.*

(Elegji, f. 79)

Pothuajse në çdo rast, kur kërkon të ravijëzojë një tablo, të përshkruajë një betejë, të poetizojë një ndjenjë, Gavril Dara u drejtobhet shfaqjeve të natyrës:

*Ja ku mjegulla errët*  
*Rrukulliset mal më mal!*  
*Sa lind dielli malit t'Gropës,*  
*Tundet, qesh i thelli shpat,*  
*Porsi ti e bardhë, e kthjellët,*  
*Cipëza e qiellit shtrihet*  
*Me një rrëth-o të pasosur,*  
*E rimët si ninëza jote.*

(Kënga e sprasme e Balës, f. 23)

Romantikët arbëreshë shpeshherë e përshkruajnë natyrën në mënyrë të atillë, që e bëjnë t'u përgjigjet edhe dridhjeve më të imta të ndjenjave të tyre. Janë fare të rralla këngët e poemave «Milosao» dhe «Kënga e sprasme e Balës», të cilat nuk përbajnë vokacionin e natyrës. Pothuajse në çdo rast gjëzimi, optimizmi, vuajtjeje, trishtimi apo malli, ata do t'i kthehen natyrës, e cila është shumë e afërt për zemrën e tyre. Atje gjejnë alter egon e tyre:

*Jam i vetëm në mesnatë,*  
*si bilbili i pafat,*  
*Që me zënë e tij i thotë*  
*sa mjerime ndien dhe lotë,*  
*Trëndafiles del nga gjembi,*  
*q'ë ka zemërën si shkëmbi.*

(Këngëtarë dhe bilbili, f. 93)

optimizmin e jetës:

*Vera e magjeps më shumë:*  
*lule të bardha, lule të verdha,*

*të përhapura, të vjerra  
duan veç gojë t'i flasin.<sup>1</sup>*

trishtimin e thellë për fundin e saj:

*Atje nuk do të zgjohem më  
luleve që i tund era  
si suvalë e pasosur;*

(Milosao, f. 127)

Romantikët arbëreshë krijonin marrëdhënie të drejtpërdrejta me shfaqjet e natyrës. Ata i kërkonin dhe i gjenin ato, herë si orakuj të ngjarjeve që do të vijnë dhe të fateve që presin heronjtë e veprave të tyre, herë si të vetmet ngushëlluese, herë si një burim emocionesh, nga më të pasurat e më të thellat, dhe herë si dukuri të frikshme e të gjithëpushtetshme mbi njeriun, madje si armike me të.

Në përputhje me prirjet subjektive e dispozitat e tyre shpirtërore shfaqjet e natyrës që tërheqin poetët arbëreshë janë të ndryshme. Kështu, Zef Serember e tërheqin hëna, yjtë, zogjtë, që i gjallërojnë kujtimet e së dashurës, apo tufani, lumenjtë e rrëmbyer dhe gurët e tyre që shkojnë nga i shpie vala dhe i kujtojnë sa fatkeqe ështëjeta e tij. Jeronim De Rada priret më shumë nga ato fenomene të natyrës, që shprehin më mirë shfaqjet idilike të poezisë së tij:

*Kundrejt kodrave e detit,  
dita e kaltër jetoi  
Valleve të vashave  
i shohin të dashurit*

(Milosao, f. 77.)

Një tjetër prirje vihet re në poezinë e Gavril Darës së Ri: ai kthehet më shumë pas shfaqjeve të madhërishme, të ashpra të natyrës, hera-herës edhe pas momenteve fantastike,

1) Jeronim De Rada, «Milosao» përshtatur në gjuhë të sotme nga Dh. S. Shuteriqi, në «Vepra letrare» 1, Tiranë 1987 f. 126. (Citimet e tjera nga kjo poemë do të janë të këtij botimi.)

të cilat i shkojnë për shtat dhe theksojnë më tej karakterin epiko-heroik të poemës së tij:

*Hoqi mjegulla me nxit  
Stolinë e grisur erës,  
Zëri i shpellave rënkonte  
Larg prej shpateve të Borës,  
Atë mbrëmje pa një yll,*  
.....

(Kënga e sprasme e Balës, f. 49)

Ishte një gjë fare e zakonshme për romantikët arbëreshë që natyrën dhe shfaqjet e saj t'i shihnin si trupëzime të përsosura të bukurisë, të një bukurie të pakrahasueshme, të cilën poezia duhej ta gjallëronte:

*U patakса e ruajta jashtë:  
rrusht', pak aguridhe,  
dheut ton't i kishin hie;  
lule liu të hapura,  
n'i tund era e i përzien,  
në atë ninull qeshin;  
si ato lule-qielli  
Ti shikoje dhe s'kujoje  
asnje mbëhi njerëzish.*

(Milosao, f. 65, 66)

Natyra dhe njerëzit shpeshherë konceptoheshin si të bërë njësh, të shkrirë, në harmoni të plotë me gjëzimin apo hidhërimin e përbashkët.

Nëpërmjet pasqyrimit të kësaj harmonie romantikët arbëreshë, gjejnë rastin të shprehin adhurimin e tyre ndaj zotit, krijuesit të saj. Serembe shihte në të një mundësi për të krijuar kontakte të drejtpërdrejta me «krijuesin» pa pasur nevojë për ndërmjetësinë e kultit:

*Tash gjithshka është e kthjelltë dhe e bukur  
Nga mali ikën disa re,  
Që ajri i shkund dhe i shtyn  
Dhe drita përhapet dhe rri*

*Mbi gjithshka që krijoi Žoti ynë.*

(Elegji, f. 83, 85)

ose:

*Një dritë dallge në mëndje m'u fut,  
Se me harmoni të kthjelltë dhe fatmirë,  
Natyra u tund dhe Perëndisë iu lut.*

(Natë, f. 137)

Shumë prej romantikëvë evropianë prireshin pas përhakimit të shfaqjeve të frikshme të natyrës, shpesh pas egërsisë së saj, ku gjenin tjetësimin e pasioneve të fuqishme, tallazeve e trazirave të shpirtit të tyre. Nëpërmjet tyre romantikët, i jepnin gjallëri etjes së tyre për lëvizjen, për stuhinë, përpërblysjen e tiranisë. Në egërsinë e natyrës, në pamjet e saj të frikshme, në madhështinë e verbërinë fatale, më në fund në virgjerinë e saj, ata gjenin atë që më kot e kërkonin në shoqërinë e kohës, të mbetur nga plogështia, ngajeta e amullt, nga dëshirat e vogla, meskine. Një jetë e tillë për romantikët ishte krejt e huaj, pa kurrfarë ndjenjash. Për ta ishte e domosdoshme t'u shpëtoje kurthieve të saj të tmerrshme, të gjëje burime të tjera emocionesh, dhë një prej tyre ishin të gjitha shfaqjet e natyrës, në mënyrë të veçantë shfaqjet e saj të ashpra. Romantikët, këta të revoltuar kundër shoqërisë aktuale, këta të vëtmuar, heretikë, që s'pranonin moralin hipokrit të kohës, të munduar nga shumë lëkundje e dyshime, me lehtësi tërhiqen nga natyra, që qetëson ose përkundrazi bën të shpërthëjnë pasionet e tyre. Mbrëmja, hëna, yjet, rëtë, i shkojnë shumë përshtat gjendjes së tyre shpirtërore, që përgjithësisht përcaktohet nga dëshpërimi, vuajtja, melankolia. Të gjitha këto hassen shpesh dhe në poezinë e Serembes. Po kjo përbajtje, pa qenë e huaj për romantikët arbëreshë, nuk ubë themelore në veprën që lanë. Romantikët arbëreshë nuk e shndërruan natyrën në një kult, sidiqë adhurorin bukuritë e saj të pashoqe dhe jepeshin fort pas ndjenjave që u ngjallte ajo. Ndryshe nga romantikët evropianë, poetët arbëreshë në përgjithësi nuk e shihnin natyrën si vendin që u krijonte mundësitet për t'u shmangur ngajeta, nga problemet e saj; ajo që i shtyn romantikët tanë drejt natyrës nuk është druajtja

nga realiteti, po malli i pashuar për dheun e të parëve, dëshira e flaktë për të gjallëruar në çdo faqe të veprës së tyre bukuritë e përfytyruara të atdheut.

Këtu duhet kërkuar thelbi ideor i qëndrimit të tyre dhe në përgjithësi, i gjithë letërsisë romantike të Rilindjes, ndaj natyrës. Prandaj është i drejtë pohimi, sipas të cilit «nuk është rastisje...., pse edhe natyra në letërsinë e Rilindjes Kombëtare është bërë më tepër objekt fryshtimi i poeziës patriotike se sa i poezië meditative.<sup>1</sup>

Për poetët arbëreshë nuk qe koha që të kërkonin shërimin e plagëve të tyre shpirtërore në natyrë, nuk qe koha që nëpërmjet saj të shprehnin të ashtuquajturin «pikëllim botëror», që pas Bajronit qe shndërruar në letërsinë romantike evropiane edhe në një farë mode. Arsyetimet mbi rolin dhe vendin që zë natyra në jetën e njeriut, mbi shkakun që e shtyn drejt saj, ata nuk bënë; natyra vërtonte në poezinë e tyre ashtu siç shpërthente në të malli për atdhe; ajo ishte e bukur për shumë arsy, por në radhë të parë sepse ishte natyra, sigurisht e imagjinuar, e dheut të të parëve; ajo ishte shpesh e trishtuar, e përhumbur, sepse atdheu jetonte ende nën pushtimin e huaj. Heronjtë e veprave të De Radës dhe heroï lirik i poeziës së Serembës, mund të kërkonin dhe në të vërtetë kërkuan në natyrë vetminë, vendin ku shpërthente lirisht shpirti i tyre i vuajtur e kujtimet e tij. Ata e shndërronin natyrën shpeshherë në qenie kaq të afërt, sa i besonin të gjitha të fshehtat e zemrës, të bindur se vetëm ajo mund t'i kuptonte e jo tjetër kush. Po me gjithë këto, romantikët arbëreshë nuk u shtynë më tej. Ta shndërronin harmoninë e natyrës në një shembell-tyre të organizimit të shoqërisë njerëzore, ata nuk patën fortuge të arsyetonin rrëth kësaj ideje, në themel të së cilës qëndronte mendimi rusian. Po të mbahet parasysh se letërsia e Rilindjes sonë Kombëtare kishte si problem themelor problemin national, atëhere bëhet krejt i qartë ndryshimi, që vihet re midis saj dhe letërsisë romantike evropiane në shkallën e intensitetit të përbajtjes shoqërore, filozofike e etike që mori trajtimi i natyrës në veprën e tyre.

---

1) Shih: R. Qosja, **Kontinuitete**, Prishtinë, 1972, fq. 27.

Në studimin «Disa karaktere të poezisë së De Radës», prof. Eqrem Çabej shënon: «Mendoj se në disa figura e motive të poemave të tij, vihen re gjurmët e poemave italiane të Rënësancës. Ndërkaq këtu do vënë në dukje dhe një tjetër ndikim, i pavënë re gjer më sot. Për të mbushur skenat luftarake me figura burrash e grash të orientit, që duhej të dilnin aty në lagjen e osmanëve, poeti pati idenë të merrte disa motive dhe emra nga poezia klasike e Indisë. Kështu motivi i këqyrjes së një pikture që paraqet Adinen te «Nata e Këershëndellave», na kujton një skenë analoge të dramës Sakuntala të Kalidasas, kumbreti Dushanta sheh një pikturë që paraqet Sakuntalën me dy shoqe të saj. Paraqitura e ngjarjeve nëpërmes tablosh të pikturuara na del dhe në të tjera vepra të De Radës. Emri i Vantisës te libri i pestë i poemës «Skënderbeku i pafanë» shihet se është marrë nga Savantasena, heroina e dramës Mehakatika të Dandinit, bashkëkohës i Kalidasës.

Një tjetër emër indas është Davadasa, e cila na del në këngën e gjashtë e të tetë të «Serafina Topisë». Te drama e Dandinit, Vasantasana hipën në stivën e druve, për t'u djegur së toku me fëmijët e sâj, po shpëton bashkë me të shoqin. Një skenë të tillë na paraqet De Rada te poema e «Serafina Topisë», ku Evoda pëson këtë vdekje të tmerrshme për hakmarrje politike të popullit. Me kërkime të mëtejshme në të ardhmen — përfundon prof. Eqrem Çabej, — mund të gjinden dhe të tjera gjurmë të literaturës inde në veprat e poetit tonë<sup>1</sup>. Pas këtyre konstatimeve të prof. Eqrem Çabejt, po të mbajmë parasysh gjithash tu se shumë ngjarje, sidomos të poemës «Skënderbeku i pafanë», zhvillohen në vise të Orientit, të tjera të poemës «Kënga e sprasme e Balës», në Peloponez, se në to veprojnë personazhe që vijnë ose janë banorë të këtyre viseve, duhet të shtrojmë si një çështje që do studiuar, ndikimin e mundshëm të ekzotikës së njojur romantike në letërsinë arbëreshe.

Prej kohësh studiuesit kanë vënë re si një tipar të rëndësishëm të romantikëve, prirjen për të përshkruar me dashuri të veçantë vendet ekzotike, të cilat, sipas tyre, kishin mbetur të papërdhosura nga qytetërimi borgjez. Ishte krejt e natyrshme përtat, madje thellësisht njerëzore, t'i admiroje këto vende,

1) Eqrem Çabej; Disa karaktere të poezisë së De Radës, «Drita», 6.12.1964.

peizazhet e mrekullueshme, njerëzit që banonin atje. Ato qenë të magjishme, të pakrahasueshme në bukurinë e tyre të egër, burimi i romantikës së vërtetë. Ç'kërkonin e nuk gjenin dot në jetën, që i rrethonte në vendet e tyre, romantikët e shihnin në formën më të pastër e më të kulluar në viset e Orientit, por edhe në Shqipëri, Greqi, në vise të Spanjës e të Italisë. Veti shkrimtarët romantikë udhëtonin shpesh në vende të preferuara; Bajroni jetoi një kohë në Itali, kaloi në Shqipëri dhe vdiq në Mesolongji pranë kryengritësve grekë; Merimeja adhuronte Korsikën; Lermontovi Kaukazin; Mickievici Krime-në etj. Për shumë romantikë viset e Orientit të afërt qenë vëçanërisht të preferuara, ato i tërhojnë jo vetëm me bukurinë natyrore, por edhe me arkitekturën, me mitologjinë, folklorin e fenë, me psikologjinë e njerëzve. F. Shelgeli, një prej doktrinarëve të shkollës romantike, thoshte se, pikërisht në Orient duhet këruar ajo çka është romantike në shkallën më të lartë. Romantikët u rjohën edhe me kulturën e letërsinë e viseve të Orientit, përkthyen disa prej poetëve arabë dhe persianë, madje, në raste të veçanta, Gëtja dhe poetë të tjera gjermanë, i imituan. Se ç'i shlynte përgjithësisht romantikët të turreshin në trojet, që ata i konceptonin si ekzotike, kjo tashmë është svaruar prej kohësh. Nuk ishte vetëm natyra e këtyre viseve me bukurinë e saj të ashpér e të pastër, origjinaliteti i kulturës së popujve, po mbi të gjitha mënyra e jetesës së banorëve të këtyre anëve, e cila, pér shkrimtarët romantikë, ishte një lloj modeli i jetës së vërtetë njerëzore, që po shpërfillej pa mëshirë në shoqërinë borgjeze. Romantikët mendonin se doket, zakonet, mbi të cilat qe organizuarjeta e banorëve të vendeve ekzotike, qenë të tillë që nxirrnin në pah dhe kultivonin pastërtinë morale, virtytet e larta të ngulitura thellë brez pas brezi në karakterin e tyre. Sipas romantikëve këto doke, ligjet e ashpra, të shkruara e të pashkruara, përbënët një gardh, që nuk lejonte depërtimin e civilizimit të mëpsur borgjez, i cili po shkatërronte në themel njeriun, po e kthente në një qenie të tharë shpirtërisht, pa ndjenja, pa pasione, të krimbur në vese, të mbërthyer nga ethet e fitimit. Me pak fjalë, adhurimi i ekzotikës pér romantikët ishte një mënyrë shumë e përshtatshme, pér të kundërshtuar e sfiduar shoqërinë borgjeze të vendeve ku ata jetonin. Nga ana tjetër, në luftën kundër estetikës klasiciste, romantikëve ua donte puna të kërkonin e ta gjenin bukurinë kudo e sido që të shfaqej, ashtu siç qe, në format e saj më të natyrshme. Në kundërshtim me estetikën klasiciste, që e konceptonte të

bukurën të pandryshueshme në kohëra, të tillë që mund të shfaqej vetëm nëpërmjet subjektit, ata mendonin se e bukurë ndryshon jo vetëm gjatë rrjedhjes së kohës, por edhe në vërsi nga ambienti i vendeve, nga konstitucioni shpirtëror i popujve të ndryshëm.

Pa dyshim, do të gabonim po të kërkonim të tilla qëndrime ideore dhe estetike në ato të pakta raste të përbajtjes së poetizë arbëreshe, të cilat japid shkas pér të gjykuar mbi prirjet ekzotike. Në tërësinë e tyre, këto qëndrime në krijimet e arbëreshëve mungojnë, jo sepse poetët tanë ishin bij të një vendi, që, sipas koncepteve romantike, ishte në vëtvete ekzotik. Ashtu siç qenë të malluar gjer në dhimbje pér atdheun e tyre të laشتë, poetët arbëreshë tërë forcën e shpirtit, të gjitha mundësitetë krijuar ia kushtonin evokimit të atdheut, historisë së bashkë-atdhetarëve e natyrës së trojeve ku ata jetonin. Në mënyrën si e përshkruan atdheun e tyre, të cilin ata s'e kishin parë kurrë, po e njihnin përmes burimesh të tjera, bie në sy, sidomos në poemat «Kënga e sprasme e Balës», «Serafina Topia» etj., prirja pér të pasqyruar, shpesh me thekse ekzaltimi, shfaqjet madhështore të natyrës shqiptare, pamjet e ashpra të bukurisë së saj, që të kujtojnë disa aspekte të ekzotikës së romantizmit evropian. Por, po të mbahet parasysh se kujtimet e të parëve, veprat e atëhershme historike mbi Shqipërinë, e sidomos Bajroni e Pukëvili, veç të tjerave, u ofronin shumë tipare pikërisht të tilla të natyrës shqiptare, atëhere është e kuptueshme pse u shfaqën hera-herës këto prirje në poezinë arbëreshe. Nga ana tjetër, dhe kjo është kryesorja, të nisur nga synime të qarta patriotike, nga karakteri epik i tematikës që trajtuan, poetët arbëreshë, në mënyrë krejt të natyrshme, do të tertiqeshin nga bukuritë madhështore të dheut të të parëve, do të krijonin figura të fuqishme e të pastra në tiparet e karakterit të tyre. Për një poezi si ajo arbëreshe, në taban të së cilës qëndronte problemi kombëtar, ishte e pakuptimtë që të lihej mënjanë atdheu e të kalohej në përshkrimin e viseve të tjera. Vuajten shpirtërore, që u shkaktonte pushtimi e prapambetja e dheut të të parëve, romantikët arbëreshë nuk mund ta kapërcenin duke u turur në vendet ekzotike. Thellësisht të angazhuar në këtë përpjekje, ata gjenin atje kuptimin e jetës së vërtetë, kënaqësinë shpirtërore, afirmimin e unit të tyre. Por edhe nëse kishin nevojë që të shprehnin gjerësinë e botës shpirtërore, prirjet, kërkesat dhe predispozitat e tyre, qëndrimet opozitare ndaj gjendjes së atëhershme politike të Shqipërisë, por edhe ndaj realitetit italian, qëndrimet kritike ndaj

ritmeve dhe intensitetit të lëvizjes kombëtare, ata kishin një burim të gjallë e të pashtershëm që u ofronte të gjitha ato, që plotësonin kërkesat e tyre shpirtërore. Ky burim ishte historia e popullit, në mënyrë të veçantë shekulli XV, epoka e qëndresës së shqiptarëve ndaj invazionit turk. Të gjenin në Orient apo në vise të tjera ekzotike pastërtinë morale? Po këtë ua ofronte me të gjitha bukuritë njeriu shqiptar. Të ekzaltonin kulturën e këtyre anëve? Naimi e njihte mirë këtë kulturë, Samiu dha një kontribut të madh për zhvillimin e saj, po në përgjithësi rilindësve tanë, pra, edhe romantikëve arbëreshë, u duhej të evidentonin, të studionin e të përhapnin kulturën e lashtë të popullit të tyre, madje të luftonin kundër ndikimeve të kulturës orientale, që i kishin të gjalla në atdhe, që pengon zhvillimin e kulturës kombëtare dhe fshihnin pas tyre synime grabitqare politike.

Ashtu si edhe të gjithë shkrimitarët e tjerë të Rilindjes, poetët arbëreshë nuk mund të futeshin kushedi se ku në ekzotikën e Orientit, në një kohë kur Shqipëria vuante ende nën pushtimin e një shteti oriental. Nëpërmjet veprës së tyre, poetike ose jo të tillë, ata krijuan një ideologji krejt të kundërt me atë që synonin të impononin pushtuesit e huaj nëpërmjet kulturës së tyre. Kjo ideologji e shfaqi forcën e vitalitetin e saj, veç të tjerave, në luftën e papajtueshme kundër shumë pasojave të dëmshme, që shaktuan në vendin tonë pushtuesit dhe kultura që ai solli me vete. Disa nga romantikët evropianë, duke ekzaltuar Orientin në tërësinë e tij, shpesh nuk bënin dallime midis aspekteve që vërtet mund dhe duhej të ekzaltohen dhe të tjerave që qenë të dëmshme, të egra. Kështu, ata shihnin në gjakmarrjen, që ishte shumë e përhapur në këto vise, një shfaqje të pasioneve të fugishme, të moralit të kulluar të banorëve të këtyre anëve, fanatizmi i verbërt i të cilëve, prapambetja e thellë, ashpërsia e zakoneve për shumë shkrimitarë romantikë nuk ishin shfaqje që duheshin luftuar, përkundrazi, ishin të bucura që duheshin poetizuar.

Romantikët tanë nuk mund të merreshin me poetizimin e dukurive të tilla, që qenë të rëndomta edhe në jetën zakonore të bashkatdhatarëve të tyre. Përkundrazi, ata i kritikuan ashpër këto dukuri dhe i quajtën, me të drejtë, si pengesë në udhën e vështirë të realizmit të pavarësisë kombëtare.

Pas këtyre konstatimeve, nuk mund të mos vijmë në përfundimin se ekzotika, ky tipar thelbësor i romantizmit evropian, sado që është shfaqur hera-herës, sidomos në poezinë e De Radës, nuk ka qenë e nuk mund të qe e tillë për romantiz-

min arbëresh, për romantizmin e Rilindjes sonë Kombëtare në përgjithësi. Është e vërtetë se disa prej episodeve të krijimeve të Jeronim de Radës, sidomos të poemës «Skëndërbeku i pafanë», zhvillohen në vise të Orientit, po kjo s'është medoemos shfaqje e ekzotikës, pasi duke i marrë subjektet nga historia e popullit të tij, nga ngjarjet e shekullit XV në mënyrë të vëçantë, poeti shpesh ishte i detyruar që disa prej ngjarjeve, që përshkruante, t'i vendoste në ato vende.

Për sa u përket konstatimeve të sjella nga prof. Egrem Çabej dhe të tjerave që mund të dalin, pas studimeve më të imta, ato tregojnë se ndikimet anësore të ekzotikës, si tipar i qenësishëm i romantizmit, nuk duhen përjashtuar në mënyrë të prerë edhe në letërsinë arbëreshe. Po ndërkaq, siç u munduan të provojmë, ekzotika objektivisht nuk mund të ishte një karakteristikë e rëndësishme e romantizmit arbëresh.

E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për një prirje tjetër të romantizmit, për tërheqjen pas së jashtëzakonshmes. Duke luftuar estetikën klasiciste, romantikët iu kundërvunë pikëpamjes që kërkonte bukurinë në ato objekte dhe fenomene, të cilat ishin në raporte të drejta me njeriun. Bota për klasicistët ishte shprehje e një rregulli harmonik, në të cilin e pakufishmja, e stërmadhja, nuk paraqisin asnjë interes në pikëpamje estetike. Romantikët priren fort pas asaj që është e çuditshme, që i shmanget rregullit, madje pas asaj që duket anormale. Të bukurën në natyrë, piktoresken, ata e gjenin pikërisht në të tillë shfaqje. Po jo vetëm kaq; qeniet fantastike të mitologjisë<sup>1)</sup>, dragonjtë, hijet, vampirët, shndërrohen në personazhe të veprave të shumë prej shkrimitarëve romantikë. Këtë prirje ata e shtrinë dhe në karakterizimin e heronjeve, të cilët janë përgjithësisht hyjnorë në virthitet ose satanikë në veset, trima të pëimagjinueshëm, dashnorë që digjen flakë prej pasionit të tyre të fuqishëm, krijues të një bukurie mahnitëse ose të një shëmtimi të përbindshëm. Në këtë udhë romantikët shpesh krijonin një botë e një jetë pak të besueshme, gati-gati jashtë-njerëzore. Në kundërshtim me shkrimitarët klasicistë, që të bukurën e shikonin në përgjithësi te rregulli, te proporcioni, romantikët e gjenin në thyerjen e rregullit, në shproporcionalen, në disharmonikën. Përsëri në kundërshtim me veprat e klasicistëve, të cilat krijonin një atmosferë që në fund të fundit përcaktohej nga «arsyeja», romantikët prireshin pas atyre fe-

1) Marrëdhëniet midis mitologjisë dhe letërsisë janë trajtuar gjérësisht nga Alfred Uçi në librin **Mitologjia, folklori, letërsia**, Tiranë, 1982.

nomeneve, që dukeshin të paspjegueshme, enigmatiklerronte -herës të tmerrshme, të cilat nxisnin më fort imagjinali shëri tyre.

Kishte shumë arsyë që i dhanë shkas kësaj prirjeje në veprën e romantikëve; ndër më të rëndësishmet prej tyre ishte, pa dyshim, lufta kundër estetikës dhe praktikës letrare klasiciste. Në qoftë se një e tillë karakteristikë nuk ka lënë pothuajse fare gjurmë në letërsinë arbëreshe, kjo shpjegohet me faktin që ajo u integrua në mënyrë të vetvetishme në romantizëm, pa qenë nevoja që të luftonte ndonjë rrymë klasiciste. Po jo vetëm kaq; siç është vënë re edhe në analizën e tipareve të tjera të romantizmit, letërsia arbëreshe ka bërë të saj ato tipare që nuk e kanë penguar të shprehte fort idenë e saj themelore, idenë patriotike. Të gjitha të tjerat nuk kanë gjetur vend në veprën e romantikëve arbëreshë. Kështu ka ndodhur edhe me prirjen drejt së jashtëzakonshmes, të stërmadhes, të çuditshmes, që vihet re në veprën e shumë romantikëve evropianë; ajo nuk u shfaq dhe objektivisht nuk mund të shfaqej në letërsinë arbëreshe. Ideja themelore që mbartte poezia arbëreshe mund të shprehej përmes krijimit të një atmosfere; e cila vërtet mund të mos i përgjigjej si duhej realitetit historik, ku i vendoste subjektit, po megjithatë përpinqej të mbetej sa më afër shqetësimëve të popullit, të ishte sa më e besueshme për të.

## ORIGJINALITETI I ROMANTIZMIT TË POEZISË SË NAIM FRASHËRIT

Për veçoritë romantike të veprës së Naim Frashërit studiuësit tanë kanë folur me kohë!. Megjithatë, një vështrim krasues midis saj dhe tipareve të romantizmit, krahas të përbashkëtave, vë në dukje se në disa anë ajo nuk i ka karakteristikat e njoitura të këtij drejtimi.

Romantikun përparimtar evropian e mundonin shumë plagë të jetës shoqërore, ndërsa Naimi, pa qenë indiferent ndaj tyre, përkundrazi u dha më shumë pas çështjes themelore që qëndronte në ato kohë para vendit të tij, çështjes kombëtare. Konflikti midis individit dhe shoqërisë, konflikti më i rëndësishëm në veprën e romantikëve, është pak ose aspak i trajtuar në poezinë e Naimit, që e shprehte qëndrimin e tij kundërshtues ndaj shoqërisë së kohës, nëpërmjet përpunimit dhe përhapjes së ideologjisë iluministe atdhetare; vepra e tij ishte shembulli i kultivimit të një qëndrimi të ri ndaj jetës politike e shoqërore të kohës. Naimi nuk u mor shumë me arsyetime të pafundme mbi filozofinë e epokës, mbi shenjat e kohërave moderne e të tjera si këto; ai nuk u dha fort pas krijimit të një letërsie që vinte mbi gjithçka ndjenjën, që kërkonte të depërtonte në të fshehat e zemrës njerëzore.

Vepra e Naimit i kushtoi ndjenjës një vend që mund të kishte këto ose ato tipare, të ngjashme e më pak të ngjashme

1) Shih: Eqrem Çabej, Elemente të gjuhësisë të literaturës shqipe, Tiranë 1938; Historia e letërsisë shqipe, v. II, Tiranë 1960; D. Shaplllo, Disa tipare të romantizmit në letërsinë shqiptare të Rilindjes Kombëtare, në librin «Dukuri dhe vepra letrare», Tiranë, 1974; Rexhep Qosja, Letërsia e Rilindjes dhe romantizmi evropian, në librin «Kontinuitet», Prishtinë, 1972; R. Qosja, Naim Frashëri, studim hyrës në botimin e veprave të Naim Frashërit, vol. I, Prishtinë, 1978; Dhimitër S. Shuteriqi, Naim Frashëri, Jeta dhe vepra e tij në botimin e veprave të zgjedhura të Naim Frashërit, Tiranë 1980; po ai, Naim Frashëri, Jeta dhe vepra, Tiranë 1982; Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë, 1983 etj.

me letërsinë romantike, po që kurrsesi nuk e shndërronte në të vetmen masë të kohërave dhe të njerëzve. Naim Frashëri ishte një natyrë shumë e ndjeshme dhe dinte në mënyrë aq të hollë t'i këndonte bukurisë e dashurisë, po ai nuk e shndërrroi lektisjen pas tyre në të vetmin moral, siç bënин shpesh romantikët për të sfiduar botën që i rrëthonte. Vendi kishte nevojë për dritën e arsimit, prandaj Naimi, nëpërmjet veprës së tij, shfaqet në radhë të parë si iluminist i bindur.<sup>1)</sup> Në poezinë e Naimit do të gjejnë vend edhe shqetësimet e një shpirti kontradiktor, edhe dëshira për t'u harruar për një çast; në ndonjë rast atë do ta mundojnë edhe nota fataliste. E megjithatë Naimi nuk i lejoi shpirtit të tij boshllëk, sepse ishte i angazhuar i téri pas përpjekjeve e luftës së vazhdueshme për lirinë e Atdheut dhe emancipimin e popullit të tij. Naimi nuk mund të vinte në qendër të poezisë melankolinë, trishtimin, e t'i quante këto gjendje shpirtërore si të vetmet qëndrime të drejta të imponuara nga koha. Atij i duhej besimi dhe jo spekticizmi, entuziazmi dhe jo trishtimi. Me një poezi të tillë ai u qëndronte besnik idealeve më të përparuara të kohës, si edhe kërkeseve të tij shpirtërore. Naimi nuk mund të merrej në krijimtarinë e tij me dramat e mprehta të ndjenjës, nuk mund të merrej me enigmatikën, me qieloren, me atë që në vështrimin e parë dukej e egër, po që ishte e pastër dhe e bukur në egërsinë e saj; ai nuk mund të merrej shumë me meditime të ndërlikuara për të gjetur çështë e ç'nuq është e përjetshme. Ankimet e pafundme dhe kërkesa për një jetë boheme mungojnë gjithashtu në veprën e Naimit. Tek ai nuk vëmë re asnjë dëshirë për t'u veçuar e dalluar nga të tjerët. Për t'iu kundërvënë realitetit shqiptar të asaj kohe, Naimi ndoqi rrugë të tjera: evokimin e historisë, ekzaltimin e bukurive të atdheut dhe të virtyteve të bashkatdhetarit, iluminizmin, luftën kundër identifikimit të kombit me fenë.

Të gjitha këto ndryshime e të tjera që do të vihen në dukje më poshtë, shpjegohen me faktin se përhapja e romantizmit në gjithë Evropën ruante, sigurisht, një thelb të pandryshuar, po megjithatë, nga vendi në vend, ai humbte disa tipare dhe theksonte disa të tjera. Studiuesit i kanë vënë në dukje, me kohë këto dallime; ata kanë vënë në dukje gjithashtu,

1) Prof. A. Uçi në librin e tij «Mitologjia, folklori, letërsia» (f. 266) ka formuluar tezën se «themeli iluminist i krijimtarisë së Naimit është kaq i gjerë, saqë e veçon dhe e shkëput atë nga krijimtaria letrare e mirëfilltë romantike, e bën përfaqësues të një letërsie iluministe».

se në përgjithësi romantizmi në vendet e Evropës Lindore e sidomos në vendet ballkanike, të cilat, kush më herët e kush më vonë u ndodhën para çështjes kombëtare, mori disa tipare të përbashkëta, që u vunë re edhe në Itali. Evokimi i së kaluarës historike, kërkesa e vazhdueshme dhe e flaktë pér lirinë kombëtare, vlerësimi i këngës popullore dhe mbështetja krijuese në të, ku më e fuqishme dhe ku më pak e fuqishme, këto janë disa nga karakteristikat e përbashkëta të romantizmit ballkanik, pér të cilin, ndër ne, ka tërhequr vëmendjen i pari prof. E. Çabej<sup>1</sup>.

Te poezia e Naimit vendin kryesor e zënë përfytyrimet pér të ardhmen e atdheut, historia e Shqipërisë në shekullin XV, përpjekjet pér të ndryshuar në përgjithësi tiparet e jetës shpirtërore të popullit nëpërmjet emancipimit kulturor të tij, lufta pér zhvillimin e kulturës kombëtare, demokratike dhe iluministe. Që të gjitha këto prirje bashkohen në një pikë — në idenë se Shqipëria nuk duhej dhe nuk mund të jetonte siç kish jetuar, se gjendja e atëhershme e Shqipërisë duhej kapërcyer medoemos. Rrethanat e vështira politike, ekonomike, kulturore që kishin mbërthyer vendin, e shtynin Naimin të përpunonte e të shpallte kërkesa të gjera, të cilat shtriheshin nga pikëpamjet mbi rrugët që duheshin ndjekur pér fitoren e pavarësisë e rendin që duhej të vendosej pas saj, e gjer tek arsyetimet mbi të mirën e të kegen e idetë pedagogjiko-didaktike; nga përpjekjet pér të krijuar një besim që mënjanonte përcarjen fetare e gjer në arsyetimet mbi rolin e shkencave në jetën e vendit; nga bukuritë e natyrës, tek bukuria shpirtërore e njerëzve që jetonin në gji të saj. Thelbi romantik i veprës së Naim Frashërit, më fort se në ekzaltime e ndjenjës si të tillë dhe në shndërrimin e saj në një lloj udhërrëfyesi drejt jetës me të vërtetë njerëzore, më fort se te shqetësimet e vazhdueshme vetjake, te trishtimi e melankolia pa shkaqe të qarta, duhet kërkuar në radhë të parë te përfytyrimet pér të ardhmen e Atdheut, te pasioni pér lirinë e përparimin e te sakrifikimi pér idealin atdhetar. Është vënë në dukje me kohë nga studiuesit tanë se Naimi u mor rrallë me botën shpirtërore vetjake. Edhe në ato të pakta raste kur ia kushtoi poezinë vetes, Naimi jo gjithnjë do të merrej me ndjenjën e tij. Te «Fjalët e qiririt» ai shpall se kishte pasur si qëllim të mos i takonte vetes. Ndaj rolit të poetit në jetën shoqërore në përgjithësi romantikët ishin fort të ndjeshëm. Shumë prej tyre kanë folur pér poetin me pasion

1) E. Çabej, *Studime gjuhësore V*, Prishtinë, 1975, f. 335.

të veçantë dhe e kanë konsideruar herë si profet e herë si mbar-tësin e shqetësimeve më të thella të kohës. Në vlerësimet e tyre poeti gati-gati hyjnizohej, aq sa për Hygojin zoti shfaqeji tek njerëzit së pari, nëpërmjet natyrës dhe së dyti, nëpërmjet poetit, i cili ishte pothuajse një Mesia, që i rrëfente udhën njerëzimit e i shpjegonte atij botën e jetën. Shpesh, në pajtim me fryshtë e njojur egocentrike të romantizmit, poeti konsiderohej si njeriu, që, me vetminë e trishtimin e tij të pafund, me madhështinë e shpirtit e gjenialitetin e mendjes, ishte krijuar për t'u dalluar nga të tjerët, nga «turma» që nuk mund t'i kuptonte kurrsesi. E famshmja vjershë «Fjalët e qiririt» nuk duket të jetë krijuar vetëm për të treguar konceptet që kishte Naimi për poetin dhe poezinë, ajo ka një përbajtje më të gjërë. Në të shfaqet poezia e një misionari të idesë kombëtare, të humanizmit në përgjithësi, që ka si kredo themelore t'i shërbujej gjer në vetëmohim Shqipërisë e bashkatdhetarëve e, në një vështrim më të plotë, njeriut dhe njerëzimit. Megjithatë, Naimi pati poezinë si veprimtarinë kryesore ku realizoi qëllimet e jetës së tij. Prandaj vlerësimet e qëndrimet ndaj kuptimit që do t'u japë viteve të veta, objektivisht i takojnë në një masë të madhe vokacionit më prodhimtar të krijimtarisë së tij, poezisë. Vjersha përmban edhe nota mistike, pikëpamje të metempzikozës, që, siç dihet, kanë luajtur rolin e tyre në formimin e përgjithshëm të botëkuptimit të Naimit. Po sidoqoftë, në një pikëpamje, ideja e vjershës përkon në mënyrë të dukshme me vlerësimet e romantikëve për rolin dhe funksionin e poetit në jetën shoqërore.

*Në mest tuaj kam qëndruar  
 E jam duke përvëluar  
 Që t'u ap pakëzë dritë,  
 Natënë t'ua bënë dité  
 Do të tretem, të kullohem,  
 Të digjem, të përvëlohem,  
 Që t'u ndrinj mir' e të shihni  
 Njëri-tjatrin të njihni<sup>1</sup>.*

(Fjalët e Qiririt, f. 93)

---

1) Naim Frashëri, **Vepra të zgjedhura I.** Botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë, 1980. Me disa përjashtime, citimet e tjera nga poezia e Naimit do të janë nga ky botim.

Kjo «*auto da fe*», siç është quajtur me kohë e me të drejtë nga studiuesit tanë, edhe po të mos ketë ndikime të drejtpërdrejta romantike, duke qenë se veçon në një farë mënyre subjektin e krijuesit vetëm nëpërmjet rolit të posaçëm të tij, objektivisht bashkëvete me konceptet romantike.

Letërsia e vjetër shqiptare ishte një letërsi e kultit, i cili mbeti një peshë e rëndë edhe për vjershat e bejtexhinjve. Naimi e kapërceu lehtë këtë anë të traditës letrare, po me gjithatë, feja luan një rol jo të vogël në veprën e tij. Në tërësinë e pikëpamjeve filozofike të Naimit, janë përcaktuar si më të afërtë për poetin pikëpamjet panteiste, sipas të cilave zoti shfaqet kudo në natyrë e tek njeriu, ai është i shkrirë e i bërë një me ta. Shkenca letrare është marrë dhe tashmë ka zgjidhur shumë probleme të botëkuptimit të Naimit; ajo që na intereson në këtë studim është një çështje më vete, pak ose aspak e trajtuar gjer tani. Dihet se romantizmi, i cili sipas ihtarëve të tij, kërkonte që krijimtaria letrare të nisej nga jeta në të gjitha shfaqjet e saj, i la një vend të gjerë besimit fetar, sepse e konsideronte atë si një nga anët më vepruese në jetën shpirterore të shoqërisë. Shumë romantikë besonin thellë në forcën e në drejtësinë qëdibërëse të qillit dhe i drejtoheshin shpesh zotit për t'i ndihmuar të kapërcenin shqetësimet e shumta që i mundonin. Sidoqoftë, ata nuk ishin shkrimtarë të kultit dhe feja si ortodoksi vetëm rrallëherë do të trajtohej në veprat e tyre. Edhe Naimi flet për gjithëfuqinë e zotit, shpreson në ndihmën e tij, e thérret të gjykojë e të vendosë drejtësi për shumë çështje që prek në poezinë e vet. Po edhe kur veptron kështu, ai nuk bie në ekstazë fetare. Në një shkallë të caktuar, feja në poezinë e tij u trajtua nga pozita të veçanta, që diktoheshin nga synimet e lëvizjes kombëtare. Prej kohësh pushtuesit dhe armiqtë e tjerë të Shqipërisë kishin punuar e punonin për t'u mohuar shqiptarëve kombësinë, duke shfrytëzuar fetë e ndryshme që ata të besonin. Megjithëse në konstitucionin shpirtëror të shqiptarëve feja nuk luante rol vendimtar, prapë besimi në fe të ndryshme shfrytëzohej nga të huajt, shkaktonte përcarje gjithsesi të ndjeshme dhe pengonte seriozisht realizimin e qëllimeve të lëvizjes kombëtare. Naimi e kuptonte mirë rrezikun e përcarjeve fetare dhe u mundua të gjente një mënyrë për t'i kapërcyer ato. Të shpallte absurditetin e besimeve fetare, këtë s'e bënte dot, sepse populli dhe ai vëtë besonin. Sigurisht, ai bënte shumë lëshime në çështje të fesë dhe dogmën e saj heraherës e sfidoi në mënyrat që atij i dukeshin më të përshtatshme. Në veprën e tij ai u udhëhoq

nga mendimi iluminist është jo nga ai fetar. Po, sidoqoftë, kufijtë e kohës që kishin lënë gjurmë të thella edhe në formimin e tij, ai nuk mund t'i shpérthente lehtë e në të gjitha drejtimet. E rëndësishme është që Naimi u përpoq dhe gjeti një shteg, që sipas pikëpamjes së tij, do të shpinte në rrafshimin e përçarjes fetare, në mënjanimin e dogmave ekzistuese nëpërmjet konceptimit panteiste të zotit dhe të rolit të tij në natyrë e në jetë.

Naimi iu kthye shpesh motiveve panteiste, jo vetëm se në to shikonte një mënyrë të shpjegimit të botës dhe gjente pikëpamjet më të pranueshme për formimin e tij. Naimi ngulte këmbë në qëndrimet panteiste edhe sepse, sipas tij, ato i bënin të pavlefshme dogmat e tri feve që ushtroheshin në Shqipëri, nuk i binin ndesh dijes dhe e drejtonin vëmendjen te njeriu, te aftësitë e tij realizuese:

*Me fjal' e me agjerime  
Nuk' e gjen dot perëndinë,  
As me kreshm' e me kungime,  
Si punojn' ata që s'dinë*

*Paskëtaj, o shokë, kurë  
Mos kërkon perëndinë  
Nëpër mur' e nëpër gurë,  
Po shihni mirë njerinë*

*Mer dorën' e diturisë  
Pa ajo do të të nxjerë  
Gjer te fron' i perëndisë  
Ndaj soje do të të shpjere*

(Perëndia, f. 157, 160)

Te qëndrimet panteiste Naimi gjeti ato pikëpamje, që i dukeshin se i shërbën më mirë çështjes së bashkimit të të gjithë shqiptarëve. Duke qenë shpirtërisht të afërtë për të, ato përmbanin njëkohësisht edhe një kahje të qartë politike. Naimi erdhi tek ato i shtyrë nga shumë faktorë, po në radhë të parë nga synimi për të gjetur një modus që, në kushtet e atëhershme, do të realizonte bashkimin kombëtar të shqiptarëve. Tek bindjet e tij panteiste, të ushqyera prej sektit bektashian, poeti shihte një shpjegim të botës që jo vetëm ishte i pranueshëm

për të, pasi nuk mundohet aq fort prej iracionalizmit të feve zyrtare, po as nuk shkonte ndesh me çeshtjen kombëtare. Sigurisht, ky modus nuk ishte dhe nuk mund të ishte fatlum. Bashkimi i shqiptarëve u arrit për shkaqe të tjera politike e shoqërore, që bënë të mundur të mënjanoheshin dallimet fetares aq sa të mos pengonin realizimin e idealit atdhetar.

Synimet politike, shoqërore e morale që ndiqte Naimi, kur kapej fort pas pikëpamjeve panteiste, mbetën një utopi: si të tilla ato përmbanin një tipar romantik të qartë. Sigurisht, do të ishte krejt e gabuar të supozonim se në krijimin e këtij tipari do parë ndonjë lloj ndikimi i një pjese të romantikëve, mes të tjerëve, edhe të Viktor Hygoit, të cilët iu afroan qëndrimeve panteiste, të shtyrë edhe nga karakteri i frymëzimeve, që shihnin në to një mundësi për të poetizuar natyrën, universin. Burimet e krijimit të panteizmit të Naimit tashmë janë bërë të qarta, këtu do theksuar vetëm se me pikëpamjet panteiste Naimi gjithsesi i thjeshtëzonte marrëdhëni e njeriut me zotin, i bënte ato më të drejtpërdrejta, pavarësisht se mund të mos jetë nisur nga synime të tilla. Prandaj mistika sigurisht rëndon mbi to. Megjithatë, në këto qëndrime Naimi nuk u shty as se tërhiqej nga mishteret që mundonin përgjithësisht mjaft romantikë, e as se ishte i prirur pas ndjenjash intime të errëta. Shfaqjet e mistikës tek Naimi nuk kanë të bëjnë me prirjen e zakonshme të romantikëve për t'u larguar në çdo mënyrë nga ambientet që i rrëthonin, në kuqtimin më të përgjithshëm të fjalës. Kjo prirje tek vepra e Naimit është më tepër një dëshirë e çastit se sa veçori e brendisë së poezisë së tij. Prandaj edhe në krijimet me motive panteiste mungonte çdo lloj tendencë për të ndarë veten nga realiteti i kohës. Po kështu do të ishte e padrejtë të hiqej ndonjë paralele midis figurës së Maviesë së poemës «Qerbelë» dhe Satanait, që u trajtua nga disa romantikë, të ndikuar prej Miltonit dhe Mefistofelit të Gëtes. Në përgjithësi, poema «Qerbelë» nuk i shton tipare të tjera natyrës romantike të krimtarisë së Naimit; figurat e Maviesë dhe të Jezitit janë larg përbajtjes së figurës së Satanait, me të cilën disa romantikë simbolizonin shumë shqetësime shpirtërore dhe intelektuale.

Përbërësit filozofikë të brendisë së veprës së Naimit janë të shumtë dhe kompleksë. Naimi përgjithësisht udhëhiqej nga idetë iluministe, ai ishte liberal në kuqtimin më pozitiv të kësaj fjale, me gjithë anët e shumta fetare të botëkuqtimit të tij. Me kohë janë vënë në dukje karakteri kontradiktor i botëkuqtimit të Naimit, si edhe shkaqet që e shtynin poetin të kalonte

me lehtesi nga qëndrimet fetare në pikëpamjet panteiste e te përkrahja e teorive materialiste, që stigmatizonin rëndë dogmën fetare. Naimi nuk i vuri vetes si qëllim të krijonte një filozofi, një sistem të plotë pikëpamjesh, që do të dallohej nga kërkesa më të rrepta për koherencën dhe unitetin. Një prej arsyeve që bëjnë të mundur shfaqjen e kontradiktave në qëndrimet botëkuptimore të Naimit, do kërkuar edhe në faktin se ai nuk u nis kurrë nga pozitat e filozofit doktrinar. Naimi u mor shumë me filozofinë në veprën letrare dhe jashtëletrare, ai u bë një nga nismëtarët e mendimit filozofik përparimtar shqiptar dhe një histori e këtij mendimi, pa dyshim, do t'u kushtonte pikëpamjeve të Naimit një vend të veçantë e të rëndësishëm. Për rrëthanat e kohës, ishte e domosdoshme që Naimi të jepte kontributin e vet në përpunimin e filozofisë përparimtare shqiptare, e cila në atë periudhë historike përgatiste ndryshimet politike, që nuk vonuan të vinë disa vjet pas vdekjes së Naimit. Tërësisht i angazhuar në lëvizjen kombëtare, Naimi ishte nga ata udhëheqës të saj, që e kuptuan se amullia shpirtërore duhej kapërcyer medoemos. Prandaj ai pa hezituar u mor edhe me filozofinë, edhe me moralin, me organizimin e shkollës shqipe, me popullarizimin e të dhënave shkencore dhe me hartimin e teksteve mësimore. Janë të rrallë poetët e mëdhënët si ai, që u kanë kushtuar kaq energji edhe fushave të tjera që nuk lidheshin drejtëpërdrejt me prirjen kryesore të jetës së tyre. Natyrisht, mendimi spekulativ për Naimin nuk qëndronte jashtë poesisë, po ai i dha filozofisë shumë vend në krijuaritë e tij dhe atëhere kur s'kishte ndonjë frymëzim të veçantë, i nisur nga pikëpamja se poezia ishte mënyra më e mirë për të cuar në popull idetë, që, sipas tij, i duhesin lëvizjes kombëtare. Në përgjithësi romantikët kanë qenë kontradiktorë në botëkuptimet e tyre; me ta s'mund të ndodhë ndryshe. Te Naimi, ashtu si te një pjesë e romantikëve, kontradikta është edhe shprehje e përpjekjeve të tyre për t'u shkëputur nga botëkuptimet sunduese të kohës, të cilat, domosdo, nuk mund të realizoheshin pa rënë ndesh me to. Nga kjo pikëpamje, Naimi mund të konsiderohet kontradiktor vetëm në kuptimin se s'arriti t'u mbahej gjer në fund qëndrimeve më të përparuara filozofike që shprehu në veprën e tij. Bota e tij poetike, që ndiente fort bukurinë kudo që shfaqej, meditative në prirje, në mëdyshje për aksiomat që ngulisin mijediset ku jetoj, e etur për ndryshime që do të sillnin përparimin në çdo fushë, e tregonte qartë natyrën romantike edhe në luhatjet e saj, në kërkimet, në përpjekjet për të arritur përsosmërinë e

gjithanshme, e cila i mungonte jetës që e rrighthonte. Sigurisht, në të kanë vend edhe notat e trishtimit e qëndrimet fataliste, naiviteti, madje dhe idetë regresive, sidomos në një pjesë të krijimeve me karakter didaskalik moralizues. Po në tërësinë e vet, poezia e Naimit është kthyer e tëra nga e ardhmja më e bukur dhe më e mirë në kuptimin më të gjërë e më human të kësaj fjale.

Poema «*Bagëti e bujqësia*», duket se dëshmon për ndikimet që ka pësuar Naimi nga Rusoi e pikëpamjet e tij për njeriun e natyrës, të cilat, siç dihet, kanë lënë gjurmë të thella në formimin e botëkuptimeve romantike. Duke ndjekur një prirje të zakonshme të vetën, po edhe duke e konsideruar natyrën si mjedis të pastrimit shpirtëror, Naimi nuk i kurson porositë morale për të arritur në përfundimin e njohur romantik, se yetëm jeta pranë natyrës e shpëton njeriun nga të këqijat e qytetërimit:

*Mëndje! mer fushat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti,  
Nga brenga, nga thashethemet, nga rrëmuja, nga rrëmeti.*

(*Bagëti e bujqësia*, f. 74)

Po megjithatë, te Naimi nuk është e theksuar tendenca më e përgjithshme e romantikëve, që, të vëtmuar siç qenë, të ndarë nga bota e në kundërshtim të hapët me të, kërkonin të gjenin në natyrë sigurinë e qetësinë shpirtërore. Kur i këndon natyrës, Naimi bashkohet po edhe ndahet nga romantikët në disa pika: së pari, natyra është mishërimi më i gjallë i Atdheut; së dyti, tek natyra ai shihte një nga trajtat më të plota të bukurisë, e cila është, sipas tij, një nga dukuritë që ndikon fort në lulëzimin e virtyteve të njeriut; në ndonjë rast të rrallë ai jepet pas ndjenjave që i ngjallnin shfaqjet e ashpra të natyrës, të cilat e shtynë të meditojë për forcën e verbër të saj. Po ndërkaq, poema «*Bagëti e bujqësia*» askund nuk krijon përshtypjen se Naimi shihte te natyra një mundësi që i lejonte të shprehte lirisht trishtimin, melankolinë, siç ndodh shpesh me romantikët. Naimi nuk e përshkroi natyrën si vendin kù ai gjente intimitet e besim të plotë, ajo për të është Atdheu, malli i pashuar, e pastaj bukuria, hyjnia, vendi që nuk njeh e nuk pranon hipokrizinë. Në mes të tjerash, natyra për Naimin është mjedisi që e afron me njerëzit e që përgjithësisht i afron njerëzit midis tyre. Më tepër se meditimini, te Naimi na-

tyra nxit ndjenjën atdhetare, ekzaltimin që priret nga gëzimi, nga entuziazmi, nga e bukura dhe e mira.

Prandaj në poemën «**Bagëti e bujqësia**» mungojnë pëershkrimet e shfaqjeve të tillë të natyrës si nata, vjeshta, hëna, simbole të trishtimit në poezinë romantike, ose pemët e vëtmua- ra që lëkunden nga i shpie era e furtuna, shprehje të vëtmisë e të dobësisë së njeriut. Në këtë vepër janë fare të rralla çastet e dhëmbjes, që nuk shkaktohen kurrsesi prej natyrës, e cila për Naimin mbetet vetëm burim i bukurisë dhe i së mirës.

*Sa ësht' e bukur faq' e dheut! S'të zë syri gjë të metë.*

*Gjithë kjo bukuri vallë nga dheu të ketë mbleruar,*

*A më të matht të ti zoti pej parrajs' e ka dërguar?*

(*Bagëti e bujqësia* f. 75)

— Do të pyesë Naimi në poemën e vet, pa u shtyrë më tej të japë një përgjigje. Po edhe pse mbetet kështu në mëdyshje, Naimi e sheh natyrën vetëm si të bukur. Ndryshe nga pjesët e para të ciklit «**Bukuria**», ku Naimi niset nga pozitat e mendimtarit që kërkon të gjejë realizimet e bukurisë së abstraguar më parë, në poemën «**Bagëti e bujqësia**», bukuria objektive e natyrës është shkaku i parë e i vëtëm, që nxit përfjetimet estetike të poetit. Nga kjo pikëpamje, bukuria e natyrës për Naimin ekziston realisht, cilësitet që e bëjnë atë të bukur janë inherente, pa ato natyra nuk mund të përceptohet. Edhe në qofshin krijuar nga zoti, përsëri ato ekzistojnë objektivisht, dhe poeti, në kërkoftë të bukurën, vetëm atje mund ta gjejë.

Një trajtë të përsosur, delikate të bukurisë, aq fort të kërkuar nga romantikët, Naimi e sheh te gruaja:

*Kudo është bukuria*

*Në qiej, në dhe, në hënë,*

*Në diell, në shënjë, në yj*

*Ndër lule, nër drurë, ndër pyj,*

*Çdo vënt që të ketë zënë*

*Atje tfaqet perëndia,*

*Po këtu është e tërë*

*Dhe ajo ti është bërë.*

(*Bukuria*, f. 169, 170)

Gruaja që do Naimi nuk shquhet për gjë tjetër, ajo është vetëm tepër e bukur. Duket sikur poeti, sidomos në vjershat e para të ciklit «Bukuria», është rob jo i një gruaje, qenie e gjallë, po vetëm i bukurisë që vezullon prej saj. Në këto vjersha Naimi e ka të pamundur pëershkrimin e bukurisë së gruas dhe mjaftohet ta metaforizojë atë me fjalët «dritë», «diell», «ditë». Më pas edhe poetikisht, ai kërkon mjete të tjera shprehëse, krahasime dhe metafora, të ngritura mbi bazën e përgjasjes së bukurisë së gruas me objekte materiale. Meditimit tani nis t’ia zërë vendin ndjenja, një ndjenjë fort e trazuar që kalon nga një skaj në tjetrin, nga lektisja marramendëse pas bukurisë së të dashurës, te vuajtja e thellë për shkak të mospërfilljes së saj e të kohës së rinisë që shkon e s’kthehet më. Naimi tani i shpreh lirisht ndjenjat e tij dhe nuk qëndron më në pozitat e soditësít, i cili me gjithëse në asnjë rast nuk mbetej i ftohtë, gjithsesi meditonë mbi bukurinë, që tërhiqte në mënyrë të veçantë romantikët. Bukuria e gruas atij i shfaqet reale, si shkallë më e lartë e bukurisë që gjendet kudo: në qiej, në dherë, ndër pyje e lule. Poeti është i gatshëm të sakrifikohet për hirë saj dhe një gjendje e tillë shpirtërore nuk mund të përjetohet e shkaktuar nga ideja e së bukurës, po nga një bukurie gjallë, reale, e jashtëzakonshme. Ndaj edhe qenia prej nga shpérthen kjo bukuri, s’mbetej më në një ëndërr a fanitje.

Naimi nuk u mor shumë me motivin e dashurisë dhe, pardysim, në ato raste që e trajtoi, nuk u nis nga qëndrimet më të përgjithshme të romantikëve, të cilët shihnin tek kjo ndjenjë shpeshherë kuptimin e vetëm të jetës, një nga mënyrat më të përshtatshme për të sfiduar boshllékun e jetës shpirtërore që, sipas tyre, triumfonte gjithnjë e më dukshëm në realitetin e kohës dhe të vendeve të tyre. Meqenëse, siç dihet, romantizmi ynë lindi si i tillë pa hyrë në luftë me klasicizmin që nuk u zhvillua tek ne, Naimi nuk kishte pse të shihte te ndjenja e dashurisë udhëheqësen e vetme të jetës njerëzore, që i ku’ndërvihej «arsyes» së predikuar nga klasicistët. Naimi e trajtoi këtë motiv si një nga motivet më jetësore. Mrekullitë lirike që krijoj, tregojnë qartë se Naimi ishte pranë koncepteve romantike, sipas të cilave dashuria e vlen sakrificën, se ajo në natyrën e saj është hyjnore, se sensualizmi është i huaj për të. Pikërisht për këto arsyen te cikli «Bukuria», edhe nëse shfaqen ndikime të poezisë orientale, ato janë të sipërfaqshme dhe nuk prekin thelbin romantik të tij.

Në arsyetime të shumta për gruan Naimi nuk shtyhet, bota e saj shpirtërore nuk i intereson. Naimi bën fjalë vetëm

për indiferencën e vajzës; në kontrast të thellë me të vjen dashuria e poetit që s'gjen rrugë tjetër, veç kënaqësisë që do t'i sjellë vdekja për shkak të bukurisë së vajzës. Ajo që sundon në ciklin «Bukuria» është pasioni i fuqishëm, një lloj nënshtrimi, të cilin Naimi e pranon si një ndër shfaqjet më komplekse e njëkohësisht më fatale të jetës:

*Pse heq unë  
Hidhërimë  
A në vdekça, ti mos qaj;  
Vdekja ime  
S'të prish punë,  
Haj, e zeza jetë, haj!*

(Bukuria, f. 173)

Më tej, të gjejë ç'është e ç'nuk është dashuria, Naimi nuk shkon; dashuria si bazë e bashkimit hyjnor midis burrit dhe gruas ose, përkundrazi, dashuria e lirë jashtë çdo detyrimi moral, dashuria si burim gjëzimi e lumturie e si shkak dramash të rënda — të gjitha këto shqetësimë të romantikëve nuk janë trajtuar te cikli «Bukuria». Atje pasqyrohen më fort të tjera qëndrime të njobura romantike, sipas të cilave bukuria është një urë që shpie te zoti, te e vërteta, një shfaqje, e cila, kur kuptohet dhe ndjehet si e tillë, ndikon thellë në shpirtin e njerëzve, aq sa konsiderohet si e vëtmja mundësi për të ndrejtur botën. Më qartë se kudo Naimi e ka shprehur këtë pikë-pamje në poemën «Histori e Skënderbeut»:

*Ra në dett të bukurisë  
mëndjenë vala ja mori,  
ju afroa Perëndisë  
se vala atje e nxori,  
Shumë herë bukuria  
e ngre njerinë përpjjetë,  
e shpie te Perëndia  
i rrëfen zotn' e vërtetë<sup>1</sup>*

1) Naim Frashëri, Vepra 3, Histori e Skënderbeut, Prishtinë 1978, f. 180.

Në këtë poemë Naimi është përsëri i pranë konceptit të njohur romantik, sipas të cilët bukuria është edhe një virtut, madje bûrim i tij:

«*O bukuria pa anë!  
o burim' i mirësisë!  
gjithë ty të kemi pranë!  
je afërë njerëzisë»*

(Histori e Skënderbeut, f. 181)

Po ndërkaoq, nuk mungojnë rastet kur Naimi e sheh bukurinë si shkaktare të një vuajtjeje të rëndë, që lind nga kontradikta midis saj dhe kohës që shkon e më nuk vjen. Kjo kontradiktë i ka tërhequr vazhdimisht romantikët dhe te Naimi është mjaft e theksuar.

Në poemën «O eros» Naimi i mbahet idesë se vetëm gjithë fuqia e zotit është në gjendje të krijojë dashurinë dhe se çdo gjë e bukur në këtë botë, lulet, vera, dashuria, janë fryt i dashurinë, që tanë është konceptuar jo si një pasion i thellë, po si një forcë e vërtetë purifikuese për njerëzit, vepra i shmanget mjaft titullit që mban dhe kërkon të realizojë synime të tjera, që kanë të bëjnë me një prirje të vjetër të poetit, shfaqur që në krijimet e hershme të tij, («Tehajylat» — Endërrimet), me meditimet për raportet midis gjithësisë e njëriut.

E shkuara në bashkëvajtje me të mirën nga njëra anë, dhe e tashmja, në mos në bashkëvajtje me të ligën po prapë zhgënjiyese në shumë pikëpamje — këtë trajtë ka marrë në poezinë e Naimit kulti romantik për të kaluarën. Po Naimi nuk e përgjithëson jashtë çdo kufiri këtë qëndrim romantik. Për të vetëm e kaluara e Shqipërisë ishte e bukur, ndërsa vendet e tjera të Evropës, shekuj më parë ishin në prapambetje të thellë dhe do të zgjöheshin, siç thotë ai, nga Rusoi dhe Volteri. Naimi kishte arsyë që mbajti një qëndrim të tillë. Si iluminist thallisht i bindur, që vepronte pikërisht në kushtet e Shqipërisë, qëndrimi i Naimit ndaj së kaluarës do të ndryshonte në krahasim me vlerësimet më të përgjithshme romantike. Aktualiteti evropian, prej pozitave nga nisej Naimi, ishte padyshim më i përparuar se vendi i tij, e nga kjo pikëpamje poeti nuk mund të mbahej pas ideve të njohura të romantikëve, për të cilët bukuria, e mira dhe njeriu i vërtetë du-

heshin kërkuar vetëm në të kaluarën ose në viset ekzotike. Në përputhje me synimet e veprës së tij, Naimi çmonte të kaluarën e atdheut dhe të tashmen e Evropës, e shkuara e së cilës për të, ndryshe nga përfytyrimet romantike, ishte e kritikueshme në shumë anë. Për Naimin pikëpamjet iluministe mbeteshin ideale që duheshin realizuar; ai nuk provoi dhe objektivisht nuk mund të provonte zhgënjime të thella prej realitetit të shoqërive borgjeze, i cili nuk ishte krijuar ende, në Shqipëri. Romantikët evropianë, sidomos ata të Evropës Perëndimore, ishin shkrimitarë që jetuan e punuan në kohën e konsolidimit të borgjezisë si klasë drejtuese e shoqërisë, atëherë kur kjo kish pushuar së qeni një klasë përparimtare; ndërsa Naimi ishte përfaqësues i borgjezisë shqiptare, e cila, ndonëse e do-bët, mbetej klasa më përparimtare e shoqërisë shqiptare të epokës së Rilindjes.

Sidoqoftë, kundërvënia romantike: «e kaluara e virtytshme — e tanishmja plot vese» ekziston si e tillë në veprën e Naimit me një brendi, që përputhej plotësisht me synimet politike të Rilindjes: liria e së kaluarës, robëria e kohës së tij:

*O liri e shënjtëruar!  
 ëngjëlli i Perëndisë,  
 erdhe me gëzim ndër duar,  
 i dhe dritë Shqipërisë.  
 Vallë kur do të vish prapë,  
 e të na sjellë atë ditë,  
 përsë rri pështjellë me napë?  
 pa hiqe, të shohëm dritë!*

(Historia e Skënderbeut, f. 91)

Kushtrimi për lirinë, prirja themelore e romantizmit shqiptar, u realizua kryesisht nëpërmjet evokimit të së kaluarës historike. Naimi me shokë bashkohen në shumë pika me veprën e romantikëve arbëreshë, po pasqyrimi i shekullit XV, i luftërave të popullit tonë nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit kundër pushtuesve osmanë përbën atë pikë, ku më fort se kudo gjetkë shfaqet qartë njësia e letërsisë së Rilindjes sonë Kombëtare. Naimi në veprën e tij poetike shtyhet më tutje në histori, në mugëtirat e saj, duke u kapur pas tezës pellazgjike të origjinës së shqiptarëve, për të ardhur në kohëra më të reja, në kohët e ilirëve. Çdo gjë në ato vite në Shqipëri për Naimin ishte e bukur dhe e mirë:

*Ish parrajsë Shqipëria,  
Se ishte gjall mirësia.*

(Parrajsa, f. 214)

Në disa raste, si te poema «*Bagëti e bujqësia*», Naimi dallon të bukurën nga e mira, po më shpesh ai niset nga mendimi platonian, sipas të cilët e bukura burimin e ka te e mira. Me prirjen e tij prej moralisti, Naimi i njëson me lehtësi këto koncepte. Por në krijimet që flasin për atdheun, ai nuk nisej nga pozitat e filozofit që meditonë për të bukurën e të mirën, po nga mendimi se ato ishin të vetmet tipare që mund të karakterizonin të kaluarën e Shqipërisë. Kur flet për të shkuarën, te Naimi mungon çdo lloj qëndrimi kritik; ndryshe nga romantikët evropianë, që vlerësonin pasionet e fuqishme të njerëzve të atyre kohërave e, për pasojë, jepeshin edhe pas përshkrimit të dramave të rënda të tyre, Naimi sheh atje vetëm harmoninë e bukurinë më të plotë, mirësinë më të thellë, trimërinë më të flaktë. Sigurisht, Naimi ishte në gjendje të kuptonte fare mirë se jo çdo gjë në të kaluarën vinte mbarë, ashtu siç i paraqet ai në «*Historinë e Skënderbeut*» dhe në mënyrë të veçantë te «*Parajsa*». Ai theksoi adhurimin romantik për të kaluarën, megjithëse ishte i bindur se kohërat më të vona kishin sjellë përparim në çdo pikëpamje. Nuk ndodhi kështu me romantikët arbëreshë, të cilët u ndodhën më pranë zhvillimeve të romantizmit evropian dhe i ndien më të afërta jehonat e tij. Po në këtë mes rëndësi ka fakti që Naimi, për të shprehur kundërshtimin e fuqishëm ndaj statusit politik të Shqipërisë së viteve të tija, ndoqi një udhë të njojur romantike, ekzaltimin e së kaluarës. Mënyra si e ekzaltoi ai këtë të kaluar, duke e përshkruar vetëm si të bukur e të mirë, sillte pa dyshim një lloj monotonie nga pikëpamja artistike. Po Naimi e kuptonte se, që të depërtonte menjëherë në botën shpirtërore të njerëzve të thjeshtë, për nivelin e zhvillimit kulturor të popullit, në kohën e tij duheshin shfrytëzuar mënyra gjithashu të thjeshta, që tregonin shpejt e qartë vetëm mirësinë e së kaluarës, e cila duhej ringjallur në të sotmen. Ai u kap fort pas këtij synimi dhe, nëse rendit më pas, sidomos tek «*Parajsa*», një varg pamjesh me të cilat përpinqet të krijojë përfytyrimin e bukurisë së përgjithshme, këtë e bën jo aq shumë për të shprehur bindjet e veta sesa për të rritur shkallën e ndikimit, të nxitjes dhe të frymëzimit të ndjenjës kombëtare. Nga ana tjetër, Naimi, plotësisht i ndërgjegjshëm, kërkoi mënyra të thjeshta të të

shprehurit artistik, pa qenë gjithmonë në gjendje të shmangë thjeshtëzimet.

Ashtu si shumë romantikë, Naimi gjeti tek historia e popullit të vet një nga mënyrat më të efektshme për të mohuar sidomos realitetin politik të Shqipërisë së kohës së tij. Zaten tek historicizmi do parë një nga tiparet më të qenësishme romantike të veprës së tij. Po ndërkaq, Naimi, në një shkallë akoma më të ndjeshme sesa poetët arbëreshë, për pasqyrimin e shekullit XV u nis nga synime që ndryshonin në shumë pikë nga synimet e romantikëve evropianë. Naimi vërtet ekzaltoi atë kohë dhe njerëzit që e jetuan, por kur fliste për këta të fundit, thuajse në asnjë rast nuk i diferenconte nga bashkë-kohësit e vet; duke vlerësuar virthitet e së kaluarës, ai nuk theksoi veset e së tashmes. Po ashtu, në evokimin e historisë së vendit të tij Naimi nuk u nis nga konsiderata e përgjithshme romantike, sipas së cilës mesjeta ishte tërheqëse në shumë anë të jetës së saj. Këtë pikëpamje romantikët e mbanin të nxitur më fort nga motive estetike, të kundërtat me qëndrimet klasiciste, që shihnin tek ajo epokë një kohë të errët, e cila është e tillë edhe për Naimin që e gjykonte Mesjetën si iluminist dhe nuk mund të pranonte që rrjedha e kohës të mos sillte përparimin.

Sigurisht, Naimi nuk e kuptoi mekanizmin e zhvillimit historik. Por, po kaq e sigurt është gjithashtu se kur krijonte «Historinë e Skënderbeut», ai u nis nga pozitat e poetit dhe jo të historianit. Prandaj një nga qëndrimet më të njëjësishme që mund të mbaheshin ndaj veprës së tij, do të ishte gjykim i saj nga pozitat e historianit të mirëfilltë. Një gjykim i tillë nuk është i pamundur; në të mund të shtyjë subjekti i veprës, e cila pasqyron në mënyrë kronologjike ngjarjet më të rëndësishme të jetës së Gjergj Kastriotit. Në atë poemë janë rrashuar të gjitha kontradiktat sociale, të cilat pa dyshim, edhe pse kishin dalë në atë kohë në plan të dytë, prapë vepronin e ndikonin fort mbi kontradiktën themelore, kontradiktën midis popullit dhe pushtuesit të huaj. Në poemën e vet Naimi, në përgjithësi, i ka shmangur gjithmonë konfliktet midis shqiptarëve. Edhe atëherë kur është gjendur para fakteve të njoitura historike, që flisin për interesa të kundërtat dhe grindje në mes feudalisëve shqiptarë të atyre viteve, ai në më të shumtën e rasteve u ka dhënë një përbajtje vetëm morale. Nga kjo anë, poema «Historia e Skënderbeut» ndahet prej krijimtarisë romantike me temën historike, e cila krijonte gjithnjë konflikte të thella të natyrave nga më të ndryshmet. Dihet se Naimi

me vëtëdije e përshkrroi epokën e Skënderbeut si një epokë të ndritur të historisë së popullit të tij, thelbi historik i së cilës duhej vënë në shërbim të zhvillimeve politike të kohës kur jetoi poeti. Vepra e romantikëve arbëreshë, sidomos ajo e Jeronim de Radës, arriti të prekë zado pak e në mënyrë të sipërfaqshme kontradiktat midis feudalëve shqiptarë. Po edhe ajo ashtu si vepra e Naimit, si e kemi vënë në dukje gjetkë, nuk pasqyroj e nuk mund të pasqyronte kontradiktat midis feudalëve shqiptarë. Naimi gjykonte se, nga pikëpamja politike, pasqyrimi i atyre kontradiktave shkonte ndesh me qëllimet e lëvizjes së Rilindjes Kombëtare. Dobësitë e borgjezisë shqiptare kanë luajtur sigurisht rolin e tyre në këto qëndrime të tijat. Sidoqoftë, mënyra si e ka pasqyruar Naimi shekullin XV trëgon fare qartë së ai mbetej me të dyja këmbët në kohën e vet. Héronj si Skënderbeu, Kamani etj., skenat e njëpasnjëshme të luftës, mbi të gjitha ndjenja e thellë dhe e zjarrtë atdhetarë, që e përshkon në çdo qelizë poemën «*Historia e Skënderbeut*», mbartin pasqyrimin e së njëjtës kontradiktë themlore, e cila gjatë epokës së Rilindjes Kombëtare, ishte acaruar përsëri. Ngå ana tjetër, vepra në vetvete shpreh një evoluim shumë të rëndësishëm të pikëpamjeve të Naimit mbi rrugët që duheshin ndjekur përritjen e pavarësisë kombëtare. Naimi iluminist hera-herës mendonte se bashkëatdheta-reve të tij nuk u duhej «veç pena dhe karta» për të fituar lirinë e vendit. Ai e krioi shumicën e veprave të tij në periudhën pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në një kohë kur atdhetarët rilindës intensifikuan shumë veprimtarinë e tyre për emancipimin kulturor të popullit, të cilin, e konsideronin të domosdoshëm përfitoren e pavarësisë. Me të drejtë atdhetarët tanë vunë re se një nga shkaqet e shkatërrimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte prapambetja e thellë kulturore e vendit, prandaj ata u kapën pas asaj veprimtarie, realizmi dhe drejtësia e së cilës mund të cenohej vetëm po të shpihej në ekstrém e të konsiderohej si e vetmjë rrugë që duhej ndjekur për sigurimin e lirisë. Në pozita të tilla Naimi nuk ra kurrë. Poema «*Historia e Skënderbeut*» është mjaft elokuentë për të treguar se Naimi e kapërceu përfundimisht idenë se pavarësia mund të arrihej vetëm me mënyrat iluministe; ajo ishte njëkohësisht shprehje e qartë e qëndrimit gjithnjë të afërt që mbante poeti ndaj zhvillimit të kërkësave politike të Rilindjes. Vështruar nga pikëpamja e temës së këtij punimi, ky qëndrim i Naimit theksonte fort karakterin përfundimtar të frysës romantiqe të veprës së tij.

Ihtar i republikanizmit që lindi pas Revolucionit borgjez francez, Naimi megjithatë flet shpesh «për mbretësinë» shqiptare të krijuar nga «mbreti Skënderbe». Kur vepron kështu, Naimi siguriqësht nuk shpreh ndonjë parapëlqim të veçantë ndaj mbretërisë si formë e organizimit shtetëror, por vetëm adhurimin ndaj bashkimit të shqiptarëve, që ai e mendonte të arritur nën një formë të tillë, të zakonshme për kohërat për të cilat bënte fjalë.

Naimi bëri përpjekjen e parë për të krijuar një përfytyrim të plotë për Gjergj Kastriotin. Kjo figurë ishte trajtuar më parë nga shkrimitarët arbëreshë, sidomos nga Jeronim de Rada dhe Gavril Dara. Notat që theksuan ata në figurën e Skënderbeut, janë vënë tashmë në dukje. Ndryshe nga poetët arbëreshë, Naimi synonte të krijonte figurën e shumanshme të udhëheqësit të asaj kohe, që i duhej njëherazi edhe kohës së tij. Prandaj ai nuk do të flasë për dramën që mbajti mbi shpatullat Skënderbeu, pas së cilës u tërroqën më shumë arbëreshët, të cilët në këtë pikë qenë më pranë qëndrimeve që mbanin romantikët evropianë ndaj personaliteteve të fuqishme historike. Naimi kërkon më shumë që edhe më figurën e Skënderbeut t'i japë krahë apoteozës së fitores, entuziasmit, besimit dhe optimizmit. Tragjizmi, që për shumë shkaqe u shfaq në veprat e poetëve arbëreshë, në poemën «Historia e Skënderbeut» nuk ka vend. Sigurisht në këtë dallim të dukshëm kanë ndikuar një varg faktorësh, në radhë të parë lidhja më e ngushtë e Naimit me zhvillimin e gjendjes shpirtërore të shqiptarëve në ato vite. Nga ana tjetër, tek arbëreshët ishte e natyrshme të shfaqeshin notat tragjike, pasi tragjedinë shqiptare të shekullit XV të parët e tyre dhe ata vetë e kishin ndier gjer në palcë. Edhe pse është njohës i thellë i shpirtit njerëzor, Naimi me vetëdije i ka shmangur përgjithësisht dramat në veprën e tij, po të përjashtojmë përshkrimin e vuajtjeve të rënda të nënës që i marrin peng djemtë dhe të gjendjes së vështirë shpirtërore të Gjon Kastriotit që nuk gjen prehje as në varr, sepse i biri ende nuk kishte marrë në dorë fatet e Atdheut. Sigurisht, Naimi, sa herë që ka rastin, përshkruan mjerimin e vendit nën pushtimin turk dhe vuajtjet e shqiptarëve nga vërvshimi i hordhive otomane. Po ai u ndal në to më shumë për të krijuar kontraste të thella e të menjëherësht me midis këtyre dhe gëzimit të përgjithshëm, harmonisë e mirëqenies që sundonte sa qe gjallë e drejtoi vendin Skënderbeu. Një personalitet si ai i Skënderbeut, që u kërkua nga atdheu dhe veproi në një kohë mjaft të vështirë, domosdo ka pasur

një jetë intensive shpirtërore, që nuk përjashtonte, përkundrazi i kishte vazhdimisht të pranishme çastet e vendimeve të rënda e të përgjegjësive të mëdha, të cilat kërkonin prej tij forcë të jashtëzakonshme morale, kë-konin pra, të ndiente thellë vështirësitet e të gjente rrugën e kapërcimit të tyre. Të gjitha këto nuk mund të përballoheshin pa luftën shpirtërore, e cila në përgjithësi nuk është pasqyruar prej Naimit. Për ndërtimin e figurës së Skënderbeut, ashtu si për të gjithë vepren, Naimi është mbështetur mjaft te Barleti. Skënderbeu i Naimit është paraqitur si i parë ndër të parët, me tipare të theksuara demokratike, megjithëse mbetet një hero legjendar; ai përfaqësonte një harmonizim të përkryer të virtuteve morale me cilësitë më të përsosura trupore e me një mendje të fuqishme. Te Skënderbeu — thotë Naimi, — Perëndia ka grumbulluar:

*Gjithë q'janë mirësitë  
e të tërë trimërinë  
urtësit', e dituritë  
bukurin' e njerëzinë*

(Histori e Skënderbeut, f. 142)

Veç cilësive morale e fizike, Naimi iluminist nuk ka lënë mënjanë dashurinë e heroit për diturinë dhe arsimin. Skënderbeu në përfytyrimet e Naimit është edhe një mecenë, mbrojtës i dijeve dhe i arsimit. Atij ia donte puna të vepronë kështu me figurën e heroit. Duke synuar të jepte portretin e udhëheqësit të kombit edhe për kohën e tij, Naimi mendonte se ky udhëheqës duhej të dinte të harmonizonte luftën e krahut me atë të mendjes. A duhen parë këtu ndikime të konceptit që ushqenin iluministët mbi «mbretin filozof» a «principi e ndritur», kjo është një çështje që duhet gjurmuar më nga afëri. Sidoqoftë, mënyra si e konceptoi Naimi Skënderbeun ka bërë që figura e tij në përgjithësi të jetë pothuajse e një trajtshme, pa ndryshime e zhvillime gjatë ngjarjeve, një figurë e derdhur në një kallëp të përgatitur më parë. Për të gjitha këto arsyen, te figura e Skënderbeut nuk duhet kërkuar heroi romantik, edhe pse Naimi i veshi asaj cilësi të jashtëzakonshme. Skënderbeu i Naimit mbetet shumë larg heronjve tipikë romantikë, konceptimi i të cilëve, siç dihet, është ndikuar aq fort prej frymës bajroniane. Dhe përgjithësisht kjo frymë, e cila pa qenë

aspak sunduese, mund të ketë lënë gjurmë në letërsinë arbëreshe, sidomos te vepra e Jeronim de Radës, nuk është ndier fare në poemën «*Histori e Skënderbeut*» dhe në gjithë krijimtarinë e Naimit. Në «*Historinë e Skënderbeut*», me mënyrën si e pasqyroj shekullin XV, Naimi përsëri mbeti larg praktikave e prirjeve romantike të zakonshme. Në këtë vepër mungojnë kalorësit, jeta dhe zakonet e kështjellave, zonjat fisnikë dhe dashnorët e tyre, aventurat, magjistarët dhe figurat mitologjike. Sigurisht, të gjitha këto nuk janë karakteristike për çdo vepër romantike, po në tërësinë e vet romantizmi i përbante të tilla shfaqje. Me Naimin nuk ndodhi dhe nuk mund të ndodhë kështu. Qëllimet që i kishte vënë vetes: të krijonte eposin për heroin kombëtar, t'i shërbente në këtë mënyrë një nevoje të ngutshme jo vetëm për letërsinë dhe kulturën tonë në përgjithësi, po edhe për jetën politike të vendit, kërkonin që poeti të kapej më shumë pas cilësive morale që kultivonte ajo kohë betejash e provash të rënda. Prandaj, nëse ka ndonjë kult në poemën e Naimit, ai nuk i takon as pasionit, as natyrës dhe as dramave të fuqishme vetjake, ai i takon vetëm virtytit. Jo vetëm në këtë vepër, po përgjithësisht në tërë krijimtarinë e tij, Naimi u kushton një vend shumë të gjerë cilësive morale. Sigurisht, pas këtyre cilësive u dhanë të gjithë romantikët, të cilët, siç dihet, njëriun e ditëve të tyre shpesh e përbuznin, pasi e gjenin të krimbur në vese; virtytin ata e kërkonin në kohëra të tjera, të shkuara. Edhe te Naimi ka një përpjekje të dukshme për të krijuar një sistem pikëpamjesh etike. Nuk është vendi këtu të analizohet ky sistem, i cili përban shumë vlera, ashtu siç ka edhe pika të dobtë<sup>1</sup>. Ajo që na duhet të dimë është nëse bota e virtytit, pas së cilës kapej aq fort poeti, i shkonte për shtat frymës së përgjithshme romantike të veprës së tij. Studiuesit tanë janë marrë shumë me pikëpamjet etike të Naimit dhe kanë vënë në dukje burimet e formimit të tyre, jetën zakonore të popullit tonë, fenë, sektin bektashian në mënyrë të veçantë, filozofinë orientale, filozofinë antike etj. Në përgjithësi ata nuk kanë vënë re ndonjë ndikim të romantizmit në krijimin e kësaj prirjeje te Naimi. Po në një vështrim më të gjerë, interes i veçantë i Naimit për tiparet morale të njëriut, nuk shkon ndesh me qëndrimet e tij romantike, sidomos me ëndërrimin për të krijuar një jetë tjetër, të bukur e har-

1) Shih më hollësisht: Zija Xholi, **Humanizmi i Naim Frashërit dhe mësimet e tij morale**, Nëntori, 1971/5.

monike, në qendër të së cilës do të ishte njeriu i virtytshëm.

Shumë shkrimitarë romantikë ekzaltuan triumfin e virtytit në fatkeqësi, në dramë të thellë. Këtë qëndrim ata e trashëguan nga sentimentalizmi. Ndryshe nga atë, Naimi ndjek një mënyrë tjetër: herë vlerëson poetikisht virtytet e herë i transmeton ato në trajtë sentencash. Rruja e parë ndiqet pothuajse në gjithë krijimtarinë poetike, tek poema «**Bagëti e bujqësia**» e në «**Historinë e Skënderbeut**»; e dyta shfaqet më shumë në krijimtarinë jashtëletrare të tij. Ishte e natyrshme që ky ndryshim të ndikonte në një shkallë të ndjeshme në nivelin artistik të asaj pjese të krijimtarisë, ku Naimi merret gjatë me cilësitë morale të njerëzve. Vetëm në ndonjë rast fare të rrallë, te figura e Moisi Golemit, Naimi përpinqet të pëershkratë gjendjen shpirtërore kontradicione pas kapercimit të së cilës triumfon virtuti; poema «**Histori e Skënderbeut**» nuk dallohet pëpasazhe të shumta e të goditura të analizave psikologjike. Në disa krijime Naimi i rendit cilësitë morale të heronjeve të vet në mënyrë të njëtrajtshme, me tone prej predikuesi. Kur rithesojmë se Naimi në shumë vepra të tjera ishte plotësisht në gjendje të pasqyronte një botë shumë të pasur e të hollë shpirtërore, duam të vemë në dukje njëkohësisht se ai shpesh nisej nga vlerësimi i veçantë - racionalist mbi rolin e edukatës në jetën e një kombi, nga mendimi se për çastet historike që po kalonte vendi e populli i tij, ishte e domosdoshme të bëheshin të gjitha përpjekjet për të krijuar ndërt shqiptarët bindjen e ndërgjegjshme se kishte ardhur koha të merrnin përsëri në duar fatet e Atdheut. Këtë shqiptarë nuk mund të ishin ndryshe, veçse të pajisur me të gjitha virtytet. Virtuti, si një nga prirjet më të theksuara të veprës së Naimit, mbetet i tillë edhe të poetët që erdhën pas tij, te Çajupi e Asdreni sidomos. Ndodhi kështu jo vetëm se në fillimet e krijimtarisë ata u ndikuau shumë nga Naimi, po sepse tërë letërsia e Rilindjes ishte letërsia e një populli që po gjalléronte forcat e tij morale. Përrrethanat e atyre viteve ishte më e përshtatshme që virtuti të ekzaltohej në mënyrë të drejtpërdrejtë, kryesisht nëpërmjet një gjendjeje shpirtërore patetike, po edhe në trajtën e këshillave morale. Te Çajupi dhe Asdreni virtytet e shqiptarëve evokohen shpesh nëpërmjet krijuarit të një kontrasti të thellë midis cilësive morale të të parëve dhe bashkëkohësve. Siguarisht, Çajupi e Asdreni kishin besim te cilësitë që ua mohonin hera-herës bashkëkohësve, prandaj qëndrimet e tyre, dëuke qenë të çastit, mbeten edhe retorikë e mënyra që ata i gjenin me forcë të madhe shprehëse. Naimi nuk vepron në

këtë mënyrë, patosi kritik i veprës së tij rrallëherë është i drejtpërdrejtë. Në poemën «*Histori e Skënderbeut*», e në vepra të tjera si «*Parajsa*», ai krijon kontraste, por pa u munduar të ndërtojë me to situata dramatike të fuqishme. Në «*Historinë e Skënderbeut*» mungojnë përpjekjet për të krijuar e përshkruar mjedise karakteristike, jetën zakonore të kohës. Atje mungojnë gjithashtu edhe shumë shfaqje të tjera romantike, tërheqja pas së jashtëzakonshmes, së çuditshmes dhe anormales. Nga kjo pikëpamje, metoda krijuese e Naimit, të paktën në dy prej veprave të tij «*Bagëti e bujqësia*» dhe «*Histori e Skënderbeut*», në një anë themelore largohet nga mënyra romantike e pasqyrimit të jetës. Ambiente e situata të jashtëzakonshme dhe heronj të tillë në këto vepra të Naimit nuk gjenden. Megjithatë metoda krijuese e Naimit mbetet në thelb romantike, sepse në të vihet re fare lehtë vendi i gjerë që zë përfytyrimi, sidomos në poemën «*Bagëti e Bujqësia*». Me rolin e madh që luante ëndërrimi në krijimet romantike, ishte e natyrshme që përfytyrimet poetike, fantazia në përgjithësi, të genë ndër mënyrat më të parapëlqyera prej shkrimitarëve për pasqyrimin e jetës, ashtu siç e konceptonin ata. Kjo nuk do të thotë aspak se romantikët linin mënjanë vëzhgimin, konkrèten; përkundrazi, në luftën e tyre kundër klasicizmit, ata pasqyronin në veprat e tyre të përditshmen, të rëndomtën, madje banalen e të shëmtuarën. Po ndërkohë, synimet që ata kishin, të krijonin përfytyrimin e një bote tjetër, kérkonin medoëmos një fantazi të fuqishme. E kaluara historike mund të rikriohej duke u mbështetur sigurisht në të dhënët e historisë, po për ta, fantazia mbetej e pazëvendësueshme; romantikët mund t'i shkelnin vetë viset e ashtuquajtura ekzotike, po kërkosat e tyre për një jetë të pasur me pasione e virthye, ata i shprehnin kryesisht nëpërmjet fantazisë. Nga pikëpamja e rolit të veçantë që luante fantazia në krijimtarinë romantike, vepra e Naimit, në metodën e saj të pasqyrimit të jetës, afrohet në mënyrë fare të dukshme me veprën e romantikëve në përgjithësi.

Sic mund të shihet edhe nga këto shénime, veçoritë romantike të veprës së Naimit ruajnë në themel tiparet kryesore të epokës së Rilindjes Kombëtare. Poezia e tij përftoi ato tipare të drejtimit romantik, që lejonin të pasqyrohej në radhë të parë lufta dhe përpjekjet e gjithanshme të popullit për fitoren e pavarësisë. Ato mbruheshin me një brendi që buronte dhe i shërbente në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjes kombëtare. Pikërisht këtu duhet këruar dhe gjetur thelbi i originalitetit të romantizmit të veprës së Naimit.

## BRENDIA ROMANTIKE E POEZISE SË ÇAJUPIT

Ndërsa krijimtaria e poetëve arbëreshë, bashkë me ta edhe ajo e Naimit, përshkohen në përgjithësi nga tiparet romantike, vepra e Çajupit është më komplekse. Në poezi, ai mbeti romantik; po në dramaturgji krijoi vepra realiste, komedinë «14 vjeç dhëndër», ose ndoqi modele klasiciste, siç ndodh në tragjedinë «Burri i dheut». Pikërisht për këtë arsyë krijimtarisë së Çajupit do t'i kthehem i edhe kur të flasim përrjetuar që dhat realiste e dukuritë klasiciste në letërsinë tonë.

Në pajtim me frymën e letërsisë së Rilindjes, tek «Baba Tomorri» vihet re i njëjtë adhurim për kohërat e kaluara, të cilat përfshijnë Çajupin ishin të përsosura nga shumë pikëpamje, kohërat e triumfit të lirisë dhe të lulëzimit të virtyteve, që e tashmja po i merrte keqas nëpër këmbë. Çajupi theksonte fort ndryshimet e thella midis së kaluarës e të tashmes:

*Kanë genë trima të lëvduar  
Dhe në luftë s'janë turpëruar,  
Qenë trima dhe mëmëdhatarë,  
Besa, fea s'i kishnë dhe ndarë,*

*Sot qysh gjendet komb' i Shqipërisë  
I përmbysur nga zgjedh' e Turqisë.  
Shqiptarët, si dhe bagëtia,  
Zbathur, zhveshur vdesën nga uria!  
Shqiptarët? Sot s'ka Shqiptarë<sup>1</sup>,*

(Baba-Tomorri, f. 39).

Dhe duke vepruar kështu, ai priret nga vështësime më të haptat, qëndrimet e tij bëhen gjithnjë e më kritike. Çajupi arrinte në

1) Çajupi, **Vepra I, II, III**, përgatitur dhe redaktuar nga F. Dado, Tiranë 1984. (Citimet e tjera nga veprat e Çajupit janë të këtij botimi).

ndonjë rast në përfundime tepër kategorike, të cilat në kriji-  
met e mëvonshme do ta shpinin në pozitat e skeptikut të pa-  
ndreqshëm. Përvoja e jetës e kishte mësuar poetin të dyshonte  
në të «vërtetat e amshuara», mbi të cilat qe ngritur jeta sho-  
qërore dhe morale e kohës. Kur merret pikërisht me këto pro-  
bleme, ai thuajse humbet çdo perspektivë, po në lirikën e tij  
atdhetare nuk ngjet kështu. Tek vepra e tij shfaqet e njëjtë  
karakteristikë, që vërehet në veprën e thuajse të gjithë rilindas-  
ve, të cilët, ndërsa u mbaheshin fort pikëpamjeve më të pér-  
paruara të kohës për çështjen kombëtare, nuk arrinin t'u  
afroheshin zgjidhjeve më të drejta për problemet sociale që  
shtronin hera-herës.

Kjo karakteristikë në krijimtarinë e Çajupit zë e shfa-  
qet që te vepra e tij e parë, përbledhja «**Baba Tomorri**», po  
merr një trajtë të qartë e të plotë te poema «**Baba Musa laku-  
riq**». Interesimet e tij për motivet filozofike, etike e sociale  
në këtë poemë janë pa dyshim shumë të gjera, qëndrimet  
kritike e sarkastike ndaj shoqërisë njerëzore më të thella,  
simpatitë demokratike po ashtu mjافت të qarta. Çajupi, ashtu  
si romantikët në përgjithësi, botën dhe jetën e gjente të ndërtuar  
keq, me to ai nuk pajtohej dot. E gjithë historia e njerë-  
zimit, sipas Çajupit, ka vërtetuar se të mirët, të drejtët gjithnjë  
janë imposhtur nga të ligjtë dhe të padrejtët, të cilët janë përgjithësisht sundimtarë, klerikë, shenjtorë, mbretër, pashallarë,  
bejlerë. Në zemërim e sipër Çajupi shkonte gjer në pranimin  
e dhunës si mjet i domosdoshëm për çlirimin shoqëror të nje-  
riut, po zakonisht ai mjaftohej me konstatimin e mjerimit  
dhe padrejtësisë, më shpërthimet kundrejt të gjithë sundim-  
tarëve, për të arritur në përfundimin se jeta e njerëzve është  
përcaktuar fatalisht të mbetet gjithnjë e tillë. Skepticizmi i  
Çajupit shfaqet në një trajtë ekstreme, madje shndërrohet në  
qëndrime hera-herës nihiliste. Megjithë vështrimet e mprehta  
mbi dallimet e thella sociale e shumë plagë të tjera sho-  
qërore, Çajupi i shtronte problemet thuajse vetëm në rraf-  
shin etik. Edhe zgjidhjet që ai dëshironte, ishin të këtij rra-  
fshi dhe, natyrisht, mbeteshin të paqena dhe naive:

||

*Sulltan, mbret, sikur të jesh  
Do dijë të mbretërojë,  
Gjithë njerëzit do t'i kesh  
Si djemt' e mi do t'i dojë  
Do t'i ndijë varférise  
Dhe do të nderojë pleqtë,*

*Në shërbim të mbretërisë  
Do të vërë njerëz të drejtë*

*Për dritën e diturisë  
Do të përpinqesh me besë,  
Edhe mbrojtës i lirisë  
Do të jeshë sa të vdesë.*

(Baba Musa lakuriq, f. 315,316)

Ndërkaq, po ky Çajup i flakte tej të tilla qëndrime kur fliste për Shqipérinë e lirinë e saj. Ai e kishte krejt të qartë se ç'rrugë duhej ndjekur për arritjen e pavarësisë dhe, pikërisht për këtë arsy, jeta në sytë e tij fitonte vlera të mëdha:

*Kush punon për Shqipérinë,  
Si atdhetar i vërtetë,  
Dhe në vdekjtë për lirinë  
Do të mbahet mend për jetë.*

(Baba Musa lakuriq, f. 212).

Kur Çajupi thërret «Sot s'ka shqiptarë», kjo nuk është veçse shprehje e një gjendjeje shpirtërore të ekzaltuar, pikërisht romantike. Çajupin nuk e kënaqin ritmet e zhvillimit të lëvizjes kombëtare të atyre kohërave; me romantikën e tij, heraherës disi të nervozuar, ai kërkonte ndryshime më të shpejta në statusin politik të Shqipërisë, kapërcime të thella në psikologjinë e bashkatdhetarëve të tij.

Çajupi nuk i kushtoi vepra të plota shekullit XV, jetës dhe veprës së Gjergj Kastriotit. Në një prej vjershave të tij ai shkruante:

*Vdiq Naimi, që këndoi  
Trimërinë, Skënderbenë,*

(Naim Frashëri, f. 63)

Ka shumë të ngjarë që Çajupi të mendonte se pas Naimit nuk kish tjetër që do mund të mund ta përshkruante si duhet heroin. Megjithatë ai do të kthehej te kjo figurë dhe epoka

e saj, duke krijuar kundërtinë e njohur të romantikëve shqiptare: periudha e Skënderbeut e shkëlqyer në çdo pikëpamje — koha e tyre e mjerë, në radhë të parë se i mungonte liria. Si Naimi më parë, edhe Çajupi nuk kërkoi të gjente tek Gjergj Kastrioti heroin që u jepte shkas përfytyrimeve romantike mbi njeriun e jashtëzakonshëm në aftësitë dhe passionet e tij, që mbartte frymën e epokës me të gjitha tiparet e saj. Ashtu si Naimi, Çajupi shihte tek figura e Gjergj Kastriotit karakteristikat e një udhëheqësi që u duhej viteve të Rilindjes. Për Çajupin, si për të gjithë rilindësit, Skënderbeu ishte simboli i lirisë kombëtare, i bashkimit të të gjithë shqiptarëve. Karakterin e heroit ai nuk e përshkroi, po u mjaftua të verë në dukje rezultatin më të dukshëm të veprës së tij, bashkimin, organizimin e udhëheqjen e qëndresës së shqiptarëve si rrugë e vetme përruajtjen e lirisë së tyre. Të tjera synime Çajupi nuk i vuri vetes dhe në përgjithësi përfytyrimet që ai krijoi mbi Skënderbenë, sigurisht shumë më të kufizuara, ndoqën ato që kishte realizuar Naimi.

Lufta kundër përçarjes fetare është nga shqetësimet më të thella të poezisë së Çajupit. Me të ai u mor shumë e në mënyrë fare të hapët. Naimi do të përpinqej të kapërcente ndasitë fetare duke u dhënë pas pikëpamjeve panteiste, ndërsa Çajupi, te «**Baba Tomorri**», do të flasë shpesh në mënyrë të drejtpërdrejtë për dëmin e tyre dhe, më rrallë, do të mundohej, në përmjet ndonjë balade sentimentale si «*Atdheu dhe dashuria*», të ndikonte sa të ishte e mundur në mendësitë fetare të bashkatdhetarëve. Ai do t'ia linte krijimtarisë së mëvonshme ironizimin e thellë të dogmës fetare. Në fillimet e krijimtarisë Çajupi denonconte dëmet e mëdha të përçarjes fetare, duke u përpjekur gjithnjë të transmetonte reagime të fuqishme shpirtërore ndaj saj. Ai mbështetet më fort pikërisht në këto reagime se sa në arsyetimet logjike, që do të tregonin shkaqet historike, faktorët nxitës dhe absurditetin e këtij fenomeni shumë regresiv. Prandaj edhe fryma e përgjithshme e krijimeve në këtë motiv mbetet romantike.

Sic është vënë në dukje me kohë, në një pikëpamje, poema «**Baba Musa lakuriq**» është parodi ndaj dogmës fetare. Megjithatë Çajupi, edhe pse qe i bindur në iracionalizmin e thellë të dogmës, edhe pse luftoi ashpër e hapur kundër klerit, edhe pse, më në fund, nuk besonte fare në zot, prapë problemin e përçarjes fetare ndër shqiptarët mendoi ta shmangete në rrugë iluministe etike. Për të, bashkëjetesa e feve të ndryshme që ushtronin shqiptarët ishte e mundur dhe mund të mos krijonte

shqetësime politike, në rast se ajo do të saturohej me lirinë, mësimin e vertytin. A besonte Çajupi në të tilla zgjidhje, kjo është tjetër çështje. Luftëtar kundër iracionalizmit e dogmatizmit fetar, satirizues i pamëshirshëm ndaj klerit, temperament thellësisht kritik. Çajupi, sigurisht, e njente se qëndrime si këto vështirë se do të jepnin rezultatet që shpresonte e ëndërronte, ndryshe nuk shpjegohet dot skepticizmi i tij. Megjithatë ai kapej pas zgjidhjesh morale, në vëtvete utopike, të cilat domosdö e shpinin poemën në ujërat e romantizmit.

Nga tërësia e vjershave të përfshira në pjesën e parë të «**Baba Tomorrit**», vjersha «**Varfëria dhe liria**» duhet veçuar si shumë domethënëse në pikëpamje të argumentit që po trajtojmë. Ideja se vetëm te kasollet e të varférve kultivohen vertytet dhe pasionet me humane është e lashtë, atë e gjemë edhe tek dramaturgjia klasike greke. Iluministët e përpunuan këtë ide me predispozicion të veçantë dhe e kthyen gati-gati në një ligj të zhvillimeve morale, ndërsa shumë shkrimitarë përaparimtarë romantikë shihnin te populli e te varfëria e tij burimin e vetëm të humanizmit. Ndaj ekzotika e njojur e tyre ishte fort e thellë. Çajupi nuk ndalet shpesh në pasqyrimin e kësaj pikëpamjeje, interesat e tij kryesore vetëm në ndonjë rast të rrallë tërhiqen pas saj. Po në këto raste pozitat e tij janë fare të ngjashme me ato të romantikëve përaparimtarë në përgjithësi:

*Jam i varfër, po i lirë,  
Ndaj më pëlqen varfëria;  
  
S'më duhet ergjëndi mua,  
Dua lirinë edhe nderë,  
Dua të bëj si të dua  
Jo si të duan të tjerë.*

(Varfëria dhe liria, f. 70)

Sic ndodh zakonisht me romantizmin, edhe Çajupi, në krijimet e para e konceptonte antagonizmin social, të cilin e ndiente thellë, vetëm ose pothuajse vetëm në rrafshin etik, si burim të antinomisë vertyt-ves. Tek vjersha «**Varfëria dhe liria**» ai nuk shtyhet të arsyetojë për përfundimin e mjeruar logjik ku shpinte qëndrimi i tij. Ai e shihte varférinë jo si një gjendje ekonomiko-shoqërore që duhej kapërcyer, po e

poetizonte atë duke e shndërruar në të vetmen mundësi për të genë i pastër moralisht. Sigurisht, Çajupi, i mprehtë sic qe, e kuptonte fare mirë se pasuria në shoqërinë ku jetonte, në mos tjetër të paktën i lejonte të kamurit të sillej ashtu sic donte. Vetë ai, kështu jetoi dhe diti, nga ana tjetër, të çlrohej prej ankthit e frikës së pasigurisë që shkakton pasuria e madhe, e cila e tjetërson zotërueshin e saj. Sipas Çajupit, duhet një forcë e madhe morale pér të mos u kthyer në rob të pasurisë. Çajupi e pati këtë forcë, ai diti të vërente se jeta e pasanikëve nuk mbetej më në duart e tyre, ajo bëhej lodër në duart e pasurisë. Pa qenë në gjendje të kuptonte deri në fund shkaqet materiale të këtij fenomeni, Çajupi e pranon varfërinë si të keqen më të vogël në krahasim me zvetënimin shpirtëror dhe komplekset që sjell me vete pasuria. Kësaj pikëpamjeje Çajupi do t'i mbahet edhe tek poema «Baba Musa lakuriq».

Disa herë Çajupi do ta lërë veten të pushtohet prej ndjenjash të trishtuara e fatale. Kotësia e ekzistencës, një nga motivet e përhapura në letërsinë romantike, është trajtuar edhe tek Çajupi; ajo ka krijuar ndoshta kontratin më të thellë të poezisë së tij. «Bon vivant» sic qe, pér Çajupin ishte e natyrshme të ndiente thellë shkurtësinë e jetës e të përpinqej t'i afrohej idesë së fundit të pashmangshëm, pa ushqyer asnje lloj iluzioni. Zhgënjesë pér të mbeten bota e jeta, të cilat pér njeriun e veçantë janë gjithnjë efemere:

*Botë, moj bot' e pabesë,  
Nukë ke gjë të vërtetë,*

*Pastaj do të më harrojnë,  
Dhe sikur s'kam qënë kurrë.*

(Vaje, f. 87)

Romantikët meditonin vazhdimisht pér misterin e vdekjes dhe, në më të shumtën e rasteve, i mbyt fataliteti më i theksuar e një trishtim i rëndë. Disa ngushëllohen ngaqë njerzit janë tmerrësisht të barabartë ndaj vdekjes, të tjerë ngushëllimin kërkojnë ta gjejnë vetëm tek shpresa se eshtrat do t'u prehen në dheun e vendlindjes. Çajupi është në këto ujëra:

*Kur shkoj nëpëri varre, ku ka mbirë bari,  
Që rritet e mahet me trupinë tënë,*

*Kujtoj kush ka vdekur, mendoj ç'kanë qenë  
Zëmra më lëndonet dhe s'pushon së qari.*

(Vaje, f. 87)

Po në krijimet e tij me motivin patriotik, vdekja dhe valli tingëllojnë ndryshe, kthehen gati-gati në simbole shumë kuptimplotë të vendlindjes, të atdheut. Në këto raste atmosfera që rrëthon vjershën mund të jetë e atillë ose e këtillë, po e zyrtë kurrsesi:

*Mëmëdhe quhetë toka  
Ku më ka rënurë koka,*

*Stërgjyshëtë ku kanë qenë  
Dhe varret q'i kanë vënë*

*Ku rroj me gaz e me shpresë,  
Ku kam dëshirë të vdesë.*

(Mëmëdheu, f. 42)

Çajupi nuk e identifikoi asnjëherë vdekjen e individit me zhdukjen e njerëzimit, veten nuk e shndërroi në kërthizë të botës dhe në asnjë rast nuk ra në pozita egocentrike, aq të zakonshme pér mjaft shkrimtarë romantikë. Kur flet pér vahdimësinë e jetës, ai është përgjithësisht racional, ndërsa tek mediton pér fundin e pashmangshëm, trishtimi është shumë i thellë. Janë çaste dobësie të poetit, të cilat ai nuk i fsheh, i shpreh me sinqeritet, pa u përpjekur të gjejë asnjë lloj ngushëllimi:

*Ditën që do të vdes  
Nukë e di dot, po e pres,  
Nukë ka gjë m'e vërtetë  
Se vdekja në këtë jetë;*

(Baba-Musa lakuriq, f. 262)

Po Çajupi mbeti poeti i bukurive dhe i gjëzimve të jetës dhe vdekjes iu kthye i shtyrë, veç të tjerave, edhe nga dhë-

mbja e madhe e thellësisht njerëzore që i shkaktoi humbja e së shoqes, me të cilën ai nuk mundi të mësohej kurrë.

Tiparet romantike të poezisë së Çajupit shfaqen qartë në vjershat me motivin e dashurisë. Në pajtim me konceptet më të përhapura romantike, Çajupi e quante hera-herës dashurinë të vetmen kënaqësi të ekzistencës. Ai nuk besoi kurrë në dogmat fetare dhe, kur i këndon dashurisë, me lehtësinë më të madhe heq dorë nga perëndia:

*S'e kam parë Perëndinë,  
Shoh ngaherë dashurinë;  
Dashuria mbretëron  
Se njeriu pa të s'rron.  
Cinë të besoj taninë.  
Perëndin' a Dashurinë?  
Perëndi në këtë jetë  
Eshtë dashuria vetë.*

(Dashuria, f. 77)

Kur trajtonte pikërisht këtë motiv, Çajupi prirej pas meditimeve, të cilat zakonisht, karakteri i tij i hapët nuk para ia duronte. Po edhe këtu nuk e zgjastë shumë, mjaftohej të vinte në dukje, shpejt e shkurt, keqardhjen për vitet e rinisë që ikin e s'kthehen më dhe të shpalte dashurinë si realitetin më tërheqës të jetës. Çajupi e shihte dashurinë jo vetëm si burim gëzimi e lumturie, po anasjelltas, edhe si shkak vuajtjesh të rënda e dramash të thella, të cilat vinë nga egoizmi i shfrenuar që përmban kjo ndjenjë në natyrën e saj. Në konceptimin e Çajupit ajo i ngjan shpesh një shitimi të beftë, që gjithnjë e ka burimin te hijeshia e vajzës:

Bukuria, bukuria,  
Sa shpejt ndizet dashuria;  
Bukuria, burrat trima  
I godet si vetëtima

(Baba Musa lakuriq, f. 245)

Sidomos në poemën «Baba Musa lakuriq» dashuria është një ndjenjë krejt e verbër, e cila nuk ndalet jo vetëm nga asnje

pengesë e çdo karakteri qoftë, po edhe nga asnë poshtërsi, ligësi e hakmarrje. Gruaja për Çajupin është edhe pjellë e Sathanait, në shpirt e pabesë, e aftë për çdo lloj dredhie. Këto qëndrime të poetit gjajnë të janë të afërtë me ato të disa romantikëve evropianë, po është e vështirë të supozohet se, në këtë mes, kemi të bëjmë me ndikime të këtyre të fundit ndaj tij. Ai nuk u mbahet gjithnjë gjykimeve të padrejta mbi gruan. Në shumë pjesë të poeziës që la, gruaja, shqiptarja në mënyrë të veçantë, përshkruhet si një krijesë e përsosur në çdo pikëpamje. Çajupi ishte ai që për herë të parë në letërsinë tonë shtroi me forcë problemin e saj, vështuar në disa anë, ekonomike e etike. Qëndrimet e poetit ndaj gruas, sidomos te «Baba Musa lakuriq» janë jashtëzakonisht ekstreme, po duket se burimi i tyre nuk do kërkuar në bindje të përpunuara filozofike e morale. Ato ngjajnë të janë më shumë pasoja të ndodhive të jetës personale të Çajupit. Nga ana tjetër, zvetë-nimi moral i gruas për të është një ndër shfaqjet e rënies së përgjithshme të njerëzimit.

Sidoqoftë, vëtëm tek Çajupi gjejmë një konkordancë me konceptet, të cilave u janë mbajtur një pjesë e romantikëve ndaj figurës së gruas. Duke përashtuar ndikimet, do menduar se pikëpamjet e Çajupit ndaj saj, janë edhe rrjedhojë e skepticizmit të tij të thella. Ai vinte në dyshim mbi të gjitha besimin në një të ardhme më të mirë shoqërore, në mundësitë e krijimit të njeriut me veti të larta morale, prandaj nuk e kishte të vështirë të dyshonte në pastërtinë e çiltërsinë e gruas. Skepticizmi i Çajupit bëhej shkak përrjedhime të ndryshme. Ai ishte i pari që në letërsinë tonë vuri në dyshim «drejtësinë» e përcaktimit hyjnor të pozitës së gruas, po ndërkohe mbeti edhe i vërti që e trajtor kaq padrejtësisht figurën e saj. Në qëndrimin ndaj gruas Çajupi është krejt kontradiktor; kur arsyetimet i nis nga përshkrimi i kushteve ekonomike e shoqërore të jetës së saj, atëherë vlerësimet e Çajupit janë përgjithësisht objektive e të drejta. E kundërtat ngjet kur këto arsyetime ai i nis në rrafshin etiko-moral; këtu shfaqen gjyki, të cilat, natyrisht, nuk janë aspak nga më të rëndësishmet në tërësinë e pikëpamjeve të tij dhe nuk duhen marrë shumë seriozisht.)

Së fundi, ndryshe nga përbledhja «Baba Tomorri», në poemën «Baba Musa lakuriq», Çajupi u rikthehet motiveve të natyrës, po me një denduri më të paktë, pa arritur nivelet më të larta të lirikës, që u krijuat në ato vite. Edhe nga pikëpamja ideore, këto motive në krijimtarinë e Çajupit nuk

mundën të formësojnë përmasa të reja, të panjohura prej poezië së gjeratëhershme.

Në ato raste, kur Çajupi u mor me natyrën, bie në sy se ai, në gjurmët e romantizmit të Naimit, e sheh atë shpesh si vendin e qetësisë e të paqes shpirtërore:

*S'ka më të bukur jetë,  
Sejeta që shkon bariu,  
Nëpër lule, nëpër gjethë  
Dhe nëpër male me gurë,*  
• • • • •

(Baba Musa lakuriq, f. 198)

Temperament tjetër nga ai i Naimit, Çajupi nuk u tërheq aq shumë pas bukurive të natyrës. Profili i tij poetik, i krijuar në kohën e acarimit me të theksuar të kontradiktave politike e sociale, shfaqej më i plotë në trajtimin e motiveve të tjera, ndërsa sensibilitetin e njohur romantik ai e tregonte më shumë në motivin e dashurisë.

Pavarësisht nga shkalla e trajtimit të disa temave të njohura të romantizmit, si historia, natyra etj., poezia e Çajupit në thelbin e saj, është e këtij drejtimi. Problematika shoqërore, së cilës ai i dha një vend shumë më të gjerë, sensi kritik mjaft i theksuar dhe qëndrimet antifeudale e antiklerikaliste që tek Çajupi janë krejt të hapta, të gjitha këto nuk janë tipare që i takojnë ekskluzivisht realizmit. Ato janë shumë të gjalla në veprën e romantikëve më të shquar dhe përbëjnë trashëgimin më të vyer të përpunuar nga romantizmi përparrimtar, ku u mbështetën zhvillimet e mëvonshme realiste të letërsisë. Kështu ka ndodhur edhe në letërsinë tonë të Rilindjes; vepra e Çajupit përbënte atë stad të zhvillimit të saj, pas të cilit do të vinin ndryshime cilësore në brendinë e krijimtarisë letrare të viteve '30. Më qartë se kudo gjetkë ky stad shfaqet, si është vënë në dukje nga studiuesit tanë, në komeditë e tij, sidomos në komedinë «14 vjeç dhëndër»<sup>1</sup>.

1) Shih: F. Dado, Mbi veprën letrare të A. Z. Çajupit, Vepra letrare, V, I, Tiranë, 1984, fq. 32.

## **ÇËSHTJE TË DISKUTUESHME TË DREJTIMEVE LETRARE**

### **POEZIA E ASDRENIT**

Nga pikëpamja e përkatësisë në drejtimet letrare, vepra e Asdrenit, është ndër më të ndërlikuarat në historinë e letërsisë sonë. E shtrirë në një kohë relativisht të gjatë, ajo u krijuar në etapa të ndryshme historike, që domosdo sollën dallime të rëndësishme në tiparet e saj.

Gjithsesi, në prirjen themelore krijimtaria e Asdrenit ishte romantike.

Vepra e tij e parë, «Rreze dielli», përmban po ato veçori që dallojnë në përgjithësi romantizmin e viteve të Rilindjes; karakteri kushtruar e atdhetarizmi i flaktë, malli për vendlindjen e adhurimi i pakufi i historisë së Shqipërisë, simpatitë e thella demokratike, tendencat iluministe etj. Në kra-

hasim me krijimtarinë e gjeratë hershme, Asdreni ka më të theksuar prirjen ndaj peisazhit. Pa dyshim, ai nuk është në gjendje të arrijë nivelet që kapi Naimi tek poema «*Bagëti e Bujqësi*» dhe mbetet larg forcës evokuese e përshkruese të saj. Po ndryshe nga Naimi, që pothuajse vetëm tek kjo vepër, të paktën ndër ato të shkruara shqip, i kushtoi vëmendje të posaçme natyrës, Asdreni, qysh në fillimet e krijimtarisë, do të kërkojë t'i japë asaj një dimension të veçantë, vërtet të njohur e të trajtuar me shumë ndjeshmëri prej letërës së asaj kohe, po, në më të shumtën e rasteve, gërshetuar me motive të tjera. Kjo prirje e poezisë së Asdrenit, që më pas do të theksohet e do të evoluojë në mënyrë të dukshme, është vënë re me kohë<sup>1</sup>. Çajupi nuk e mori këtë profil, që tek Mjeda shfaqet në mënyrë më të plotë, po në përmassa të kufizuara, për shkak të vëllimit përgjithësisht të vogël të krijimtarisë së tij.

Poezia e Asdrenit në këtë fazë të zhvillimit të saj duket që është krijimtari që sapo ka nisur rrugën; aftësitë vëzhguese nuk janë ende të imprehta, përshtypjet janë akoma jo shumë të pasura.

Natyra si mundësi për të qetësuar shpirrat e trazuara. («*Qetësia e zëmrrës*»), kohët e shkuara si më të bukurat («*Mëtime*»), gremina që ndan fatalisht endrrën nga realiteti («*Vërtetësia e gjërave*»), dashuria e konceptuar shpesh si e vetmja lumturi e mundshme dhe më rrallë si shkak dhëmbjesh të thella, të gjitha këto, krahas brendisë së lirikës patriotike, që shpreh në mënyrë aq të qartë endërrimin për një Shqipëri tjetër, krejt të ndryshme nga ajo e kohëve të poetit, përbëjnë botën romantike të Asdrenit. Ato përbajnjë gjithashtu mjaft të dhëna, të cilat, në periudhat e mëpastajme të krijimtarisë, do të marrin trajta më të plota e më të qarta edhe si zhvillime pasromantike, parnasiane e simboliste.

Vepra e dyta e Asdrenit «*Endrra e lotë*», në vijat më të përgjithshme të përbajtjes së saj, mbetet perséri romantike. Është e vërtetë, siç e kanë vënë në dukje me kohë studiuesit, që disa vjersha të saj, si «*Krerëve tradhëtarë*», «*Lulëkuqja*», «*Zëri i kryengritësve*», arrijnë të vërejnë antagonizmin klasor-shoqërore. Po ndërkokë, këto vjersha janë të pamjaftueshme, edhe si sasi, për të qenë përcaktuese në brendinë e veprës. Vjersha të tjera, në të cilat poeti, nëpërmjet konstatimesh të

1) Shih më hollësishët: Rëxhep Qosja, *Asdreni, jeta dhe vepra e tij*, Prishtinë 1972, f. 228.

përgjithshme, në në dukje mjerimin e Atdheut, nuk mund të përbëjnë argument të qëndrueshmë pér të mbrojtur tezën se tek krijimtaria e Asdrenit realizmi bëri hapa të ndjeshme përparrat! Krijime të kësaj natyre janë të shumta në veprën e römantikëve përparimtarë dhe janë në vendin e tyre, si pjesë përbërëse të fisionomisë së përgjithsme të saj. Po të shkojmë më tej, shumë prej këtyre shkrimitarëve kishin arritur me kohë, në veprat e tyre më të mira, tek qëndrimet e theksuara demokratike e të vlerësimi i popullit si një forcë e madhe krijuese. Ata e konsideronin jetën e tij si një ndër ambientet më të fuqishme ku ruheshin, ende të pacenuara, vlerat njerezore. Në këtë rrugë u krijuan ato premisa, të cilat bënë të mundur që zhvillimet përparimtare të romantizmit të shpinin në shfaqjen e realizmit, po që, sigurisht, nuk mund të ndryshonin dhe nuk ndryshuan karakterin e përgjithshëm të veprës së tyre. Prandaj përfundimet ku kanë arritur disa nga studiuesit që janë marrë me veprën e Asdrenit, sipas të cilëve ajo vepër përfaqëson fillimet e realizmit në letersinë e Rilindjes, duhen saktësuar. Më shumë se fillimet e realizmit, në veprën e Asdrenit duhen parë më të qarta e më të thella se gjer atëhere, disa tipare të romantizmit, si fryma demokratike e patosi kritik, që u trashëguan e u thelluan më tej nga realizmi. Poezia e Asdrenit nuk mund të vihet krahas dramaturgjisë së Çajupit nga pikëpamja e kontributit që solli në lindjen e realizmit.

Po le të vazhdojmë me zbulimin e tipareve romantike të vëllimit «Endrra e lotë». Me Çajupin, Asdreni vazhdon t'i mbahet pikëpamjes se liria, aq shumë e dëshiruar përgjithësisht nga romantikët gjëndet vetëm tek varfëria e tek natyra («Thëllëza»); me Naimin, ai sheh tek bukuria e gruas një shfaqje të hyjnisi, më të përsosurën e të gjitha bukurive të gjithësisë, që ka dhuntinë e veçantë pér të vepruar fort tek njerëzit («E bukura e dheut»); me Serember, në ndonjë rast Asdreni i kthehet qetësisë së varrit dhe nis të poetizojë vdekjen («Dëshira ime»). Ndryshe nga vëllimi i parë, në të dytin theksohet më fort prirja subjektiviste. Tek «Endrra dhe lotë» Asdreni nis të merret më shumë me veten; ngjarjet, njerëzit, natyra filtrohen në subjektin e poetit, vargjet ndërtohen gjithnjë e më shpesh në vetën e parë. Asdreni tani përpiqet më dendur të zhbirojë në botën e vet; shpirti i trazuar e kontradiktor, tipik

1) Koço Bihiku, Aleks Stavre Drenova, studim hyrës në botimin e veprave të Asdrenit, Tiranë 1976, f. 50.

për heroin romantik, është më i rëndomti, sidomos në vjershat e tij filozofike («Mendime qetësie», «Mall nâtë», «Njeriu» e sidomos «Çaste hidhërimi»):

*Se ç'natyrë kam, s'di vetë,  
S'di her' shpirti pse m'helmohet  
S'kam as prehje s'jam i qetë;  
Rreth trishtimi më qarkohet<sup>1</sup>.*

(Endrra e lotë», «Çaste hidhërimi», f. 334)

Paaftësia për të kuptuar botën e errët dhe kaotike, një lloj frike prej saj («Tingëllime», «Njëj zogut»), e që këtej trishëtimi e fataliteti («Gjykime») dhe më rrallë zemërimi që kërkon të shkatërrojë gjithçka, bindja se lumturi nuk mund të ketë në këtë jetë, veç në qzell (*«Lumturia e shpirtit»*), castet e vëtmisë së thellë, vuajtja për kohën që shkon e s'kthehet, hera-herës një déshirë epikuriane për t'u harruar disi (*«Me kupat plot»*), këto janë karakteristikat që shfaqen më së shumti sidomos në poezinë meditative të Asdrenit. Vështirë të gjendet në to gëzim, besim, entuziazëm, vështirë të gjendet një rrugëdalje nga kaosi, padrejtësia dhe shëmtimi moral, përvëç durimit dhe shpresës tek zoti. (*«Druri i jetës», «E veja»*).

Duhet kaluar në motivet atdhetare, të natyrës e të dashurisë, për të gjetur një gjendje shpirtërore krejt të ndryshme të poetit.

Etja e pasuar për lirinë (*«Shqipëria», «Lutja e të humburve», «Betimi mbi flamur», «Kënga e bashkimit» etj.*), thirrjet kundër tiranisë shoqërore (*«Lulëkuqja», «Krerëve tradhëtarë»* etj.), adhurimi i simboleve kombëtare (*«Krujës», «Varri i Skënderbeut», «Armët e Skënderbeut», «Drini»* etj.), ngazëllimet që sjellin bukuritë e natyrës (*Cikli «Natyra»*) e më në fund dashuria e pastër si forcë jetëdhënëse, përbëjnë anët kryesore të botës romantike që hap vëllimi *«Endrra dhe lotë»*. Kjo botë vjen e plotësohet edhe me nota të theksuara sentimentaliste, që bien në sy veçanërisht kur poeti trajton probleme të marrëdhënieve midis prindërve e fëmijëve. Në të gjitha këto raste (*«Malli i nënës», «E veja»* etj.), Asdreni është me të vuajturit, të cilët zakonisht nuk arrijnë ta gjejnë të drejtën e tyre, po nuk humbin kurrë tiparet njerëzore, që u

1) Asdreni, Vepra, I, II, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 1980 (Edhe citimet e tjera nga kjo vepër do të jenë të këtij botimi).

frymëzohen gjithnjë nga zoti, tek gjithëfuqia e të cilit Asdreni, fetar i bindur, ka besim të patundur.

Tek feja, poeti gjen shpesh herë zgjidhjen e problemeve që e shqetësojnë, pér të cilat më kot është munduar t'ua zbulojë ndryshe fundin. Edhe pér çështjen e lirisë së Atdheut Asdreni, kur nuk ishte në gjendje të dallonte si duhet ato forca politiko-shoqërore, që po e bënин domosdoshmëri historike zgjidhjen e çështjes kombëtare, theksonte shumë, tej mase, ngjyrat e errëta dhe mbështetej vetëm në drejtësinë e zotit, që së fundi, me autoritetin e tij hyjnor do të mbronte lirinë e kombit e të truallit shqiptar («Vatra e të humburve», «Shqipërisë», «Besa jonë» etj.). Zoti pér Asdrenin, si pér shumë poetë romantikë, është frymëzuesi i dashurisë në përgjithësi, i dashurisë familjare në veçanti, i bukurisë, i së drejtës, i së mirës. Etika e Asdrenit mbështetet thuajse tërësisht në bindjet fetare.

Endërrimi i romantikëve, duke qenë shpesh fantazist dhe i turbullt, e kishte të natyrshme që, sa herë që s'gjente rrugë tjeter, të drejtohej nga hyjnia, e cila me forcën e saj supreme, do të ndihmonte me siguri, pér realizimin e atyre kërkësave pér të cilat endërronte shkrimtari. Asdreni u mor rrallë me arsyetimet mbi fenë dhe dogmën e saj, dënoi përçarjen që sillnin besimet e ndryshme të ushtruara nga bashkëkohësit, si dhe rolin reaksionar që luante kleri në jetën politike të vendit. Po sidoqoftë, tek zoti poeti gjen përgjigje pér shumë enigma, atje gjen edhe paqen shpirtërore e lumturinë, motiveve të së cilës u kthehet e u rikthehet vazhdimisht pér të arritur në përfundimin:

*Lumtësi vërtet se ka.  
Më tha zëri që s'u pa,  
Veç në vafsh «la' e më la»!*

(«Endrra e lotë», «Lumtësia e shpiritit», f. 326)

Hera herës ai, ashtu si Serembe, do të ankohet ndaj zotit, sepse megjithëqë ka kaluar një jetë prej besimtari të devotshëm, nuk ka mundur të gjejë dot lumturinë. Asdreni nuk qëndroi gjithnjë në këto pozita; i munduar vazhdimisht të gjejë kuptimin e jetës e të qenies, në ndonjë rast, të rrallë vërtet, po sidoqoftë krejt të hapët, ai shfaq mëdyshje të thella. Në to ai arrin jo ashtu lehtë si Çajupi, po me shumë vështirësi. Megjithatë, pas Çajupit, Asdreni është ndër më të parët në letërsinë tonë që fillon të vërë në dyshim idhuj të adhuruar

prej shekujsh. Tek vjersha «Paradoksej ai shkon më tutje se sa të vërë re kotësinë e hipokrizinë e praktikave fetare. Kjo vjershë, frysmezuar nga një dramë e rëndë, shpreh zhgënjinët më të thella që mund të ketë provuar poeti. Ashtu si dhe Çajupi, Asdreni është në këtë periudhë të krijimtarisë skeptik gjër në palcë dhe, sidoqë me keqardhje, ai beson vetëm që përpjekjet e njeriut për t'iu shmangur mëkatit e vesit duke menduar për amshimin, janë fare të kota, sepse ngasia, tundimi demoniak nuk e lëshojnë nga thonjtë e tyre. Ligji i përgjithshëm që drejton botën dhe shoqërinë, sipas Asdrenit, është sundimi i së keqes mbi të mirën. Ky ligj cinik, i shpie dëm lëydatat që i thurren së vërtetës, të cilën njerëzit, robërit të pafuqishëm ndaj veprimit të së keqes, s'e kujtojnë veçse rrallë, ndërsa jepen krejtësisht pas gënjeshtës. Shfaqje të forcës fatale të këtij ligji të përbindshëm janë luftërat e përgjithshme midis popujve, që i shpërfillin keqas predikimet e njerëzve të urtë për paqe e bashkim; shfaqje e saj është pabarazia e madhe shoqërore, që, sipas poetit, ka qenë dhe do të mbetet e përjetshme, është egoizmi i shfrenuar që lind bashkë me njeriun, i cili e kërkon gjëzimin e tij në rrugë instiktesh. Në tërë krijimtarinë e Asdrenit nuk mund të gjesh vjershë tjetër ku ai të jetë kaq i zymtë, në pasiguri të plotë, me një mllef të grumbulluar prej vitesh, që tani nuk njeh asnjë kufi e nuk kurson botën, jetën, hyjnité, njeriun. Qëndrime të tillë ishin të zakonshme për shumë romantikë. Tek **«Endrra e lotë»** dhe sidomos tek **«Psallame murgu»** Asdreni u kthehet gjithnjë e më shpesh motiveve meditative. Dyshimet e tij përmundësítë e ndreqjes së botës janë të hershme, po ndërsa në fillimet e krijimtarisë, ai gjente shumë anë të gëzuara të jetës, tani pesimizmi i është kthyer në një bindje të thellë që e sundon plotësisht mendimin e tij.

Si Serembe më parë, natyrisht pa supozuar ndonjë lloj ndikimi të poeziës së tij, Asdreni, në periudhën e fundit të krijimtarisë, i thellon më tej notat fataliste, të cilat qenë duktur në formë latente, ku më të spikatura e ku më pak të tillë, që në vëllimet e para. Këto qëndrime Asdreni i shtjellon, ndofta më hapur se kudo gjetkë, në vjershën e gjatë **«Hije e keqe»** te vëllimi **«Psallme murgu»**, ku shfaq pikëvamjen thellësisht regressive, të përhapur tek disa romantikë e më fort në drejtimet pasromantike, sipas së cilës njeriu është absolutisht i pafuqishëm të reagojë ndaj verberisë së fatit.

Te **«Psallme murgu»** ka marrë formë një shfaqje, që tani s'mund të quhet më mezi e dukshme, prirja për t'iu drejtar një publiku të kultivuar, duke trajtuar në mënyrë më të ra-

finuar temën meditative ose duke theksuar shumë përbajtjen filozofike të motiveve të tjera. Tani poezia e Asdrenit lidhet më shumë me kërkime subjektive intelektualiste, veprimi në të është fashitur, problematika shoqërore kurrsësi nuk zë vendin kryesor. Krijimtaria e Asdrenit bëhet më e vështirë për t'u kuptuar; shpesh ajo kthehet në një lloj jehone të vetvetes.

Tani Asdreni e sheh poezinë si një dhunti për të arritur të bukurën që shfaqet në harmoninë e vijave, ngjyrave e tingujve, që gërshetohen gjithnjë e në mënyrë më të koklavitur. Që në fillimet e krijimtarisë Asdreni tërhiqej pas sonetit, lloj, që siç dihet, ka kërkesa të rrepta formale. Tek «*Psallme murgu*» soneti është bërë vjersha më e preferuar e tij. Në motivin e dashurisë e të natyrës Asdreni tregohet më i përbajtur, thuajse i ftohtë, larg shpërthimeve e hoveve shpirtërore. Tani i pëlqen më fort t'i mposhtë ndjenjat për hir të krijimit të një bukurie, e cila buron vetëm nga cilësitë fizike të vajzës, po edhe nga kthimi i tyre në simbole, herë herës tepër të abstraguara, të një gjendjeje shpirtërore të veçantë, të përshtatshme për të përjetuar të bukurën. Këto karakteristika të poezisë së Asdrenit, në vitet e fundit të zhvillimit të saj, i ka vënë në dukje me kohë studiuesi Rexhep Qosja, i cili ka analizuar gjithashtu interesin gjithnjë e më të madh që tregon tani Asdreni për teknikën e vargut<sup>1</sup>. Poeti punon më shumë me rimën, ritmin, me gjuhën, ndërsa ndjenjat, reagimet shpirtërore tërhiqen në një rrafsh të dytë.

Antikiteti, me simbolikën e tij mitologjike, është një tjetër objekt që tërheq gjithnjë e më dendur Asdrenin, sidomos në vëllimin «*Psallme murgu*». Mësimeve morale e filozofike, pas të cilave është kapur, poeti ua gjen shëmbelltyrën më të koncentruar në episodet e mitologjisë («Mbarimi i të këqijave», «Sytë e Argusit», «Narqisia» etj.). Këto tipare që ka fituar krijimtaria e Asdrenit, e kanë burimin edhe në ndikimet që pësoni prej drejtimit parnasian, që siç dihet, u përhap mjaft në letërsinë franceze. Parnasi, si drejtimi letrar, doli kundër letërsisë romantike, po, në thellësinë e vet, nuk qe gjë tjetër veçse zhvillimi i disa premisave që përbante vetë romantizmi. Individualizmi, idetë e turbullta mbi të ardhmen. druajtja nga realiteti e dëshira për t'u larguar prej tij, shpunë në qëndrimet e ihtarëve të «artit për art» e të «parnasit», të cilët mendonin se poezia mund të jetë vërtet e tillë, vetëm po

1) Shih: R. Qosja, *Asdreni, jeta dhe vepra e tij*, Prishtinë, 1972, f. 310-328.

të shkëputet krejtësisht nga çdo shqetësim politik, shoqëror e moral, po të jepet pas kultit të së bukurës, të shmangë vruillin e hovin e ndjenjës.

Poezia e Asdrenit, sidomos në kohët e fundit, nuk mbeti pa u prekur edhe prej ndikimeve të simbolizmit. Në vëllimin «Psallme murgu» Asdreni, siç e kanë vënë në dukje studiuesit, kujdeset më shumë për anën tingullore të fjalës, për një varg më muzikal, më abstrakt. Tani Asdreni pérpiqet ta konceptojë dhe ta krijojë poezinë si një procede aludive ose sugjpressive, të tërheqë vëmendjen për ato objekte që i japin mundësi të shprehë një ide, herë më të qartë e herë të turbullt. («Vegim detarak», «Ylberi», «Nakar», «Vaja e pyllit», «Lulja e këputur» etj.).

Verleni, një prej krijuesve të simbolizmit, shprehte pikëpamjen se poezia duhet t'i ngajë më shumë muzikës, ajo duhet të sugjerojë dhe jo të vizatojë. Rima, nuanca, e turbullta dhe pluskuesja duhet të jenë në qendër të krimtarisë poetike, e cila ka si objekt të sajin pavendosmërinë e boshllékun e shpirtit. Për Rembonë dhe Malarmenë, të tjerë përfaqësues të simbolizmit, fjala nuk do konceptuar vetëm si shenjë që emërtón një objekt, po edhe si realitet konkret që fiton gjallëri e kolorit nga bashkëtingëlloret dhe zanoret e saj. Fjala, me këto cilësi, është elementi i parë i poesisë së vërtetë. Sipas simbolistëve, vlera e fjalës gjer në kohën e tyre ishte marrë nëpër këmbë edhe nga romantizmi, që tërhiqej më fort prej sendeve se sa prej saj.

Natyrisht, nuk është vendi të zgjatemi më tej në shtjellimin e pikëpamjeve që mbanin simbolistët për poezinë. Këtu do theksuar se poezia simboliste si dhe ajo parnasiane, ishin shfaqje të krizës së romantizmit, të rënies së tij. Ithtarët e simbolizmit, të cilët pranuan edhe emërtimin «dekadentë», në analizë të fundit ishin përfaqësues të anarkisë në politikë, në mendim dhe në moral. Protesta e tyre ndaj shoqërisë së kohës mbeti pa vlerë dhe mund të ndikonte vetëm në shresa të caktuara intelektualësh të çorodit.

Megjithë ndikimet që pësoi nga parnasi e simbolizmi, sidomos në përbledhjen «Psallme murgu», krimtaria e Asdrenit mbeti gjithnjë një poesi e angazhuar jo vetëm në çështjen kombëtare, po edhe në problematikën shoqërore, duke ruajtur vazhdëmisht një frymë të thellë demokratike. Ky përfundim nuk është aspak subjektiv ose aprioristik. Drejtimet më të fuqishme të përbajtjes së veprës së Asdrenit, të mbledhur ose jo në vëllime të veçanta, janë përcaktuar nga gjendja shpirtërore kolektive e popullit shqiptar. Prandaj në të zunë

një vend kryesor krijimet që pasqyrojnë lëvizjen e mendimit iluminist përparimtar, dëshirën e zjarrtë për lirinë, veprimet revolucionare konkrete që u ndërmorën ose duheshin ndërmarrë për zgjidhen e çështjes së pavarësisë kombëtare. Kjo esençë e poezisë së Asdrenit, shfaqet e pacenuar në çdo vëllim të tijin, ndonëse tiparet e saj evoluojnë nga karakteri kushtues që mbështetej në historicizmin, në luftën kundër identifikimit të kombit me fenë dhe iluminizmin (në krijimtarinë para vitit 1912), tek ekzaltimi i simboleve kombëtare shqiptare, në krijimtarinë e botuar pas këtij viti. Këto anë të brendisë së veprës Asdreni i shpuri më tutje; ai ndjeu dhe arriti të shprehë në krijmtari atë dukuri që po e provonin gjithnjë e më qartë zhvillimet historike të kohës, rolin vendimtar të popullit, duke shënuar kështu një kapercim cilësor në mendimin poëтик të kohës. Jeta e shpaloste me gjithë forcën e saj këtë të vërtetë, që i bënte tani të papërshtatshme parullat për «bashkimin» e «harmoninë» midis shqiptarëve. Çlrimi kombëtar dönte bashkimin e vegjelisë jo vetëm kundër pushtuesit të huaj po edhe kundër parisë, që përbënte mbështetjen shoqërore të pushtimit dhe pengonte me sa mundte lëvizjen kombëtare. Më tej akoma, Asdreni, sidqë jo në mënyrë konsekiente, ishte ndër shkrimitarët e parë që pa tek populli forcën e aftë të realizonte përbysjet shoqërore. Mjerisht ai, për shumë arsy, nuk qëndroi në këto pozita, po kritikën ndaj realitetit politik që u krijuai në Shqipërinë e paspavarësisë nuk e kurseu. Mohimin e atij realiteti ai e shprehu jo vetëm me tërheqjen, zhgënjin, vetminë, po edhe më rendjen pas një bukurie, herë konkrete e herë të abstraguar, të kërkuar e të gjetur në natyrë, në dashuri, në lashtësinë shqiptare e atë të huaj. Kur ia duan bindjet politike, Asdreni di të jetë shumë konkret në sarkazmën e tij therërëse. Një vjershë si «Republika shqiptare» është fryt i një millefi të vjetër të poetit që kurrrë nuk i besoi parësisë as në çështjen kombëtare, as në organizimin e shtetit të ri shqiptar. Demokratizmi i poetit mbeti i paprekur edhe në ato periudha të krijimtarisë, kur trishtimi e depresioni ishin krejt të dukshme. Për më tepër, të ky qëndrim, Asdreni vec të tjerave, gjente shpesh qetësinë shpirtërore:

*Zili kam për pallate të shëndrisur  
Me shtylla t'arta, shkalla gjith' mermér  
Por dhe kasollja bukur e stolisur,  
Më tepër e ndjenj qysh malli i saj më therr.*

(«Psallmë mërgu, Paradokse», f. 113)

Por si ndodhi që krijimtaria e Asdrenit, e cila në thelb mbetet romantike, të përbajë nga njëra anë disa premissa, si zgjerimi i motiveve shoqërore, thellimi i qëndrimeve demokratike e i patosat kritik, të cilat me gjithëse nuk arritën t'u jasin shtat proceseve realiste gjithsesi përgatitën lindjen e tij, dhe, nga ana tjetër, të njohë ndikime të poezisë parnasiane e simboliste?

Studiuesit që janë marrë gjer tanë me veprën e Asdrenit, kanë hedhur dritë mbi këtë çështje. Kontradikta fare e hapët midis brendisë së krijimeve me motivin atdhetar dhe më së shumtës së krijimeve me motive filozofike, ndryshimet e mëdha që pësoni përbajtja e poezisë së tij nga periudha e parë në të dytën, janë shpjeguar me deziluzionin e thellë të poetit prej zhvillimeve politike në Shqipëri në vitet që erdhën pas Pavarësisë, me shkëputjen e poetit ngajeta e vendit, me botëkuptimin e tij idealist. Po këtu do ngulmuar më fort në faktin që Asdreni në krijimtarinë e tij qëndroi përgjithësisht në pozitat e intelektualit demokrat mikroborgjez. Gjatë Rilindjes mikroborgjezia ishte e interesuar për arritjen e pavarësisë së vendit, ajo u tregua përgjithësisht entuziaste për fitoret e lëvizjes kombëtare, po në natyrën e saj klasore ajo ishte thellësisht e predispozuar të pësonte zhgënjime të rënda nga mossukseset e lëvizjeve përparimtare, të kridhej në pasivitet e të kërkonte zgjidhje që bazoheshin në humanizmin panjerezor, tek «arsyeja e kulluar», feja dhe mëshira kristiane. Këto qëndrime bien në sy në shumë krijime të Asdrenit, sidomos në vjershat që ai shkroi kundër luftës («Lufta e botës», «Interesi», «Dituria», «Qytetërimi» etj.).<sup>1)</sup>

Në lëvizjen kombëtare roli i mikroborgjezisë ishte përgjithësisht përparimtar, i tillë mbeti ky rol edhe në lëvizjen demokratike që shpuri në Revolucionin Demokratik Borgjez të vitit 1924. Po disfata e këtij revolucioni e hodhi mikroborgjezinë, në mos në pozitat e pajtimit me realitetin politik, në pranimin e tij si një e keqe kundër së cilës nuk luftohej dot. Këto pozita edhe kur shprehnin kundërshtimin ndaj zhvillimeve të jetës politiko-shoqërore, zakonisht mbeteshin tepër aludive, të paqarta, individualiste dhe si të tillë ishin të padtëmshme ndaj forcave që sundonin vendin. Në historinë e letërsisë shqiptare, sidomos të viteve 20-30, Asdreni nuk qe i vetmi ndër poetët përparimtarë që pasqyrojnë qëndrime të kësaj natyre. Bukuria në vetvete, si kuptimi i jetës, bukuria

1) Koço Bihiku, Aleks Stavre Drenova, Studim hyrës në botimin e veprave të Asdrenit, Tiranë 1976, fq. 34.

e përsosur e synuar jo vetëm si objekt i artit, por hera herës edhe si e vëtmja mundësi për përsosjen morale të njerëzimit, bie shumë në sy edhe në krijimtarinë e Lasgush Poradecit.

Në përgjithësi këto janë shkaqet, të cilat e shtynë Asdrenin t'i gjejë hera-herës të afërtë, në periudhën e dytë të krijimtarisë, praktikat parnasiante e simboliste.

## POEZIA E NDRE MJEDËS

A përfaqëson edhe vepra e Ndre Mjedës proceset historiko-letrare që bënë të mundur kalimin e letërsisë shqipe nga romantizmi në realizëm? Nëse ekzistojnë, ku dhe si shfaqen prirjet realiste të poezisë së tij? Këto çështje e të tjera që kanë të bëjnë me to janë shtruar edhe më parë në studimet tonë, të cilat kanë ardhur në përfundimin se krijimtaria e Mjedës duhet konsideruar si kapërcyell nga romantizmi në realizëm, si kontribut në lindjen dhe përhapjen e realizmit në letërsinë tonë të periudhës së fundit të Rilindjes dhe të viteve që erdhën pas Shpalljes së Pavarësisë<sup>1</sup>. Po a kanë qenë të mjaftueshme e deri në fund të drejta argumentet e sjella në të mirë të kësaj teze, ky është një problem që do rihapur e do parë për së afërmni.

Përbajtja e poemës «Andrra e jetës» ka shërbyer si argumenti themelor i tezës në fjalë; ajo është trajtuar si krijimi, me të cilën Mjeda «bëri një hap drejt realizmit»<sup>2</sup>.

Disa nga tiparet e saj, pasqyrimi i jetës e i shuarjes së një familjeje fshatare, vërtetësia e figurës së Lokes, detajet konkrete etj. janë sigurisht të rëndësishme, po megjithatë nuk mjaftojnë për të treguar se vepra përpunoj një prirje të dukshme realiste; të tilla anë nuk kanë munguar aspak në krijimtarinë e shumë romantikëve përparimtarë, përkundrazi.

«Andrra e jetës» mbetet poemë me brendi të qartë roman-tike, thelbi i së cilës do shikuar në disa komponentë, sidomos në përfytyrimet që kishte Mjeda për ndjenjën fetare dhe rolin që ajo luan në jetën e njerëzve. Por, po të kërkohej kjo brendi vetëm në disa vargje të shkëputura si:

— *Bij'*, mos e prek, se njomja  
Tash' à tue folë me Zojën;  
len zan' e mos cil gojën

1) Shih Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë 1983, f. 359.  
2) Po aty, f. 348.

ose:

### *Se e lumja Zojë t'bërtetti.*

*T'lypë nji des' e ta nep t'ndershme  
Dora e unaza qi t'ven n'gisht;  
E ndërmjet pr'ut bësë t'gjithhershme  
â dorzan' i lumi Krisht<sup>1</sup> (Andra e jetës, f. 67)*

argumentet e sjella, pa dyshim, nuk dô të ishin të plota e gjithnjë bindëse. Ato mund të merreshin fare lehtë si reminishenca të profesionit të poetit, që ishin të natyrshme; jo më pér një klerik si ai, po edhe pér shumëkend ndër hjerézit e zakonshëm të kohës.

Tek «Andrra e jetës» zoti është pjesëtar intim i ngjarjeve të familjes së Lokes. Ajo gjallesë aq e varfér në të gjitha pikëpamjet, nuk mund të kishte ngjarje më të shënuara se sa lindja, martesa dhe vdekja, në të cilat hyjnia, fjala e urdhri i saj, janë gjithnjë të pranishme.

Me subjektin që ka, poemë nuk lë shtigje pér të provuar qëndrimet optimiste të Mqedës në gjykimët e tij të përgjithshme mbi jetesën. Njerëzit rrojnë me ç'u jep natyra, më fjalën ungjillore, me bindjen ndaj hyjnisi. I trishtohen vdekjes, i gëzohen martesës e fëmijës dhe i nënshtronës përsëri fundit, duke i pritur të gjitha këto nga gjithëfuqia e zotit. Natyra dhe njerëzit që jetojnë e vdesin në të i përulën një ligjësie qelllore. Në këtë rrugë e tjetërsonte poeti botën që e rrëthonte, duke hyjnizuar gjithçka që shihte përreth. Ndryshe nuk mund të shpjegohet fakti, që në poemë mungon cdo shenjë zemërimi, që rezinjacioni në të është i plotë. Mjeda i «Andrrës jetës» nuk është Mjeda i «Lirisë». Te «Andrra e jetës» nuk mund të flitet kurrsesi pér heroin që ngre krye kundër shokërisë; do të ishte naive ta shihnim atë tek figura e Lokes, aq më pak te ajo e Zogës, e cila përfaqëson vetëm një nga bukuritë e shumta të botës, që Mjeda ndonëse klerik, i ndien thelli.

Shumë poetë romantikë e gjenin botën që kërkonin te vlerat morale, të cilat sipas tyre i ruante besimi tek zoti. Dissa, si Shatobriani me shokë, e shihnin te kristianizmi parajsën e

1) Ndre Mjeda, *Juvenilia dhe vepra të tjera*, mbledhur dhe redaktuar nga Mark Gurakuqi, Tiranë 1964, f. 61. Citimet e tjera nga kjo vepër janë të këtij botimi.

humbur të shtresave e klasave të përbysura; të tjerë, si Hygoi, krijonin karaktere si Zhan Valzhani që me durimin e mirësinë e tyre të pafundme, transmetonin pikëpamjen në thelb fetare, sipas së cilës njerëzit do të janë me të vërtetë të tillë vetëm po të dinë të falin, po të dinë ta pranojnë të keqen ashtu siç u vjen. Sigurisht, do të gabonim po të mendonim se, me frymën e poemës «*Andrra e jetës*», Mjeda ka dashur të ndjekë posaçërisht qëndrimet e shumë romantikëve që shikonin tek zoti frymëzuesin e dashurisë familjare, burimin më të parë të harmonisë pannjerëzore. Tek u mbahej këtyre pikëpamjeve, ai nuk bënte gjë tjetër vëç shprehte vetvehten si klerik që ishte, shprehte një botëkuptim, me të cilin që mësuar prej kohësh. Mjeda nuk mund të shmangonte kultin në marrëdhëniet me zotin, siç ndodhët me disa shkrimtarë romantikë, të cilët e shfaqnin spiritualizmin e tyre, duke krjuar raporte të drejtpërdrejta me perëndinë, pa ndërmjetësinë e dogmës. Sidoqoftë, qëndrimet që përshkojnë poemën e tij bashkëvenë me botëkuptimet romantike.

Thekset realiste te «*Andrra e jetës*» studiuesit i kanë parë sidomos te figura e Lokes<sup>1)</sup>. Dhe me të vërtetë, në karakterin e saj, është bindëse psikologjia fetare, janë të natyrshme ankimet për djalin që nuk e pati; shuarja e saj në vetmi, si nënë pa bir, është në logjikën e jetës zakonore të kohës.

Po të gjitha këto nuk arrijnë dot të ndryshojnë esencialisht përbajtjen e poemës. Mjeda nuk ka marrë përsipër të tregojë se ishin kushtet shoqërore ato që sillnin fate si ai i Lokes, autori mbetet shumë larg synimeve e analizave të tilla. Prandaj figura e Lokes, megjithë vërtetësinë e saj të pakontestueshme, me fatalizmin që përmban, ka shprehur artistikisht pikëpamjen se jeta në këtë botë është e shkurtër dhe kalon si një ëndërr. Kjo figurë nuk arrin të pasqyrojë raportet sociale, vlera përgjithësuese e saj është e kufizuar; vetë gjendja familjare e Lokes, për të mos thënë që është e jashtëzakonshme, të paktën është e veçantë. Duket qartë në tërë komponentët e poemës se Mjeda, në krijimin e figurës së Lokes, nuk i kishte vënë vetes synime shumë të gjera: me të dhe me figurat e të bijave poeti ka theksuar bindien se fatet e njerëzve janë në duart e zotit, vullneti i të cilit herët a vonë do të veprojë; kundër tij s'mund të bëhet asgjë. Po të njihet ky fatalitet, njerëzit do të kalojnë një jetë tjetër, përdëllimitare, larg së keqes e trazirave shpirtërore. Vetë Mjeda ndjeu fort mbi

1) Shih ndër të tjerë: M. Gurakuqi, *Mbi veprën poetike të Mjedës*, Tiranë 1980, faqe 162.

shpatulla dallgë e shqetësimë. Ai ruajti shumë pasione, mbi të gjitha pasionin për lirinë, dinjitetin vetjak e dashurinë për njerëzit e thjeshtë; po, me gjithatë, kohët e fundit e deri sa mbylli sytë parapëlqeu t'u mënjanohë luftërave shoqërore. Me sa duket, poeti mendonte se të mjeruarve të kësaj bote do t'u vihej në ndihmë duke jetuar si ata e midis tyre. Natyrish, këto qëndrime të Mqedës, edhe pse nuk qenë ndër më radikalet, aq më pak ndër më revolucionaret, shprehnin pakënaqësinë e tij ndaj kohës dhe e shtynin të kërkonte një tjetër mënyrë të organizimit të jetës, të cilën te «*Andrra e jetës*» e gjente tek njerëzit e thjeshtë që rronin së toku me natyrën, sipas vullnetit të hyjnisi; ndërsa tek «*Lissus*» e «*Scodra*» këtë mënyrë ai do ta gjente në lashtësinë e shqiptarëve.

Për të gjitha këto arsyen, mund të vihet në përfundimin se pikëpamja që tek poema «*Andrra e jetës*», sheh veprën nëpërmjet së cilës Mjeda dha kontributin e vet për kalimin e letërsisë sonë nga romantizmi në realizëm, vështirë të qëndrojë. Ndërkaq, për tiparet romantike të «*Andrrës së jetës*», flasin edhe argumente të tjera. Një ndër to është, pa dyshim, ndjeshmëria e thellë e poetit ndaj natyrës. Një zemër si ajo e tij, hapej e téra në natyrë; vargu i Mqedës, përgjithësisht i trish-tuar, ndryshonte thuajse krejtësisht kur trajtonte motivet e saj; ai e përshkruante natyrën si gurrë gjëzimi. Mjeda, si të tjerë romantikë, gjente atje një ndër mundësitë e pakta që jepte bota për t'u çlodhur, për të shpëtuar nga mundimet e përditshme. Edhe te poema «*Andrra e jetës*», e cila si e vumë në dukje, s'mund të cilësohet optimiste, në peisazhet që përban, transmeton gjithnjë ndjenja të hareshme, me përjashtim të stropheve të pjesës së tretë. Mjeda pothuajse nuk e trajtoi fare motivin e dashurisë, veladoni rëndonte mjaft mbi botën e tij shpirtërore, prandaj tek natyra ai drejtohej me një afeksion të rrallë. Poeti kaloi një jetë shumë të kursyer në gjëzimet, prandaj bukurinë e natyrës e donte gjithnjë pranë, ta ndiente në mënyrë të drejtpërdrejtë, gati-gati fizike, pa i stërholluar efektet e saj mbi qenien e tij. Burimet e së bukurës Mjeda i kishte të pakta, te natyra ai kërkonte harmoninë e gjallërinë e pakrahasueshme, ndërsa pamjet e egra të saj i përshkroi kur fliste për vdekjen e pleqërinë. Mjeda nuk pa tek natyra sendërtimin e pasioneve të thella e kontradiktore apo dëshira të pakuptueshme. Melankoli dhe trishtim kishte mjaft në ditët e tij, prandaj Mjeda nuk donte që edhe natyrën t'ua nën-shtronte hidhërimeve. Edhe tek nata e hëna që tërhiqnin aq fort shumë romantikë, të cilët kërkonin atje simbolet e vuajtjeve të tyre, ai gjente bukurinë e gjëzimin:

*E kandshme asht hana  
 Kur del me zana,  
 E n'tokë me dritë përndaret.  
 Hyjzët qi shndrisin  
 E qi shetisin  
 Ndër qiel, jan t'bukur faret.* («Andrra e jetës, f. 67)

Përgjithësiht, në poezinë e tij, madje edhe tek «Andrra e jetës», natyra është himni i bukurisë, apoteoza e gëzimit. Mjeda e donte natyrën si biri i saj, si njeriu që jetonte bashkë me të. Ai e donte natyrën ashtu siç adhuronte Zotin; tek ajo ai shihte shfaqjën e divinitetit, ashtu siç bën edhe shumë romantikë të tjerë.

Përmjaft krijime të tjera të Mjedës mëdyshjet mbi karakterin romantik nuk kanë më asnje truall ku të lindin<sup>1)</sup>. Në shumë anë këto krijime pasqyrojnë krizën e jetës shpirtërore të kohës e të vetë poetit, e cila kërkonte një rrugëzgjidhje. Nuk mund të vazhdohej të jetohej më *par inertie*, nuk mund të lejohej më që në epokën kur, të paktën në Evropë, kombet kishin fituar pavarësinë, Shqipëria të mbetej ende një provincë e perandorisë otomane. Nuk mund të durohej mbi shpatulla egërsia dhe hipokrizia e urdhrit jezuit edhe për Mjedën. Lufta për t'i shpérthyer së fundi kufijtë e këtij stacioni, që bëhej nga dita në ditë më i paduruar, për të krijuar një tjetër jetë, për atdheun e për poetin, përbën thelbin e poemës «Vaji i bylbylit», që përmban ndoshta si asnje ndër krijimet e tjera të Mjedës, konfliktin midis individit dhe shoqërisë, aq të përhapur në letërsinë romantike. Po cilat do të qenë, sipas Mjedës, rrugët e realizimit të ndryshimeve? «Rrugët e arsyeshme» së pari, puna, durimi e rrjedha e kohës që mbulon çdo plagë:

*Tui dnes' i vorfni se e mbëluene t'kqijat,  
 Me ankime t'veta mbushë rrugët e shpijat;  
 Lecim por s'mbramat gjen tui punue;  
 Fillo me gëzue  
 Kjajnë fëmin'e dekun prindt'e shkretnuem  
 Me 'j vaj, qi duket se s'ka t'pajtuem!  
 Por zëmrën zoti jau ndrron tui shkue:*

1) Frymën përgjithësisht romantike te «Juvenilja» e ka vënë në dukje me kohë Dh. S. Shuteriqi në «Historia e letërsisë shqipe», Tiranë 1958, f. 203.

*Fillo me gëzue*  
*Ndér-ishuj t'detit kjan i burguemi*  
*Pér fmij', pér grue, qì s'shef i shuemi,*  
*Por prap' durimi ka me ja prue;*  
*Fillo me gëzue*

(«Vaji i bylbylit», f. 38)

Po Mjeda nuk do t'u mbahet vetëm këtyre rrugëve, «Ar-syeja e pastër» nuk do ta shpinte fort larg çështjen e lirisë. Pér poetin, sidoqë ai ende nuk shprehet më këmbëngulje siç do të ndodhë në krijime të tjera të tij, mund dhë duhet t'i dilet ndesh «arsyes», pritjes që ajo sjell, fashitjes që i shkakton ndjenjës shpërthyese e realizuëse. Ndryshe nuk mund të ndodhë që:

*....., ky shekull orë e ças ndrrrohet;*  
*Bijnë poshtë të naltit, i vogli çohet;*

(Vaji i bylbylit, f. 39)

Pakënaqësia më e thellë ndaj humbjes së lirisë e robërisë shekullore, pasioni i flaktë pér ta përbysur atë gjendje, besimi i patundur se kështu nuk do të vazhdohej gjatë, perbëjnë karakteristikën themelore të predispozitës shpirtërore romantike të poemës. Kjo anë e brendisë së poezisë së Mjedës, do të theksohet fort në krijime të tjera të mëvonshme të poetit, sidomos në tufën e soneteve «Liria», ku ai shfaqi më hapur e më qartë se kudo pikëpamjet e tij politike. Prej saj mund të krijojen përfytyrime, sidoqë jo të plota, mbi ndryshimet që kërkonte Mjeda pér vendin e tij. «Liria» është shkruar në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit tonë, në kohën kur Lëvizja e Rilindjes po hynte në fazën përfundimtare. Vepra u bëri jehonë, siç e kanë vënë në dukje studiuesit, jo vetëm çështjes kombëtare, po edhe forcimit e thellimit të prirjeve demokratike në gji të saj. Se ç'e ka shtyrë Mjedën të gjejë pikërisht tek lufta e amerikanëve kundër anglezëve, e udhëhequr nga Xhorxh Uashingtoni, shembullin më tërheqës të kryengritjes kundër sundimit politik e shoqëror, kjo është një çështje tashmë e trajtuar<sup>1</sup>.

1) Shih: M. Gurakuqi, *Mbi veprën poetike të Ndre Mjedës*. Tirana 1980, f. 142.

Evokimi i kësaj lufte tregon se Mjeda, megjithëse nuk u shpreh fare hapur e deri në fund qartë, ishte për ndryshime edhe të karakterit shoqëror në Shqipërinë e paspavarësisë. Nga pikëpamja e argumentit të këtij punimi, këto qëndrime theksojnë më shumë akoma karakterin romantik të veprës së Mjedës, sepse nxjerrin në pah me forcë të veçantë artistike diskordancën e plotë të idealit të tij me realitetin, e cila, tek «Liria», shprehet me mënyrën e zakonshme të shumë romantikëve shqiptarë, me krijimin e antipodeve: e kaluara dhe e tashmja e Shqipërisë, vendet e lira dhe robëria e atdheut.

Natyra përgjithësisht romantike e krijimtarisë së Mjedës shpaloset hapur edhe në vjershat «I tretuni», «I mbetuni», «Shtegtarë». Që në titujt e tyre bie në sy vëtmia, ndarja e mali, që janë motive të njoitura romantike. Larg vendlindjes e bukurive të saj, larg nënës e bashkatdhatarëve, mbytur nga kujtimet, si mund të shtyhej më tej dhimbja, që aq shpesh fryshtëzon romantikët? Ç'janë më të afërta e më të shenjtë për heroin e këtyre krijimeve, poeti i ka vënë në një kontrast të ashpër me mjedisin, prandaj ato përbajnjë vuajtje e trish-tim të thellë.

Në krijimet romantike, heroji, edhe në mos gjettë më forma për të luftuar mjediset që e mundojnë, edhe në u lodhtë, shpirtërisht qëndron i ndarë prej tyre. Në këto raste vuajtja kthehet në shenjë më të parë të virtutit. Domosdo, këtej ka marrë udhë një lloj pajtimi me realitetin që, kur u nxit nga rrëthana të caktuara politike, shoqërore e filozofike, bashkë me egocentrizmin, që përbante vetë romantizmi, shpuri në lindjen e drejtimeve dekadente, simboliste e parnasiane, të cilat, siç dihet, e shkëputën poezinë ngajeta. Sigurisht, të tillë shfaqje janë të huaja për Mjedën; ai qëndroi larg tyre. Po mendimi fatar e pengonte poetin që, kur trajtonte, ashtu në mënyrën e vet, temën shoqërore, të kapej pas qëndrimeve më të drejta, të mundshme për kohën e tij. Kështu, vjersha «I mbetuni», që duhet vlerësuar vërtet si një ndër krijimet ku ai vë në dukje pabarazinë dhe vuajtjet e rënda të vegjëlisë, që gjithnjë ka mbajtur mbi kokë fatet e vendit, prapë nuk dallohet për qëndrime të gjalla kundërshtuese; në të sundon bindja se mëshira dhe amshimi, kaq të afërta për poetin, mund ta lehtësonin gjendjen e të shtypurve e fatkëqijve të asaj jete. «I tretuni», «I mbetuni» dhe «Shtegtarë» përbajnjë një tension të vazdueshëm gjendjesh kontrastive e dramash të thella, karakteristike për krijimet romantike; «I mbetuni» dhe «Shtegtarë» kanë trajtën e bëladës, formë e poezisë narrative, që u zhvillua mjaft nga romantikët. Të kësaj natyre janë edhe

shqipërimet e Mjedës «Të vorruemit e Sir John Moore» dhe «Mbreti i Tules». Krejt romantike është patetika e vjershavë të tjera të tij, të papërfshtira në vëllimin «Juvenilja»: «Andërr», «Shqypes arbnore», «Bashkonju», «Në dekë të shoqit tim Gj.S.» etj., ku sublimja, heroikja, po ai adhurim i thellë për lirinë, për virtutin e drejtësinë, përbëjnë elementët kryesorë të brendisë së tyre.

Te poemat «Scodra» dhe «Lissus» Mjeda i është kthyer lashtësisë shqiptare, për të cilën, siç dihet, janë interesuar edhe Naimi e poetë të tjerë rilindës, po pa u ndaluar gjatë, sepse gjetën në epokën e Skënderbeut vite të tjera më të adhuruara, më të ndritura e më të afërta.

Pa dyshim, edhe në poezinë e Mjedës zënë një vend të rëndësishëm krijimet që i kushtohen epokës dhe figurës së Gjergj Kastriotit. Po, në përgjithësi, Mjeda nuk u shtoi ndonjë tipar të ri përfytyrimeve të letërsisë rilindëse për to, po të përashtojmë këtu poemën «Lissus», ku ai e pa heroin, ashtu siç ishte e natyrshme ta shihte përgjithësisht kisha, edhe si luftëtar të fesë kristiane:

«*Qe dishmuesin, o Zot*, këndoshin, «*qi jetën*  
Për shejten Fé, për shqyptarin e shkrini  
E patundshme për herë shtyllë e mburojë»

(Lissus, f. 168)

Në temën historike Mjeda anoi nga motivet e nxjerra prej lashtësisë ilire. Kjo prirje, pas gjasash, do të ketë qenë një mënyrë e preferuar për të shprehur ftohtësinë e tij ndaj realitetit politik e shoqëror, që u krijuar pas Shpalljes së Pavarësisë. Njëherazi ajo flet edhe për ndikimet që pësoi poezia e Mjedës prej klasicizmit. Tek «Scodra» e «Lissus», ku sigurisht është fort i gjallë patosi atdhetar, ndihet e qartë një tendencë për ta estetizuar historinë, për ta kthyer atë në një statujë vërtet të bukur, po që u takonte kohërave të shkuara, ku duhen kërkuar e gjetur jo vetëm bukuria, po edhe heroikja dhe e mira.

Në lashtësi njerëzit dhe mjediset ku jetojnë janë në har-

moni të plotë, çdo gjë synon përsosmërinë. Kontrastet, përthyerjet mungojnë krejtësisht; është mënjanuar e keqjâ, e tmerrshmja, e ulta, është gjetur e pasqyruar vetëm e bukura, vetëm virtyti, që janë të pashkëputura nga njëra-tjetra. Fantazia nuk mungon, përkundrazi, po ajo është rreptësisht e kontrolluar, nuk lejon në asnjë rast shpërthimet dhe është gjithjë «e arsyeshme».

Figurat e mitologjisë greke e shqiptare hasen thuajse në çdo sonet, sidomos tek «Scodra». Një veshje poetike tepër e lëmuar, një punë me të vërtetë minucioze pér stilin, përgjithësisht një formë e disiplinuar gjer në ekstrem, tregojnë se këto krijime të Mqedës janë në ujrat e klasicizmit. Sigurisht, ndikimet e këtij drejtimi në veprën e Mqedës janë të natyrshme, madje të pritura. Me një shkrimitar si ai, klerik, që kishte mësuar në shkolla, ku retorikës klasiciste i njihet një rol i posaçem pér përgatitjen e nxënësve, nuk mund të ndodhë ndryshe.

Megjithatë, poezia e Mqedës do vlerësuar, veç të tjerave, edhe se u tërroq pak pas modeleve klasiciste, se, duke kapërcyer mbi burimet e formimit të saj, ndoqi rrjedhat e letërsisë romantike të Rilindjes.

\* \* \*

Cilat janë shtresat e përbashkëta që afrojnë krijimtarinë e arbëreshëve dhe poezinë e Naimit, Çajupit dhe shkrimitarëve të tjerë të kohës, kjo është një çështje që nuk mund të zgjishumanshmë mbi veprën e tyre. Naimi me shokë e poetët e përtej detit e patën tepër të vështirë të vendosnin kontakte të vazhdueshmë e të pérhershme; fatet e atdheut ata i ndjenë rendë gjatë gjithë jetës që shkuan. Botimet e poetëve arbëreshë nuk shndërrroheshin dot në faktorë letrarë në Shqipëri, sepse, pér shumë shkaqe nuk siguronin komunikimin e domosdoshëm me publikun sado të kufizuar shqiptar. Po të përashtojmë disa nga veprat e Jeronim de Radës, krijimet e tjerë të mjaft poetëve të Rilindjes janë pak a shumë të së njejtës periudhë. Megjithatë ata e kishin të zorshme, tej, çdo përfytyrimi, të njihnin shpejt e thellë punën krijuese, të njëri tjetrit. Do të duhen njohuri të imta pér historinë e krijimit, të botimit, përhapjen e jehonës së veprave të poetëve

rilindës për të përvijuar dendurinë e jetës letrare shqiptare të atyre viteve. Po e çfardo shkalle që të ketë qenë, ajo nuk pengoi aspak që përmes diversitetit të saj, sigurisht të natyrshëm, të përbente një tërësi, që i dha shtat romantizmit shqiptar.

Pa dyshim, ndjeshmëria e veçantë ndaj historisë së popullit, sidomos ndaj epokës së Skënderbeut, përbën pikën më konvergjente të brendisë së poezisë së të gjithë poetëve rilindës.

Historia ishte shëmbelltyra e shkëlqyer e lirisë së shumëpritur, ajo u jepte gjallëri e besim përpjekjeve të arbëreshëve për të ruajtur identitetin e tyre, ajo është një ndër argumentet kryesore të gjithë veprimitarise që kreu Naimi e poetët e tjerë për afirmimin e kombit shqiptar. Romantikët evropianë mund t'i kenë kushtuar vëmendje historisë së vendeve të tyre në këtë ose atë masë, ndërsa romantikët tanë më të shquar Naimi e J. de Rada, e jetuan dhe e krijuan poezinë kryesisht përmes historisë, aq i thellë është adhurimi i tyre për lavdinë e shekullit XV dhe të protagonistit të saj, Gjergj Kastriotit. Natyrisht, përfytyrimet e tyre mbi epokën e Skënderbeut ishin të ndryshme. De Rada dhe Dara i Rithiqeshin më fort pas madhështisë së tragedisë së asaj kohe; ndërsa Naimi kërkonte dhe gjente atje sendërtimin e bukurisë dhe të harmonisë së atdheut. De Rada, tek evokonte shekullin XV, edhe për shkak se jetonte në mjediset arbëreshe, mbetej më pranë përfytyrimeve më të përgjithshme romantike, kurse Naimi, duke mënjanuar me këmbëngulje dramatiken e notat e trishtimit, u largohet atyre në disa anë për të krijuar një vepër që përfytyronte në mënyrë të drejtpërdrejtë synimet politike të Lëvizjes së Rilindjes, realizimi i të cilave kërkonte që historia, epoka e Skënderbeut të shihej jo vetëm si vitet e heroizmit të pafat e të humbjes tragjike, po në radhë të parë si koha që nxiste e fryshtëzonte mbijetesën e kombit shqiptar. Sigurisht, për De Radën e Gavril Darën pasqyrimi i «motit të madh» kishte vlera të pazëvendësueshme në të mirë të çështjes kombëtare; po ata kishin më shumë arsyë ta rikrijonin atë kohë me një theks të veçantë tragjizmi, pasi i vuanin fort pasojet e shpërnguljeve të mëdha të të părëve të tyre që mbetën pa atdhe.

Më anë tjetër, De Rada nuk e trajtoi tematikën aktuale; të gjitha shqetësimet e pikëpamjet e tij ai i derdhi në vepra me subjekt historik. Prandaj ishte e natyrshme që evokimi i ngjarjeve historike në atë vepër, të shërbente veç të tjerave,

edhe si sfond ku ai ngrinte subjekte që pasqyronin konceptet e tij të përgjithshme filozofike mbi jetën dhe njerëzit.

Romantikët evropianë, me të cilët De Rada i pati më të shumta pikat e takimit, nuk dallohen në përgjithësi optimiste kur gjykonin mbi fatet e njerëzimit. Në tërësinë e vet romantizmi shprehte krizën e filozofisë optimiste të iluminizmit.

Vëç poemës «**Historia e Skënderbeut**», Naimi la edhe shumë krijime të tjera, ku shprehen pikëpamjet politike, shqetësimet, botën e tij shpirtërore në përgjithësi, e cila kishte arsyë të besonte fort në idetë racionaliste të iluminizmit. Po të përjashtohen disa vjersha të veçanta, që mbartin nota fataliteti e dëshpërimi, Naimi nuk krijoj karaktere të tilla si Serafina e Bozdari, jo se nuk e njihet natyrën njerëzore, po sepse e dinte që zhbirimet e shumta psikologjike do t'ia zbehnin forcën ndikuese poezisë së tij. Në veprën «**Parimet e estetikës**» De Rada, gjithashtu, pranonte karakterin njohës dhe edukativ të artit. Figurat që krijojnë poezinë e tij, Serafina e shumë të tjera, tregojnë qartë se me ç'tipare morale e shpirtërore e donte ai njeriun. E megjithatë, brendia e poezisë së tij ishte në disa anë mjaft e komplikuar dhe nuk e kishte të lehtë të krijonte lidhje të ngushta e të menjëherëshme me lexuesin.

**Historia**, folklori dhe fantazia ishin burimet ku u mbësh-tetën De Rada dhe Dara për të përfytyruar heronjtë e poezisë së tyre; ato u dhënë tipare origjinale, të cilat, sigurisht, gërrshetoheshin me disa nga karakteristikat më të përgjithshme të heroit të letërsisë romantike, që u shfaqën ndoshta më qartë se kudo gjetkë tek poezia e De Radës.

Heroi romantik i Naimit, po edhe i Asdrenit e Çajupit, u realizua në lirikë dhe më pak në krijimet e tyre tregimtarë. Ndryshe nga ata, De Rada dhe Dara i zbulonin veçoritë e personazheve të tyre duke i kaluar nëpër një jetë të mbushur me ngjarje, të cilat kërkonin forcë të veçantë karakteri për tu përballuar.

Romantikët shqiptarë përmes trajtimit të shumë motiveve përvjuan një botë shpirtërore të pasur në pasione të fuqishme, të mrekulluar pas bukurive të Atdheut, të historisë së tij, të cilësive morale të bashkatdhatarëve, të malluar gjër në dhembje, të lektisur pas dashurisë, të etur përmendimin e veprimin përparimtar e të munduar prej shumë kontradiktash botëku-pimore etj., etj..

Të gjitha këto tipare të përbashkëta vinin në poezi përmes kaq temperamentesh krijuese, që dallonin fort midis tyre e njëkohësisht plotësonin njëri-tjetrin. Me heronjtë e tij De Rada synoi të pasqyronte shpirtin njerëzor në përgjithësi, të

cilin ai e përfytyronte shumë të ndërlikuar, tragjik në thelbin e vet; Dara gjente bukurinë e jetës te njerëzit e karaktereve të qëndrueshme, që e kishin gjithnjë shumë të qartë ç'kérkohej prej tyre e ç'kérkonin ata nga jeta. Serembe ishte fort i prirë ta shihte botën kryesish përmes ndjenjës së vet, që, e zhgënjer kaq shpesh, sillte në poezinë e tij, trishtimin e vuajtjen e rëndë, po gjithnjë thellësisht të singertë.

Me heroin e poezisë së tij, Naimi realizonte idéalin e vet human, të ndritur e optimist; njeriu që donte Naimi ishte i të gjitha virtuteve, i pasioneve më fisnike, ishte mendimtari që kérkonte vazhdimisht të përparuarën, të arsyeshmen e të mirën, ndjenjën e hollë ndaj së bukurës, që mundohej hera-herës prej mëdyshjesh e fatalitetit të çastit. Njeriu i Çajupit është më i vrullshëm në pasionet e tij, nuk e njeh dhe nuk e do vetë-përbajtjen, urren mitet, dyshon në «drejtësinë e mirësinë», e amshuar. Ndryshe nga Naimi e të tjerë romantikë të Rilindjes, Çajupi gjente në botën shpirtërore të kohës së tij shumë cene e dobësi, për kapërcimin e të cilave ai nuk besonte fort. Në këto qëndrime arrin edhe Asdreni në periudhën e dytë të krijimtarisë, po përmes kérkimesh e përsiatjesh të shumta e të mundimshme, që vijnë e bëhen gjithnjë e më të zymta dhë e ndryshojnë mjaft natyrën e poezisë së tij, e cila në fillimet e saj u nis e mbështetur fort tek vepra e Naimit. Romantikët tanë shihnin tek natyra një nga vokacionet e përhershme të krijimtarisë së tyre. Ashtu siç qenë, mërgimtarë të mëdhenj, ata shprehën nëpërmjet saj ndjenjën e tyre më të thellë, mundimin e jetës, mallin e pashuar për Atdhenë. Është kjo arsyje themelore që romantikët tanë nuk e poetizuan natyrën në vetvete dhe vetëm në raste të rralla e trajtuan si mjedisin që i siguronte qetësinë e çlodhjen qenies së tyre të shqetësuar a të pakuptuar nga banaliteti e meskiniteti i shoqërive ku jetonin. De Rada e Dara nuk i kushtuan natyrës krijime të veçanta, po ajo është e pranishme thuajse në çdo këngë të poemave të tyre, siç janë të pranishëm njerëzit e fatet e tyre, përfytyrimet për dheun e gjyshërvë. Ndër romantikët që e trajtuan lirikën e peizazhit si lloj të veçantë, Naimi shquan si poeti që i dha asaj veç të tjerave, brendi më të qartë filozofike, që afrohej me qëndrimet më të përgjithshme romantike. Naimi i konceptoi dukuritë e natyrës dhe njerëzit që jetojnë ndër to si shfaqjen konkrete të perëndisë, që urdhëron harmoninë e bukurinë, virtutin e dashurinë.

Sigurisht, të tilla qëndrime ishin shumë të afërtë edhe për poetë të tjerë rilindës, po shumë prej tyre, romantikët arbëreshë, Asdreni e më pas Lasgush Poradeci shihnin tek

natyra edhe mundësi të shumta e të pazëvendësueshme për të shprehur dallgëzimet e botës shpirtërore të personazheve ose të heroit lirik që krijuan.

Këto shënime që synuan të krijonin një përfytyrim sintetik mbi aférítë dhe ndryshimet në krijimtarinë e romantikëve janë pa dyshim ende shumë të varfëra. Po ato sigurisht nuk do të mbeten të tilla me zgjerimin e vështrimeve krahasuese mbi veprën e poetëve të Rilindjes, të cilat tani janë shtruar para shkencës sonë historiko-letrare si një problem i hapur.

## LAZGUSH PORADECI

### NJË POET PASROMANTIK\*

Nuk është detyrë e këtij punimi të zbulojë në të gjitha anët brendinë e poezisë së Lazgush Poradecit; studiuesit që ia kanë hyrë kësaj pune, e që, padyshim, kanë hedhur dritë mbi këtë krijimtari tepër të koklavitur, me siguri janë gjendur para shumë çështjesh, që do të mund të kapërcëhesin duke njojur mirë burimet e formimit filozofik e artistik të poetit, të cilat janë mpleksur shpeshherë në mënyrë hermetike dhe pengojnë mjaft atrimin në përbajtjen e saj. Sidoqoftë, rrafshi që na intereson, drejtimi letrar i poezisë së Lazgushit, me gjithë vështirësitë, mund të vihet në dukje në vijat më të përgjithshme.

Tek krijimtaria e Lazgushit, ajo e Asdrenit dhe e ndonjë shkrimtari tjetër, vihet re një dukuri që përgjithësisht ka karakterizuar zhvillimet pasromantike të letërsisë. Me ndjeshmërinë e veçantë ndaj dukurive të përditshme të jetës, patosin e vet kritik që vinte në dukje plagët e rënda shoqërore, me interesin e thellë për jetën shpirtërore të njeriut, me zgjerimin e madh të dukurive që mund të ishin objekte të pasqyrimit artistik, romantizmi përparimtar përbante thellë premissat e rrjedhave realiste të letërsisë. Nga ana tjetër, jo vetëm tendenca reaksionare, po në tërësi romantizmi evropian përbante edhe mjaft elemente, zhvillimi i të cilave shpuri në lindjen e «artit për art», të simbolizmit e parnasizmit. Dukuri analoge ndodhën në mënyrë të qartë edhe në historinë e letërsisë sonë. Çajupi e nisi rrugën e krijimtarisë në frysën

\*) Termi «pasromantik» sigurisht nuk është krejt i saktë, sepse romantizmi mbeti një drejtim i ndjeshëm edhe në vitet e krijimtarisë së Lazgush Poradecit. Ky term është përdorur për të treguar se poezia e tij jo vetëm që shfaqeji si romantike në një kohë kur lulëzimi i këtij drejtimi ishte kapërcyer, po edhe për të vënë në dukje se tiparet e disa zhvillimeve romantikoide si parnasi etj. janë më të dukshme pikërisht në këtë poezi.

e Rilindjes si romantik, po më pas në një pjesë të krijimtarisë së tij u dukën të qarta prirjet realiste, që erdhën e u thelluan disa vjet më vonë në një nivel të lartë artistik, sidomos tek Migjeni. Po tek Lazgushi, për shkaqe të ndryshme, u shfaqën disa karakteristika të tjera dhe, nga kjo pikëpamje, pohimi i studiuosit të njohur Rexhep Qosja, sipas të cilit «Lazgush Poradeci ndien si romantik, mendon si klasicist, asht i vetmuem dbe i hermetizuem shpirtnisht si simbolist dhe i kujdeshëm e fanatik ndaj formës e vargut si parnasist»<sup>1</sup>, mbetet i drejtë po të përjashtojmë «të menduarit klasicist». Një përzasje sado e shpejtë e poëzisë së Lazgush Poradecit me pikëpamjet më të përgjithshme të klasicistëve nxjerr në shesh se ajo është shumë larg më esencialevé prej tyre.

Lazgush Poradeci, përgjithësisht, në shumë krijime të tij nuk u nis nga vetëdija se krijimtaria letrare që të ekzistojë si e tillë, e ka të domosdoshme të transmetojë patjetër synime të caktuara morale, siç ngulnin këmbë fort klasicistët. Sigurisht, vjershat e tij më të fuqishme «Gjeniu i anijes», «Vdekuja e nositit», «Lundra dhe Flamuri» shpalosin ideale të larta etike, po, sidoqoftë, në tërësinë e vet, poëzia e Lazgushit nuk përban prirje të theksuara moralizuese; ajo nuk niset nga sentanca etike, nga synimet që t'u mësojë të tjerëve qëndrimet që duhet të mbajnë. Botës shpirtërorë të njeriut, më tepër te vëvtes, poeti i kushtoi shumë vënd, por pa qenë pranë pikëpamjes së njohur klasiciste, sipas së cilës tek njeriu në mënyrë te perjetishme gjenden e mira dhe e keqja në luftë të vazhdueshme midis tyre.

Lazgushi nuk tërhijet shumë pas botës antike; shumë më i interesuar pér të është Asdreni. Pikëpamjet e Lazgushit imbi të bukurën shpesh janë të paqarta, po sidoqoftë, e sigurtë është që ai nuk udhëhiqei nga ideja se bukuria mund të arrihet nga një vepr letrare vetëm po të ndjekë rregulla të përcaktuara që i kanë qëndruar kohës siç mendonin shpesh klasicistët.

Krijimtaria e Lazgush Poradecit, në prirjen e saj më të përgjithshme, është ajo e një romantiiku të vonuar në historinë e letërsisë sonë. Subjekti i krijuesit, natyra, dashuria, atdheu, theket meditative, këto janë disa nga karakteristikat më themelore të poëzisë së tij, të cilat e afrojnë atë në mënyrë të dukshme me romantizmin dhe me drejtime të tjera pastromantike, që janë vënë re me kohë. Lazgush Poradeci është ndoshëta poeti më subjektiv i letërsisë sonë të atyre viteve.

1) Rexhep Qosja, Dialogje me shkrimitarë, Prishtinë 1968, f. 144.

Kur e përcaktojnë si të tillë, me këtë nuk duam të themi se ai s'bëri gjë tjetër vegse krijoi kultin e vvetvetes. Po në krijimet e tij Lazgushi duket se e ndien yeten shpesh disi të pavarur nga shqëria, jehonat e jetës së përditshme tek ai vijnë po-thuajse të shuara; po të përjashtojmë vjershat me motive patriotike, bota e tij, e gjerë nga përpjekjet për të kuptuar filozofikisht jetën, mbetet përsëri me spektër të ngushtë, një botë përshtypjesh, ndjenjash për bukurinë e natyrës, të vajzës, të dashurisë, që domosdo, nuk e lejojnë poetin të shkëputet nga «ego» e tij. Lazgushi vërtitet shumë rreth vetes, në një pjesë të madhe të poezisë ai krijon marredhenie midis tij dhe natyrës, midis subjektit dhe gjithësisë, te cilën e sodit duke e nepërkaluar përmes dispozitiveve shpirtërore e pikëpamjeve të tij, përgjithësisht shumë të komplikuara. Në historinë e romantizmit ka pasur shkrimitarë që, duke i kushtuar shumë vëmendje subjektit të tyre, binin, le ta quajmë kështu, në një lloj narcisizmi, që dukej veç të tjera, edhe në vlerësimin e tyre, gadi divin, për rolin dhe figurën e poetit. Në poezinë e Lazgush Poradecit nuk është e vështirë të kuptohet se ai e shikonte poetin si një të zgjedhur të zotit, si një njeri që përendia e kish vecuar prej të tjereve me dhuntinë që i kish falur. Për Lazgushin frymezimi poetik është gjithnjë prej burimi hyjnor:

*Sbret një yll prej lartësije,  
Një të ndritur shkrepëtime  
Posi flakë e posi hije  
Ajo ryn në zemër t'ime  
E kuptoj me shpirt të sosur  
Si kallon dale-nga-dale  
E si fjalës së palosur  
M'i hap kindën e një pale...  
  
Unë qit një psherëtitje,  
Thyem pak e zë të shkruar<sup>1</sup>*

(Ri mbështetur në tryezë, f. 57, 58)

Është tepër e vështirë të ndiqen tiparet e botëkuptimit të

1) Lazgush Poradeci, Vdekja e Nosilit, zgjedhur e përgatitur nga Sabri Hamiti, Prishtinë, 1978 (Citimet nga poezia e Lazgushit janë të këtij botimi).

poetit, sidomos në ndikimet e shumta që ka pasur. Po ndërkaq tek ai bien në sy shpejt një lloj panteizmi që po aq sa filozofik, duket të jetë edhe poetik, një fare ezoterizmi, si dhe soditet spekulative kozmogonike, qëndrimet mistike që synojnë të afrojnë poetin me përjetësinë e amshimin. Ndjenja e pafundësise, si shprehje e ezoterizmit të qëndrimeve të tij botëkuptimore, është një nga më të thellat në poezinë e Lazgushit.

Kjo ndjenjë e tërheq vazhdimisht poetin dhe e shtyn të kërkojë krijuesin e gjithëfuqishëm e më shpesh të shprehë pikëpamjet e tij teozofike, sipas të cilave njojha e zotit vjen nëpërmjet thellimit të jetën e brendshme të subjektit. Metaforat e ngritura me fjalat «yll», «përjetësi», «fellësi» janë ndër më të përdorurat në poezinë e Lazgushit. Për të arritur tek zoti, ai rrallëherë mbështetet tek dogma ortodokse, më shpesh e gjen atë në frymëzimin poetik, e gjen tek vetja:

*Ndaj të qëndron, po, zoti, — tha zemra shpesh vetiu,  
Më tha me zë të fellë, dhe prapë-u qetësua;  
Dhe prapë që nga gjiri q'u tund e pshëretiu,  
Me fshehtësi më foli: Ay qëndron ndaj mua...*

(Njeriu dhe zoti, f. 191)

Në poezinë e Lazgushit haset një gjendje e veçantë shpirterore që rreh të jetojë me sendet, që sheh tek krijimi mundësinë për të penetruar ndër to, e që synon të shprehë mënyrën si e percepton universin poeti, një mënyrë sinkretike tepër e turbullt.

Qëndrime si këto të Lazgushit ishin të zakonshme për romantikët, të cilët, herë tek kultet fetare e në pikëpamjet deiste e panteiste dhe herë në mistikë, kérkonin të gjenin një mënyrë për spastrimin e shpirtit të njerëzve, që ishte, sipas tyre, shumë kontradiktor, një pre e lehtë për tundimin e mëkatin që po lulëzonte në atë shoqëri antihumane. Konfuzioni i pikëpamjeve të tyre ishte i natyrshëm, sepse romantikët objektivisht nuk qenë në gjendje të kuptionin shkencërisht shoqerinë dhe njeriun. Idealistë deri në fund, ata pandehnin se shoqëria, mund të ndregej vetëm nëpërmjet transformimit të shpirtit të njeriut. Vlera e qëndrimeve të romantikëve përparrimtarë do kérkuar në simpatitë e thella demokratike, në kritikën e ashpër ndaj klasave shfrytëzuese, ku shpesh përfshinin edhe klerin, në përkrahjen e luftërave çirimitare

të popujve etj. Më tej ata s'mund të shkonin; letërsia realiste ndjeu nevojën e një analize më të thellë të shoqërisë, jo vetëm në rrafshin etik, po në radhë të parë në atë ekonomiko-social, pa qenë në gjendje sigurisht të zbulonte forcat e vërteta që mund të realizonin shndërrimet e thella në jetën shoqërore. Të tjera zhvillime të romantizmit theksuan më shumë qëndrimet idealiste në gjykitë mbi jetën, theksuan paqartësinë e subjektivizmin.

Me përjashtim të vjershave me motive patriotike, në përgjithësi poezia e Lazgushit është e ftohtë ndaj çështjeve të përparimit shoqëror. Edhe krijimet e tij më të mira, i mbarëtin idelet e larta sociale, pa iu referuar një shoqërie konkrete të caktuar. Një krasim i shpejtë midis poezisë së tij dhe krijimtarisë së autorëve të tjerë përparimtarë të kohës nxjerr në mënyrë fare të dukshme ndryshimet e mëdha midis tyre.

Për të zbërthyer konceptet të cilave u mbahej Lazgush Poradeci për artin poetik, studiuosit janë nisur nga brendia e disa prej vjershave të tij. Në to është vënë re se ai e shikonte aktin e krijimit si kërkim të përmalluar, të vazdueshëm e shumë të mundimshëm të së bukurës<sup>1</sup>, që me t'u arritur, realizon qenien dhe shpirtin e poetit.

Po t'u shtohej këtyre konstatimeve edhe fakti që angazhimi qytetar i Lazgushit mbeti brenda kufijsh të ngushtë, se duke kërkuar në mënyrë këmbëngulëse të bukurën, si qëllim më vete, synimet e tij ngjajnë të jenë të afërtë me ato të «artit për art» e të parnasit, atëhere gjykitë mbi qëndrimin që mbante Lazgushi ndaj poezisë do të bëheshin më të plota. Megjithëse e konsideronte bukurinë si synim në vjetvete, Lazgushi, sigurisht, nuk arrii në pozitat ekstreme të «artit për art», të parnasianëve e simbolistëve. Për atë qenë të huaja, të paktën nga ç'jep krijimtaria e tij, pikëpamjet sipas të cilave poezia duhet të qëndrojë larg çdo përbajtjeje morale, se ajo kërkon një publik të kultivuar për t'u kuptuar etj. Është e vërtetë se shumë nga vjershat e Lazgushit nuk kuptohen nga të gjithë, një pjesë e tyre është me të vërtetë tepër e vështirë për t'u kapur; po ndërkohë, më të bukurat e krijuarëve të tij janë njëkohësisht shumë të qarta ose kuptohen pa shumë vështirësi. Kultura helene, që për parnasianët ishte

1) Shih: Sabri Hamiti, *Studim hyrës* në botimin e veprës së L. Poradecit, Prishtinë, 1978, fq. 28-35.

ndër burimet kryesore të poezisë nuk ka lënë gjurmë të vëçanta në poezinë e Lazgushit. Ai i kushtoi kujdes të vëçantë anës tingellorë të vargut dhe fjalës si lëndë poetike. Po afria e një pjese të krijimtarisë së tij me simbolizmin nuk duhet kërkuar vetëm këtu, po në radhë të parë në notat e theksuara sugjesteive e abstrakte të saj. Sidoqoftë, lirika e natyrës dhe disa nga vjershat me motivin e dashurisë janë margaritarë artistikë, edhe sepse ai i përpunoit në mënyrë mjeshtërore vëçoritë tingullorë të fjalës. Poezitë më të mira me këto motive transmetojnë pasione të fuqishme, mendime të qarta dhe jo një ide të shumëfishtë, që mund të interpretohet sipas dispozitive të lexuesve të vëçantë. Lazgushi nuk krijoi shumë në llojet tregimtare të poezisë, megjithatë në kompozicionin e disa prej vjershave të tij, ai nuk e mënjanoi narracionin, sic kërkonin simbolistët. Mbi të gjitha, Lazgushi ishte poeti i ndjenjës së thellë, i hoveve të fuqishme shpirtërore, karakteristike për romantizmin, po të papranuara e luftuara nga shumë simbolistë, të cilët objektin e veprës artistike e gjenin vetëm tek idetë abstrakte.

Studiuesit me kohë kanë vënë në dukje se shkrimtarët romantikë prireshin aq fort nga natyra, kryesisht për shkak se e ndienin veten krejt të shkëputur nga njerëzit e kohës dhe të vendit të tyre, se për ta ishte e pamundur t'u përshtateshin shoqërisë dhe mënyrës së saj të jetesës. Tek më përparimtarët prej tyre kjo ishte, si e kemi vënë në dukje edhe më parë, një rebelim ndaj shoqërisë, një sfidë herë e hapët dhe herë e tërthortë ndaj saj. Me Lazgush Poradecin nuk ndodhë gjithnjë kështu; sigurisht, ai ishte jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj natyrës, disa nga kryeveprat e tij është i krijuar me këtë motiv. Po ndërkaq, Lazgushi nuk shkonte tek ajo i shtyrë nga shkage sociale e etike; është e veshjtire që në krijimet e tij me motivin e natyrës të gjesh ndonjë llo kundërvënieje ndaj amullisë, apatisë e padrejtësisë që karakterizonin jetën e viteve të tij. Temperament melankolik, atij i pëlgente vëtmia, jo aq se nuk mund të pajtohet me shumë tipare të jetës shpirtërore të kohës, po më fort sepse gjente tek natyra vendin, që u jepte trajtë përjetimeve të tij estetike:

*Në këtë ças perëndimor  
Ndaj po më dehen sytë e mi,  
Kuptoj si shpirtin vjershëtor  
N'a frymëzon një mall i ri*

(Dremit lijeni, f. 78)

Si vendi që spastron moralisht njeriun, natyra nuk ka ndonjë rol të vegantë në krijimtarinë e Lazgushit; virgjiniteti, kontrastet dhe ashpërsia e saj, si asosacione shqetësimesh të fuqishme, gjithashtu nuk përbëjnë ndonjë prirje të dukshme në të. Sidoqoftë, motivet e natyrës, edhe në atë shkallë që janë trajtuar, përbëjnë një tregues të qartë të karakteristikave romantike të poezisë së tij. Në vjershat e peizazhit, Lazgushi afrohet me romantikët, veg të tjerave, edhe për atë ndjenjë përgjithesisht të trishtuar që i përshkon, për sinceritetin e lirizmin e thellë, për shnderrimin e natyrës në një krijuar shpirtërisht shumë të afert. Romantike është edhe prirja e Lazgushit per të parë te natyra, në disa prej vjershave të tij, një mundësi të shkrirjes së subjektit të poetit me makrokozmosin; ylli është ndër objektet më tërheqëse për te edhe sepse, me lëvizjen, shndritjen, largesine e tij, i kryjon poetizionin e një bote tjetër ekstranjërëzore, krejtësisht të veçante, të ndjere e të kuptuar vetëm prej tij:

Ti fli... dhe në do që të sgjohesh,  
T'a dish si djeg yll i vërtetë,  
Kapto' nëpër qjejt' e përflokur  
Dh'u ndis e zhurit e ti vetë  
Si yll të zhuritesh ti vetë.

(Gjumi i shpirtit, f. 61)

Karakteri romantik i poezisë së Lazgushit theksohet akoma më tej në vjershat me motivin e dashurisë. Ndikimi i qëndrimeve të Naimit në këto vjersha është kryt i dukshëm. Ashtu si për Naimin, edhe per Lazgushin dashuria është një ndjenjë komplekse, që, me shume se gezim, shkakton mall trishtim, vuajtje e megjithatë mbetet e lakmuar, tërheqëse, shumë ngazëlluese pikërisht në mundimet e saj. Lazgushi shpesht e hyjnizon dashurinë; sipas tij është vullneti i zotit de neperimjet saj, bashkon dy qenie njerëzore:

Atje lart në mal të thatë  
Zoti Krisht bëke një kishë  
N'atë kishë ç'paske brenda!  
Qënke trimi dhe vasha:  
Trimi ç'paske dhëndëruar  
Vasha ç'paske nusëruar,  
Zotin ç'paskan lavdëruar,

*Jetën ç'paskan trashëguar  
Shpirtin ç'paskan shentëuar.*

(Balladë, f. 183)

Edhe Lazgushi si të gjithë poetët tanë, kur e trajtonte motivin e dashurisë, nuk nisej nga qëndrime të caktuara që kishin si synim kryesor të theksojnë pikëpamjen e njohur romantike, sipas së cilësjeta do organizuar jo mbi bazën e «arsyes» morale, qytetare e shtetërore, po vetëm mbi «ndjenjën» e thellë e të pastër. Thelbi romantik i motivit të dashurisë te Lazgushi duhet gjetur në radhë të pare në kërkesën e vazhdueshme shpirtërore të poetit për ta përshkruar në detajet më të imta këtë ndjenjë, në prirjen për të zbuluar në menyre sa me të plote mijediset, hollesite intime, bëkurinë e vajzës dhe pasojat e saj në botën e brendshme të poetit.

Çajupi dhe Asdremi e shikonin dashurinë edhë si një dukuri ku vepronin fort faktorët shoqërorë, që e shndërronin në interesa meskine e korruption. Lazgushi përkundrazi, do të gjejë gjithnjë bëkurinë e saj, ndërsa përmartesën, si synimin dhe kurorëzimin e dashurisë, do të flasë rrallë. Kjo nuk do të thotë aspak se ai, në konceptet e tij, u mbahej pikëpamjeve mbi dashurinë e lirë, të cilave u qëndruan me këmbëngullje disa shkrimitarë romantikë. Lazgushi ndryshtë nga Naimi, nuk është platonik, po ai asnjëherë nuk është gjithashu sensualist e voluptuoz. Si Naimi, ai gjente te dashuria trajten më te përsosur të bëkurisë, prandaj i kushtonte aq shumë vëmendje përshkrimit të cilësive fizike të vajzës. Në poezinë e tij dallojmë dje disa tipare të tjera të qarta, karakteristike të poeziës romantike. Dashuria është veshtruar shpesht si një tendencë e përgjithshme universale që shfagjet kudo, që qëndron mbi gjithçka, si mishërimi më i plotë i harmonisë, të urdhheruar nga zoti e që duhet të sundojë botën e jetën:

*Yjtë e ndezur si fingjill  
Që vërtiten palë-palë*

*Zunë fill me dashuri  
Që kur bota zu të ngjizet,  
Pa sikush për shok të ti,  
Përvëlohet edhe ndizet,*

(Vallja e yjeve, f. 154)

Po ajo mbetej edhe një enigmë e çuditshme dhe e pakuptuar:

*Se s'dashuroja as un' as ti,  
Po dashuronte dashurija;  
Një dashuri — një fshehtësi  
M'e fshehur sesa fshehtësia.*

(Ku shtrohej vala, f. 125)

Asdreni hera-herës përpiqej ta largonte dashurinë, sepse sipas tij, nuk krijonte gjë tjeter veçse një gjendje të rëndë, shumë vuajtje që binin ndesh me qetësinë e lakmuar të shpirtit. Çajupi shihte tek ajo, krahas bukurisë, edhe një mashtrim të rafinuar prej burimi djallëzor. Tek Lazgushi nuk ndodh kështu në asnje rast. Është e vërtetë se në lirikën e tij erotike janë të rralla çastet e gëzimit, të cilat shfaqen pothuajse gjithnjë në poezitë ku ai i këndon dashurisë së njerëzve të thjeshtë («Kroj i fshatit tonë», «Kush po shkon ashtu» etj.); në të tjetra viersha, që gërshtojnë edhe motivet filozofike, ndjenjat që sundojnë janë përgjithësisht të trishtuara, po jo të zymta. Trishtimi i poetit është thellësisht njerëzor, ai ka të bëjë shpesh me vuajtjen e përgjithshme që sjell rrjetdhë e kohës, malli, rinia e kapercyer, kujtimet e së kaluarës («Të ritë e viteve të mi», «Syr' i fshehur», «Oh, vanë fletët» etj.).

Nga ana tjetër, shkaqet e dolorizmit, të ndjenjës së vuajtjes që përshkon shpesh motivet e dasi urisë te Lazgushi, duhen gjetur edhe në një prirje të përgjithshme të romantikëve që mendonin, siç është vënë në dukje, se vetëm dhimbja e vuajtja janë ndjenja shumë të thella, me të vërtetë njerëzore, të denja pér t'u pasqyruar në poezi.

Në pajtim me pikëpamjet më të përhapura romantike, Lazgushi e sheh dashurinë si mënyrën e vetme të krijimit të lumturisë së plotë, si një strehë që e shpëton nga shoqëria njerëzore:

*Edhe kështu qëndro përjetë  
Larg njerëzisë e pranë meje:*

(Eja, motër, f. 129)

Vajza, objekt i kësaj dashurie kaq pasionante, që, për nga forca e saj jashtëzakonisht ndikuese, siç thotë poeti, shkon gjer në llahtari, është trajtuar prej tij, ashtu si më parë nga

Naimi vetëm si burim bukurie. Se c'natyrë kish kjo vajzë, cila éshëtë bota shpirtërore e saj për të gjitha këto Lazgushi interesohet pak; atij i duhet vetëm bukuria e vajzës. Poeti nuk i pëershruan cilësitë e saj morale, ai nuk e përfytyron vajzën të virtytshme si engjëll, siç veprojnë shpesh romantikët, po si një kriesë të zakonshme njerëzore. Me pasojat purifikuese që sillte dashuria në shpirtin e të rinjve, pas të cilëve tërhiqeshin fort romantikët, Lazgushi nuk zgjatet shumë.

Bota romantike e Lazgush Poradecit, edhe pse i kushton shumë vend lirikes intime meditative e të natyrës, éshëtë sigurisht më e gjere. Në të vijnë ende të fresketa jehonat e karakteristikave të letërsisë së Rilindjes kombëtarë, sensibilitati i vëçantë ndaj lirise kombëtare («Marshi i djalerisë», «E fundit mërzitje», «Ç'u mbush malin», «Bjenë telat», «Dita e njëzetetës»), poetizimi i gjuhës shqipe si shenje e lashtë dhë e sigurtë e vëçansisë kombëtare («Kënga pleqërishte» e sidomos «Naim Frashërit») etj. Poezia e Lazgushit nuk arriti dot që, nepërmjet èndërrimeve të fuqishme, të përvijonte një jetë tjetër, të re, të kundërt me jetën e kohës se tij. Ajo nuk mundi ta sfidojë në shumë anë shoqérinë shqiptare te paspavarësise; patosi kritik, që tek shkrimitaret romantikë më përparimtarë ishte mjaft i ndjeshëm, tek Lazgushi thuaise mungon krejt ose ishte shumë i tërthortë. Mylli e poetit në vetvete mund të përbante vërtet një lloj disaprovali ndaj jetës së asaj kohe, po sigurisht pa jehonë të gjere shoqërore.

Megjithatë, disa nga vjershat e Lazgushit, «Gjeniu i anijes», «Lundra dhe flamuri», «Vdekja e Nositit» flasin qartë se ai nuk e reduktoi jetën vetëm në përpjekjet për të gjetur bukurine, se ai nuk e identifikonte atë vetëm me dashurinë ose kërkimet kozmogonike. Me këto vjersha, Lazgushi tregon se këptimi i fili mbi jetën éshëtë më i gjere, se hera-herës ai ka një shpirt vërtet të vrullshëm që jeton me ideale të larta, me më të lartin prej tyre, idealin e vetëmohimit krijimtar:

*Pa nis ah! gjirin ta godas...  
Dh'e hap ah! — gjirin më një ças...,  
Dh'i ngjinj ah! zoqtë e vdes me gaz!...*

(Vdekja e Nositit, f. 205)

Me këto vjersha Lazgushi ka hequr dorë nga trishtimi i përhershëm që sundon në shumë nga krijimet e tij të dashurisë, të natyrës e të mendimit. Meditimi i poetit, shpesh i turbullt e thjesht spekulativ («Përjetësia», «Fryma dhe qëllimi»,

«Njeriu dhe Zoti» etj.) tani ka fituar përmasa të reja, që transmetojnë një mesazh thellësish human e përparimtar. Në konceptimin e Lazgushit ky mesazh synon të jetë pannjerëzor e i të gjitha kohërave. Po edhe pse nuk arrin të konkretizohet në rrethana të caktuara shoqërore, ideali i poetit ruan vlera të padiskutueshme dhe pasuron në mënyrë të ndjeshme përjetimet e tij romantike.

## **SHFAQJE TË ROMANTIZMIT REAKSIONAR**

Në kompleksitetin e problemeve që preku letërsia e Rilindjes kishte një a më shumë pika që, nga këndvështrimi i tendencës politike të brendisë së veprave që hartuan, mund t'i ndanin, dhe në fakt i vëruan, disa nga shkrimtarët e kohës. Siç ishte krejtësisht e angazhuar pas luftës për çlirimin kombëtar, letërsisë së asaj kohe i duhej medoemos të ishte fort e ndjeshme ndaj politikës së fuqive evropiane që kishin synime të tyre në Shqipëri. Çështja shtrohej nëse duhej konsideruar mbështetja e njërsës prej tyre si faktor vendimtar që do të siguronte krijimin e një shteti shqiptar, apo nuk duhej ushqyer asnjë iluzion dhe nuk i duhej besuar kurrikujt.

Duke përgjithësuar politikën evropiane ndaj çështjes shqiptare, shoku Enver Hoxha thekson se: «Shqipëria nuk ka pasur asnjë mik në atë kohë [...] Mik i vërtetë i pavarësisë

së Shqipërisë atëhere ishte vetëm populli shqiptar me luftën dhe përpjekjet e tij për t'u çliruar me armë në dorë»<sup>1</sup>.

Rilindësit tanë përparimtarë, mes tyre shumë prej shkrimtarëve romantikë, i kishin të qarta jo vetëm qëllimet grabitqare të shteteve shoviniste fqinje, po njihnin mirë edhe prapskenat e diplomacisë evropiane, qëndrimet e Rúsise e të Francës, Austro-Hungarisë, Anglisë dhe Italisë. Në veprat e tyre letrare dhe joletërare, sidomos Naimi dhe Samiu përcaktuan në përgjithësi drejt detyrat që duhej të realizonte populli shqiptar në ato kohëra të mbarsura me shumë rreziqe. Sami Frashëri thoshte se të shpëtuarit a të humburit e Shqipërisë është në dorë të vetë shqiptarëve. Këtu do gjetur bindja e thellë e rilindësve, që megjithatë i ndiqnin nga afër konjukturat e kontradiktat e politikës evropiane, përpinqeshin të përfitonin prej tyre, po nuk besonin se çështjen e pavarësisë do ta zgjidhte më së fundi «përkrahja e drejtësia» e fuqive të mëdha. Përkundrazi, ata e dinin se ëndrra dhe luftërat e popullit të tyre për pavarësi shkonin ndesh me një vorbull interesash të kundërtta, të cilave duhet t'u ruheshin shumë. Prandaj në pikëpamjet e tyre rilindësit tanë përpunuan qëndrime të haptë antiimperialiste që, bashkë me besimin e patundur në aftësitë e shqiptarëve për të krijuar e mbajtur shtetin e tyre, përbënë boshtet e politikës së Rilindjes, e cila u pasqyrua gjérësisht në poezinë e atyre viteve. Të ishe kundër këtyre qëndrimeve, donte të thoshte t'i pengoje seriozisht synimet e Rilindjes dhe hapur ose tërthorazi të bëje lojën e armiqve të shumtë të lirisë e mëvetësisë së atdheut. Këtu ndahej nga prirja e përgjithshme përparimtare e romantizmit tonë Zef Skiroi, poeti arbëresh nga Hora e Siqilisë. Në krijimtarinë e tij gjenden pothuajse të gjitha tiparet që karakterizojnë romantizmin arbëresh: historia, sidomos tragjedia shqiptare e shekullit XV, heronjtë e saj, traditat, adhurimi për gjuhën, ndjenja dhe ambientet familjare e idilike, dramat e thella, një lloj fataliteti, natyra, kulti etj. Poema «Mili e Hajdhia», në të cilën janë të dukshme ndikimet nga Jeron De Rada, është model i krijuar romantik. Po në shumë vepra të tij letrare dhe joletërare Skiroi bëhet zëdhënës konsekuent i pikëpamjes, se Shqipëria mund të ekzistonte vetëm nën protektoratin italian. Ndërsa De Rada vinte në përfundimin se atdheu i të parëve do të mund të jetonte më vete po të dinte të shpëtonte prej qëllimeve grabitqare të fqinjëve e fuqive të tjera evropiane, mes të tje-

1) Enver Hoxha, *Vepra*, vol. 23 Tiranë 1977; fq. 136, 137.

rëve Italisë, ndërsa Dara e Serembe nuk ushqyen asnjë lloj iluzioni ndaj «dashamirësisi» së asaj apo kësaj fugie të kohës, ndërsa, më në fund, De Rada e Dara i prisnin urat me Krispin, kur politikani arbëresh nisi të mbështeste synimet e borgjezisë italiane ndaj Shqipërisë e t'i kthente ato në një faktor të luftës elektorale, Skiroi shikonte tek interesat e asaj borgjezie në pellgun e Adriatikut, e përgjithësisht në Lindje, një forcë shtytëse për triumfin e kryengritjes shqiptare<sup>1</sup>.

Kësaj pikëpamjeje Skiroi do t'i mbahet tek poema «Kthimi»<sup>2</sup> dhe tek varianti i dytë i veprës tjetër «Te dheu i huaj», në të cilën me frymë idolatrie do t'i thurë elozhe edhe sistemit shtetëror të Italisë, që në ato vite po e cte drejt fashistizmit të jetës së vendit<sup>3</sup>.

Eshtë në logjikën e këtij qëndrimi që në shumë vlerësimë të tjera të Skiroit, sidomos të disa figurave historike, të shprehën gjykime krejtësisht reaksionare e antishqiptare, të ngrihen lart Krispi («Te dheu i huaj») dhe Esat Pashë Toptani, një nga personazhet më të urryera të historisë së Shqipërisë, të çmohen njerëz si Preng Bib Doda etj.

Emisar i vërtetë i interesave italiane në Shqipëri, Zef Skiroi, përfundoi si apologjet i fashizmit.

1) Shih: G. Schiro, Kënkat e luftës, Palermo 1897, f. 9.

2) *Tha e të gjithë e miratosën*  
*Këto fjalë shumë t'larta*  
*sa edhe klithën «Drita u shtoftë*  
*hyllit t'bardhë t'Italisë*  
 («Kthimi», Firence 1965, fq. 186)

3) *Do t'fillonjë koha e Drejtës*  
*në s'më rren dëshiri i math;*  
*mosnjeri mbi tokë i huaj*  
*s'ka me u ndier e s'ka me u njohur,*  
*ndonse ajo do t'jet e ndame*  
*me kufinjtë e ata të ruarë*  
*po nga nderi vllazëror,*  
*sa kushdo për të jetuar*  
*gaz të ket e të kënaqur*  
*si (mentre) nga bregu i KAPITOLIT*  
*ndër tri ngjyrat a të fatmira*  
*ka fuqin e tij të ndenjë*  
*e t'rrezonjë të gjith anët*  
*hylli i bardhë i paqes s'ROMËS*

(«Te dheu i huaj», Palermo 1940, f. 392)

Me këto qëndrime Skiroi praktikisht e dënoi veprën e vet, krijoj një çarje të thellë midis saj dhe romantizmit rilindës, i cili mund të lejonte vlerësimë kontradiktore në shumë anë të botëkuptimit të shkrimtarëve, mund të pranonte një fantazi të pasigurtë si ajo që bie në sy në krijimet e Skiroit, po nuk falte pikëpamje që kërkonin të zëvendësonin pushtimin e vjetër me një pushtim të ri.

\* \* \*

Oportunist gjer në palcë, që gjithë jetën ishte i gatshëm të shiste ata që e blenin, duke i mbuluar veprimet e tij me një tymnajë atdhedashurie, Gjergj Fishta, me krijimtarinë e tij, i solli shumë dëme lëvizjes së Rilindjes e më pas lëvizjes demokratike në vendin tonë. Poet i sakristisë, teokrat i bindur, Fishta rendi pas motivit fetar katolik; asnjë poet i atyre kohërave nuk i kushtoi kaq vëmendje temës fetare.

Më shumë se një e treta e vjershavë të vëllimit «Pika voesë», gati të gjitha krijimet e përbledhjes «Vallja e Parrit» trajtonë motive thjesht fetare, të cilat shpesh pëershkojnë tej e ndanë edhe lirika të temave të tjera. Janë të njohura qëndrimet që mbajti Naimi për çështjet e fesë; Mjedën nuk e bënë shkrimtar të shquar shkrimet e tij fetare, ndërsa Fishta përkundrazi, të gjitha problemet për të cilat është interesuar ia nënshtron katolicizmit, madje edhe lirinë e Shqipërisë, ai e kërkon në emër të vendosjes së «drejtësisë» katolike, që qëndron, sipas tij, në themel të çdo përparimi. Besimi në fe ishte për Fishtën forcë lëvizëse e çdo ngjarjeje historike, vullneti i zotit dhe nënshtimi ndaj tij ishte shkaku i parë dhe i vetëm i çdo ndryshimi. Trajtimi kaq intensiv i motiveve fetare, jo thjesht si një qëndrim shpirtëror e botëkuptimor, po edhe si ortodoksi në vitet e Rilindjes nuk mund të përbënte më një lloj rezistence ndaj pushtuesit të huaj, përkundrazi, objektivisht ajo shkonte ndesh me kredon aq të drejtë të lëvizjes: feja e shqiptarit është shqiptaria. Ishin shumë të largëta ko-hërat kur mbrojtja e pozitave të katolicizmit bashkëvente me diferencimin nga pushtuesi i huaj, përkundrazi, ishte e domosdoshme që të zbuteshin e të kapërceheshin sa të ishte e mundur dallimet fetare. Çështja kombëtare nuk mund të shpihej përparrë prej klerikësh sado «të emancipuar» të ishin ata; ndërgjegjja fetare, kurrë ndonjëherë fort e thellë ndër shqiptarët, nuk duhej lejuar të bëhej faktor i rëndësishëm në jetën

politike. Në kushtet e Rilindjes ajo kishte humbur çdo lloj vlore në organizimin e luftës për çlirimin kombëtar dhe ishte shndërruar në një dukuri, që ndihmonte pushtuesit, fqinjët shovenë dhe borgjezinë evropiane. Do të ishte gjysma e së keqes nëse Fishta në vjershat e tij do të shprehte vetëm botë-kuptimin e vet, pa u shtyrë në arsyetime të tjera mbi rolin e fesë. Kjo ka ndodhur herë pas here me shkrimtarët e Rilindjes. Po ai nuk vepron kështu; plotësisht i ndërgjegjshëm, Fishta ngul këmbë në pikëpamjen se vetëm feja éshtë në gjendje të sigurojë qytetërimin e vërtetë («Shqyptari i qytetëruem» tek «Mrizi i Zanavet» etj.). Kësaj pikëpamjeje Fishta i mbahej në vitet e Rilindjes, kur Naimi me shokë bënин çmos të hidhnin themellet e një kulture të re iluministe; kësaj pikpamjeje ai do t'i mbahej prapë në polemikën që zhvillohej për çështje të arsimit, edhe pse në ndonjë rast, nxitur gjithnjë prej paternalizmit që frymëzohej nga ideologjia klerikale, merrte pamjen e kontestatorit të rendit të vendosur («Gomari i Babatasit»). Këto pozita për Fishtën ishin të vetmet të mundshme, vetëm me to ai nuk donte të luante, ashtu siç luante gjithë kohës nëpër alternativa politike nga më të kundërtat.

Me pikëpamjet e tij Fishta ndahej shpejt nga trungu i qëndrimeve poetike të romantizmit shqiptar. Dihet se shumë nga romantikët tanë, Naimi me shokë sidomos, treguan, herë hapur e herë në një mënyrë më të tèrthortë, si e ëndërronin Shqipërinë e ardhshme. Si e kemi vënë në dukje edhe gjetkë, të nisur nga pozitat e demokratizmit borgjez, romantikët rilindës kërkonin një Shqipëri republikane pa feudalët ose me një rol të kufizuar të tyre. Fishta e jetoi periudhën e viteve 1912-1939 dhe ngjarjet e saj, të cilat thelluan më tej proceset e diferencimeve sociale e luftën midis tyre. Klerikalist në formimin dhe veprimet e tij, ai kërkonte pozita të privilegjuara drejtuese për njerëzit e sërës së tij, një shtet të udhëhequr posaçërisht nga katolicizmi. Në përpunim me këto pikëpamje, ai përpunonte qëndrimet e momenteve, të cilat kapeshin pas reaksionit më ekstrem, që kërkonte si qëllim të fundit aneksimin e Shqipërisë nga Italia.

Fishta mbahet në radhë të parë si poeti i «Lahutës së Malcis», vepra që i shërbeu kulturës klerikaliste-feudale për të krijuar një aureolë madhështie rrëth autorit të saj. Duhet pranuar që, në një mënyrë a në një tjetër, «Lahuta e Malcis» prekte ndjenjat atdhetare të shumëkujt, ajo ndikonte edhe në përjetimet e shtresave demokratike e të disa përfaqësuesve të kulturës përparamtare shqiptare. Në këtë ndikim kishte arsy objektive; së pari, vepra fliste, — sigurisht në mënyrën e vet

subjektive, për qëndresën e shqiptarëve, kundër hordhive serbe e malazeze, që kishin derdhur lumenj gjaku ndër mësorët e urreheshin përvdekje prej tyre; së dyti, ajo u shkrua me një gjuhë artistike të kuptueshme nga një shkrimitar përtë cilin, megjithë vargëzimet e shumta që la, gjithsesi nuk mund të thuhet se e njihet keq zanatin.

Po kjo vepër i shfyturonit keq ngjarjet historike dhe jetën e mësoreve.

Sigurisht, rilindësit tanë e njihnin mirë rrezikun e madh që i kanosej Shqipërisë nga Veriu; ata iu kundërvunë fortët këtij rreziku, po megjithatë nuk reshtën së menduari se me fqinjt mund dhe duhej jetuar në miqësi. Për rilindësit tanë kanë qenë të huaja pikëpamjet shovene. Në kundërshtim mëta, Fishta i paraqiste luftërat e mësorëve tanë me serbët e malazezët jo në shkaqet e tyre të vërteta historike, po si përplasje racash, në gjak të papajtueshme. Përfytyrime të tillë u shkonin përshtat fuqive të huaja, që kërkonin të pengonin ekspansionin sillav dhe të siguronin përvete pozitat sunduese në Shqipëri, të cilën Fishta nuk mund dhe nuk donte ta mendonte pa suzerenitetin e ndonjë prej shteteve fqinje katolike, të Austro-Hungarisë ose të Italisë; zgjedhja e tij varej gjithnjë nga konjunkturat politike të momenteve. Nisur nga interesat e këtyre shteteve, Fishta «kritikonte» te «Lahuta e Malcisin» politikën e Rusisë, Anglisë e të Francës. Po ç'fshihej pas qëndrimeve të Austro-Hungarisë e Italisë, kjo ishte e qartë që në atë kohë për shumë nga romantikët tanë. Një krahasim i shpejtë midis veprës së tyre dhe pikëpamjeve të Fishtës vë në dukje menjëherë ndryshime të mëdha. Kurrkund tek Naimi, Çajupi, Asdreni e Mjeda nuk shfaqet, qoftë edhe në mënyrë aludive, mendimi se Shqipëria mund të bëhej vetëm po të donte ndonjëra ose disa prej fuqive evropiane të kohës.

Një vepër si «Lahuta e Malcisin», e cila ka pretenduar të pasqyronte historinë e Shqipërisë nga vitet '50 të shekullit të kaluar gjer tek Konferanca e Londrës, duhej të kishte një arsyë të fortë, që i kalon fare shpejt kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912, të cilat u bënë një faktor vendimtar që shpuni Shqipërinë në Shpalljen e Pavarësisë. Ato kryengritje Fishta nuk i kish përkrahur, ai veproi për shuarjen e tyre. Duke i kaluar fare përciptazi e në mënyrë krejt të pjesshme, ai trengonte se ngjarjet, historinë në përgjithësi, e kuptonte dhe interpretonte në përpunim me interesat e fuqisë së huaj, me të cilën që lidhur.

Urrejtjen e drejtë të mësorëve ndaj synimeve të shovinistëve sillavë, Fishta u mundua ta kthejë në një faktor që i

lidhte ata fatalisht me vende të tjera, duke harruar se shqiptarët në lëvizjen e tyre të Rilindjes kërkonin një Shqipëri më vete dhe për veten e tyre. Romantikët tanë frysmezoreshin nga ky synim dhe luftonin për realizimin e tij. Fishta u doli kundër, sepse nuk besonte tek malësorët e thjeshtë, megjithë zhurmën e vargjeve që u kushtonte trimërisë e burrësisë së tyre; hipokrizia ishte qëndrimi më i natyrshëm për një njeri si ai, klerik në shpirt. Në këngën e fundit të «Lahutës» që mban titullin «Konferenca e Londonit», Fishta tregonte hapur se pavarësinë e Shqipërisë e quante një sajesë të akteve diplomatike të disa fuqive të kohës:

*N'at London, larg n'at dervent,  
Të shtatë Krajlat mbledhë kuvend,  
Me shoshojn tue bisedue,  
S'mbrami ata paskan vendue,  
Shqyptarëve me u dhanë lirin,  
Zojë m'vedi me qitë Shqypnin.*

(Lahuta e Malcís, f. 507)

Në shumë prej këngëve të «Lahutës së Malcís» sjellja e malësorëve përcaktohet në mënyrë vendimtare nga bindjet fetare, qeniet mitologjike dhe ligjet e kanunit që i veshin ata me një tis legjende dhe shtynë në errësirë shkaqet e vërteta të ngjarjeve dhe forcat e tyre lëvizëse. Pa bërë asnjë përpjekje për të pasqyruar jetën e përditshme të malësorëve, duke e konceptuar të lidhur fort me faktorë fantastikë, me zotin, zanat, orët, shtojzavallet, kanunin, të cilat ata i nënshtronë verbërisht, Fishta e çnatyrizon atë jetë, e primitivizon në shpirtin e saj. Ai bën të gjitha përpjekjet për të krijuar iluzionin se malësorët janë të paracaktuar të jetojnë vetëm ashtu, se vitaliteti i tyre nuk mund të shfaqet ndryshe, veçse nëpërmjet ruajtjes së kanunit me këmbënguljen më fanatike.

Të tillë tipare vazhdojnë të shprehen qartë edhe në përbledhjen me novela «Hija e maleve» (1929) të Ernest Koliqit, një tjetër përfaqësues i romantizmit reaksionar në letërsinë e viteve '20-30. Shtojzavallja, që ia mori gojën të dashurit të

saj, malësorit të ri, Lekë Binokut («Nusja e mrekullueshme»), zanat që e bënë Zogën, këtë vajzë shumë të bukur po të nga-thët, të bëhet vetëm për një kohë gjatë vizitës tek Skënderbeu në Krujë, kërcimtare e jashtëzakonshme («Kërcimtarja e Dukagjinit»), orët që parathonë vrasjen rastësore të Lulash Prelës, njërit prej komitetëve që gjurmoheshin nga xhandarmëria («Kur orët lajmërojnë»), dashuritë fatale të Mrikës («Ke tre lisat») dhe Dilocës («Diloca»), kanuni i kthyer në fetish e i konceptuar si faktori më i rendësishëm e më i fuqishëm i vep-rimeve të malësorit («Gjaku», «Miku»), kjo është sipas E. Koliqitjeta e maleve, të cilën ai, përmes një beletristike të rafinuar e ka transfiguruar krejtësisht. Sipas tij, organizimi i jetës në ato vite, ku feja luan një rol përcaktues, është i bukur; ai duhet ruajtur i paprekur, sepse përban të rrënjesura nga shekujt karakteristikat e psikologjisë së shqiptarit, të krijuara larg ndikimeve të qytetërimit. Mjafton vetëm ky pasazh nga novela «Nusja e mrekullueshme» për të treguar thelbin e përfytyrimit të Koliqit mbi «bukurinë» e jetës së malësorëve: «Kumbonza e kumbanores së vogël dha lajmin e mbarimit të meshës. Bashkë me tingllat e qarta të saj, u shpërndanë nëpër ledinë të gjelbër gjint që delshin prej kishet.

*Kupa qiellore përkulej gëzueshëm mbi atë skutë të blerë, trejtë midis maleve. Fryma e flădeve mbushte ajrin me dridhje të freskëta e përhapte një qymë të shëndoshë mendre t'egër e sherbelash.*

*Pataloku para famullis u mbulue me grumbuj Malsorësh e Malsoresh, veshë në petkë festë. Pleqt, me t'ecun të matun e plot madhni, fytyrën e rrëthueme në shalla bardh si bora, kërkuen hijet e lisave dhe u shtruan rrötull me ba kuvend tue pi duhan. Djelmoshat, me kapuçë të leshët në krye, kapën mazzerrët, që sa ngjati mesha kishin ndejë të varuna tu dera e kishës, e kaluen tezoshtë kah logu i shejit. Të gjatë e të zhërvjellët, çakçirët e bardhë me gjatana të zeza e të shëndritshëm, me rrypa fyshekësh, të ngjeshun për bel, tue ecun të lehtë e të shpejtë mbi bar të butë, me armë në dorë, m'u dukshin çetë herojsh e dalun prej ndonji poemi epik. Granija delte prej kiske tue ba kryq papushue e ture puthë medajat e rruzareve. Gratë lëshuen, në heshtit e kullueta, krizmën e zinxhirëve e të parëve t'argjenta, që kishin të varuna në fyt, edhe tingllimin e zaneve të holla. Vajzat me nuse të reja iu afroen dalkadalë logut të shejit ku djelmoshat preqatiteshin me dhanë provën e mjeshtrisë së tyre (Hija e maleve fq. 9, 10). Duke e veshun me të tilla ngjyra atë jetë Koliqi, plotësisht i ndërgjegjshëm, mbante qëndrime të hapta regressive; sipas tij, çdo përpjekje*

për ta ndryshuar sadopak mënyrën e ekzistencës së malësorëve, nuk pajtohej me natyrën e tyre, do të kundërshtohej e luftohet instinktivisht. Për E. Koliqin malësorët e kanë gjetur me kohë veten, ata mund të jetojnë vetëm në një botë gjysmefantastike, të drejtuar nga forca mitologjike ose mendësi qakanunore. Në asnjë nga novelat e përbledhjes «Hija e maleve» nuk preken problemet e mëdha ekonomiko-shoqërore të fshatrave të Veriut; varfëria e tmerrshme, padituria e thellë, shtypja e egër dhe kontradiktat sociale, të gjitha këto janë fshehur pas një bukurie të paqenë, burimi i së cilës, sipas Koliqit, duhet kërkuar në konservatorizmin e jetës së malësorëve, të cilën ai e konsideron si vëçori të «racës shqiptare». Tëk një ekzotikë krejtësisht iluzore, që përshtkon tej e ndanë novelat e tij, Koliqi ka gjetur mënyrën e parapëlqyer për të krijuar një botë që, sipas tij, i shkonte për shtat psikologjisë së malësorit, një botë, e cila me primitivizmin e saj kultivon fisni-kërinë e shpirtit, ruan të pacenuara vlerat morale. Konfliktet e novelave të tij nuk kanë asnjë taban social, ato barten thaujse gjithnjë nga të rinitë e dashuruar, ndjenja e të cilëve «bie ndesh» me ligjet e kanunit («Ka tre lisat», «Dilocaa», «Si qofsh, pleqnofsh», etj). Natyrisht në qoftë se donte të ruante lustrën e intelektualit, Koliqi do të gjente një anë të kanunit që do ta quante të dëmshme. Frvma me të cilën ai «kritikon» gjakmarrien, tregon qartë thelbin e pikëpamjeve të tij fataliste për këtë çështje. Doda, te novela «Gjaku», intelektual me origjinë malësore, pas shumë lëkundjesh, hakmerret për të vëllanë, respektion bra psikologjinë e gjithë të afërmve, i nënshtrohet «thirrjes» së gjakut të vet: «Në thellsi të pandërgjegjes, aty ku flejnë prirjet e rrezikshme dhe mendimet e përzanuna prej arsyes, nji instikt nisi m'u zgjue e m'u ngjit kah drita e kuptimit në gjasë të nji gjarpri të nëndershëm.» (Hija e maleve f. 50). Sipas Koliqit, hakmarria është dukuri që ka të bëjë me subkoshiençën, është një tipar i domosdoshëm i psikologjisë së shqiptarit. E keqja e kësaj pikëpamjeje nuk është vetëm mënjanimi i plotë i faktorëve historiko-socialë që bënин të mundur gjakmarrien, nuk është pra vetëm karakteri i saj thellësisht idealist; ajo përmban në mënyrë mjaft të qartë përbuzjen më therëse ndaj malësorëve, trajtimin e tyre si njerëz që jetojnë, veprojnë dhe vdesin sipas ligjesh të trashëguara brez pas brezi, që kanë në themel irrationalen, instinktin, egërsinë, si njerëz që janë armiq. të qytetërimit.

Qëndrimet që mban E. Koliqi ndaj malësorëve janë tipike për një intelektual borgjez, që i druhet shumë popullit, që,

përmes një fasadë «dashamirësie» e «përpjekjesh qytetëruese», synon ta mbajë atë në errësirë të plotë.

Nusha, shtëpia e saj që do ndreçur, martesa, kjo është bota që ëndërron Doda, këto janë për të qytetërimi, të cilin ai e përfytyron si «... *Lidhsa tē forta qì e sigurojnë anin pér breg, larg valavitjes së rreptë tē nji deti tē furishém.* ...» («Hija e maleve», fq. 50), si një strehë, pra, e cila nuk do të lejonte t'i shkatërronin lumturinë instinktet e gjakut të turmës, që ai, duke qenë bir malësori, i përbante diku në subkoshiençë. Qytetërimi, të cilin Koliqi përpinqet t'ia kundërvejë botës shqiptare, është për të privilegj i një shtrese të caktuar shoqërore, intelektualëve, të cilët nuk mund ta ruajnë atë veçse duke jetuar të shkëputur nga populli. Prandaj edhe në shumë nga tregimet e vëllimit «Tregtar flamujsh» Koliqi merret me përsiatjet shpirtërore të pinjollëve të borgjezisë shkodrane, që përpinqen të gjejnë ç'është lumturia («Lumnija»), të filofojnë mbi shkurtësinë e jetës («A t'a laçe...»), zbulojnë papritun hijeshinë fizike e shpirtërore të një vajze («Bylbylat e Plepitshit»), humbasin pas kujtimeve të fëmijërisë dhe përjetimeve të shkaktuara prej tyre («Kumbulla përtej murit», «Hanë gjaku»), jepen fort pas thashethemive («Nji ngjarje në rrugacën Kezenaj») etj. Këto janë pak a shumë shqetësimet e jetës shpirtërore të personazheve të përbledhjes «Tregtar flamujsh», një jetë e ngushtë interesash të vogla, egoiste.

Proza e Koliqit, e vënë përballë krijimtarisë së Migjenit, N. Bulkës dhe shkrimitarëve të tierë përparimtarë, është mjaft shprehëse për të treguar sa i thellë ishte diferençimi midis krijimtarisë përparimtare revolucionare që po ecte në rrugën e realizmit, nga njëra anë, dhe nga ana tjeter, letërsisë konformiste krejt të huaj ndaj problemeve të mëdha politiko-shoqërore, që krijonite një botë romantizante, që pasqyronte pikëpamje thellësish idealiste, pajtimin e plotë me realitetin politik të kohës, kundërshtimin ndaj prirjeve përparimitare të zhvillimit shqëror shqiptar, në emër të «paqes shoqërore», të «qytetërimit të ngadalte» që do të vinte nga perëndimi.

Të tilla pozita ishin të pritura e të natyrshme për mendësinë e disa shtresave të inteligençjes borgjeze, të cilat në reçjimin zogist kishin pranuar hegemoninë e feudalizmit, ëndërronin dhe përpinqeshin të ruanin statukuonë shoqërore në çdo mënyrë, edhe duke përfunduar më pas në prehrin e fashizmit, siç përfundoi E. Koliqi.

## **DUKURI KLASICISTE**

Disa herë në punimet tona historiko-letrare për veprën e disa autorëve të letërsisë arbëreshe dhe të ndonjë shkrimtarë tjetër është folur për ndikime nga letërsia klasiciste. Studiuesit nuk janë zgjatur shumë me arsyetime të hollësishme për to; ata kanë dhënë disa konsiderata, por pa i shoqëruar me argumehte të plota. Prandaj ato mbeten të diskutueshme, çështje të hapura, të cilat edhe po të shpihen më tej e të zgjidhën përfundimisht, përsëri do të mbeten anësore, të atilla, që, në fund të fundit, nuk prekin e nuk lëkundin aspak përfundimet mbi drejtimin themelor të ndjekur në krijimtarinë e atij apo këtij shkrimtari. Megjithatë ka disa vepra si «**Burri i dheut**» e Çajupit, «**Vdekja e Pirros**» e Gramenos, tragjeditë e Ethen Haxhiademit, që tregojnë fare shkoqur se letërsia klasiciste jo vetëm që njihej, po edhe shihej si një shembull prej nga mund të mësohej arti i krijimit letrar.

Siq dihet, në parathënien e dorëshkrimit të tragjedisë

«Burri i dheut», Çajupi shënon: «**Nuk fshihem prapa gishtit, fillin e kësaj vepre e mora nga vjershëtar i madh Frantzes P. Corneille**». Ky pohim i autorit i bën të pavlefshme shqyrtimet e hollësishme që do të zbulonin tiparet klasiciste të kësaj tragjedie, të cilat vihen re fare shpejt. Mëdyshjet shkatërruese ku kalojnë personazhet kryesore të veprës, ndjenjat e thella të dashurisë që vihen në prova të rënda për shkak angazhimesh më të mëdha atdhetare e morale, intrigat për të realizuar synimet drejt pushtetit mbretëror, qëndresa ndaj tyre dhe triumi i virtytit, në kuptimin më të gjërë të kësaj fjale, këto janë përgjithësisht tiparet kryesore të tragjedisë së Çajupit, e cila edhe nga pikëpamja e formës ka ndjekur krijimet klasiciste, me unitetin e tri njësive, ndërtimin me pesë akte («punë» siç i quan poeti), ku dallohen sidomos prologu dhe eksodi etj. Sigurisht, «**Burri i dheut**» nuk është ndër veprat më të arrira të krijimtarisë së Çajupit. Me sa duket, ajo ka qenë vetëm një përpjekje, një ushtrim jo nga më dorëmbarët, që nisej më shumë nga dëshira për ta zhvilluar edhe këtë lloj dramaturgjik. Për shkak të kulturës me të cilën qe formuar, Çajupi shihte tek tragjedianët klasicistë mjeshtrit e shquar të këtij lloji. Po prerja e Çajupit si krijues ishtë e një natyre tjetër, ajo nuk përbante të dhëna për të përballuar kërkесat e tragjedisë; ndërkaq mungesa e tyre nuk cenon aspak vlerën dhe vendin e tij në historinë e letërsisë sonë.

Kështu ka ndodhur pak a shumë edhe me tragjedinë «**Vdekja e Pirros**» të Gramenos, ku gjithashtu janë vëreitur ndikime të klasicizmit. Disa episode të subjektit (lutjet aë mbretëresha i drejton Pirros që ta merrte me vete në luftë për ta ruajtur nga e keqja, të cilën ia parathotë ëndrra. tundimi i saj për t'i dhënë fund jetës pas vdekjes së të shqot dhe mposhtja e tij në emër të interesave të atdheut), tivaret e karakterit të mbretëreshës, si dhe gjuha e personazheve, sigurisht flasin nër të tilla ndikime. Po filli i zhvillimit dramatik të kësaj vepre është predestinacioni i njohur i tragjedisë antike (ëndrra e mbretëreshës, fjalët e plakës, fatdëftenjës, siç e quan autori, e cila njofton mbretëreshën për vdekjen e Pirros, ndërhyrjet e perëndive, një varg arsyetimesh të Glavhos përfuqinë e fatit etj.).

Një shqyrtim tërësor i vlerave të tragjedisë «**Vdekja e Pirros**» e bën krejt të qartë se synimi kryesor i M. Gramenos ka qenë që edhe nëpërmjet gjinisë dramatike të shprehte mendimin atdhetar të viteve të Rilindjes. Pa përvojë në fu-shën e krijimit të veprave të kësaj gjinnie, Gramenoja iu drej-

tua modeleve të letërsisë botërore, antike e më të reja, po pa qenë në gjendje të realizonte nivele të spikatura artistike.

Ndërkaq, një tjetër shkrimtar Ethem Haxhiademi, në tragjeditë e tij, imitoi me këmbëngulje dramën klasiciste.

Subjektet e veprave ai i mori që të gjitha nga historia e lashtë («Pirrua», «Aleksandri»), nga mesjeta (Skënderbeu), nga mitologjia antike («Akili», «Diomedi», «Ulisi») dhe ajo biblike («Abeli»). Ashtu si në tragjeditë klasiciste, subjektet e E. Haxhiademit hedhin në balancë interesa të mëdha personazhesh të mëdhenj, mbretër e mbretëresha, komandantë ushtarakë, princër e princesha udhëheqës të njojur, që në veprimet e tyre nxiten nga pasioni i fuqishëm i pushtetit suprem, pasion që bëhet shkak i humbjes së tyre tragjike. Nën forcën e tij të papërballueshme veprojnë Zanfina, Hamzai e përmjet një kohë edhe Moisiu tek «Skënderbeu», Atali tek «Aleksandri» etj. Veprimet e tyre kanë të bëjnë me fatet e shtetit, të mbretërisë, në to sigurisht implikohen edhe pasione të tjera si dashuria, hakmarrja (dashuria e Filipit përmjet Kleopatrën në tragjedinë «Aleksandri»), ajo e Akilit përmjet Poliksenin, të bijën e Priamit, tek «Akili», etja e Priamit përmjet t'u hakmarrë ndaj Akilit, e Olimpiadës ndaj Filipit dhe gruas së dytë të tij, Kleopatras (etj.), po të gjitha këto nuk bëjnë gjë tjetër, veçse plotësojnë veprimin kryesor, mbrojtjen e sundimit mbretëror e të trashëgimit të ligjshëm të tij. Prandaj të gjitha intrigat vërtiten rrëth një konflikti kryesor, rrëth një përplasjeje interesash të kundërtta. Subjektet dhe zgjidhjet e tragjedive gjithnjë synojnë të transmetojnë përfjetimin e patetikes, nëpërmjet luftës kundër pasioneve, e përpjekjeve përmjet spastrimin e tyre (catharsis), nëpërmjet triumfit të drejtëpërdrejtë fizik ose moral të së mirës e të së drejtës. Moralizimet janë fare të dukshme në tragjeditë e Haxhiademit; në parathëni e ndonjërsë prej tyre («Abeli»), ato janë shpallur si qëllim i veprës. Në përgjithësi Haxhiademi, në tërë krijimtarinë e tij, është përpjekur të realizojë parimin e njojur esetik të klasicistëve: të mësojë, të edukojë nëpërmjet së pëlqyeshmes, që vjen nga himnizimi i virtutit në luftën kundër vesit. Po ashtu, në painit me frysmin klasiciste, subjektet e veprave të tij përpilen gjithnjë të janë të jashtëzakonshme, tepër të shndritshme, larg shqetësimeve të jetës së përditshme, të cilat klasicistët nuk i quanin të denja të pasqyroheshin artistikisht. Tragjeditë e Haxhiademit janë ato të një moralisti që kërkon të ngulisë bindjen se i duhet besuar vetëm një dogme, autoritetit sùprem të zotit, mbretërisë dhe ligjeve etike që rrjedhin prej

tyre. Nënshtimi pa kushte ndaj këtij autoriteti është për të rrugë e vetme e formimit të njeriut të vërtetë, që udhëhiqet në veprimet e tij nga «arsyeja e shëndoshë». Antagonistët e tragjedive të E. Haxhiademit lakmojnë pushtetin mbretëror, që mbrohet me të gjitha mënyrat nga protagonistët e tyre, të cilët edhe në u vrafshin, janë viktima të rrethanave që krijohen pavarësisht prej tyre. Në këto raste Haxhiademi bën kujdes që megjithatë pushteti mbretëror të kalojë në duart e trashëgimtarëve të «ligjshëm». Kështu, pasi vritet Filipi, froni i Maqedonisë i kalon birit të tij Aleksandrit. Luhatjet, mëdyshtjet, kapërceheni shpejt prej personazheve të tragjedive të Haxhiademit. Skënderbeu vërtet dyshon në drejtësinë e gjykimeve të Donikës për sjelljen e Hamzait, Filipi gjithashtu nuk i beson menjëherë shpifjes së Gelonit se Aleksandri është bir ilegjitim i Olimpiadës dhe Pausanit, po sidqoftë, ata nuk vuajnë shumë për t'i flakur lëkundjet, për të vënë në vend të drejtën ose përkundrazi, për të shpënë gjer në fund pasojat tragjike të mashtimit të pësuar nga intrigat e të tjerëve. Fittimtarë ose përkundrazi të mundur, ata s'ndalen përpara asnje lloj intrige për të realizuar dëshirat që kanë. Olimpiada në urrejtjen kundër Filipit është e verbër, me egërsi ajo vret shemrën e saj, Kleopatrën shtatzënë; Pirroja vret në shtëpinë e tij Neoptolemin rival dhe mikun e tij, Gelonin; Priami shfrytëzon ndjenjën e vajzës, Poliksenës, për të zhdukur të dashurin e saj Akilin etj.

Duke imituar në çdo anë tragjeditë klasiciste, Haxhiademi përpinqet që në veprat e tij të pasqyrojnë edhe ndjenjat e tjera, dashurinë, dhemshurinë prindërore, vrullin shpirtëror, fisionikérinë, gjithnjë nën sundimin e arsyes, të vetmes forcë që mbron e shpie në vend virthytin, të drejtën.

Në disa nga tragjeditë e tij, Haxhiademi ka synuar të realizojë parimin e njohur klasicist, sipas të cilit njeriu nuk është kurrë as krejt i mirë e as i keq deri në fund. Pas një gabimi e dobësie ai pëson rrjedhoja të rënda që s'varen më prej tij e që në përgjithësi nuk i meriton gjer në fund. Akili, trimi i pashoq, në tragjedinë homonime, bie viktimë jo vetëm i urrejtjes së drejtë të Priamit, po edhe për shkak të dobësisë së tij për Poliksenën, të bijën e Priamit; Filipi po ashtu verbohet nga dashuria për Kleopatrën, bëhet pre e Gelonit dhe kërkon të vrasë të shoqen dhe të birin.

Studiuësi e ka të vështirë të vazhdojë gjatë analizën e tragjedive të E. Haxhiademit, pa përsëritur veten, sepse brenëria e tyre është përgjithësisht e varfër dhe subjektet janë të ngjashme. Edhe shqyrtimi i formës së veprave të tij zbulon

qartë imitimet; të gjitha tragjeditë ai i ndërton me pesë akte, ndër të cilët i pari, prologu, njeh pak a shumë me interesat që do të nxisin heronjtë në veprimet e tyre të mëtejshme, të cilat zhvillohen pastaj në episodin, në aktet II, III dhe IV. Eksodi, akti V, mbylljet duke përcaktuar deri në fund fatet e personazheve. Ngjarjet kryesore të tragjedive të Haxhiademit, ashtu si në tragjedinë klasiste zhvillohen shpejt, brenda një kohe të shkurtër, përgjithësisht brenda një dite, më shumë në një vend e më rrallë në dy-tri vende, që gjithsesi nuk përshkruhen, po merren vesh nga fjalët e personazheve. Prezantimet, inskenimet, mungojnë krejt, tregohet vetëm vendi ku ndodhin ngjarjet, shumë veprime të të cilave kryhen pas perdes. Pothuajse në të gjitha veprat e Haxhiademit bie menjëherë në sy përpjekja për të realizuar një kërkesë themelore të krijimit klasicist, preciozitetin. Në sjelljet e personazheve, në zakonet, në disa nga tiparet e tyre morale, sidomos në krenarinë që është e barabartë me admirimin e vvetvetes dhe në mënyrën e të folurit vihet re gjithnjë një lloj aristokratizmi; shkrimitar tepër mediokër, Haxhiademi mbeti gjithnjë artificial në vargjet e tij dhe natyra klasikegjante e veprës që kérkoi, zbulohet fare mirë edhe te dialogu i ndërtuar me një gjuhë të pazakontë, të zhurmshme, me konstrukte sintaksore të ndërlikuara.

Të nisur nga mendimi se antikiteti realizoi modele të përsosura në dramaturgji, klasicistët merrnin shpesh subjektet e teknikat nga tragjedianët e atyre kohërave. (Studiuesit kanë vënë në dukje se Rasini parapëlqente Euripidin, La Fontenit Ezopin etj). Edhe në këtë aspekt vepra e Haxhiademit do t'i ngjajë klasicizmit. Tragjedia «Ulisi» është ngritur mbi pohimin e forcës fatale të predestinatës. Me èndrrën e Penelopës e fjalët e orakullit të tempullit të Minervës, në tragjedi paralajmërohet fundi i dhimbshëm i Ulisit, që vritet me vullnetin e perëndive nga djali që ai kish me nimfën Circe, Telegoni.

Ethem Haxhiademi është, pa dyshim, një epigon i tragjedisë klasiste. Sidoqoftë në jetën kulturore të viteve '20-'30 dramaturgjia e tij përbën një fakt letrar, që megjithatë kërkon shpjegimin e vet. C'nevojë kishin anë të veçanta të asaj jete për një vepër me përbajtje të tillë? C'arsye e bënë të mundur? Sigurisht prirjet subjektive të shkrimitarit luajnë në këtë mes një rol të dorës së parë, po gjithsesi jo përcaktues. Shumica e veprave të Haxhiademit u krijuan dhe u botuan gjatë monarkisë zogiste, e cila u përhoq të krijonte iluzionin se

mbretëria ishte forma shtetërore më e përparuar që i duhej Shqipërisë. Por po ashtu si monarkia e Zogut nuk ishte gjë tjetër veçse një karikaturë e absolutizmit, i cili, siç dihet, në ndonjë vend si Franca ka qenë për një kohë dukuri progressive, edhe vepra e E. Haxhiademit ishte karikaturë e tragjedisë së famshme klasiciste. Në térësinë e zhvillimeve letrare të atyre viteve ajo ishte një anakronizëm krejtësisht i pajustifikuar, siç qe anakronik rendi monarkik i Zogut.

Klasicistët francezë, në një pikëpamje, kishin arsyet e shihnin tek autoriteti mbretëror një forcë përparimtare dhe, nëpërmjet konfliktit të njojur midis detyrës e ndjenjës, t'i mbaheshin në krijimtari idësë se monarkia është tjetërsimi i arsysë format shtetërore. Sigurisht, edhe nga pikëpamja historiko-letrare klasicizmi francez, megjithë postulatet e tij, përbënte një hap të rëndësishëm në zhvillimin e letërsisë. Nuk është vendi të zgjatemi mbi të, këtu do theksuar se veprat e E. Haxhiademit janë tepër larg shembujve që kanë ndjekur; lloji dramatik që ai zgjodhi e mori përsipër, nuk përballohej dot nga aftësitë e tij shumë të kufizuara. Personazhe shumë skematike, konflikte të stisura që precipitojnë shpejt, varfëria e madhe e vëzhgimit psikologjik, një gjuhë që shpeshherë bëhet qesharake në përpjekjet e saj për të qenë e zgjedhur dhe e rafinuar, vargëzimet e pafundme, këto e të tjera si këto janë tipare të shkrimeve të E. Haxhiademit, me të cilat nuk mund të ndodhë ndryshe jo vetëm për arsyet e mediokrititetit të shkrimitarit, po në radhë të parë për shkak të angazhimit politik që ai mbajti. Të ishe apologjet i rendit që përfaqësohej nga «shakaxhiu i përparimit», i atij rendi që e mbante në fuqi një klasë thellësisht reaksionare siç qe feudalisti, i përkrahur nga një borgjezi e mefshtë, donte të thoshte, në thelb, të mbëteshe pas kohës dhe në krijimtari të mbartje të gjitha pasojat që rrjedhin prej kësaj prapambetje. Ç'probleme qëndronin para shoqërisë shqiptare në ato vite dhe ç'tema trajtonin tragjeditë e E. Haxhiademit, ky ballafaqim do të mjaftonte për të arritur në përfundime të shpejta e fare të sakta mbi konformizmin e tyre të thellë. Haxhiademi prandaj dhe u prir nga klasicizmi, se gjente atje një nuancë të prekshme konformiste. Po penat që e kultivuan tragjedinë klasiciste ishin të shquara dhe e kapërcenin, në një farë shkalle, këtë dobësi të qëndrimeve politike, ideologjike e estetike nga niseshin. E. Haxhiademi përkundrazi, mbeti një

imitues diletant, që njoihu disa rregulla të ndërtimit të asaj tragjedie dhe ia hyri një pune që kurrsesi nuk e mbanin shpatullat e tij. Goditja më e rëndë që u jep koha shkrimtarëve të tillë është harrimi i plotë. Këtë fat patën shkrimet e Haxhiademit, të cilat nuk lanë as më të voglën gjurmë në historinë e letërsisë sonë.

## **SENTIMENTALIZMI NË HISTORINË E LETËRSISË SHQIPE**

Për tipare sentimentaliste studiuesit tanë kanë bërë fjalë edhe kur janë marrë me vepra të Jeronim De Radës, Santorit e Naimit, po pa u ndalur në mënyrë të hollësishme e pa e ndier të domosdoshme të hyjnë në arsyetime mbi shkaqet e shfaqjes së tyre. Po në një grup krijimesh të viteve të fundit të Rilindjes dhe të periudhës që pasoi, në «romancat» e Ndoc Nikajt, novelat e Mihal Gramenos, tregimet e Kolë Mirditës Nikajt, romanet e Foqion Postolit e të Haki Stërmillit, (Helenaut), atyre u kanë tërhequr vëmendje disa nga tregimet e S. Spases, atyre u kanë natyrës sentimentaliste, të veçantë shumë karakteristika të natyrës sentimentaliste, të cilat herë i kanë quajtur vetëm si dukuri të shkëputura e herë i kanë parë si përbërës të frymës së përgjithshme të

tyre<sup>1</sup>. Disa anë të brendisë së këtyre veprave e kujtojnë kaq lehtë sentimentalizmin, sa lejojnë të shtrohet çështje: letërsia shqipe në zhvillimin e vet historik a e ka njohur edhe drejtimin sentimental? Që të afrohesh sa më pranë zgjidhjes së drejtë të kësaj çështjeje, puna e do të analizohen më thellë karakteristikat themelore të përbajtjes së vepgrave në fjalë për të gjykuar nëse janë në thelb sentimentaliste. Në rast se ato janë krijime të tilla, më pas, është e domosdoshme të shihet nëse arrijnë të krijojnë një dukuri të qëndrueshme, e cila, edhe në mos qoftë përcaktuese në letërsinë e kohës, mbetet sidoqoftë e dallueshme në mënyrë pak a shumë të qartë. Dhe, së fundi, po të argumentohet se letërsia shqipe u zhvillua në ato vite edhe në një rrugë sentimentaliste, do një përgjigje pyetja tjetër; përsë sentimentalizmi u shfaq në historinë e letërsisë sonë si një dukuri pasromantike në ndryshim të hapët nga sentimentalizmi i letërsisë evropiane që përgatiti romantizmin dhe, pikërisht për këtë arsy, nga disa studiues është quajtur preromantizëm? Vetëm pasi të jenë sqaruar çështjet që sapo shtruam, problemi i sentimentalizmit në letërsinë shqipe mund të marrë një zgjidhje gjithsesi të kënaqshme.



Tek studiohet vepra e këtij grupei shkrimitarësh, bie në sy fare lehtë se subjektet e tyre përgjithësisht janë ngritur rrëth ndjenjës së dashurisë. Për triumfin e saj veprojnë heronjtë që përpiken të përballojnë pengesa të natyrave të ndryshme, shoqërore ekonomike, etiko-psikologjike, koïncidenca fatale etj. Në të shumtën e vepgrave këto pengesa janë tepër të fuqishme, krejt të pakapërcyeshme dhe u lënë plagë të rënda heronjve. Të gjithë ata i qëndrojnë besnikë thirrjes së zemrës së tyre të dashuruar, e cila nuk merr parasysh asnjë

1) Shih: I. Kastrati, *Kolë Mirdita (Helenau)*, 1900-1906, parathënie e botimit të vëllimit «Trëndafila që s'çelin për ne», Tiranë, 1959, faqe 8; N. Jorgaqi — R. Hysa, *Parathënie* e botimit të veprës letrare të H. Stërmillit, Tiranë 1982, fq. 24, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1983, fq. 116, 447, 535, 539; R. Qosja në «*Historia e letërsisë shqipe, Roman-tizmi*», v. II, Prishtinë, 1984, f. 348 shpreh pikëpamjen se romani «Bardha e Temalit» e P. Vasës gërshteton prirje romantike dhe sentimentaliste.

lloj qëndrimi «të arsyeshëm», që do t'ua diktonte prejardhja e rrethanat e tjera shoqërore e zakonore. Thënia e njohur «zëmra nuk urdhërohet dot» është për ta thellësisht njerëzore e fiskikëruese, gjithnjë e drejtë. Prandaj nëpërkëmbja e pamëshirshme e kësaj të drejte nga mjediset ku jetojnë është shpesh herë shkaku kryesor i vuajtjeve të tyre të shumta. Heronjtë e Gramenos e të Stërmillit s'mund të jetojnë ndryshe: kur humbasin dashurinë, humbasin gjithçka, jeta u bëhet e padurueshme, vdekja u vjen si fund logjik i tragedisë, e cila u ka goditur të vetmen përbajtje që ata i kanë dhënë jetës së tyre. Kështu vdesin Marga dhe Miti, Afërdita dhe Thana te novelat «E puthura» dhe «Varri i pagëzimit» të M. Gramenos, kështu vdes Dija te romani «Sikur t'isha djale» i Haki Stërmillit. Në këto e të tjera vepra të F. Postolit e Helenaut ndjenja, në një pikëpamje, është kthyer në virtut; ajo i bën bartësit e saj të janë njerëz të mirë, shumë të dhembshur ndaj fatkeqësive të të tjerëve. Gramenoja në sjelljet e veprimet e heronjve të tij niset gjithnjë nga mendimi, se një njeri që dashuron, që jeton pra ndjenjën më të thellë, nuk mund të jetë kurrë i keq; nëpërmjet dashurisë heronjtë e tij janë gjithnjë të pastër moralisht, nga qenia e tyre nuk buron veçse dashamirësia ndaj të tjerëve, që shkon gjer në vetëmohim për ta. Dramat e rënda që përjetojnë heronjtë e novelave të Gramenos nuk e përthajnë shpirtin e tyre, nuk e bëjnë atë të vrazhdë. Si i vënë zemrës një gur, në qoftë se nuk vdesin si Miti, ata i shërbijnë së mirës dhe jetojnë vetëm pér hir të saj. Qëllimi i vetëm që u mbetet në jetë është të bëjnë mirë, gjithnjë të nxitur nga kujtimi i dashurisë së humbur. Rrugët që ndjekin janë të ndryshme. Maloja vepron gjallërisht në mbrojtje të së drejtës, kurse Thana tërhiqet e jeton i vemuar pér të ndihmuar fatkeqët sa herë i jepet rasti. I pari afrohet kështu më tepër me heronjtë romantikë, ndërsa i dyti është më pranë heronjve sentimentalë, që në përgjithësi s'janë në gjendje t'u kundërvihen me forcë e të kundërshtojnë të këqijat që u vijnë herë nga egoizmi e poshtërsia e të tjerëve (Thana) dhe herë nga gabimet fatale që mund të kenë bërë në jetë (Miti). Heronjtë e Gramenos nuk pajtohen me të keqen, aq më pak ndryshojnë karakterin e tyre nën veprimin e saj, po ndërkohë, në të shumtën e rasteve, janë krejt të pafuqishëm ndaj shkaktarëve që u sjellin kaq fatkeqësi. Kështu ndodh pak a shumë edhe me heronjtë e Helenaut, tek i cili është më e ndjeshme kritika ndaj jetës zakonore të kohës. Tek «Oxhaku» dhe «Lulja e kujtimit», ku janë fare të dukshme

Jundet e lumtura, dashuria triumfon për hir të fateve të mira  
të heronjve pas të cilëve qëndron zoti, që gjithnjë dënnon të  
keqen dhe ndihmon të mirën.

Në romanin e Haki Stërmillit, përkundrazi, heronjtë bëjnë  
ç'është e mundur e ç'kanë në dorë për triumfin e ndjenjës së  
tyre. Nëse Dija nuk arrin të fitojë, kjo vjen nga shkaqe që  
s'varen prej saj: rrëthanave të rënda etiko-sociale ajo s'u bën  
dot ballë e vetme, edhe pse kuptohet jo vetëm nga Shpendi,  
po edhe nga dajë Haxhiu e nga Irena.

Jashtëzakonisht të ndjeshëm, heronjtë e Gramenos, të  
Helenaut, Dija te «Sikur t'isha djalë», kanë te lotët reagimin  
më të rëndomtë ndaj ndjenjave që provojnë. Edhe kur vuajnë  
nga fatkeqësitetë më të mëdha, edhe kur shprehin dashurinë,  
edhe kur gëzohen, ata qajnë vazhdimisht. Lotët janë shprehja  
më e qartë, e menjëherëshme e ndjeshmërisë së tyre. Sidomos  
heronjtë e Helenaut, që është ndoshta shkrimtari tipik senti-  
mentalist i letërsisë sonë të atyre viteve, lotojnë për shumë  
shkaqe: nga entuziazmi për lirinë e atdheut, nga hidhërimi  
për humbjet e të afërmve të familjes, nga hovet dhe dhimbjet  
e dashurisë. Në pergjithësi, ajo që sundon në jetën e heronjve  
të veprave të Helenaut e të të tjereve është humbja, trishtimi,  
dëshpërimi. Një jetë e tillë ka qenë karakteristike për heronjtë  
e sentimentalizmit ne pergjithësi, ne të ka zenë fill i ashtu-  
quajturi «pikëllim botëror» që u ndoq më pas prej romanti-  
këve. Dashuri të paracaktuara të dështojnë, vuajtje të panu-  
mërtë për shkak të saj, një jetë e mbushur me hidhërimë,  
nëpër një fat të tillë kalojnë Luigji e Luçi të tregimit «Bur-  
buqet e trëndafilat» të Helenaut, Miti dhe Marga të novelës  
«E puthura»; Thana dhe Afërdita, të novelës tjetër të Grameno-  
s «Varri i pagëzimit», Dija e romanit «Sikur t'isha djalë»  
etj. Heronjtë e këtyre veprave janë thellësishët të pasionuar,  
po pikërisht për kete arsyen janë po ashtu thellësishët të trish-  
tuar. Besnikë gjer në vetëmohim ndaj pasionit të tyre, pro-  
vojnë t'u bëjnë ballë të keqijave që u sjellin të tjerët në  
mënyre të ndërgjegjshme ose jo. Qëndresa e tyre si: ndodh  
me Dijen, është nganjëherë vepruese, po megjithatë rrëthanat  
fatale i shpien në shkatërrimin përfundimtar të ëndrrës që i  
mban gjallë.

Ricardsoni, një nga më të shqarrit shkrimtarë sentimen-  
talistë, thoshte: «Një shpirë i ndjeshëm është një e mirë që  
u kushton shumë atyre që e kanë». Ai ka formuluar kështu  
një nga karakteristikat thelbësore të veprave sentimentale,  
që është fort e gjallë edhe në krijimet e Gramenos, Postolit,

Helenaut, Stërmillit. Dija ngaqë ishte kaq e ndjeshme d'he dashuronte aq shumë, vetëm vuajti në jetën e saj të shkurtër; Thana i novelës «Varri i pagëzimit» të Gramenos kaloi jetën e eremitit, sepse nuk mund të shkakte mbi ndjenjën e tij; Leci i Helenaut gjeti ngushëllim vetëm në luftën për lirinë e atdheut, ku priste vdekjen, së cilës donte t'i jepte një kuptim të lartë.

Në letërsinë sentimentaliste evropiane pati një prirje të vecantë për të poetizuar natën, varret, për të parë te ato motive nga më të rëndësishmet, burimet kryesore të frymëzimit. Në veprën e Jungut, Greit e ndonjë shkrimitari tjetër kjo prirje ishte mjaft e përhapur, ashtu siç qe e tillë edhe tërheqja pas pafundësisë, amshimit, një nga shqetësimet më të fuqishme të sentimentalisteve. Të tilla dukuri nuk janë të përhapura në letërsinë tonë; nëse vdekja shpeshherë rrëmbejn heronjtë në moshë fare të re, kjo nuk ndodh për shkak të ndonjë qëndrimi të caktuar filozofik të autorëve të saj. Me forcën e saj shkaterruese vdekja në veprat e Gramenos, Helenaut me shokë, shërben herë për t'u kujtuar personazheve të tjera se c'njerëz të rrallë ishin të rinjtë që humbën jetën e tyre, herë si peng pendese për shkaktarët e shkaterrimit të dashruarve.

Dashuria, që sigurisht është ndjenja më marramendëse e më e thellë, ne peripécie e saj të panumërtë, edhe në rastet kur nuk arrin të realizohet, asnjéherë nuk është vetëm. Të dashruarve do t'u gjenden gjithnjë njerëz të afërt, që më dashamirësinë e tyre të singertë do t'i ndihmojnë e përkrahin: Maloja ka pranë Rustemin që sakrifikohet për miqësinë e tij të shenjtë; Dijen, veç dajallarëve, e ndihmojnë Irena dhe prindërit e saj; Olimbisë i gjendron vazhdimisht afër taja e saj... Ishte e natyrshme për këta shkrimitarë, ashtu si në përgjithësi për sentimentalistët, që ndërsa e konceptionin njeriun e vërtetë si mishërim të ndjeshmërisë, të himnizonin të gjitha virtytet, t'i quanin ato si shenjat më të singerta të botës shpirtërore thellësish humane. Prandaj në vepra të tilla ka kaq betime, fjalë të dhëna e të mbaitura deri në fund, përqafime, lotë, një gjuhë shumë emfatike, ku pshëritimet e thella po edhe mallkimet e rënda janë krejt të zakonshme.

Nuk është e vështirë të arrihet në përfundimin se ndjenja, ndjeshmëria (sentimentalité) në veprat që po shqyrtojmë është pare si përbajtja kryesore, madje e vetme në jetën e njerëzve. Në to është e hapët dhe e qartë prirja për të krijuar një moral të ri, të ngritur mbi ndjeshmërinë e thellë, që sigu-

ron mirësinë dhe të gjitha virtytet e tjera. Në veprat e shkrimtarëve tanë nuk bëhen shumë arsyetime mbi natyrën e njeriut, po fryma që sundon në to është e tillë që lë të kuptohet fare qartë se Gramenoja me shokë besonin në mirësinë e njeriut, e cila, siç ngulej këmbë në letërsinë sentimentaliste, nga Rusoi në mënyrë të veçantë, është gjithnjë e mundimshme pér t'u ruajtur e pacënuar.

Vëmendja e veçantë që i kushtojnë ndjenjës, natyrisht, do të kërkonte që këto vepra të qenë më të plota në pëershkrimin e temperamentit të heronjve. Sigurisht, përpjekjet nuk mungojnë, po shpesh ato përfundojnë në ekzaltime, pikërisht në ekzaltime dhe jo në analizën e hollësishme psikologjike të një ane të jetës shpirtërore të personazheve, vetëm të ndjenjës së dashurisë. Ndryshe nga heronjtë e tjerë, Dija, përkundrazi ka një botë më të gjerë, që është vërtet e përcaktuar nga dashuria e thellë pér Shpendin, por duke u nisur prej saj, arrin të shfaqë shqetësimë të tjera, që kanë të bëjnë me fatin e femrës shqiptare në vitet e regjimit mesjetar të Zogut. Pothuajse të gjithë studiuesit kanë qenë të pakënaqur nga shkalla e motivimit artistik të shqetësimeve të Dijes. Ata kanë të drejtë, po në këtë mes është e rëndësishme të vihet në dukje se një krahasim midis heroinës së Haki Stërmillit dhe heronjve të M. Gramenos, të Postolit, po edhe të Helenaut, nxjerr në pah fare shpejt se te romani «Sikur t'isha djalë» proza në letërsinë tonë përparimtare nis të fitojë një përmasë që nuk e kishte njohur më parë, shqyrtimin edhe psikologjik të personazheve. Sigurisht, zbulimi i veçorive të jetës shpirtërore të Dijes, siç është vënë në dukje me kohë, shpeshherë është gërshtuar me meditimet e shkrimtarit, por megjithatë përpjekja është e dukshme, ajo është shenjë e sigurtë, se proza jonë, me kalimin e viteve po përpunonte kërkesa më të larta artistike.

Natyra disi e ngushtë e problemeve të shtruara, kufizimet e botëkuptimit të autorëve, që përcaktonin zgjidhje të paqena e shpesh naïve, më në fund përvuja ende e pamjaftueshme e prozës së kohës, të gjitha këto i pakësuan mundësitë pér përfytyrimin dhe krijimin e heronjve më të plotë, më të pasur në karakteristikat e tyre shpirtërore.

\* \* \*

Një ndër pikat më të dukshme të ndikimit të shkrimtarëve sentimentalistë mbi letërsinë romantike ishte, pa dyshim, afe-

ksioni i thellë ndaj natyrës. Për rolin që ka luajtur natyra në krijimet e romantikëve tanë tashmë është folur. Ai do të vazhdojë të jetë i ndjeshëm në tregimet e Helenaut vëcanërisht, po edhe në romanin «Sikur t'isha djalë», ndërsa në krijimet e Mihal Gramenos e të Fojion Postolit natyra shërbën vetëm për të krijuar në njëfarë mënyre mjedisin. Në këto të fundit pëershkrimit e saj pothuajse nuk kanë asnjë forcë.

Ishte fare e zakontë që heronjtë e Helenaut, kaq fort të ndjeshëm ndaj bukurisë, të tërhiqeshin pas natyrës që vepron mbi ta menjëherë. Vëçoritë e natyrës plotësojnë hijeshinë e vajzës: «Në fytyrë të saj flokët i vezullojshin si fije ari. Hana derdhë rrezet e argjënta ndër fusha e lulishte të fshatit e vjollcat e vogla, strukë e mbështetë njana me tjetrën, kishin ra në gjumë t'ambël. N'ahishte t'afërme bylbylet e kënaqun prej rrezeve t'argjenta e të lmuem prej flladit të këndshëm filluen m'u shkri ndër melodina t'ambla si të dojshin me i këndue kangë gjumi vjollcave të vogla. Kur kanga e bylbylavë meni, mbretroi një qetësi aq e thellë sa m'u ndi voesa tue ra prej hyjve e ndër lulset e trëndafilave të pemëve. Tue i çue sytë prej vjollcave, pashë në terracë të vilës një vashë, bukuria e së cilës m'i ngrehi sytë për vedi e s'më la t'i kullotshë ndër fusha e kodrina...» («Trëndafila që s'celin për ne» f. 67, 68). Karakter tepër sentimental, Kolë Mirdita priret gjithnjë nga shfaqjet delikate të natyrës, të cilat hera-herës është i aftë t'i pëershruajë me plasticitet. Edhe humbjet e mëdha, ai përpigjet t'i japë më shpesh me fishkjen e një luleje se sa nepërmjet dukurish të ashpra të natyrës.

Haki Stërmilli në mënyrë të vazhdueshme shesh te natyra tjetësimin e gjendjes shpirtërore të heroinës së vet. Në ato raste kur objektivisht natyra nuk mund të jetë vecse e bukur e gëzimndjellëse, Stërmilli e vështron atë përmes trishtimit të pafund të heroinës dhe ia heq shkëlqimin, ia zbeh bukurinë: «Erdhi, po, pranvera. Po sivjet më duket sikur nuk është e shkëlqyeshme si herët e tjera, më ngjan sikur nuk e ka sjellë me vete gazin dhe harenë e përhershme» (Vepra letrare I, f. 212). Për pëershkrimin e natyrës Stërmilli e Helenau përdorin më shpesh parallelizmin, ndersa kontrastin e njohin pak. Po edhe parallelizmi është tepër i hapët dhe vetëm në raste të vecanta ruan forcën shprehëse. Megjithatë, më shumë se sa për të treguar mjeshtërinë e tyre në artin e pëershkrimit, Helenau dhe Stërmilli merren me natyrën kryesisht për të gjetur një mënyrë transmetimi të casteve shpirtërore të heronjve. Në përgjithësi të trishtuara, këto caste përkojnë më shumë me

vjeshtën, lulen e vyshkur, pemët e mundura nga era etj.: «Jam ule buzë dritares dhe po shof poshtë, fryn një muran i egër. Vërvhellima e tij e vrazhdë ngjan si jehonë e fyellit të vdekjes së botës... Pemët, lulet dhe gjithë ato që kanë shpirt i kanë zanë ethet dhe po dridhen prej tmerrit të mordjes. Lulet e vyshkura janë përkulë kah toka, e cila duket sikur e ka hapë krahanorin për me i përpimë e me i futë në gji të vet. Pemët janë zhveshë pjesërisht. Ato të pakta zhele që u kanë mbetë, kanë ngjyrë të verdhë; të verdhën dhe të zbehtën e asaj që dergjet në shtratin e vdekjes. Sa fort më ngjasin mue....» (H. Stërmilli, Vepra letrare, I, f. 199).

Helanau e Stërmilli e trajtuan natyrën vetëm si konkretizm asociativ i gjendjes shpirtërore të heronjeve, më tej nuk shtyhen. Natyra, si vendi i vetëm që mund t'u krijojë mundësinë e shkëputjes nga bota e shqetësuar, si e vetmja konfidente që arrin të kuptojë hallet e shpirtit të heronjeve, si i vetmi mjedis që nuk është prekur ende nga të këqijat e qytetërimit, të gjitha këto nuk ndihen fare në veprën e shkrimitarëve që po shqyrtojmë. Nga kjo pikëpamje romantiket tanë, me vendin shumë të gjerë që i dhanë natyrës në veprën e tyre, duke e parë si burim frymëzimi për të medituar mbi botën e jetën, për të kërkuar e gjetur bukurinë e përsosur etj., kishin sjellë me kohë në letërsinë tonë një pasuri të veçantë, që në krijimet e Helonaut me shokë nuk u ripërtëri. Është e vërtetë se roli i natyrës në romantizmin tonë nuk ishte i njëlljtë si në romantizmin evropian për shkaqe tashmë të sqa-ruara. Natyra në veprën e Jeronim De Radës, Naimit e shkrimitarëve të tjera të Rilindjes u vështrua në radhë të parë, si mundësi fort e përshtatshme për të shprehur ndjenjën më të thellë të mërgimtarëve, mallin për atdhe. Po sidoqoftë, natyra tek ata ka një funksion shumë të gjerë në krahasim me krijimet e Haki Stërmillit e Kolë Mirditës. Ndërkaq, te Mihal Gramenoja e Foqion Postoli, deri diku edhe te Ndoc Nikaj, natyra ka një rol tepër të kufizuar. Nuk është e vështirë të merren me mend shkaqet e këtij ndryshimi. Në mes tyre dallon, pa dyshim, karakteri i gjinisë letrare, që u lëvrua nga ky grup shkrimitarësh, proza, e cila, siç dihet, u kushton më shumë vëmendje komponenteve të tjera të brendisë së veprës. Nga ana tjetër, aftësitë pëershkruese janë të pabarabarta kur krahasohen De Rada e Naimi nga njëra anë, dhe Helanau me shokë nga ana tjetër.

Heronjtë e krijimtarisë së Gramenos e të shkrimtarëve të tjerë janë thuajse gjithnjë bij familjesh të shtresave të popullit, ndërsa antagonistët, bartësit e së keqes, janë ose armiq të çështjes shqiptare (priftërinje e novelës «**Varri i pagëzimit**», Nikoja i romanit «**Lulja e Kujtimit**» etj.), ose përfaqësues të parësisë, të cilët, në veprimet e tyre, nisen nga paragjykimet e klasës shoqërore, së cilës i takojne. Simpatitë e thella demokratike që dallojnë në përgjithësi letërsinë sentimentaliste, e cila pikërisht për këtë arsyen është quajtur nga shumë studiues shprehëse e mendësisë dhe e protestës «së shtresës së tretë», janë të dukshme në këtë krijimtari.

Megjithëse heronjtë e saj, po të heqim mënjanë Dijen, e kanë të vakët karakterin përgjithësues, megjithëse kjo letërsi nuk arriti t'i vështronë problemet e shtruara edhe në tabanin e tyre shoqëror dhe, nga kjo pikëpamje, nuk kristalizoi dot qëndrime të qarta antifeudale, ajo prapë përpunoi një prirje të hapët demokratike përparimtare.

Në kahasim me heronjtë e tjerë të veprave që po shqyrtohen, Dija pati jehonë shumë më të gjerë në gjendjen shpirtërore të kohës, sigurisht jo aq shumë për shkak të veprimeve të saj praktike në mbrojtje të dashurisë, po më fort se guxoi të godiste në një pikë që ishte bërë nevralgjike, kishte akumular mjaft e jepte mundësi për të kritikuar disa anë të mendësisë së ngritur mbi bazat e një shoqërie irrationale, antinjerëzore.

Jeta e Dijes nuk ishte vetëm apologjia e dashurisë së pastër. Shtresat përparimtare të shoqërisë së asai kohe, duke u nisur nga romani, ngritën shqetësimë më të thella, që pasqyronin kërkesat për ndryshime të rëndësishme sociale. Veprat doli në një kohë kur sundonte tirania e gjithëpushtetshme feudo-borgjeze, kur paragjykimet zinin vend të dukshëm në marrëdhëniet morale. Në të tilla rrëthana te Dija, edhe në ato vite, nuk u pa vetëm vajza që mbronte të drejtën e saj njërzore, por edhe e reja që në ményrën e saj kundërshton, përpiqet, proteston. Nga kjo pikëpamje, romani i Haki Stërmillit, më mirë se çdo vepër tjetër e këtij grupei autorësh, përbënë e shpreh prirjen përparimtare të krijimtarisë sentimentaliste të letërsisë sonë. Gjithsesi, kjo prirje në veprat e Gramenos, Postolit e Stërmillit, më shumë se kudo gjetkë, do kërkuar te pikëpamja që mbrohej me kaq ngulm, sipas së cilës

shumë nga normat e jetës morale-zakonore të kohës janë irrationale. Për ta vetëm ajo që është thellësish e ndjerë është thellësish e moralshme dhe e pranueshme nga arsyjeja. Dashuria, si më e thella ndjenjë njerëzore, nuk mund të merret nëpër këmbë, veçse prej qëndrimesh irracionaliste. Ku duhen kërkuar burimet e këtyre qëndrimeve? Te feja e forca e zakonit, — thotë Haki Stërmilli; — tek paragjykimet fetare e fisionore, — thotë Gramenoja, megjithëse nuk i quan të tilla. Në këto ujëra janë pak a shumë autorët e tjerë, Postoli e Helenau. Po ç'duhet bërë? Ndër ta vetëm Haki Stërmilli e shtroi qartë këtë pyetje. Sigurisht, zgjidhja që i jep ai kësaj çështjeje nuk është as e plotë e as e mundshme, po sidoqoftë, nuk u mjaftua me rastësitë që i bëjnë njerëzit të marrin kthesa të papritura e as me ndryshimet e çuditshme të qëndrimeve të etërve ndaj fëmijëve të tyre; fundet e luntura të novelës «Oxhaku» të Gramenos dhe të romanit «Lulja e kujtimit» të Fojion Postolit gjithashtu janë të pranueshme prej tij, të paktën në romanin «Sikur t'isha djalë». Mënjanimi i zgjidhjeve të tilla ka bërë që pikërisht në këtë roman prirjet realiste të nisin të ravigjëzohen.

Po të përijashtojmë Haki Stërmillin, shkrimtarët e tjerë janë që të gjithë besimtarë të bindur. Pa ndërhyrjen e zotit nuk mund të shpëtonte Valideja dhe djali i saj Rexhepi; ai i dëgjoi së fundi lutjet e vazhdueshme të Rushan beut për t'i falur mëkatet; ishte vullneti i zotit ai që shpuri pranë Dhimitrit të rrëthuar nga ujqérir luftëtarët e huaj etj.. Shkrimtarët tanë nuk përpilen në asnjë rast të shprehin qëndrime që ndryshojnë sado pak nga dogma fetare. Për ta besimi në fe është një faktor që ndikon në mënyrë vendimtare në fatet e njerëzve, në përmirësimin moral të tyre. Nëse hera-herës fatkeqësítë e renda të heronjve së fundi kapércehen, kjo ndodh se ata, në pajtim me botëkuptimin e tyre, nuk e humbën kurrrë besimin te zoti dhe ditën të durojnë sic i mësonte ai, Virtyti, i kërkuar e mbrojtur prej tyre me këmbëngulie që shkon bashkë me ndjenjën e thellë e bukurinë e botës, kultivohet me durimin e me besimin e patundur te frysëzimi dhe drejtësia e zotit.

Përfaqësues të mikroborgjezisë, Gramenoja, Postoli me shokë anuan fort nga shtresat demokratike, por njëkohësisht nuk mundën të dallonin e të ndiqnin gjer' në fund zhvillimet revolucionare në jetën shoqërore të kohës. Këto zhvillime ata nuk i kuptuan, ashtu siç nuk kuptoheshin në përgjithësi prej sentimentalisteve, të cilët kundërvënien e tyre ndaj jetës e

shprehin kryesishët nëpërmjet ekzaltimit të ndjenjës e virtutit të heronjeve të dalë nga shtresat popullore. Gramenoja, Hele-nau e më fort nga të gjithë Stërmilli, e donin ndryshe një-riun, jetën e familjen. Po reagimet e tyre më të shpeshta ndaj të këqijave që sundonin në ato vite ishin lotët e derdhura pa kursim, psherëtimet dhe ofshamet. Më tepër se kudo gjetkë këtu do kërkuar thelbi sentimentaliste i qëndrimeve të tyre, që priej më shumë pas zgjidhjesh etike, që e kërkonte vir-tytin jashtë kushtëzimit social, tek dashuria pannjerëzore, e cila duhej të vinte, me besimin te zoti (Nikaj, Grameno), me reformat, me propagandimin e ideve të përparuara që nuk përjashtonin, interpretimet më të drejta të fesë (Haki Stërmilli). Dihet se mikroborgjezia është gjithnjë e prirur shpirtë-risht të gjejë të tilla zgjidhje; në qëndrimet e saj ajo, më tepër se çdo klasë e shtresë tjetër shoqërore, është e lëkundur, e paaftë të kuptojë zhvillimin e ngjarjeve, shumë e drujtur ndaj kthesave të mëdha, e pazonja t'u përshtatet ndryshimeve, të cilat vërtet i kérkon, po me një intensitet të atillë që nuk prek pozitën e saj ekonomike dhe mendësinë e krijuar mbi atë bazë.

\* \* \*

\*

Sic mund të shihet, te Gramenoja e Postoli me shokë kemi të bëjmë me një grup shkrimtarësh, që në krijimtarinë e tyre trajtuan probleme pak a shume të ngjashme, e vësh-truan dhe e vlerësuan jetën e kohës përmes qëndrimesh botëkuptimore gjithsesi të përaferta, që pasqyruan përjetime estetike të njëjta e që, më në fund, në praktikat e tyre kri-juese patën anë të përbashkëta, sidomos në konceptimin dhe krijuimin e heroit, në subjektet e veprave, në ndërtimin kompozicional etj.

Të gjitha këto tipare të afërtë kanë një thelb sentimentaliste, të cilin u munduam ta vëmë në dukje edhe nëpërmjet kahasimeve me dukuri analoge të letërsisë evropiane. Po të mbajmë parasysh se tiparet sentimentaliste në prozën shqipe të viteve të fundit të Rilindjes dhe në dy dëskat që erdhën më pas ishin sunduese, atëherë cështja që u shtrua që në hyrje të këtij kapitulli, është e udhës të marrë këtë përgjigje: zhvillimet e letërsisë shqipe njohën drejtimin sentimentaliste që, sic do të përpinqemi të argumentojmë, vinte në letrat tonë mënyrë origjinale dhe të natyrshme.

Shumë studiues kanë theksuar se letërsia sentimentaliste sidomos në Francë, me vëmendjen e veçantë që i kushtonte ndjenjës për të cilën mendonte se duhej të ishte e vëtmja forcë shtytëse, madje udhëheqëse e jetës njerëzore, iu kundërvu në disa anë racionalizmit të letërsisë iluministe dhe optimizmit qe rriddhe prej tij. Kjo kundërvënie për letërsinë sentimentaliste, veç një thelbi kritik ndaj shoqërisë së kohës, e cila në industrializim e sipër krijonte plagë të rënda, përmblante njëkohësisht edhe një notë regresive, që shfaqej në pikëpamjen se qytetërimi e shkatërronte moralisht njeriun. Kjo pikëpamje la gjurmë shumë të ndjeshme edhe në mendimin romantik. Kampion i saj ishte Rusoi, ashtu siç qe ihtar i flaktë i afrimit të njeriut me natyrën, ku shihte një nga mundësítë më të përshtatshme për të shpëtuar njeriun nga të këqijat e qytetërimit, të cilat, sigurisht, ai nuk ia mononte përparimet që sillte. Sidoqoftë, në letërsinë sentimentaliste evropiane këto qëndrime sillnin nota të theksuara trishtimi. Nota të tilla karakterizojnë në përgjithësi edhe krijuarit e Helenaut, romanin «Sikur t'isha djalë» dhe ndonjë novelë të Gramenos. Po nderkaq, per asnjë çast nuk do menduar se këto vepra i kundërvihen optimizmit historik të viteve të Rilindjes, bazë e romantizmit të krijuarve të Naimit me shokë. Po ashtu do të ishte gabim që në krijuarit e Helenaut e shkrirtarëve të tjerë të kërkoheshin pikëpamje që kundërshtonin qytetërimin, duke e quajtur burim të së keqes morale. Kërkimi i paraleleve midis sentimentalizmit evropian dhe veprave që po shqyrtohen, në këtë pikëpamje do të ishte krejt pa vend. Në veprat e autorëve tanë nuk ka asnjë lloj përpjekjeje për të vënë përballë «kultit të arsyesh», që nga sentimentalistët e romantikët identifikohej shpesh me cinizmin e egoizmin, kultin e ndjenjës, si udhë e kapërcimit të gjendjes aq fort të kritikueshme që po krijohej në disa vende të Evropës Perëndimorë pas së cilës, u tërroqën shumë sentimentalistët e, pas tyre, edhe romantikët.

Iluminizmi ynë, me gjithë pikat e shumta të përafërtë me idetë iluministe në përgjithësi, ndryshonte prej tyre në një drejtim themelor. Duke qenë ideologji e luftës për çlirimin kombëtar e për emancipimin e kombit shqiptar, iluminizmi ynë vuri në qendër të vet mendimin patriotik. Të gjitha pikëpamjet e rilindësve tanë të shquar, pra edhe idetë e tyre racionaliste synonin të argumentonin ekzistencën e mëvetësider, realizimin e imperativit historik të kohës — krijuimin e

shtetit të pavarur shqiptar, demokratik e të përparuar. Racionalizmi i tyre mbështetet në një përvojë historike të gjatë, rë kushtet e favorshme që ishin krijuar për kryerjen e një shndërrimi të madh në statusin politik të atdheut. Me argumente shkencore, racionale ata luftuan të provonin lashtësinë e kombit shqiptar në trojet e veta dhe mëvetësinë e gjuhës shqipe, të tregonin karakteristikat nacionale të popullit, nevojën e krijimit të Shqipërisë së përparuar, krejt të ndryshme nga gjendja ku e kishte hedhur pushtimi i huaj shumëshekullor. Për të gjitha këto, Gramenoja dhe shkrimtarët e tjerë nuk kishin asnjë arsyё përsë t'i kundërviheshin racionalizmit mjafit të përhapur në mendimin iluminist të Rilindjes, aq më tepër që një pjesë e veprave të tyre u shkruan ende pa u çliruar Shqipëria ose në një kohë kur problemet nacionale nuk ishin zgjidhur përfundimisht dhe jehona e tyre mbetej ende shumë e fuqishme. Nuk është e vështirë të merren me mend shkaqet e këtij ndryshimi të madh. Shoqëria shqiptare e çerekut të parë të shekullit XX kishte të tjera probleme nga ato që kishte shoqëria e vendeve evropiane të Perëndimit në mbyllje të shekullit XVIII. Për këto të fundit ishte koha e triumfit të borgjezisë, që kishte marrë ose kërkonte pushtetin dhe, krahas anëve të saj përparimtare, shfaqte edhe esencën regresive që përbante; ndërsa për Shqipërinë ishin vitet e mëkëmbjes së shtetit të pavarur shqiptar, që vazhdonte të kërcënohej seriozisht nga lakmitë e shovinistëve fqinjë, që kërkonte të hynte në udhën e përparimit, të linte prapa errësirën mesjetare feudale. Borgjezia shqiptare mbeti edhe pas Shpalljes së Pavarësisë shumë e dobët, ajo dështoi në përpjekjet që bëri për të marrë pushtetin në revolucionin e qershorit të vitit 1924. Plagët e shoqërisë shqiptare të atyre kohëve vinin, në një masë të madhe, jo nga përparimi intensiv i qytetërimit borgjez me gjithë të këqijat e tij, po nga mungesa e theksuar e këtij përparimi. Shkrimtarëve tanë të atyre viteve u duhej të kërkoni me forcë krijimin e kushteve të atilla, që do të lejonin triumfin e ndjenjës, të dinjitetit personal të njeriut, i cili shpërfillë kegas nga paragjykimet sociale dhe morale. Ata e shprehën këtë kërkësë, por siç e vumë në dukje, pa qenë në gjendje, ashtu si përgjithësisht sentimentalistët, t'i shihnin problemet e shtruara edhe në rrafshin shoqëror, me gjithë përpjekjet që bëri ndonjëri prej tyre.

Një ndër më të shquarit shkrimtarë sentimentalistë të Evropës, Zhan Zhak Rusoi, krioi një sistem pikëpamjesh mbi te ashtuquajturin «njeri të natyrës». Duke u orvatur të

tregojë karakterin kontradiktor të zhvillimit, ai ngul këmbë në mendimin se njeriu, sa më pranë natyrës të jetojë, aq më shumë i mbetet besnik thelbit të vet, aq më fort mund të ruhet nga të këqijat që sjell në mënyrë të pashmangshme qytetërimi. Sipas Lansonit, thelbi i pikëpamjeve që mbronte Rusoi mund të karakterizohej në këtë mënyrë: «Natyra e ka bërë njeriun tē mirë, kurse shoqëria tē keq; natyra e ka bërë njeriun tē lirë, kurse shoqëria skllav; natyra e ka bërë njeriun tē lumtur, kurse shoqëria tē mjeruar. Tri vlerësimë tē lidhura njëra me tjetrën, tē cilat janë shprehje tē ndryshme tē së njëjtës së vërtetë; shoqëria ndaj natyrës është njësoj si e keqja ndaj së mirës<sup>1</sup>. Themelet e një shoqëri me tē vërtetë humane, ndjeshmérinë dhe mirësinë; Rusoi i kushtëzonte me jetesën e njerëzve sa më pranë natyrës. Kulti i ndjenjës, si një prej elementeve konstruktivë tē mendimit romantik, i ka burimet edhe në sentimentalizmin e Rusoit. Kjo bërendi filozofike e sentimentalizmit mungon në veprat e Gramenos, Postolit, Hele-naut etj. Natyrisht, në një kuptim më tē gjërë, apologjia që i bëjnë këta shkrimtarë triumfit tē ndjenjës së dashurisë në lutfë me pengesat e shumta sociale e etike nuk është zhveshur nga një kuptim filozofik. Por në këtë mës, fjala është për një sistem tē përpunuuar pikëpamjesh, që i konsideronin natyrën dhe ndjenjën si rregullatorë tē jetës shoqërore, si tē vetmet ose tē paktën ndër zgjidhjet më tē efektshme tē problemeve sociale. Në romanin «Sikur t'isha djalë» synimet social-etike të Haki Stërmillit janë më tē gjera e më tē haptë, ai u kushton shumë vend arsyetimeve mbi nevojën e ndryshimeve ne jetën morale tē Shqipërisë së kohës së yet, aq sa hera-herës, siç e kanë vënë në dukje studiuesit, del nga natyra e një vepre letrare për tē ecur në fushën e publicistikës etike. Por veprat e Haki Stërmillit vëtëm reagonte ndaj disa anëve tē jetës së atyre viteve, pa u shtyrë me thellë në kritikën e qytetërimit e tē shoqerise njerezore në përgjithësi.

\* \* \*

Eshtë pranuar përgjithësisht se sentimentalizmi në shumë pikëpamje përgatiti romantizmin. Ky i fundit ruajti mijëft të

1) G. Lanson, *Histoire de la littérature française, remaniée et complétée pour la période 1850-1950* par P. Tuffrau, Paris 1957, f. 801.

pare të burimeve të tij, si pasionin e veçantë ndaj natyrës, ndjenjën e thellë, sidomos dashurinë, si shenjë te parë të njeriut të vërtetë, analizën e hollësishme të botës shpirtërore etj., aq sa ka studiues të tjerë që nuk bëjnë dallime midis sentimentalizmit dhe romantizmit dhe i konsiderojnë si një dukuri të vetme. Studiuesit kanë vënë në dukje se kundërvënia romantike ndaj klasicizmit, që u përpunua edhe teorikisht, zanafilën e ka te sentimentalizmi, që nisi të mos e konsideronte më letërsinë krijim të idesë, të mendimit e të arsyes po shprehje të zemrës, të botës shpirtërore, të bukurisë së dashurisë e natyrës. Te sentimentalistët francezë, gjermanë, anglezë ndjenja nisi të merrte vlera të reja, që nuk i duhen nënshtruar më arsyes. Për ta ndjenja e thellë, kultivimi i saj, ishin mënyra më e mirë pér të përsosur njerëzit moralisht. Në veprat e tyre është i gjallë interes i pér njeriun e veçantë, pér mjediset etnike e natyrore ku ai jetonte. Vështruar nga këto anë, krimtaria e Gramenos, Helenaut dhe e disa shkrimtarëve të tjerë të tri dekadave të para të shekullit XX mund të quhet vërtet sentimentaliste në disa karakteristika të rëndësishme, po ndërkakq, nga pikëpamja historiko-letrare ajo mbeti një dukuri pasromantike. Në letërsinë tonë veprat e drejtimit sentimentalist lindën në një kohë kur romantizmi ishte zhvilluar në mënyrë pak-a shumë të plotë dëhe kur proceset historike po nxirrin në shesh-nevojën e krijimit të një letersie që do të pasqyronte edhe problemet shoqërore, ndërsa problemi kombëtar do ta trajtonte nën prizmin e qëndrimeve që mbanin ndaj tij klasat dhe shtresat e ndryshme sociale. Dallimet e dukshme në jetën poltiko-shoqërore të vendit tonë në krahasim me vendet e tjera kù u shfaq sentimentalizmi, përbëjnë faktorin vendimtar që përcaktoi këtë ndryshim kaq të thellë në rolin që luajti letërsia sentimentaliste në vendet e Evropës, nga njëra anë, dhe në vendin tonë, nga ana tjetër. Letërsia moderne shqiptare që nisi me veprat e epokës së Rilindjes, duke u ndodhur para çështjes kombëtare, do të merrej në radhë të parë me të, në qoftë se donte që të bëhej jehonë e kohës, forcë e vërtetë shpirtërore me ndikim të fuqishëm në jetën politike të atyre viteve. Asaj i duhej të krijonte një gjendje të veçantë shpirtërore, që përcaktohej nga èndërrimi dhe përpjekja pér krimin e një Shqipëri të lirë. Më fort se të merrej me analizën e shoqërisë shqiptare të atyre kohëve dhe të tregonte atje diferençimet e mëdha sociale e shkaqet e tyre, letërsisë së Rilindjes i duhej të merrej me historinë e lashtë të atdheut që ia mohonin të huajt, të frymëzonte bashkimin e shqiptarëve

kundër përçarjes që mbillnin fetë e ndryshme dhe armiqtë që qëndronin pas tyre. Me fjalë të tjera, letërsisë në ato vite i duhej të sendërtonte një èndërr, një aspiratë të lashtë, një përfytyrim, të krijonte një patos sa dramatik, aq edhe entuziast. Vetëkuptohet se për të gjitha këto letërsia e Rilindjes në mënyrë të pashmangshme mund të lindte vetëm si romantiqe. Ajo nuk mund të ndiqte rrjedhat nëpër të cilat kishin kaluar proceset letrare në vendet e Evropës perëndimore, edhe pse format e organizimit shtetëror dhe nivelet e zhvillimit shoqëror e kulturor të arritura në ato vende synoheshin prej ideologëve e shkrimtarëve të kohës.

Në historinë e letërsisë sonë, siç mund të shihet, «thyhet» ecuria që vihet re në historinë e letërsisë së vendeve evropiane. Kjo «thyerje» provon edhe një herë se dukuritë letrare shfaqen atëhëre kur bëhen të domosdoshme nga zhvillimet historike të jetës sociale të një vendi. Sidomos pas Shpalljes së Pavarësisë, jetë e vendit tonë u ndodh para shumë problemesh të karakterit shoqëror. Në letërsi ato mund të trajtoheshin nëpërmjet veprash që mund të ishin romantiqe, sentimentale dhe realiste, drejtime që kush më shumë e kush më pak, e kanë trajtuar secili në mënyrën e vet tematikën sociale. Në poezi disa nga romantikët tanë të viteve të fundit të Rilindjes ë morën me këtë temë në një masë e thellësi të caktuar. Po romantizmi nuk ishte më në apogjeun e vet dhe shkrimtarët e viteve që erdhën pas Pavarësisë mund dhe duhej të gjenin rrugë e qëndrime të tjera për pasqyrimin e jetës. Çajupi me komeditë e tij e Asdreni në disa poezi, filluan të priren nga realizimi qysh në kohët e fundit të Rilindjes e në vitet që erdhën menjëherë pas saj dhe mund të mendohej lehtë se zhvillimi i letërsisë së mëvonshme sipas drejtimit realist duhej të ishte rruga më e natyrshme. Megjithatë nuk ndodhi kështu. Realizmi në prozë mori një trajtë vetëm në vitet '30; pranë tij dhe romantizmit shfaqet si një dukuri gjithsesi mjaft e qartë një letërsi me brendi sentimantale.

Veç arsyeve historiko-sociale për të cilat u fol më lart, në këtë mes, sigurisht, kanë ndikuar edhe shkaqe historiko-letrare. Në rrethanat kur letërsia, krahas çështjes kombëtare që vazhdonte të mbetej shqetësuëse për jetën shpirtërore të vendit, e ndiente se duhej të trajtonte edhe probleme të tjera shoqërore e morale, proza në mënyrë të veçantë, do të merrete domosdo tiparet sentimentaliste. Ajo po hidhte hapat e saj të parë, tradita në këtë gjini mungonte thuajse fare. Për të ishte

krejt e pamundur që qysh në fillimet e veta të fitonte menjëherë karakteristika të dukshme realiste, të cilat sigurisht, kërkonin formimin e bindjeve më të qarta për proceset e zhvillimit historik, përvojë më të gjatë në pasqyrimin e tyre në letërsi, e përgjithësisht, nivele më të larta të jetës social-kulturore.

Për të gjitha këto arsy, historiko-shoqërore e historiko-letrare, krijimtaria e drejtimit sentimental ka ardhur në mënyrë të natyrshme në rrjetin e letërsisë sonë. Me ato vlera që mundi të përpunojë, ajo solli kontributin e vet në zhvillimet e mëvonshme realiste të letërsisë shqipe, duke u futur në shpirtin e njeriut të thjeshtë dhe duke shtruar, ndonëse ende në mënyrë të sipërfaqshme, probleme shoqërore.

## NGA ROMANTIZMI, ARJEDHAVE TE REALIZMIT

Shumë tipare të krijuarit e romantike, sidomos karakteri thellësisht demokratik dhe, në etapën e fundit të zhvillimit të saj, patosi kritik me brendi jo vetëm politiko-kombëtare, po edhe shoqërore, krijonin truallin e nevojshëm që letërsia të ndiqte rrugë të tjera, të cilat do të synonin të rrisin më tej aftësitë analizuese e pasqyruese të saj, të shikonin më thellë proceset sociale në jetën e kohës, të zgjeronin më tej interesimet tematike të shkrimitarëve. Të nxitur nga pjesë-marrja gjithnjë e më e gjerë e masave të popullit në ngjarjet historike, pikëpamjet botëkuptimore dhe qëndrimet politike të krahut përparimtar të lëvizjes së Rilindjes, në fillim të shekullit tonë nisën të pësojnë ndryshime të ndieshme. Të zbulohen këto qëndrime dhe evoluimi i tyre në vitet që erdhën pas shpalljes së Pavarësisë është puna e parë që do kryer për të shpjeguar proceset e reja që u shfaqën në historinë e letërsisë.

Përpjekjet për të vështruar botën e jetën shoqërore ndryshe nga c'predikonte feja, botëkuptimi sundues i kohës, gjenitek Naim Frashëri një përfaqësues të shquar. Iluminizmi i tij, frut i rrëthanave politiko-sociale të Shqipërisë së gjysmës së dytë të shekullit XIX, përbante si komponentë të rëndësishëm pikëpamjet demokratike dhe idetë racionaliste.

sishëm pikëpamjet demokratike dhe idetë racionalistë. Republikanizmi i Naimit presupozonte pa dyshim rendin demokratiko-borgjez; ai e shihte realizimin e idealeve të tij atdhetare të pashkëputur nga krijimi i një rendi më të përpruar shoqëror. Siç qe entuziast për fitoren e afërt të lirisë kombëtare, Naimi mbeti po ashtu optimist edhe në mundësitë e krijimit të një shoqërie të re shqiptare, sipas shembullit të demokracive borgjeze të perëndimit. Qëndrimet optimiste të poetit përligjeshin nga çdo pikëpamje kur ishte fjala për çlirimin e afërt të Shqipërisë, po kishte shumë arsyë që besimi i tij i gëzueshëm për ndërtimin e një shoqërie më të mirë në rrrethanat e atyre viteve të mbetej më fort një nga shfaqjet më elokuente të karakterit romantik përparimtar të veprës së tij. Gjithsesi, baza filozofike prej nga nisej Naimi, ilusë tij, i lejonte ta shihte jetën shqiptare nga pozita thellësisht të angazhuara, nga një kënd racionalist që i krijonte të gjitha mundësitë për të pasqyruar në veprën e tij problemet jetike të kohës; luftën kundër pushtimit të huaj, prapambe tjes së thellë, përcarjes e fanatizmit fetar.

Naimi nuk arriti dot të shkëputej nga filozofia idealiste, qëndrimet e tij demokratike akoma nuk venë gjer në pasqyrimin e popullit si forca që mund të marrë përsipër e të

realizojë ndryshime të mëdha politike, ndërsa interesat e kundërta që vepronin në gji të shoqërisë shqiptare, të cilat sigurisht i ndiente e i kuptonte, ai nuk i vështroi dot si interesa klasash që luftonin midis tyre.

Patosi demaskues te Naimi në përgjithësi ishte i tertiortë, mohimi gjithashtu vinte nëpermjet pohimit èndërrimtar të Shqipërisë së ardhshme të përfytyrimeve të tij të ndritura. Natyrisht, do të ishte e padrejtë të mendohej se këto mënyra që ndiqte Naimi, e pengonin të thellohej në pasqyrimin e realitetit shqiptar; janë të njohura arsyet që e shtynë të vepronte ashtu siç veproi. Po sidoqoftë, fryma e poezisë së Naimit, me kalimin e kohës, nuk mund të mbetej në çdo anë e përshtatshme. Pas vdekjes së tij, erdhën vite të atilla që për t'u pasqyruar në letërsi, e kishin të domosdoshme jo vetëm të zgjerohej tematika, por sidomos të shiheshin ngjarjet e vlerësimet e tyre në shkaqet më të thella ekonomiko-sociale. Realizimi i këtyre kërkesave donte gjithashtu të ndryshoheshin disa qëndrime politiko-shoqërore, të cilat duhej të shpreheshin në letërsi më hapur se gjer atëhere. Vetëm optimizmi, që domosdo mbetej gjithnjë i nevojshëm, vetëm bindja se emancipimi kulturor i popullit do të ndihmonte në zgjidhjen e problemeve të tjera, nuk mund të shpinin shumë larg, pa treguar njëkohësisht pengesat e mëdha që dilnin në zhvillimin e lëvizjes së Rilindjes, shkaqet dhe natyrën e tyre. Kohërat kërkonin që të goditeshin paria feudal e ndikimi i saj, politikanët oportunistë, kleri e institucionet e tij për të shkuar më tej, në atakimin e fesë si botëkuptim. Ato kërkonin pra, vështrime kritike të drejtpërdrejta mbi realitetin shqiptar, mbi qëndrimin e forcave të ndryshme shoqërore ndaj lëvizjes së Rilindjes; ato donin që besimi i patundur në lirinë e atdheut të mbështetet fort në aftësitë e pashtershme të popullit për të përshpejtuar dhe diktuar zhvillimin e ngjarjeve historike, të cilat shpinin në arritjen e pavarësisë. Në kushtet e asaj periudhe ishte e pamundur që historia të kuptohej në mënyrë shkencore, po, ndërkaj, mund dhe duhej të vihej në dukje se shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane e donin dhe do ta realizonin masat e gjera të popullit, në kundërshtim me parësinë feudale, të lidhur me shumë fije me pushtuesin e huaj, në kundërshtim me klerin që përpiquej, sipas fesë që ushtronnte, ta ruante pushtimin ose ta vinte vendin nën një sundim të ri. Prandaj ishte në logjikën e zhvillimit të mendësive politike e ideologjike të kohës, që të përpunohezin e të shfaqeshin qëndrimet antifeudale dhe antiklerikale,

të cilat në letërsi i gjejmë shkoqur sidomos tek Çajupi. Këto qëndrime shoqëroheshin hera-herës me shfaqjen e notave të zhgënjimit, që shkaktoheshin nga kontradikta midis dëshirës së zjarrtë të poetit për ta parë vendin sa më shpejt në flakët e kryengritjes popullore, nga njëra anë, dhe disa dobësive të lëvizjes kombëtare, nga ana tjetër. Këto nota nuk ishin aspak sunduese, ato tregonin se Çajupi ishte i ndërgjegjshëm që parësia feudale dhe kleri përfaqësonin një forcë regresive të rrezikshme, e cila ndikonte mjaft në jetën e vendit e ndaj së cilës ende nuk po kristalizohej sa duhej një qëndrim i fuqishëm kundërshtues.

Perspektiva e shoqërisë shqiptare pas fitores së pavare-sisë, ka qenë një nga shqetësimet e mendimit përparimtar të kohës. Naimi kishte bindjen iluministe se arsimimi dhe edukimi, në përgjithësi emancipimi kulturor i shqiptarëve, ishin ndër faktorët e dorës së parë që do të krijonin shoqërinë e përparuar, të drejtë e njerëzore. Çajupi përkundrazi, dhe Asdreni në periudhën e dytë të krijimtarisë, nuk besonin në një mundësi të tillë; poema «Dhjata e vjetër e shfaqur» duket se një nga synimet e saj do të ketë patur shtjellimin e pikëpamjes se njerëzimi nuk do të arrijë dot të realizojë ditë më të mira për të mjeruarit e kësaj bote. Vjersha «Paradokse» e shumë krijime të tjera të Asdrenit, sidomos të vëllimit «Psallme murgu», kësaj pikëpamjeje i mbahen. Skepticizmi i Asdrenit dhe i Çajupit, siç e kemi vënë në dukje edhe gjetkë, i ka burimet në kufizimet e formimit botëkuptimor të inteli-gjencies përparimtare të kohës, që rridhë nga shtresa e mikroborgjezisë e të borgjezisë liberale. Pikërisht për këtë arsyet nuk ishin në gjendje të kuptionin zhvillimet historike, të shihnin në to forcat sociale që, në kushte të caktuara, mund dhe duhej të luftonin e të krijonin një shoqëri të drejtë, të cilën ata e ëndërronin sinqerisht.

Në një pikëpamje tjetër, skepticizmi i Çajupit bëhej shkak për vështrime më të thelluara në fenomenet e jetës. Të mos besohej në një të ardhme më të mirë të njerëzimit, ky ishte një qëndrim që në fund të fundit i diktohej poetit edhe nga egërsia e pushtetit të gjithanshëm të klasave sunduese, që vazhdonin prej shekujsh t'i shkaktonin njerëzimit vuajtje të shumta. Çajupi e njihte forcën e tyre, të cilën, hera herës e përfytyronte fatalisht të pakapërcyeshme. Sidoqoftë qëndrime të tilla kanë ndikuar në zgjerimin e vështrimeve realiste, sepse e shtynin shkrimitarin të gjykonte më thellë mbi shkaqet ekonomiko-shoqërore të plagëve të vjetra e të reja të njerëzimit.

Natyrisht, këto vështrime mbeteshin të kufizuara dhe s'ishin kurrsesi deri në fund objektive; për shkak të thekseve fataliste, ato nuk arrinin të zbulonin tendencat përparimtare në zhvillimet shoqërore dhe bartësit e tyre.

Te përfaqësues të tjerë të jetës shpirtërore, që qëndronin në pozitat e mikroborgjezisë, u krijua iluzioni se duke kultivuar ndër njerëzit një zemër më të ndjeshme, mund të zgjedheshin shumë probleme që mundonin jetën shoqërore. Në këto pozita qëndronin në përgjithësi sentimentalistët tanë. Edhe pse i ndienin dhe i vërenin diferencimet midis njerëzve, shumë nga shkrimitarët tanë të fillimeve të shek XX e të viteve 20 mbetën, siç ishte e natyrshme, me koncepte ende të vagëlluara për klasat dhe luftën e tyre. Përparimin që kishin sjellë kohërat gjatë rrjedhës së tyre, ata e kuptionin në mënyrë idealiste, si të ardhur nga zhvillimi i përgjithshëm i natyrës dhe i intelektit njerëzor.

Çajupi, më radikali ndër shkrimitarët e fillimeve të shkullit XX, u bë bartësi i qëndrimeve ateiste. Përçarjen fetare, këtë plagë pér majisjen e së cilës kishin punuar armiqëtë e shumtë të Shqipërisë, e ndjeu fort edhe Naimi që, si e kemi vënë në dukje, u përpoq ta shéronte duke u kapur pas pikëpamjeve panteiste, të cilat në mënyrën e tyre, i bënin të pavlefshme dogmat e besimeve që ushtroheshin në atë kohë. Çajupi ndoqi rrugën e dyshimit ndaj çdo besimi, madje, ndaj idesë së ekzistencës së zotit. Ateizmi i tij nuk është gjithnjë konsekuent, po megjithatë rrënjet e këtij qëndrimi botëkuptimor në letërsinë tonë përparimtare tek vepra e Çajupit duhen gjetur. Pikëpamjet ateiste ishin të pritura në mendimin dhe letërsinë shqiptare, drejt tyre shtynin faktorë të shumtë të jetës shpirtërore të atyre kohrave. Rilindësit tanë e dinin se fëja nuk luante rol fatalisht përcaktues në psikologjinë dhe sjelljen e shqiptarëve. Pikërisht pse ishte kështu, Pashko Vasa do të dilte hapur kundër institucioneve fetare dhe do të shpalte kredon e famshme: «Feja e shqiptarit është shqiptaria». Nga ana tjetër kleri, në veprimet e tij, po tregonte çdo ditë armiqësinë e vet ndaj lirisë dhe përparimit të Shqipërisë. Po as në periudhën e fundit të Rilindjes e as në vitet që pashuan, ateizmi nuk u kristalizua dot si një tipar dallues i qëndrueshëm në botëkuptimin e shumë shkrimitarëve përparimtarë të kohës. Asdreni, Mjeda, shkrimitarët sentimentalistë në përgjithësi, besonin në fuqinë supreme, megjithëse disa nga ata ishin antiklerikaliste të vendosur. Tek Noli, kjo çështje është më e ndërlidhur. Ne ende s'kemi studime të plota mbi

botëkuptimin e tij, po nisur nga vepra komplekse që ná la, mund të arrihet në përfundimin se në një pjesë të saj vihet re një frymë e qartë mesianizmi. (Krishti me kamxikun, Marshi i Krishtit). Vetëm tek Migjeni, Nonda Bulka e tek shkrimtarët e tjerë përparimtarë të viteve '30 do të flaken përfundimisht besimi në dogmën, iluzionet e mëdyshjet fetare. Vetëkuptohet se qëndrimet e prera ateiste ndikonin fort në karakterin e gjykimeve e të vlerësimeve që do të shprehnin shkrimtarët në krijimtarinë e tyre; prirjeve realiste në të, pa dyshim, u krijohej truall më i qëndrueshëm.

Në kohërat që erdhën pësuan ndryshime të dukshme edhe karakteristikat e tjera botëkuptimore të shprehura në letërsinë përparimtare. Simpatitë demokratike u thelluan më tej dhe shkuan gjer në pranimin e idesë, se masat e gjera të popullit janë në gjendje të realizojnë përblysje të mëdha shoqërore. Kjo ide u shfaq së pari tek Asdreni, po atje nuk u shtjellua veçse në disa vjersha të shkëputura e të pakta. Te Noli ajo fitoi përmasa më të gjera; në kryengritjen e katundarve dhe të punëtorëve ai pa, sigurisht në disa nga krijimet e tij më të mira, të vetmin majet pér të shpëtuar jo vetëm Shqipérinë, po gjithë njerëzimin nga plagët që e mundonin. Me përhapjen e ideve komuniste, tiparet revolucionare të qëndrimeve demokratike u theksuan më shumë ndër shkrimtarët përparimtarë të viteve '30, që sapo kishin nisur udhën e krijimtarisë. Shfaqjet e skepticizmit përsëri vazduan të jenë të ndieshme, sidomos në veprën e Nonda Bulkës; Migjeni gjithashtu vuante nga notat e pesimizmit e të fatalitetit. Po përgjithësisht letërsia përparimtare e viteve '30, në krijimet e disa prej autorëve të saj, sidomos të atyre që u ndikuau nga idetë komuniste, përvijoi si prirje gjithsesi mjaft qartë, idenë që pranonit zhvillimin e shoqërisë njerëzore nëpërmjet përblysjeve të mëdha, të cilat vinin nga acarimi i vazdueshëm i kontradiktave midis të varfërve dhe të pasurve, midis të shtypurve dhe despotëve. Skepticizmi i pashpresë, natyrisht jo tek të gjithë shkrimtarët, tani po kapërcehej; pér disa nga ata realiteti shoqëror ishte i ndryshueshëm, ai nisi të kuptohej historikisht. Më parë Naimi e përfytyronte përparimin, që sillte rrjedha e kohërave, të shkaktuar nga evoluimi i mendimit, zgjerimi i dijeve, emancipimi kulturor-edukativ i njeriut; kështu mendonin përgjithësisht edhe Çajupi e Asdreni, të cilët megjithatë, mundën hera-herës të shihnin se ndryshimet historike vinin nga luftërat midis të sunduarve dhe sunduesve. Sigurisht, edhe më pas nuk u arrit që jeta të konceptohej deri në fund

shkencërisht, kuptimi historik i saj për shumë arsyen nuk u kristalizua plotësisht; megjithatë, tanë në letërsinë përparimtare janë zhdukur jo vetëm gjurmët e besimeve fetare, po kana filluar të tkurren edhe qëndrimet e theksuara subjektiviste e shpjegimet vetëm etike të dukurive shoqërore. Proza e Migjenit dhe e Nonda Bulkës përmban përpjekje të shumta për të pasqyruar disa anë të gjendjes ekonomiko-shoqërore të kohës së tyre, interesat e kundërtë klasore, njeriun si qenie sociale. Për shkak të zhvillimit ende të pakët të llojeve të gjata të prozës, këto synime nuk u realizuan dot gjerësisht, megjithatë ato u ravigjëzuan fare qartë. Në këtë udhë shkrimtarët përparimtarë po anonin gjithnjë e më shumë nga konceptimet materialiste të jetës, nga pasqyrimi i saj përmes faktorëve objektivë, të cilët vepronin pavarësisht nga dëshirat e njerëzve. Ata nuk i merrnin dukuritë e jetës si të dhëna njëherë e përgjithmonë, po i shihnin si procese që përcaktohen nga raporte shkakësore, në ndryshim të vazhdueshëm, që nuk përjashtojnë, përkundrazi, presupozojnë lëvizjet e tronditjet e mëdha shoqërore. Jo vetëm diferencimet, po edhe antagonizmi klasor konsiderohej prej tyre si një shfaqje objektive e shoqërisë. Prirja materialiste e botëkuptimit të shkrimtarëve përparimtarë të viteve '30 i shtynte ata të përpinqeshin të analizonin shoqërinë, të gjenin atje raportet midis saj dhe individit. Kjo prirje lejonëtë Migjenin, më të shquarën e shkrimtarëve të atyre viteve, që nga njëra anë, të përshkrante botën shpirtërore të njeriut të përcaktuar nga mjediset ku jetonte dhe, nga ana tjetër, të shihte mes kaq vëzhgimesh të fakteve jetësore një esencë sociale, në më të shumtën e rasteve regresive, që duhej luftuar, e më rrallë përparimtarë, të cilës i takonte e ardhmjë.

Letërsia përparimtare e viteve '30 më shumë e ëndërroi botën e re se sa e konceptoi të lindur nga triumfi i proletariatit, të vetmes klasë që mund të realizonte vërtet rendin e dëshiruar. Për shkaqe objektive, realistët tanë nuk iu përmbytën pikëpamjeve të asaj klase, që do të ishte e aftë të merrte përsipër e të zgjidhët çështjet më jetike të shoqërisë shqiptare. Në ato kohëra proletariati ishte i vogël në numër, i paorganizuar si duhet nga pikëpamja politike, ndërsa përhapja e ideologjisë marksiste ishte vetëm në fillimet e saj. Sidoqoftë, zhvillimi i lëvizjes demokratike antizogiste, jehona e ngjarjeve revolucionare në botë, po edhe ndikimi i pikëpamjeve komuniste tek një pjesë e tyre, i shpinin shkrimtarët përparimtarë në krijimin e përfytyrimeve të reja që

shihnin tek të varfërit e të përbuzurit e kësaj jete njërejtë e kohërave më të mira. Këto përfytyrime ruanin, pa dyshim, një natyrë akoma romantike, po megjithatë, në brendinë e tyre ishin krejt të kundërtat me pikëpamjet që përhapnin fetë, «neoshqiptarizma», e të tjera rryma të mendimit reakcionar të kohës.

Eshtë e vështirë të përcaktohet karakteri i pikëpamjeve politike të Migjenit; e sigurtë është vetëm që ndryshimet ai i donte të ishin rrënjosore, radikalizmi i tij ishte i hapët. Sarkastik ndaj rendit në fuqi ishte edhe N. Bulka, po spekticizmi që haset shpesh në veprën e tij, nuk lejon të gjykohet nga afër mënyra si e mendonte ai një shoqëri të përparruar shqiptare, shoqerinë njërezo në përgjithësi. Migjeni në prozë ka zgjedhur si mjet kryesor mohimin për të pohuar fort kërkесën për një jetë tjeter, ndërsa në poezi ai është përpjekur, qoftë edhe në trajtë vegimesh, të përvijojë botën e re. Kurse tek N. Bulka thua jse është e pamundur të gjen den përfytyrime për të ardhshmen; ai duket të ketë qenë po aq fatalist në mosbesimin ndaj mundësive të krijimit të një jete tjeter shoqërore, sa ç'kishtë qenë më parë Çajupi. Sidqoftë, jo vetëm Migjeni e N. Bulka, po në përgjithësi të gjithë shkrimitarët përparimtarë të atyre viteve nuk janë iluzionistë, ata nuk mbështeten tek liberalizmi borgjez, as tek legjitimizmi aristokratik, aq më pak në etikën obskurantiste fetare a pikëpamjet teokratike; përkundrazi, ndaj tyre janë thellësisht kritikë.

Ndërkaq në veprën e N. Bulkës sidomos, deri diku edhe në prozën e Migjenit, shfaqet në mënyrë të pashmangshme një kontradiktë botëkuptimore: qëndrimet kritike ndaj shumë anëve të jetës së kohës, duke rënë ndesh me mosbesimin, hera-herës mjaft të hapët, ndaj çështjes së krijimit të një bote më të mirë, nuk mund të mos zbeheshin e të hynin në një udhë pa krye. Prandaj edhe studiuesit tanë kanë folur për dëshpërimin e N. Bulkës<sup>1</sup>, një farë nihilizmi të tij<sup>2</sup>, për ndërthurjen e pikëpamjeve materialiste me ato idealiste që vihen re tek ai<sup>3</sup>, për trishtimin e melankolinë e Migjenit<sup>4</sup> etj.

Afrimi ndaj pikëpamjeve më të drejta për shpjegimin e jetës e të shoqërisë vjetveti theksonte qëndrimet humaniste të shkrimitarëve tanë realistë. Në veprën e Naimit humaniz-

1, 2, 3, 4 — Shih: M. Xhaxhiu, **Parathënie** në botimin e veprës së Nonda Bulkës, Tiranë 1980, fq. 21, 22.; M. Gurakuqi, **Autorë dhe probleme të letërsisë përparimtare shqipe** të viteve 30, Tiranë 1966, f. 42.

mi ka qenë i thellë, po ai mbetej në disa rrafshe abstrakt, pannjerëzor dhe, kur nisej nga porositë morale fetare, shndërrrohej dashur pa dashur në të kundërtën e vet. Gjersa mbështetetj në dëshirat e mira, utopik ishte edhe humanizmi i Çajupit, sidomos tek poema «**Dhjata e vjetër e shfaqur**». Por kur ai mundohej të gjente shkaqet e dukurive jetësore, atëherë qëndrimet e tij humane fitonin një patos tjetër, objektiv dhe shoqërisht përparimtar. Kështu ndodhët pak a shumë edhe me Asdrenin. Ndërsa tek sentimentalistët tanë humanizmi identifikohej me ndjenjën, nga e cila buron e mira, virtuti që për ta ishin mishërim i qëndrimeve me të vërtet njerëzore. Ndjenja, e në lidhje të shpeshta me të edhe bukuria, ishin për Lazgush Poradecin, katalizatorët e një jete, që ai do ta konsideronte plotësisht humane.

Në botëkuptimin e shkrimitarëve tanë realistë këto qëndrimet do të kapërcehen përfundimisht. Rolin e dhunës në shndërrimet politike e kishte shprehur më parë Fan Noli në vjershët e ciklit biblik. Në këto krijime ai, i pashkëputur nga pikëpamjet e tij mesianiste, e ka kthyer atë në një të drejtë që mund ta ushtrojë vetëm individi, i aftë të kryejë realizime të mëdha, po pa u kuptuar dot nga «turma». I nxitur edhe nga zhvillimet e ngjarjeve në Evropë, Noli në ndonjë rast arriti të kapërcente qëndrimet mesianiste dhe të zëvendësonte nën-vleftësimin e «turmës», i natyrshëm për ato qëndrime, me besimin e plotë ndaj saj. Ai mundi ta konceptonte dhunën lidhur ngushtë me kontradiktat klasore, si veprim revolucionar të masave popullore. Këto ndryshime në pikëpamjet e poetit bënин të mundur thellimin e vlerësimeve realiste në veprën e tij («Anës lumenjve», «Rent or Marathonomak»).

E gjithë vepra e Migjenit, në mënyrë të veçantë «Poema e mjerimit», është, në një pikëpamje, shprehje e shkëlqyer e mendimit se humanizmi, që të jetë vërtetë i tillë, duhet të flakë tutje mëshirën që iu është ngatërruar nëpër këmbë vazhdimisht edhe humanistëve më të shquar të së kaluarës; duhet të flakë tej bindjen e moskundërshtimin, që shpesh e kanë kthyer humanizmin në demagogji e, për pasojë, në antihumanizëm.

Ai mbante qëndrime thellësish kritike ndaj gjithë shty-llave të humanizmit borgjez, i cili mbështetetj në një moral, që, në forma nga më të ndryshmet, synonte të përjetësonte su-ndimin e një pakice mbi shumicën. Ai ironizoi artin që nisej prej këtij morali, duke treguar hapur falsitetin e tij («Nove-lë mbi krizën», «Programi i një reviste» etj.). Migjeni mund

të lëkundej hera-herës në besimin e tij për një të ardhme më të mirë të njerëzimit, i shtyrë nga disa motive, po ndër-kohë, ai në asnjë rast nuk qëndroi në pozitat e humanizmit pasiv, në asnjë rast nuk e barazoi humanizmin me durimin, me shpresën e amshuar, që për të, ishin shprehje e hipokrizisë më të urryer. Patosi kritik që krijuan shkrimtarët më përparrimtarë të viteve '20-'30 në pasqyrimin e njeriut në letërsi, solli në qëndrimet e tyre humaniste një përbajtje të re, të panjohur nga letërsia e epokës së Rilindjes. Ai përbën njëkohësisht një nga arritjet më të rëndësishme të drejtimit realist.

\* \* \*

Pas kësaj paraqitjeje të shpejtë e të përgjithshme, të karakteristikave të botëkuptimit, të disa shkrimtarëve përparrimtarë të viteve '20-'30, në të cilën domosdo u prekën dhe çështje të brendisë së veprës së tyre, metodikisht është më e përshtatshme të nisemi nga përbajtja e romantizmit rilindës dhe, në vështrim krasues me të, të vëmë në dukje ndryshimet që pësoi letërsia e miëvonshme, duke arsyetuar njëkohësisht mbi shkaqet që i bënë të mundura.

Atdheu, historia e tij, liria e shumëpritur, motivet që përbënин boshtin e romantizmit shqiptar, vazhduan të jenë të afërtë për shkrimtarët tanë edhe pas Shpalljes së Pavarësisë; atyre do t'u kthehen Noli, Asdreni, Haki Stërmilli në dramat e tij, Lazgushi, N. Bulka e Migjeni. Vetëdija se pavarësia u arrit me shumë mundime, se ajo nuk u shtri në të gjitha trojet shqiptare, se edhe ashtu e cunguar kërceno-hej vazhdimi sht nga shumë rreziqe, është gjithënjë e gjallë, sidomos në krijimtarinë poetike, po edhe në prozën e atyre viteve. Për shkrimtarët përparrimtarë të asaj kohe atdheu është, sigurisht, dashuria e malli për të, historia e popullit, janë zakonet e traditat e lashta, veçoritë kombëtare të ruajtura ndër shekuj, është lufta për mbrojtjen e kufijve, kundër insinuatave dhe armiqësisë së fqinjëve shovinistë agresorë. Po përgjithësisht tema atdhetare me këtë brendi në letërsinë e viteve '30 ka filluar të tkurret. Nga ana tjetër, motivet e saj trajtohen thuajse gjithnjë të gërshtuara me motive shoqërore. Tani Shqipëria është vendi i problemeve të mëdha socia-

le, i kontrasteve, i prapambetjes dhe i luftës që bëhej e duhej bërë kundër tyre. Edhe më parë Çajupi e Asdreni çështjen kombëtare e panë lidhur ngushtë me domosdoshmérinë e qëndrimeve të prera kundërshtuese ndaj parësisë feudale. Zgjidhja e çështjes kombëtare, për ta, nuk mund të realizohej pa mënjanuar prej saj feudalizmin, jo më duke heshtur e as duke i bërë lëshime, po duke luftuar hapur kundër tij. Çajupi nuk u mjaftua vetëm me kaq; në poezinë e tij ai tregoi se tek feudalizmi shihte burimin e shumë të këqijave të tjera shoqërore. Kjo anë e brendisë së krijimtarisë së tyre, prirja për të zbuluar qëndrimet e interesat e kundërtë sociale, nuk ka mbetur vërtet në periferi të saj, po në përgjithësi s'ishte ndër më të thelluarat. Sidoqoftë, disa premissa i krijoj dhe Migjeni, N. Bulka e shkrimtarë të tjerë të viteve '30 do ta shikojnë e do ta krijojnë letërsinë si pasqyrë analitike të jetës, të shoqërisë në kontradiktat e saj antagoniste.

Nuk është vështirë të merren me mend shkaqet e këtij ndryshimi të rëndësishëm që pësoi letërsia jonë në rrjetin e veta. Megjithëse atdheu u copëtua keqas dhe populli ynë pësot padrejtësi të mëdha e zhgënjime të thella, përsëri problemi kombëtar, me Shpalljen e Pavarësisë e një varg ngjarjesh të tjera, mori një zgjidhje, të cunguar vërtet, po që bëri të mundur krijimin e shtetit shqiptar. Pas viteve '20 letërsia në përgjithësi nuk ndeshej më me këtë çështje. Natyrisht, revolta ndaj arbitraritetit e arrogancës, me të cilat ndërhyjnë shovinistët dhe fuqitë e mëdha në çështjen tonë kombëtare, jetonte vazhdimi i ndërgjegjen krijuese të shkrimtarëve përparimtarë edhe më pas. Po ndërkojë, shqetësimet e mëdha ishin të një natyre tjetër, angazhimi politik i shkrimtarëve tanë përcaktohej nga qëndrimet që mbanin ndaj problemeve të shumta shoqërore. Skiroi dhe Fishta u veçuan nga shkrimtarët e tjerë të Rilindjes dhe përfaqësuan një prirje krejt të kundërt në brendinë e letërsisë së kohës për shumë arsy, po ndër kryesoret ishin, sigurisht, pikëpamjet e tyre mbi rrugët e zgjidhjes së çështjes kombëtare. Fishta, Koliqi, Haxhiademi e ndonjë tjetër u bënë bartës të një prirjeje thellësishët antirealiste në letërsinë e viteve 1912-1939, sepse shmanqën nga vepra e tyre çështjet shqetësuese të shoqërisë shqiptare dhe krijuan një mjegullnajë iluzioniste mbi jetën. Vlerësimet kritike ndaj shoqërisë së viteve '20-'30, ose përkundrazi, mënjanimi i tyre nga letërsia, ishin guri i provës që i ndante krijimet e asaj kohe në dy grupe, romantike përparrimtare e realiste nga njëra anë, dhe romantike reaksionare

e klasikegjante, nga ana tjetër. Studiuesit tanë kanë analizuar dhe kanë vënë në dukje më kohë e në mënyrë të hollësishme problematikën shoqërore të krijimtarisë së shkrimtarëve përparimtarë të viteve '20-'30, prandaj po të ndalemi në të, nuk do të bëjmë gjë tjetër vëçse të përsërisim tezat dhe vlerësimet tashmë të njohura<sup>1</sup>. Këtu do theksuar fort se përpjekjet e shkrimtarëve përparimtarë të atyre viteve për ta konceptuar në mënyrë materialiste jetën, dhe pse jo gjithnjë konsekuenta e të qarta, u hapnin rrugë pasqyrimeve sa më objektive të saj, zgjeronin në mënyrë shumë të dukshme tematikën shoqërore, përpunonin edhe teorikisht e argumentonin nevojën e domosdoshme që letërsia shqipe të zhvillohej vetëm si letërsi realiste. Ky konceptim shfaqej në radhë të parë, në këmbënguljen e shkrimtarëve për të parë pas shumë dukurive të shëmtuara të jetës, pas shumë problemesh etike nga më të ndryshmet, shkaqe ekonomike, ndryshimet kolosale në nivelin e jetesës që e polarizonin shoqërinë në grupime të kundërtë. Premisat e një mënyre të tillë të të menduarit artistik i gjej më që tek Naimi, më të theksuara tek Asdreni e sidomos Çajupi. Po në krijimtarinë e N. Bulkës e të Migjenit më shokë, siç është vënë në dukje, janë mënjanuar iluzionët mbi mundësinë e zgjidhjes së problemeve sociale nëpërmjët rrugësh etiko-filosofike, pas të cilave imbahej Naimi e De Rada paratij. «Poema e mjerimit», shumë skica, si dhe novelat «Studenti në shtëpi», «Historia e njërës nga ato», «Bukën tonë të përditshme falna sot...» të Migjenit, skicat, pamphletet, fejtonet e N. Bulkës e vjershat e Kristaq Cepos e shkrimtarëve të tjera janë mjaft shprehëse për të treguar gjithashtu se që këtej, nga vlerësimi ekonomik i realitetit jetësor, marrin shkas që ndrimet kritike ndaj sistemit shoqëron. Letërsia përparimtare e viteve '30 në prirjet e saj kryesore arrin të zbulojë së në themel të marrëdhënieve shoqërore, të cilat ajo i koncepton si shumë të ndërlikuara, qëndron gjithnjë një ësencë ekonomike, një mënyrë tmerrësisht e padrejtë e shpërndarjes së të mirave materiale. Ky tipar i ri i brendisës së letërsisë përparimtare të atyre viteve shfaqet qartë që në titujt e shumë krijimeve të N. Bulkës e Migjenit: «Një përpjekje tragjiko-

1) Shih: M. Gurakuqi, Autorë dhe probleme të letërsisë përparimtare shqipe, të viteve 30, Tiranë 1966; në mënyrë të veçantë shih studimet: K. Bihiku, Proza e Migjenit, në librin «Probleme letrare» Tiranë 1979; M. Xhaixhiu, Parathënie në botimin e veprës letrare të Nonda Bulkës, Tiranë, 1980.

mike me mis Krizën», «Zbritja e rrogave», «Tragjedia e mierillit», «Legjenda e misrit», «Bukën tonë të përditshme falna sot...» etj. Në këtë rrugë vepra e Migjenit dhe e N. Bulkës atakonte drejtpërdrejt konvencionet morale të krijuara prej kohësh nga klasat shfrytëzuese, i stigmatizonte ato rëndë dhe përpunonte një mënyrë të re të menduarit e të pasqyrimit artistik, që edhe pse mund të vuante nga paqartësi të natyrave të ndryshme, nuk pajtohej kurrsesi me paprekshmërinë e miteve, në mënyrë të veçantë me mitin mbi «drejtësinë» dhe «harmoninë» e shoqërisë së kohës<sup>1</sup>. Shprehja artistike e këtij qëndrimi ishte një nga arritetjet më të shënuara të brendisë së letërsisë realiste të atyre viteve, ashtu siç ishte sukses i dukshëm fakti që ajo, në veprat e saja më të mira, siç do të përpiqemi ta vëmë në dukje, pasqyroi në një shkallë të caktuar pikëpamjen se jeta shpirtërore e njeriut, mëndësia e tij varet nga kushtet e jetesës dhe, për pasojë, psikologjia, sjellja dhe morali i një personazhi varen po ashtu nga një varg faktorësh socialë e materialë konkretë, që përcaktojnë në fund të fundit tiparet e tyre. (Kola e Filipi të novelës «Bukën e përditshme falna sot...», Lukja tek «Historia e njërës nga ato», Xheladin beu i novelës «Vjeshta e Xheladin beut», Hanko Halla etj.). Novelat e Migjenit janë bartëset më të arrira të kësaj prirjeje ideoartistike, e cila, sigurisht, për shkakte të ndryshme, nuk mundi të merrete përmasa të gjera e të plota; po megjithatë, krijoj një dallim cilësor në krahasim me romantizmin rilindës: letërsia përparimitare e viteve '30 e kapërceu përfundimisht pikëpamjen se vendin e njeriut në shoqëri e përcakton vetëm shkalla e arsimimit, edukata që ka marrë dhe tiparet morale të fituara prej saj.

Krijimtaria e autorëve të periudhës së Pavarësisë u kthye ballas nga realiteti objektiv i kohës, në radhë të parë nga njeriu i atyre viteve. Në qendër të morisë së temave të trajtuara prej saj janë vendosur gjithnjë fatet e njerëzve të thjeshtë të vegjelisë së fshatit e qytetit. Bota e tyre shpirtërore është e thjeshtë dhe e qartë, e mbushur me shqetësimet e jetës së përditshme, pa pasione të mëdha. Ankthi i luftës për ekzistencë, dhembja e ardhur nga nëpërkëmbja e dinjitetit njerëzor, naiviteti hera-herës, më rrallë zemërimi që kërkon të shpërthejë, këto janë disa nga tiparet e psikologjisë së personazhevë të një pjese të novelave e të skicave të Migjenit, të skicave,

---

1) Shih: A. Uçi, **Mitologjia, folklori, letërsia**, Tiranë 1982, f 336.

fejtoneve e pamfleteve të N. Bulkës; ato janë gjithnjë të motivuara në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale.

Trishtimi, vuajtja, një prirje e herëpashershme për të medituar mbi shkaqet e gjendjes së tyre sociale, janë të tjera tipare të botës shpirtërore të personazheve të prozës së Migjenit, të cilët, në mënyra të ndryshme, vënë gjithnjë në dukje se u takojnë të përbuzurve të kësaj jete (Lukja, Kola, malësorët e skicës «Legjenda e misrit» etj.). Rrallë, po me një forcë të veçantë, pakënaqësia e tyre merr trajtën e zemërimit shpërthyesh që do të mund të shkatërronte gjithçka. («Mollë e ndalueme»). Me një intuitë të hollë realiste Migjeni vërente se kjo revoltë nuk mund të shkonte larg, për deri sa mbetej e vetmuar. Edhe pse mund të mos i kishte gjer në fund të qarta shkaqet e asaj gjëndjeje shpirtërore apatike që sundonte në ato kohëra, Migjeni e ndiente fort mirë dhe shihte me dhembje se njerëzit e thjeshtë, të vuajturit dhe të mjeruarit, që ai i donte aq shumë, hë për hë nuk ishin në gjendje të ndërmerrnin lëvizje të rëndësishme shoqërore; vetëdija social-politike e tyre ishte ende e mjegulluar: «*Kush ka faj? Kola thotë askush s'ka faj dhe aty qëndron e tanë tragjedia e tij*» — shkruante Migjeni në novelën «Bukën tonë të përditshme falna sot...» — duke u shkëputur nga rrëfimi, siç ndodh hera-herës në prozën e tij tregimtare, për t'u shprehur me ligjërimin e drejtpërdrejtë të autorit: «*Vuajtja intime dëshpëruese, e cila t'udhëheq në vetëvrasje. Por mirë asht që Kola mendonte ashtu e jo ndryshe. Ta dinte ai se kush e ka fajin, ose së paku t'ja kishte vue ai vetë kuj fajin, atëherë, eh atëherë... Fuqitë e njerëzve n'ankant kushedi si do të veprojshin*».<sup>1</sup> Sigurisht, Migjeni nuk shfaq asnjë shenjë qëndrimesh nënvlerësuese ndaj personazheve të tij, përfaqësues të vegjelisë, po as nuk ekzaltohet prej tyre. Keqardhja e thellë është ndjenja që sundon në marrëdhëniet e shkrimitarit me kriesat e veta. Ndryshe ndodh në poezi, ku patetika është vërtet e fuqishme, ndërsa ndjenja e revoltës, sidomos në disa vjersha të «Këngëve të ringjalljes» e «Këngëve të mjerimit» është e thellë e konsekuenta. Ç'brendi kishte ëndrra e poetit, cilat forca do të mund të shndërronin atë në realitet, për këto çështje përfytyrimet e Migjenit, siç do të mundohemi të provojmë edhe më pas, mbeten ende të paqarta dhe jo gjithnjë

1) Migjeni, *Veprat*, mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, Tiranë 1961 f. 206. Edhe këtej e tutje citimet nga kjo vepër janë të këtij botimi.

të drejta. Është edhe kjo një ndër arsyet që poezia e tij në shumë anë nuk iu largua frysë së përgjithshme romantike.

Po le të kthehem tek personazhet e prozës së tij. Pasi guria e jetës, tretja e shpresave të tyre të vogla, në një shkallë e në një tjetër, i bën të jenë skeptikë, në ndonjë rast edhe cinikë: «*C'e do burrin pá punë — i tha një shoqe këto ditë*» — kujton gruaja e Kolës. — «*Dhe gruaja e votrës nuk ndjen shum' pér burrin e pa punë. Po burri me çka dallohet nga grueja? Jo vetëm me pantallona, po me punën që ban pér t'i sigurue grues mirë gjendjen... E kur burri s'e ka at punë, atëhere ç'e don? Të na lëshojnë vetë ta fitojmë jetesën, por as njatë s'të lanë, të qesin ngatrresa...*». (Vepra f. 210, 211.) Megjithatë, egoizmi pér ta është i huaj. Ata mbeten gjer në fund njerëzorë edhe në disfatën e plotë që pësojnë. Ashtu siç janë të shqetësuar vazhdimisht pér jetesën e përditshme, interesimet e tyre intelektuale janë sigurisht të varfra, po kjo nuk u ka deformuar shpirtin, pa çka se detyrohen të sigurojnë ekzistencën në mënyra që i urrejnë, që janë krejt të kundërtame karakterin e tyre (prostitucioni i Lukes, malësores, së shqes së Kolës, servilizmi i malësorit etj.).

Marrëdhëni e konfliktet midis personazheve, sidomos në novelat e Migjenit, pasqyrojnë raportet midis shtresave e klasave të ndryshme shoqërore. Jeta e tyre, mënyrat e reagimit ndaj ngjarjeve, ndjenjat, qëndrimet e pikëpamjet mbeten të kushtëzuara nga tiparet më të qenësishme të strukturave shoqërore-ekonomike të kohës. Protesta e dobësia e Nushit, që në rastin më të mirë arrin gjer te ironizimi i padëmshëm i shoqërisë, ndërsa në rastin më të keq, në pranimin e hipokritisë, si rrugë që siguron «qetësinë shpirtërore», është pasqyrim i vanitetit të inteligjencies së ardھur nga shtresat e borgjezisë e të mikroborgjezisë, e paaftë të ndërmerrte veprimtari serioze në të mirë të përparimit. Filipi dhe Kola tek novela «Bukën tonë të përditshme falna sot» i ndjejnë ngjarjet dhe sillen ndaj të tjerëve në mënyrë krejt të ndryshme; dashamirësia hipokrite e Filipit s'është gjë tjetër veçse mendësia filistine e mikroborgjezit, i cili e kthen në kërthizë të jetës pasurinë që ka vënë dhe marrëdhëni me njerëzit i ndëronton vetëm në funksion të saj. Filipi është krejtësisht indiferent ndaj fateve të të varfërve, prej nga ka dalë edhe ai vetë.

Në pajtim me kërkessat politike të Lëvizjes së Rilindjes, letërsisë së kohës i duhej të krijonte, në radhë të parë, heroin që mbartte idealet e mëdha të lirisë, shumë të gjalla në jetën

shpirtërore të atyre ditëve. Sigurisht, ai pati natyrë komplekse, po mëdyshjet, kërkimet e shqetësimet e tij, në pajtim me frymën romantike, me të cilën u krijua, i shprehu kryesishët në mënyrë subjektive e në rrafshin filozofik-etik. Në periudhën që erdhi pas Shpalljes së Pavarësisë, siç qe e natyrshme, idealet përparimtare dhe bartësit e tyre në letërsi do të këmbezin natyrë; ato duhej të fitonin brendi më të theksuar sociale, të synonin krijimin e një shoqërie më të drejtë, me të vërtetë njerëzore.

Pas shtypjes së Revolucionit demokratiko-borgjez të vitit 1924, borgjezia u pajtua shumë shpejt me gjendjen e krijuar dhe u bë përkrahëse e monarkisë zogiste. U takonte forcave të tjera shoqërore, i takonte proletariatit të merrte në duart e veta idealet revolucionare, të braktisura prej borgjezisë. Mirëpo proletariati në vendin tonë ishte ende i vogël, i paformuar nga pikëpamja ideologjike; partia politike e tij nuk ishte krijuar. Në amullinë e jetës shpirtërore të kohës shkrimitarët realistë e kishin të vështirë të dallonin forcat shoqërore ku duhej kërkuar e gjetur heroi, që do të shprehte artistikisht idealet përparimtare, drejt të cilave aspironte shqiptari i atyre viteve. Reaksioni i egër i aleancës së feudalizmit dhe borgjezisë, që kishte te monarkia zogiste një mjet të ushtrimit të dhunës kundërrevolucionare, mbetej zot i fateve të vendit dhe luftontë me të gjitha mënyrat çdo mendim e lëvizje përparimtare. Po t'u shtohet atyre rrëthanave çoroditja e jetës ideologjike, e cila, pa dyshim, linte gjurmët e saj edhe në pikëpamjet e shkrimitarëve përparimtarë, atëhere bëhet më e qartë përsë proza e një Migjeni nuk e pati të mundur të dallonte gjer në fund ata njerëz që mund të mos binin në sy, numrikisht mund të mos ishin aq të shumtë, po që në psikologjinë e veprimet e tyre mbartnin progresin, të ardhmen dhe, herët a vonë, do të realizonin tendencën përparimtare të zhvillimit historik të shoqërisë. Megjithatë, Migjeni e ndiente se përgjumja dhe apatia s'mund të vazhdonin gjatë. Më rrallë në prozë, me figurën e punëtorit të papunë («Mollë e ndalume»), e në mënyrë më të gjallë në poezi, ai arriti të paktën të shprehte shqetësimin pér domosdoshmérinë e përgatitjes së një force shoqërore, të aftë pér të realizuar ndryshime në jetë. Këtë forcë Migjeni nuk e konceptoi gjithnjë drejt; ai e shihte atë herë vetëm tek brezi i ri, herë te njerëz të veçantë, që s'janë përfytyruar të shkëputur nga ndikimi i Niçes («Të lindet njeriu», «Trajta e mbinjeriut»), e herë e humbet krejt besimin, jo vetëm ndaj saj, por edhe ndaj njeriut në përgji-

thësi («Sokrat i vuejtun, apo derr i kënaqur», «Tragjedi apo komedi»). Te N. Bulka thuajse mungojnë përpjekjet për të zbuluar forcat sociale që përfaqësonin prirjet pëparimtare të zhvillimit të shoqërisë. Tek ai është i dukshëm një lloj fataliteti, pasojë e qëndrimeve filozofike skeptike, që ai shprehu në disa nga krijimet e tij. Ndërsa në krijimtarinë e disa autorëve të tjerë të rinj si A. Varfi, P. Marko, A. Çaći, Q. Stafa etj., besimi për një të ardhme më të mirë për njeriun, sidoqë i thellë, ishte më fort shprehje e një èndërrimi entuziazist, që sillnin takimet me idetë komuniste.

Ndryshimet midis letërsisë së Rilindjes dhe krijimtarisë së prozatorëve realistë nuk qëndrojnë vetëm në mënyrën e përfytyrimit të heroit; ato janë më të shumta e shtrihen edhe në anë të tjera të pasqyrimit të njeriut.

Ndjenja e dashurisë pas së cilës tërhiqeshin aq shumë romantikët tanë, në krijimtarinë e Migjenit nuk renditet ndër më të rëndësishmet; për tëjeta është e mbushur me shqetësime më të mëdha. Fryma e trajtimit të saj në krijimet poetike mbetet përgjithësisht në ujërat e romantizmit, megjithëse Migjeni e ka shmangur atë tis hyjnizimi, me të cilën vishej dashuria në krijimtarinë e shumë prej shkrimtarëve të Rilindjes, po edhe të viteve të mëvonshme. Në poezinë e tij Migjeni e trajtoi dashurinë më shumë në rrafshin thjesht hedonistik gëreshetuar hera-herës edhe me vuajtjet që mbart, në përgjithësi me pasojet intime që ajo sjell në shpirtin e të dashuruarve.

Gruaja për Migjenin është një qenie thollësishët njerëzore, pa asgjë të veçantë, hyjnore ose përkundrazi, djallézore. Gruaja dhe burri janë krejt të natyrshëm në dashurinë e tyre, që duhet të qëndrojë në themel të krijimit të familjes; kjo është esenca e pikëpamjeve të Migjenit, tek i cili janë lënë mënjanë filozofimet e shumta mbi dashurinë si shprehje e një prirjeje të përgjithshme universale ose si një dhunti e veçantë e gruas, prej nga shpërthen bukuria në trajtën e saj më të përsosur, me ndikim vendimtar në jetën e gjithë njerëzimit. Në prozën tregimtare të Migjenit kanë zënë vend më të gjerë të tjera vlerësimë, ato që e shohin dashurinë si erotizëm që vështirë të ruajë pastërtinë e sinqueritetin e vet në një shoqëri, ku hipokrizia është shndërruar në një mjet që siguron ekzistencën. Çajupi, kur zemërohej ndaj komercializimit të dashurisë, shpeshherë nuk e ndante këtë qëndrim edhe nga paragjykimet që ai ushqente ndaj gruas. Ndërsa tek Migjeni gruaja që është kthyer në prostitutë, ajo që shkel kurorën, është gjithnjë viktimi e padrejtësive shoqërore, ekonomike dhe

morale. Atij i dhimbëj shumë Lukja, e përligj gjithnjë me dhembje veprimin e së shoqes së Kolës, nuk gjen arsyë të dënojë Agen, e cila hyri në rrugën e imoralitetit më të pranuar e më të justifikuar të asaj shoqërie.

Tek Nonda Bulka tema e dashurisë pothuajse nuk trajtohet fare dhe, kur preket, ajo vetëm ironizohet. I mësuar të shohë kudo hipokrizinë, pabesinë, N. Bulka e ka të vështirë, madje të pamundur të kuptojë se megjithatë, në çdo kohë dashuria tek njeriu i thjeshtë mund të jetë dhe është burim bukurie e force morale. Nonda Bulka, ndofta edhe nën ndikimin e leximeve, i mbahet pikëpamjes se gruaja, për nga natyra e saj, nuk mund të jetë bartëse vlerash morale; për të ajo mbetet një qënie, në mos tjetër, të paktën e mërzitshme në çdo rast.

Migjeni, me temperamentin e vet analistik, nuk është përpjekur ta idealizojë gruan, po dhe i padrejtë ndaj saj nuk është treguar.

Edhe ndaj natyrës reagimet e shkrimtarëve realistë janë krejt të ndryshme; në përgjithësi ata nuk i kushtojnë asaj shumë vëmendje. N. Bulka, me përjashtime të rralla, gati e ka lënë mënjanë; me prirjen e tij antiromantizante, ai, si duket, në parim nuk mund të pranojë që letërsia të merret me tema të tilla si dashuria pasionante e natyra, që sipas tij, janë kapërcyer e s'i përshtaten më mendësisë së njeriut të shekullit XX. Prandaj dhe skica e tij «Vetëm në gjirin e natyrës», më tepër se adhurimin ndaj natyrës, përmban qëndrime të thella kritike ndaj shoqërisë njerëzore, të cilat vështirë se mund të përfytyrohen jashtë ndikimit prej pikëpamjeve të Rusoit. «**C’do të bësh në botë? Atje do të piqesh me njeriun. . . Atje do të gjesh gënjeshtren dhe hipokrizinë, në çdo gjë dhe në çdo anë**»<sup>4</sup>.

pohon në mënyrë të prerë shkrimtari, i cili në ato vite pothuajse nuk shihte asnjë perspektivë, asnjë rrugëdalje. Skica tjetër «Varrim në heshtje» transmeton më fort një esencë filozofike, sipas së cilës shkrimtari i mundua për një çast prej ankthit të vdekjes, do të dëshironte që ajo ti vinte lehtë, ashtu njëherësh, në gjëzim e sipër, siç i vjen bilbilit.

Migjeni në poezi i kthehet herë pas here natyrës, pa e kthyer atë në vokacion të veçantë të krijimtarisë. Në skicat e më pak në novelat, natyra trajtohet si mjet artistik, përtë plotësuar pëershkrimin e mjedisit e përtë krijuar një kon-

1) Nonda Bulka, *Vepra letrare 1*, redaktuar nga R. Uçi, Tiranë 1980 f. 349. Citimet e tjera nga kjo vepër do të janë të këtij botimi.

trast tē fuqishëm që thekson fort idenë («Puthja e Cubit», «Bukuria që vret» etj.). Shumë i ndjeshëm ndaj natyrës është M. Kuteli, po peisazhet e tij mjaft tē goditura, nuk i përbajnjë krijimet e pakta që shfaqin prirjet realiste të prozës së tij; ato janë karakteristikë pér shumë tregime të tjera, të cilat nuk kanë tē bëjnë fare me realizmin, po mbeten romantike, madje, në disa raste, romantizante.

Ky qëndrim ndaj natyrës është në përputhje me logjikën e përgjithshme të krijimtarisë së shkrimtarëve tanë realistë. Arsyet që e kishin bërë natyrën një ndër atraksionet më të fuqishme të poezisë rilindëse, nuk ishin më. Nga ana tjetër, Migjeni me shokë, në konceptet teorike dhe në krijimtarinë artistike, në asnë rast nuk e menduan veten si njerëz tē shkëputur nga shoqëria, të pakuptuar prej saj e të ngushëlluar në natyrë. Pér ta shoqëria e kohës ishte e padrejtë, ajo mund tē mbetej pérjetësish tē tillë, po veçimi prej saj në emër tē qëtësisë shpirtërore vehtjake tashmë ishte anakronik, i pakuptueshëm, madje i dëmshëm. Krijimtaria letrare, sipas tyre, e justifikonte veten vetëm duke u angazhuar fort në luftën sociale. Prandaj personazhet e Migjenit e të N. Bulkës nuk kanë shumë arsyë tē merren me bukuritë e natyrës, aq më pak tē meditojnë gjatë mbi tē. Sigurisht, që tē gjithë ata e ndienin nevojën tē shkëputeshin pér një çast nga hallet e jetës; Migjeni e trajtoi në mënyrë tē veçantë këtë nevojë tē personazheve tē tij. Po ai e kuptonte fort mirë se t'i ngushëllonte ata sadopak me bukuritë e natyrës, ishte njëlloj si t'i ironizonte e tē mbante qëndrim cinik ndaj tyre.

Në pajtim me botëkuptimin e tij ateist, Migjeni krijoj personazhe, që mund tē mos e mohonin në mënyrë tē prerë hyjninë, po pér ekzistencën e saj, tē paktën si forcë që ndërhynte e vendoste drejtësinë në tē mirë tē tē mjeruarve e tē tē vuajturve, dyshonin thellë («Në kishë», «Bukuria që vret»). «*Një ditë, — shkruan Migjeni në skicën «Zoti tē dhashtë» — me një buzëqeshje ironike, duel lypsi nga një ndërtësë me kryq në majë, se aty kishte vështruar këto fjalë: «Zoti që kujdeset pér zoqt e qielles, s'ka me i lanë njerëzit tē vdesin nga uja.» Hee — thoshte lypsi tue dalë — sot nuk asht nj'ashtru. Zoti ndoshta kujdeset pér trumcakët edhe pér priftnt, po pér mue s'e besoj. Mue dhe shokët e mij po na harron dhe bota, e si mos tē na harrojë zoti që s'na ka parasysh. Por thonë, se zoti...» (Vepra, f. 139.). Edhe në novelat e tij personazhet nuk vuajnë prej ndonjë afeksioni tē veçantë fetar; çastet e përdëllimit mungojnë krejt. Po ndërkaq, disa prej tyre janë robër tē pa-*

ragjykimeve e fanatizmit fetar. (Osoja tek «Të çelin arkapi-jat», i ati i Nushit tek «Studenti në shtëpi» etj.). Ashtu si tek Migjeni, edhe në krijimtarinë e N. Bulkës, qëndrimet anti-klerikaliste e ateiste janë të harta, pa asnje ekuivok.

Ndërsa përgjithësish nuk lektisen pas ndjenjës së dashurisë, janë të ftohtë ndaj natyrës e në mëdyshje të thella ndaj zotit, personazhet e prozës tregimtare të Migjenit, po edhe të skicave e fejtoneve të N. Bulkës, e kanë zakon të arsyetojnë mbi jetën e përditshme dhe të arrijnë në përfundime, që herë kanë karakter të mprehtë dramatik e herë ironizojnë në mënyrë therëse, duke ruajtur një esencë të qartë kritike. «*Unë jam pa moral, — arsyeton Nushi, — koncepti i em menduem — mos me thanë ideologjik — nuk pajtohet me moralin, të cilin mue kjo shoqni ma imponon. Por unë e marr moralin e saj për sy e faqe, n'sa mbrapa ja loz lojen kur të due. Kështu si unë ja lozin lojën shoqnis' me qinda veta në vendin tonë. Prandaj shoqni po deshe të mos lozin në kurriz tand, ndro format. Hiqi bragashat*»\*. (Vepra, f. 181). «*Paraja është si një aktor, që mban në dorën e vet një marionetë dhe e dredh e e përdredh, e ngre e zbret, e flak, e puth, e pushton, e shkelmon dhe pastaj e vdes. Marioneta është njeriu. Po, zotni, njeriu i logjik-shëm*», — shkruante N. Bulkë tek «Floriri», (f. 119), sipas mënyrës së tij të njojur, që i transmetonte përgjithësimet më shpesh përmes paraqitjes së drejtpërdrejtë të pikëpamjeve të tij e më rrallë përmes ligjërimit të personazheve.

Personazhet e prozës së Migjenit e të N. Bulkës nuk kanë shumë kohë të ëndërrojnë; siç qenë të preokupuar për të fituar jetesën e çdo dite, kërkesat e tyre janë krejt konkrete, ato kanë të bëjnë me gjetjen e një pune të çfardoshme, me sigurimin e misrit, shtytjen edhe për një kohë të borxheve të shumta e të tjera si këto. Ata e ndiejnë fort jetën, e cila tre-gohet e pamëshirshme ndaj tyre, po megjithatë nuk i ngrejnë kulte pasionit, bukurisë, zotit, si rrugë të vetme, që mund të përmirësojnë shoqërinë. Ata janë të bindur se faktorë të tillë si «arsyeja», «mëshira kristiane» e «ndjenja», në përgjithësi kërkesat për përsosjen morale të njerëzve, nuk ndikojnë në ndryshimin e gjendjes së tyre materiale, prandaj për ta një

\* Shumë studjues që janë marrë me Migjenin i kanë shfrytëzuar pa «mëshirë», këto rradhë që mbyllin novelën «Studenti në shtëpi». Po s'kanë pasur si të vepronin ndryshe; ato vijnë vetiu në majë të pendes, kaq e ngjeshur është përbajtja e tyre, kaq shprehëse janë për të treguar thellësinë e pikëpamjeve të shkrimtarit për shoqërinë e ditëve të tij.

shpirt sentimental e përdëllimtar ishte i huaj e i pakuptuar. Disa nga personazhet e tij arrijnë të krijojnë bindjen se mënyra e organizimit shoqëror ishte e padrejtë dhe duhej ndryshuar, se shoqëria ku bënин pjesë ishte armiqësore ndaj njerëzve si ata dhe, ç'është më e rëndësishme, të kuptojnë se largimi i ndërgjegjshëm prej saj në emër të triumfit moral mbi të, nuk i lehtësonte aspak, ashtu siç nuk i lehtësonte as bukuria e dashurisë dhe e natyrës, dhe as besimi në drejtësinë hyjnore e botën e amshuar. Prandaj hera-herës personazhet e Migjenit jetojnë një gjëndje shpirtërore padurimi, që kërkon të shpërthejë, të përblysë, të ndryshojë. Po nuk janë të rralla rastet kur Migjeni, që i ndiente thellë të vërtetat e jetës, përshkruante, veç virtyteve të njerëzve të thjeshtë, edhe një lloj rezignacioni të tyre, edhe një farë shtrembërimi moral të shkaktuar nga rrëthanat materiale e shoqërore, me të cilat ndodh që ata të pajtohen të përulur.

Realistët tanë u përpinqen të pasqyronin përbajtjen morale të njeriut bashkëkohës në kompleksitetin e saj. Me personazhet që krijuan, ata sollën në letërsi mendësinë e shtresave të ndryshme shoqërore. Natyra plotësisht regresive e feudalistështë përshkruar edhe nga Çajupi, po pa mundur të krijonte një karakter që arrihet në prozën e M. Kutelit. Migjeni nuk u mor me pasqyrimin e hollësishëm të psikologjisë feudale sunduese në atë kohë. Tek «Të çelen arkapijat» ai preku vetëm një anë, moralin patriarkal dhe fanatizmin e verbër, po në tërësi dukej se ai mendonte që ajo lloj mendësie kishte natyrë shumë të dukshme anakronike dhe, si e tillë, nuk qe e vështirë të kuptohej thelbi i saj krejtësisht reaksionar. Migjenin e interesonin më shumë dukuritë negative që vinin nga Ilustra e një qytetërimi të kalbur, nga padrejtësitë e mëdha shoqërore, nga gjendja krejtësisht e pabarabartë në ndarjen e të mirave materiale etj. Prandaj në prozën e tij stigmatizohen më fort psikologjia mikroborgjeze e intelektualit vanitoz, e tregtarit filistin, që ka siguruar një mënyrë të ekzistencës dhe të fitimit, feja si botëkuptim etj. Kështu ndodh pak a shumë edhe në shkrimet e N. Bulkës, po sigurisht, pasqyruar në një mënyrë tjetër.

Në përputhje me stadin e zhvillimit të borgjezisë në vendin tonë, letërsia e kishte të pamundur të krijonte, ta zëmë, një Votren apo një Rastinjak. Ashtu siç qe, e pazhvilluar si duhet, borgjezia shqiptare nuk mundi t'i ofronte letërsisë as prototipin që do ta përfaqësonë atë si klasë. Sigurisht, në krimtarinë e realistëve të viteve '30 u pasqyruan edhe mjaft

probleme që karakterizonin një shoqëri ku borgjezia luante një rol të caktuar. Megjithatë, proza e atyre viteve, duke qenë përgjithësish në fillimet e saj, po në radhë të parë, sepse vetë jeta, për shkaqe të njoitura, nuk njihte zhvillime të thella të natyrës borgjeze, e kishte objektivisht të pamundur të krijonte figura të plota përfaqësuese të borgjezisë. Mendësia e kësaj klase erdhi në letërsi kryesish nëpërmjet gjykimeve të shkrimtarëve e reagimeve të tyre ndaj plagëve shoqërore e morale që sillte ajo. Mënyrat e jetesës në atë periudhë historike ishin të tilla, që nxirrin më fort në pah psikologjinë mikroborgjeze të qyteteve dhe gjendjen ende të përhumbur të vetëdijes së masave punonjëse. Prandaj në krijimtarinë realiste të prozës së asaj kohe mungojnë karakteret që, edhe pse të nisura nga synime egoiste, do të dallohen për energji e forcë veprimi e realizimi; borgjezia e mefshtë nuk kultivonte dot karaktere të tilla. Është kjo një ndër arsyet, që vepra e realistëve tanë synoi më fort të pasqyronte krizën e moralit të kohës.

Ndërkaq Migjeni e brezi i poetëve përparimtarë të viteve '30 ishin të bindur se morali i ri duhej kërkuar gjatkë, ndër shtresat shoqërore demokratike që e ndjenin se rendi i vendsur e morali i ngritur mbi të ishin të padrejtë, të përkohshëm dhe do të kapërçeheshin. Pathosi që buronte prej kësaj bindjeje do të mbetej edhe për një kohë subjektiv, një gjëndje ende e vecantë shpirtërore karakteristike për mendësinë e intelektualëve progresistë, të cilët nuk pajtohen me format ekzistuese të organizimit shoqéror dhe, të nisur nga ndryshimet e mëdha që po ndodhin në botë, nga rritja dhe forcimi i lëvizjes demokratike, përfytyronin se edhe vendi i tyre do të jetonte përbysje rrënjosore. Ky pathos u shpreh në letërsi përmes notash të qarta të romantikës revolucionare,<sup>1</sup> të cilat u zgjeruan e u thelluan shumë në krijimtarinë e viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare.

\* \* \*

De Rada më parë në veprën «Parimet e estetikës» dhe Çajupi e Asdreni më pas kanë shprehur vlerësimet e tyre

1) M. Gurakuqi, Autorë dhe probleme të letërsisë përparimtare shqipte të viteve '30. Tiranë 1966 f. 33.

mbi rolin e letërsisë dhe raportet e saj me shoqërinë e individualin. Është e njohur këmbëngulja e De Rädës për njohjen e funksioneve të veçanta edukuese të artit;<sup>1)</sup> është e njohur gjithashtu që krijimtaria e Çajupit, në kundërshtim me pikëpamjen e tij,<sup>2)</sup> nuk transmetonte aspak tek lexuesi ndjenjën e kalimit të këndshëm të kohës, ndërsa Asdreni vetëm për periudhat e fundit shkroi vjersha që nuk shkonin gjithënë dora dorës me ngjarjet politikë aktuale<sup>3)</sup>. Sidoqoftë mendimi estetik gjatë Rilindjes ishte ende në lindje e sipër; zhvillim të madh ai nuk njohu as më pas, po megjithatë shkrimitarët përparimtarë e ndjenë të domosdoshme të formulonin edhe teorikisht pikëpamjet e tyre mbi letërsinë<sup>4)</sup>. Sigurisht artikujt që botuan nuk kishin marrë përsipër të përpunonin doktrina të plota letrare, ata argumentonin nevojën imediate që letërsia të zhvillohej vetëm si letërsi realiste.<sup>5)</sup> Po estetika e realizmit ishte më e gjerë nga ç'mund të jetë paraqitur në ata artikuj, prandaj tiparet e saj në atë shkallë që u zhvilluan, duhen kërkuar më fort në brendinë e krijimtarisë që lanë Migjeni e N. Bulkë me shokë.

Tek vështrohet nga kjo pikëpamje vepra e tyre, bie në sy fare lehtë se ky grup shkrimitarësh vazhduan traditat e letërsisë së Rilindjes dhe mbeten krijues thellësisht tendenciozë. Tek përiqeshin të jenë objektivë në pasqyrimin e jetës, ata nuk mbeten që ka letërsia, si lloj i veçantë artistik. Për veprën e ndonjërit prej tyre, N. Bulkës p.sh., mund të diskutohet nëse tendanca është shprehur gjithnjë në përpunim me specifikën që ka letërsia, si lloj i veçantë artistik. Po është fare e qartë që novelat e Migjenit e shumë nga skicat e tij nuk mund të krijuar në qoftë se ai nuk do të mbante ato qëndrime aq të angazhuara ndaj shoqërisë së kohës. Kjo është një ndër arsyet që krijimet e Migjenit, sidomos novelat

1) Shih më hollësisht: A. Uçi, **Probleme të estetikës**, Tiranë, 1976 f. 303-317.

2) **Historia e letërsisë shqiptare**, Tiranë 1983, f. 410.

3) Shih më hollësisht: **Historia e letërsisë shqiptare**, Tiranë 1983 f. 419.

4) Shih më hollësisht: M. Gurakuqi, **Autorë dhe probleme të letërsisë përparimtare shqipe të viteve '30**, Tiranë 1966, f. 7, 8, 10, N. Jorgaqi; **Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504-1944**, Tiranë 1974, f. 46-50.

5) Për mendimin teorik që luftonte për një letërsi realiste shih më hollësisht: A. Uçi, **Mitologjia, folklori, letërsia**, Tiranë 1982 f. 324-336.

e tij, shënuan arritjet më të mëdha të realizmit në letërsinë shqipe.

Romantizmi rilindës gjente tek tema historike rrugën më të përshtatshme për të pasqyuar problemin jetik të epokës, problemin kombëtar. Si e kemi vënë në dukje, një krahasim sado i shpejtë midis tij dhe veprës së Migjenit e të shkrimitarëve të tjera përparimtarë të periudhës së Pavarësisë, nxjerr në shesh se interesi për temën historike tek këta të fundit ka rënë, natyrisht, pa u shuar krejt. Edhe Çajupi, ndër poetët rilindës, nuk u tërroq shumë pas kësaj teme. Duke hequr dorë prej saj, Migjeni me shokë tregonin jo vetëm se në rrethanat e reja politike e ekonomiko-shoqërore, shqetësimet e kohës kishin ndërruar natyrë, po edhe se e vërteta mbi to, që kërkohej me ngulm prej tyre, në kushtet e reja politiko-sociale nuk mund të zbulohet deri në fund veçse duke ia hyrë studimit dhe pasqyrimit të drejtpërdrejtë të realitetit. Ishte e natyrshme që ky synim, i cili konsiderohej si themelori në krijimtarinë artistike, të mbartte në vetvete zhvillime të realizmit në veprën e tyre.

Në praktikën krijuese të realistëve tanë disa tipare të romantizmit e të sentimentalizmit domosdo do të liheshin menjanë. Mëdyshjet e zhbirimet në botën shpirtërore vjetjake e të tjera si këto sigurisht, nuk do të shmangeshin nga letërsia, po edhe nuk do të mbeteshin ndër karakteristikat themelore të saj. Kështu do të ndodhët me fantastiken, subjektiven, heroin me shpirt të trazuar etj. Në një etapë të caktuar historike të gjithë këta përbërës të veprës letrare kanë qenë të natyrshëm, ata pasqyronin në mënyrën e tyre një të vërtetë të kohës, pakë-naqësinë e thellë të shkrimitarit ndaj robërimit e prapambetjes së atdheut. Për të zbuluar të vërtetën, shumë komplekse dhe të ndërlikuar të shoqërisë, procedimet artistike të ndjekura nga letërsia e mëparshme, në rastin më të mirë, mund të aludonin ndaj problemeve shqetësuese sociale e etike të kohës, po në përgjithësi ishin të pafuqishme për pasqyrimin e thelluar të tyre.

Përpjekjet për të transmetuar artistikisht të vërtetën e jetës kérkonin prej shkrimitarëve njohuri më të gjera ekonomike, sociale, historike e psikologjike, ato kérkonin zbulimin e thelbit të fenomeneve, që shprehej në një mori dukurish, të cilat e mbartnin në mënyrat e tyre. Kjo rrugë donte nga shkrimitarët realistë të rrisin forcën përgjithësuese të veprës së tyre, nëpërmjet tipizimit, një nga arritjet më të shënuara estetike të realizmit. Te komedia «Katërmبëdhjetë vjeç dhë-

ndër», me të gjitha figurat e saj, po sidomos me Tanën, letërsia shqipe hodhi një hap të sigurtë në zbatimin e kësaj kërkese të brendshme të realizmit. Por do të duhej të kalonin dy-tri dekada që kjo praktikë e përgjithësimit artistik, tipizimi realist, të rishfaqej në letërsinë tonë në veprën e Migjenit e në disa nga krijimet e M. Kutelit, tani në një shkallë cilësisht të re. Dukuria që përgjithësitet në komedinë e Çajupit, nëpërmjet figurës së Tanës, natyrisht, nuk ishte ndër më të rëndësishmet në jetën shqiptare të atyre viteve. Vetë Çajupi e ndien këtë, prandaj komedisë, megjithë sensin e qartë kritik, nuk i ndahet për asnjë çast qëndrimi gjithsesi dashamirës i autorit, humorit i tij i lehtë e buzagaz. Çajupi e kuptonte mirë se shoqërinë e mundonin të tjera plagë shumë më të rënda, të cilat ai i pasqyroi në veprën e tij hera-herës me sukses, por prapë pa arritur të depërtonte gjithnjë në thelbin e tyre; ai përshkroi më shumë anët e jashtme, kryesisht pa sojat morale që kultivonte përkatësia sociale në sjelljen e njerëzve. Kurse një figurë si ajo e Xheladin beut, tek novela «**Vjeshta e Xheladin beut**» e M. Kutelit, zbulon dukurinë më regresive të shoqërisë shqiptare, zvetënimin e plotë të feudalizmit. Në përshkrimin e kësaj figure nuk hynte më në punë humorit e ironia, tani duhej satira groteske, të cilën Kuteli nuk e kurseu. Figura e Nushit tek novela e Migjenit «**Studenti në shtëpi**», si është vënë në dukje nga studiuesit, pasqyron në mënyrë mjeshtërore thelbin social, në vështrimin më të përgjithshëm të termit, të psikologjisë së një shtrese të caktuar, të inteligjencies mikroborgjeze të kohës, e cila ëndrrat e veta për pérparimin i shndërrroi shumë shpejt në një lojë hipokrizie në marrëdhëni e saj me shqërinë. Lukja tek «**Historia e njërs nga ato**», ka gjithashtu forcë të madhe përgjithësuese; në ndërtimin e saj janë pasqyruar të gërshetuara shkaqet ekonomike e sociale, psikologjike e morale të një prej dukurive më të shëmtuara të rendit shfrytëzues, prostitucionit të detyruar. Mungesa e llojeve shumë-planëshe të prozës, në radhë të parë e romanit, sigurisht ndikonte në shkallën e konsolidimit të tipizimit. Megjithatë, letërsia pérparimtare e viteve '30 e njoju atë si një domoshmëri të veprës realiste, shoqërisht të angazhuar. Studiuesit kanë nënvizuar se tipizimi nuk është një praktikë krijuar që lindi bashkë me realizmin. Shkrimitarë të drejtimeve të ndryshme kanë tipizuar gjithnjë sipas mënyrave të tyre të përcaktuara nga një varg faktorësh, për të cilat nuk është vendi të flitet këtu. Vështruar nga kjo pikëpamje letërsia ro-

mantike e Rilindjes Kombëtare tipizonte edhe ajo sipas mënyrës së vet. Në veprën e poetëve arbëreshë, që ishin më pranë zhvillimeve të romantizmit evropian, intimja, subjektivja, janë ngritur në shkallën e së përgjithshmes; raportet midis kësaj të fundit dhe individuales janë gjithnjë të shpërpyjetura. Gjendjet shpirtërore intime e të veçanta të heronjve, rastësorja në rrëthanat e veprimeve të tyre, sidomos në poemën «Serafina Topia», po edhe tek «Kënga e sprasme e Balës», shpeshherë bëhen faktorë nxitës vendimtarë për shtjellimin e subjekteve. Sjelljet e heronje të De Radës nuk janë gjithnjë të motivuara, kushtëzimi social i psikologjisë së tyre, ndaj përshkrimit të së cilës poeti tregon vëmendje të veçantë, éshtë përgjithësisht i zbehtë. Me karakteret që krijoi, De Rada tipizonte gjendjen shpirtërore të arbëreshëve të etur për të parë të lira trojet e lashta të atdheut, për një rend më të përparuar, demokratik, e për një jetë shpirtërore të emancipuar në viset ku jetonin. Vetëkuptohet që në rastin e De Radës, të Serembes, të Naimit e poetëve të tjera të Rilindjes, poezia do t'i kushtonte èndërrimit hapësira të gjera. Nëpërmjet kontrasteve të krijuara sidomos midis së kaluarës histrike të bukur dhe së tashmes, në mos të shëmtuar po të kritikueshme nga shumë anë e të papranueshme për shkak të pushtimit të huaj, midis virtytit dhe vesit, poezia romantike rilindëse tipizonte prirjen shpirtërore të kohës, që kërkonte medoemos ndryshime të thella në realitetin politik, në disa raste edhe shoqëror, të Shqipërisë së viteve të saj. Patosi kompleks që krijohej në këtë rrugë përbënte thelbin e mënyrës së tipizimit në letërsinë romantike të Rilindjes, që përgjithësonte karakteristikën themelore të epokës, kontradiktën e acaruar shumë midis popullit tonë e pushtuesit të huaj. Në këtë rrugë, poezia, lloji më i zhvilluar i krijimtarisë artistike të Rilindjes, luante rolin e vet njohës e njëkohësisht vlerësues. Natyrishët, mënyra romantike e tipizimit që ndoqi sidomos poezia arbëreshe, nuk mund të ishte e plotë, pasi pengohej prej dendurisë së theksuar të pasqyrimit të së veçantës. Subjektivja ndihet e thellë edhe në krijimtarinë e Naim Frashërit. Dukuri të së njëjtës natyrë vihen re në prozën sentimentaliste, ku, si éshtë vënë në dukje, janë krijuar heronj, jehona shoqërore e të cilëve, me përjashtim të Dipes së romanit «Sikur t'isha djalë», éshtë e vakët dhe për pasojë, me vlera të pakta përgjithësuese. Nga kjo pikëpamje, letërsia romantike dhe veprat e natyrës sentimentaliste kanë shumë tipare të përbashkëta. Ndryshe ndodh në prozën e Migjenit, ku ka-

rakteret e krijuara shprehin tipare të njeriut që është formuar nën ndikimin e drejtpërdrejtë dhe vendimtar të rrethanave konkrete ku jeton. Kështu ndodh edhe në disa të pakta tregime të M. Kutelit, Nushi, Ageja, Lukja, Osoja, personazhe të Migjenit, Xheladin beu i M. Kutelit, Hanko Halla e A. Asllanit, kush më pak e kush më shumë, mishërojnë në vetvete shfaqje të caktuara të jetës shoqërore; ata mendojnë, sillen e ndiejnë në përputhje me një logjikë e botë shpirtërore që mund të kenë shumë veçori individuale, po që në fund të fundit përcaktohen nga shtresa a klasa sociale së cilës i takojnë; ata janë karaktere shoqërore. Në veprën e Migjenit, tipizimi arriti nivelin më të lartë të realizimit artistik në letërsinë tonë të atyre viteve edhe nëpërmjet vendosjes mjeshtërore të personazheve në mqedise të atilla, që u kultivonin pikërisht ato tipare psikologjike shpirtërore që ka përshkruar shkrimitari dhe jo të tjera.

Tek Migjeni qëndrimet ideore e morale, gjykimet mbi njeriun në kuptimin më të përgjithshëm, pasqyrohen nëpërmjet konkretës, të zakonshmes, të vështruara gjithnjë në lidhjet e tyre shkakësore. Ndryshe nga romantikët e sentimentalistët tanë, Migjeni në prozën e tij, sidomos në prozën tregimtare, ngul këmbë fort në aspektet konkrete të jetës dhe nëpërmjet tyre realizon përgjithësime më të fuqishme. Procesi i tipizimit në veprën e Migjenit kalon gjithnjë përmes zgjedhjes e përpunimit të vëzhgimeve të shumta jetësore, që kanë përfthuar vazhdimisht një vërtetësi të thellë, e cila përbën një nga vlerat më të mëdha të krijimtarisë së tij. Duke i mëshuar të përgjithshmes, Migjeni dhe M. Kuteli, në dy-tri novela të tijat, secili në mënyrën e vet, treguan njëkohësisht aftësi të veçanta për individualizimin e personazheve të veprave të tyre. Portretizimi i personazheve është kryer gjithnjë në përputhje me logjikën e karakterit shoqëror që përfaqësojnë.

Një vështrim këshasues midis romantizmit të Rilindjes dhe letërsisë së mëvonshme nxjerr shpejt në pah ndryshime të mëdha në vendin që zënë në to e bukura dhe e madhërishmja, nga njëra anë, dhe e shëmtuara, e ulta, nga ana tjetër. Tek Naimi e bukura dhe e madhërishmja zënë vendin kryesor. Në pajtim me botëkuptimin e poetit dhe si shfaqje e prirjes etike të veprës së tij, e bukura në ndonjë rast identifikohet edhe me të mirën, ndërsa e madhërishmja me vetëmohimin në emër të përparimit të njeriut e njerëzimit.

Në prozën e Migjenit e N. Bulkës e bukura dhe e madhërishmja nuk pasqyrohen më në mënyrë të drejtpërdrejtë, ato

janë zëvendësuar nga patosi kritik, që lind natyrshëm prej qëndrimit që mbajnë shkrimtarët ku përshkruajnë të shëmtuarën e të ultën, të cilat janë më të zakonshmet në veprën e tyre e që, veç ironisë e sarkazmës, hera-herës u japin shkas edhe notave tragjike.

Në ndërtimin e subjekteve të krijimeve të tyre, Migjeni e N. Bulka nuk shtjellonin ngjarje thjesht tërheqëse, të përpunuara në mënyrë të atillë që të nxisin në mënyrë të shpejtë e të sipërfaqshme ndjenjat e lexuesit; për ta mbeti krejt i huaj synimi që, me sajesa historish të këndshme, sentimentale e të jashtëzakonshme të dëfrenin lexuesit. Subjektet e ndërtuara prej tyre nuk ndiqnin asnjëherë parimin e kënaqësisë që duhet të shkaktonin tek lexuesi, me intriga «tërheqëse», «drama të pasionuara» e funde të lumtura a përkundrazi shkatërruese. Në krijimet e tyre më të mira ata synuan, dhe shpesh ia dolën, ta drejtojnë lexuesin në kuptimin e thellë e të vërtetë të ngjarjeve. Empcionin e lexuesit, realistët tanë përpinqeshin ta ngjallnin vetëm nëpërmjet vërtetësisë së episodeve, vërtetësisë së përshkrimit të ndryshimeve të gjendjeve shpirtërore, të personazheve nën ndikimin e rrëthanave ku jetonin. Subjektet e prozës së Migjenit grupojnë me skrupulozitet ndodhi të vogla, të rëndomta, prej të cilave buron domethënia përfundimtare e veprës. Çastet e krizave të menjëherëshme, gjendjet shpirtërore tepër të mprehta, të shkaktuara nga fatkeqësi të papritura e qëndrime tejet subjektive, në përgjithësi mënjanohen në tregimet (jo në disa skica) e Migjenit e të realistëve të tjere, të cilët përshkruajnë më shumë situata shpirtërore e morale të shtrira në kohë e të motivuara deri në fund. Subjektet e novelave të Migjenit në konceptimin dhe qëllimet artistike që ndjekin, e kanë të domosdoshme të jenë të sakta e konkrete, po kjo nuk do të thotë se autorit i mungon imagjinata, përkundrazi, ai vetëm mënjanon prirjet fantaziste, ashtu siç flak elementët sentimental-romantizantë.

N. Bulka e ndërtón më rrallë subjektin, të cilit ai nuk i jep gjithnjë rëndësinë e duhur, i têrhequr më fort pas faktit shprehës, pas një farë përshkrimi veridik të dukurive jetësore. Kjo prirje ka bërë që shumë nga krijimet e tij të anojnë edhe nga llojet artistike të publicistikës.

Hera-herës edhe Migjeni parapëlqen që gjykimet e qëndrimet e tij shpirtërore, ironinë e sarkazmën therëse, keqardhjen e dhimbjen e thellë, t'i shprehë shkëputur nga subjekti, nëpërmjet ligjërimit të vet. Ndërsa M. Kuteli në novelat «Vjeshta e Xheladin beut» dhe «Xha Brahu i Shkumbanicës» qëndron

më pranë mënyrave klasike realiste, subjekteve të shtjelluara, përshkrimeve të hollësishme të mjediseve dhe të sjelljes e psikologjisë së personazheve etj.

\* \* \*

Studimet tona historiko-letrare me kohë kanë ardhur në përfundimin se letërsia shqipe e nisi rrugën e realizmit në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit me veprën e Çajupit<sup>1</sup>.

Po siç jemi munduar të argumentojmë, në tërësi krijimtaria e tij nuk ishte realiste; në poezi ai mbeti përgjithësisht romantik dhe vetëm në komeditë «Katërbëdhjetë vjeç dhëndër» (1902) dhe «Pas vdekjes», shkruar më 1910, shfaqen qartë karakteristika të drejtimit realist<sup>2</sup>.

Disa probleme të karakterit shoqëror, detajet konkrete që përbajnë hera-herës krijimet e De Radës, Santorit<sup>3</sup>, Naimit, Mjedës e shkrimtarëve të tjera, të cilët kanë çuar në ndonjë rast në përfundimin se në to duhen gjetur elemente të realizmit, nuk janë gjë tjetër veçse nënshtresa që i përbajnë në mënyrë të natyrshme veprat e drejtimeve të tjera përparimtare. Sigurisht, këto nënshtresa e shumë të tjera të brendisë së krijimtarisë romantike kanë ushqyer realizmin, ato tregojnë se edhe në historinë e letërsisë sonë realizmi lindi në vazhdimësi të romantizmit progresist të Rilindjes, se disa tipare të tij, qoftë edhe në trajtë embrionale, bashkëjetonin me frymën e përgjithshme romantike të letërsisë së shekullit XIX dhe fillimeve të shekullit XX.

Angazhimi i thellë pas çështjeve jetike të epokës, tendencioziteti i theksuar politik atdhetar, qëndrimet e hapta demokratike, pikëpamjet filozofike përparimtare, qartësia e shprehjes artistike e të tjera karakteristika të letërsisë së Rilindjes, në rrëthanat historike që u krijuan pas Shpalljes së Pavarësisë

1) Dh. S. Shuteriqi, *Nëpër shekujt letrarë*, Tiranë 1973, f. 405; shih edhe: *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1983, f. 419.

2) F. Dado, *Mbi veprën letrare të A. Z. Çajupit*, botuar në: Çajupi, Vepra I, Tiranë 1984, f. 32.

3) Nisur vetëm nga tematika ose nga ndonjë anë tjetër e brendisë, sidomos e veprës së pabotuar, I. Fortino shikon te krijimtaria e Santorit fillimet e realizmit në letërsinë shqipe. Shih më hollësish: *Hyrje në botimin e «Brisandi, Lletixja e Ulladheni»*, Kozencë 1977, f. 10.

e konsolidimit të shtetit shqiptar, fituan brendi të re e u themilluan më tej në veprën e Migjenit me shokë, që synuan të pasqyrojnë jetën në kompleksitetin e saj ekonomiko-shoqëror, ndërsa njeriun e atyre viteve si produkt të saj, si karakter shoqëror.

Lindja dhe përvijimi i realizmit në letrat tona kanë hasur shumë pengesa në rrugën e tyre. Borgjezia, sundimi i së cilës ka kushtëuar zhvillimin e tij, në vendin tonë nuk arriti të konsolidohet si klasë hegjemonë në jetën politiko-shoqërore të viteve 1912-1939. Në vendet ku lulëzoi, realizmi u shfaq me të gjitha vlerat e veta në radhë të parë nëpërmjet prozës. Mirëpo epoka e Rilindjes për shkaqe të njohura, kërkoi në radhë të parë krijimtarinë e poetëve. Në ato vite, poezia, me veçoritë e saj, mund të ndikonte në konstitucionin shpirtëror të popullit më fort se çdo gjini tjetër letrare, madje se çdo veprimtari tjetër intelektuale. Prandaj, eshtë e kuptueshme pse romantizmi rilindës nuk synoi dhe, domosdo, nuk arriti të krijonte një traditë të gjerë në zhvillimin e llojeve të prozës.

Në vitet që erdhën më pas, realistët tanë e ndien sigurisht mungesën e saj, që ua kufizoi mundësitë për ta pasqyruar në mënyrë më të plotë e më të thellë jetën shqiptare të kohës së tyre.

Proza sentimentaliste, që, nga pikëpamja sasiore ishte më e shumtë, e pasuroi në një farë mase traditën dhe trajtoi tematikën shoqërore, për të cilën u interesuan aq shumë shkrimitarët realistë. Po fryma e saj e përgjithshme nuk mund të pranohej dhe nuk u pranua prej tyre; brendia e sentimentalizmit u kapërcye nga realistët në shumë anë.

Sidoqoftë, të gjitha këto arsyë si dhe shumë shkaqe të tjera politike e ideologjike, që buronin nga karakteri thellësisht regresiv i rendit feudo-borgjez, nuk lejuan që realizmi të arrinte të pasqyronte në mënyrë më të gjerë e më të plotë jetën shqiptare të viteve '20-'30. Jashtë tij mbeti tipi i fshatarit, që do të sillte në letërsinë e asaj kohe jetën e klasës më të madhe të shoqërisë shqiptare. Me përjashtim të disa novelave të Migjenit që pasqyruan mendësinë e shtresës së tregtarëve të qytetit, në përgjithësi dukuritë e tjera të jetës borgjeze nuk u realizuan dot artistikisht. Në letërsinë realiste arriti vetëm të ravijëzohet, po nuk u krijuat tipi i zyrtarit, shtresa krejtësisht reaksionare e të cilin përbënte një nga mbështetjet më të fuqishme shoqërore të rendit të vendosur. Ambientimi dhe konformimi i borgjezisë me pushtetin politik që u vendos pas disfatës së Revolucionit të Qershoret, pasojat e tyre në

tmendësinë e saj, patën jehonë pak të ndjeshme në krijimtarinë e realistëve tanë; ndërsa fatet, shqetësimet e demokratëve revolucionarë, që vazhduan të luftojnë kundër sundimit të reaksionit, tërhoqën vëmendjen e letërsisë, po në përgjithësi u trajtuan në mënyrë sporadike e hera-herës disi të sentimentalizuar. Roli i punëtorit që u ndie nga disa shkrimtarë, të cilët sapo kishin nisur rrugën e letërsisë, i dha shkas romantikës revolucionare, karakteristike për këtë etapë të parë të krijimtarisë së tyre.

Megjithatë, siç u munduam të provojmë, në jetën letrare të viteve 1912-1939 realizmi u shfaq qartë si një prirje e qëndrueshme, që u përhap jo vetëm në krijimtari, po luftoi përaftejimin e vet edhe në rrafshin teorik. Po ai nuk pati kohë të kristalizohej; zhvillimet historike të vendit tonë rrodhën në mënyrë të tillë, që vetëm pas fitores së revolucionit popullor, në epokën e ndërtimit socialist, krijuan të gjitha kushtet për triumfin e realizmit, tanë të një tipi të ri, të realizmit socialist.

zgjedhje e shqyrtimit i zhvillimit të formave artistike e të mjeteve shprehëse, i ndryshimeve që kanë pësuar gjatë kohës e në përputhje me drejtimet letrare, do të kërkonte sigurisht, studime e monografi të tjera.

## ASPEKTE TË EVOLUIMIT TË STILIT NË DREJTIMET LETRARE

Shqyrtimi i zhvillimit të formave artistike e të mjeteve shprehëse, i ndryshimeve që kanë pësuar gjatë kohës e në përputhje me drejtimet letrare, do të kërkonte sigurisht, studime e monografi të tjera. Më anën tjetër, do pranuar që punimet tona për çështje të kësaj natyre janë fare të pakta dhe përvoja e gjertanishme, e pamjaftueshme siç është, i bën ende studiuesit të druhën të merrin me to. Mirëpo kjo vepër që ka si synim kryesor të pasqyrojë rrugët e zhvillimit të drejtimeve letrare, nuk mund të heshtë pér evoluimin e tipareve formale të praktikave krijuëse të nxitura prej tyre. Këto tipare janë kaq të shumta, sa është krejtësisht e pamundur të vihen në dukje që të gjitha, e aq më pak, të tregohen si e në ç'kushte kanë ndryshuar. Prandaj do të mjaf-tohem me vështrime të përgjithshme mbi disa anë të për-

bashkëta dhe veçoritë e stilit të shkrimtarëve të drejtimeve të ndryshme letrare.

Romantikëve tanë që krijuan gjatë Rilindjes, epokës që kishte shtruar për zgjidhje çështjen kombëtare, ua donte puna që në krijimtarinë e tyre të prireshin pas epizmit. Kështu vepruan sidomos J. de Rada, G. Dara (i Riu) dhe N. Frashëri. Epizmi u shfaq kryesisht përmes poemës narrative, e cila mori subjektin nga historia e Shqipërisë, sidomos nga shekulli XV. Epizmi i poezisë së tyre, mbi të gjitha, synonte të ndikonte thellë në jetën shpirtërore aktuale, të ndihmonte sa të qe e mundur në afirmimin e kombit shqiptar edhe përmes krijimit të një epopeje letrare nacionale, që do të pasqyronte karakteristikat psikologjike e morale të shqiptarit. Poemat e De Radës e të Darës, përgjithësisht jo fort të gjata, në sfondin historik të subjektit të tyre kanë gërshtuar me një imagjinatë të fuqishme histori dashurish pasionante, ngjarje me filesa legjendash, intriga, prova të rënda nëpër të cilat kalojnë personazhet e tyre, hera-herës shumë kompleksë. Tek «*Historia e Skënderbeut*» të Naimit të tilla shfaqje nuk janë të dukshme; në të sundon më fort një linjë tregimtare, që përpinqet të pasqyrojë sa më besnikërisht të dhënat e gjeratëhershme mbi luftërat e shqiptarëve dhe jetën e Gjergj Kastriotit. Sidoqë të jetë, epika e romantikëve tanë përparimtarë nuk humbet në asnjë rast tendencën e qartë politike atdhetare, kurse fantazia, vetëm tek disa nga krijimet e Zef Skiroit humbiste çdo lindhje me realitetin, shkapérderdhej e krijonte përfytyrimë krejtësisht iluzore.

Romantikëve tanë përparimtarë po ashtu ua donte puna që në krijimtarinë e tyre të ishin thëllësisht lirikë<sup>1)</sup>. Për ta ishte e domosdoshme që edhe kur evokonin historinë, të transmetonin sa më gjërë një botë të atillë interesash e shqetësimesh, e cila do të shndërrohej shpejt në pronë shpirtërore të të gjithë bashkatdhatarëve bashkëkohës. Me mundësitë e saj lirika lehtësonte realizimin e këtij synimi- të letërsisë së re shqipe; pikërisht në lirkë u krijuan vlerat më të mëdha artistike, madje edhe në ato vepra që patën karakter të përgjithshëm epik, siç janë poemat «*Pasqyrë e një jete njerëzore*», «*Skënderbeu i pafan*», «*Kënga e sprasme e Balës*», «*Historia e Skëndërbeut*» etj..

Natyrisht, si romantikë që ishin e që kultivuan kryesisht

1) Shih më hollësisht: R. Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romanizmi I*, Prishtinë 1984, f. 199-204.

poezinë, për ta ishte e zakonshme t'i shihnin jetën, ngjarjet, njerëzit përmes predispozitave të tyre shpirtërore, ndonjëherë edhe të çastit. Po të përashtojmë një pjesë të vjershavë të Asdrenit e sidomos të Lazgush Poraçecit, i cili e vishtë poetin e punën e tij me një tis gati hyjnor, romantikët tanë përparimtarë, megjithëse u lanë vend të gjerë momenteve autobiografike (De Rada e veçanërisht Serembe), nuk e shndërruan poezinë në këngë të vvetves; subjektivizimi i tyre, që ishte i zakonshëm jo vetëm për romantizmin po edhe për poezinë në përgjithësi si gjini e krijimtarisë, nuk u kthyte kurrë në apoteozë të vvetves; për romantikët tanë mbetën të huaja qëndrimet impozante, artificiale e thellësisht egocentrike.

Poezia rilindëse krijoi ndërkokë përmasa të qarta edukative, me jehonë të gjerë filozofike e morale. Vjersha e Naimit «Fjalët e qiririt» shpalos fare bukur konceptin e tij mbi artin poetik. Këtij koncepti i mbahej edhe De Rada në veprën e tij «Parimet e estetikës», ku ai formulonte pikëpamjen, se arti është një mjet i fuqishëm që shërben për të ndriçuar mendjen e njerëzve<sup>1</sup>. Në vitet që erdhën pas Shpalljes së Pavarësisë, krijimtaria poetike romantike e Migjenit nisej po ashtu nga mendimi se ndjenja, tek shpërthen vrullshëm nga subjekti i krijuesit, mund t'i japë jetë poezië vetëm atëhere kur përqëndron si në fokus një shqetësim jo vetjak po shoqëror, kur rezonon me një botë shpirtërore kolektive. Vjershat e Nolit janë gjithashtu mjaft shprehëse për të argumentuar pikëpamjen se lirika shqipe, në pjesën më të madhe të autorëve të saj jo vetëm gjatë Rilindjes, po edhe në periudhën pasuese, ruajti të konsoliduara qëndrime thellësisht të angazhuara. Po le të kthehem i tek romantikët rilindës. Për shkak të jetës që kaluan e të formimit të tyre, ata kishin shumë arsyë që hera-herës, të ishin melankolikë e të triştuar, fatalistë e të vtmuan. Dhe të tilla tipare nuk munguan të shfaqen ndër heronjtë e De Radës; po edhe të Asdrenit, veçanërisht gjatë periudhës së dytë të krijimtarisë. Gjendje shpirtërore si këto nuk ishin të huaja as për Naimin e për Çajupin dhe as për Lazgushin e Migjenin më pas.

Të diferencuara në shkak e tyre, ato, gjithsesi, ishin të natyrshme. E megjithatë, romantikët tanë përparimtarë nuk i konsideruan çastet e dëshpërimit e të ashtuquajturin «dolorizëm» si të vëtmin burim të së bukurës në poezi. Poezia për ta nuk ishte vetëm vokacion i dhimbjes, sidoqëjeta e tyre

1) A. Uçi, **Probleme të estetikës**, Tiranë 1976, f. 308.

prej mërgimtarësh qe shumë e kursyer në gjëzime, sidoqë botëkuptimi me të cilin u formuan nuk u lejonte të shihnin një perspektivë më të mirë e më njerëzore. Sa qe në këmbë lufta e shumanshme për lirinë kombëtare, lirika e tyre mbarti vazhdimisht, si komponentin themelor të brendisë së saj, ndjenjet optimiste të besimit të patundur jo vetëm në fitoren e afërt të pavarësisë, po, tek Naimi e Asdreni e më vonë tek Noli e Migjeni, edhe në ndryshimet e ardhshme sociale.

Në vitet e fundit të Rilindjes lirika romantike, kahas frysëzimëve atdhetare, të natyrës, dashurisë e të mendimit të cilat shpesh bëshkëjetonin në të njëjtat krijime, buron gjithnjë e më shumë nga shqetësimë të thella politike-shoqërore. Prandaj strukturave të saj figurative nuk u mjaftojnë më vetëm personifikimet, krahasimet, apostrofat, epitetet etj., po kërkojnë gjithnjë e më shumë edhe ironinë e sarkazmën, antitezat, pyetjet retorike me ngarkesë të fuqishme emocionale, me nëntekst të thellë e të qartë. Ndërsa metafora, sidomos në lirikën e Migjenit është gjithnjë e më e beftë, më e vrullshme, me forcë krijuese e associative të rrallë. Intaciononet intime idilike e meditative, émbëlsia, delikatesa e peizazhit saturohen gjithnjë e më shumë me zemërimin, skepticizmin, furinë, patosin kritik.

Duke u nisur nga mendimi se vetëm populli ruante të pacenuar pastërtinë morale, ndjenjet e thella dhe fisnike, një shpirt të papërlyer prej smirës dhe egoizmit, shumë shkrimitarë romantikë treguan vëmendje të veçantë për folklorin. Herderi, me veprën e tij «**Zërat e popuje në këngë**», ishte i pari që, përpjekjeve të mëparshme për të mbledhur e botuar këngën popullore, u dha një kuptim të rëndësishëm politik e estetik. Jehonë të madhe pati edhe botimi i Forielit «**Këngët popullore të Greqisë moderne**». Në epokën e romantizmit kudo në Evropë u krye një punë e madhe për të mbledhur e botuar kërijimtarinë e popullit, e cila u konsiderua edhe si mundësi shumë e përshtatshme për të sfiduar klasicizmin, që, me kërkuesat e tij të rafinuara për formën e përsosur, i shikonte me përbuzje krijuarët popullore.

Përpjekjet për të mbledhur folklorin tonë janë të hershme, ato kanë nisur të paktën që në shekullin XVII. Po ato njojën një shpërthim të vërtetë gjatë viteve të Rilindjes dhe shkuarët thaujse paralelisht me proceset e lindjes së letërsisë së re shqiptare. Të gjithë studiuesit që janë marrë me poezinë tonë romantike kanë vënë në dukje se ajo, në artin e saj, dallohet, në radhë të parë për mbështetjen e fuqishme krijuese e mje-

shtërore në këngën e popullit, pa cenuar aspak individualitetet e saj të spikatura. Hera-herës Dara e Çajupi po edhe Asdreni (në periudhën e parë të krijimtarisë) e Lazgush Poradeci në shumë prej vjershave të tij, bëhen një me shpirtin e fryshtë e këngës së popullit, duke mënjanuar njëkohësisht folklorizmin e thjeshtë.

Sigurisht, mënyrat si iu afruan këngës së popullit, si mësuan prej saj janë të ndryshme nga njëri shkrimtar tek tjetri. Në krahasim me De Radën, Darën e Seremben që priren më fort pas peizazhit idilik mëditativ ose pamjeve të ashpra të natyrës, që kërkojnë dramaticitetin episodik dhe për pasojë, parapëlqejnë paraleлизmin figurativ, personifikimin, krahasimin e metaforën me fillesë folklorike, Çajupi, nga pikëpamja stilistike ruan më shumë karakteristika të këngëtarit popullor në një pjesë të madhe të krijimeve të tij.

Poezia e Naimit, veç figuracionit, mbështetet fort në kadencën e vargut popullor<sup>1</sup>, e cila haset edhe te poezia e Asdrenit dhe e Nolit. Sa i takon poeziës së Lazgush Poradecit, ajo është, pa dyshim, model i përsosur i shfrytëzimit mjeshtëror të bukurisë së folklorit. Tiparet formale të vargut pòpullor i kanë edhe disa krijime të Gj. Fishtës, po ndryshtë nga romantikët tanë përparimtarë, Fishta u la vend të gjerë shtresave mitologjike e të kanunit, të cilat, edhe pse ishin komponentë të rëndësishëm të mendësise së malsisë, nuk përcaktonin aspak fryshtë e përgjithshme të folklorit të atyre viseve.

Mbështetja në këngën popullore u dha dorë romantikëve tanë të zgjerzonin sistematikisht e të krijuin një fjalor shumë të pasur, shprehës, emotiv, plot kolorit. Po puna që kryen romantikët me gjuhën është me vlera shumë më të mëdha. Dara dhe Serembe, më pak J. De Rada, u munduan ta afrojnë të foluren arbëreshë me shqipen që flitej në Shqipëri, kurse Naim Frashëri, me poezinë e tij solli një ndihmesë të pazë-vendësueshme për themellet e shqipes së shkruar letrare. Kujdesi i veçantë për gjuhën e popullit ishte një nga shqetësimet më të thella të të letërsisë sonë romantike.

Po të përjashtojmë disa vjersha të periudhës së dytë të krijimtarisë së Asdrenit, disa të tjera formaliste të Lazgushit, të romantikët tanë përparimtarë mungon çdo përpjekje për të kë-kuar fjalën «e zgjedhur», «tingëlluese», për të transmetuar nëpërmjet saj «shije të veçantë» e «të rafinuar».

1) Për mbështetjen e poeziës së Naimit në folklor shih më hollësishët: Q. Haxhihasani, **Naimi dhe folklori**, Studime filologjike 1971/2.

Në përputhje me prirjet e veprës të tyre, ndër disa nga poetët tanë ndryshon qëndrimi ndaj fjalës. Mjeshtër i efektit akustik Noli, kur ia kërkonte vargu, nuk hezitonte të përdorët fjalën e huaj, madje edhe ato që kishin denduri përdorimi fare të kufizuar. Migjeni, po ashtu nuk druhet nga fjala e huaj, nga çdo fjalë e shtresave të ndryshme stilistike, mjafton që të realizojë një figurë dinamike, me ekspresivitet të madh, me ngarkesë të dukshme mendimi.

Kujdes të veçantë përfjalën tregoi Lazgush Poradeci, që kërkonte prej saj jo vetëm vlerën tingullore po sidomos aftësinë përshkruuese plastike. Të tillë kërkesa ndaj fjalës pati edhe Asdreni<sup>1</sup>, po i realizoi ato me më pak sukses se Lazgushi. Ndërsa në vjershat ku të dy poetët shfaqin ndikime të simbolizmit e të parnasit, prirjet formaliste, ndër të tjera, i mbartin edhe sajesat që ata krijonin me fjalën, të cilat nuk patën jetë të gjatë.

Folklori u dha romantikëve tanë përparimtarë modelet e një sintakse të thjeshtë e të qartë poetike, që vetëm në disa vjersha të periudhës së dytë të Asdrenit dhe në krijimet klasiste të Mqedës vjen e rëndohet. Ajo është e errët në pjesën më të madhe të veprave të Gj. Fishtës, që kanë edhe një gjuhë tepër të ngarkuar me dialektalizma.

Po të mendohet se mbështetja në folklor, ky tipar i përbashkët stilistik i romantizmit shqiptar dhe jo vetëm i atij, shkaktohej ngaqë letërsisë sonë i mungonte një traditë paraprirëse dhe prandaj poetët detyrimisht do t'i ktheheshin kë-jimtarisë së popullit, ose, meqë ata u integruan në drejtimin romantik do të interesoheshin domosdo përfolklorin, kjo është vetëm një pjesë e së vërtetës. Ishin kohërat ato që kërkonin krijimin e një arti poetik sa më të afërt përfshirtin e popullit. Romantizmi shqiptar shprehu të gjitha kërkkesat politike, ideologjike e kulturore të Lévizjes së Rilindjes. Traditat liridashëse të popullit, ndjenjën e tij kombëtare, ai i pati komponentët themelorë të përbajtjes së tij. Romantikët tanë përparimtarë morën mbi vete detyrën e pishtarit të çështjes nationale, të këngëtarit të historisë madhështore të Shqipërisë, të virtuteve e të temperamentit të shqiptarit. Të gjitha këto nuk mund realizoheshin ndrysht, pa krijuar një poezi të tillë, të cilën populli do ta përvetësonë shpejt, në të cilën ai do të gjente të shprehura ëndrrat e luftës e tij për liri e përparim. Po të

1) Shih më hollësisht: R. Qosja, **Asdreni — Jeta dhe vepra e tij**, Prishtinë, 1972.

mos kishte ndjekur këtë rrugë, romantizmi ynë nuk do të kishte luajtur dot atë rol që luajti në Lëvizjen Kombëtare, nuk do të kishte krijuar ato kryevepra që krijoj. Më anë tjetër romantikët arbëreshë, që krijuan në një truall të huaj ku ishin të hapura shtigjet e ndikimit prej letërsisë vendëse, e kishin të domosdoshme të shpëtonin prej imitimit. Ata e realizuan me shumë sukses këtë detyrë, sepse panë te poezia e popullit një barrierë të pakapercyeshme, që ruante për bukuri origjinalitetin e tyre poetik.

Poëtë me shije të hollë, romantikët tanë ditën t'i vlerësojnë mrekullitë artistike të folklorit; në mënyrë të ndërgjegjshme ata u bënë nxënës të tij. Dhe nuk dolën të humbur, përkundrazi.

\* \* \*

Fillimet e prozës shqipe ishin përgjithësish të natyrës sentimentaliste. Tek i mbaheshin mendimit se ndjenja dhe virtyti që buronte prej tij, mund të krijonin një jetë morale të denjë për njerëzit, shkrimtarëve sentimentalistë do t'u duhej që t'i jepnin një vend të gjerë pëershkrimit të hollësishëm të psikologjisë së personazheve të tyre. Disa prej tyre u përpoqën ta realizonin këtë kërkjesë, Helenau e më shumë Haki Stërmilli tek romani «Sikur t'isha djalë». Po mungesa e përvojës në llojet e prozës tregimtare i pengoi ata të arrinin nivele të larta në analizat psikologjike të personazheve, si një ndërkarakteristikat më të para artistike të veprës sentimentaliste. Vetëm Dija është përfytyruar si figurë me një botë të pasur shpirtërorë, përvijimi i së cilës ka qenë ndër synimet kryesore të krijuësit të saj. Tek veprat e M. Gramenos, Helenaut e F. Postolit vështrimet psikologjike janë të sipërfaqshme e të pafuqishme. Sidoqë u kushtojnë vëmendje të veçantë ndjehnave, ata nuk mundën t'i pëershkruanjë në hollësitetë e tyre; pshëritima, ofshame, metafora të përsëritura, shpesh të ndërtuara me fjalët «lule», «trëndafil», «vjollcë», krahasime që thua jse gjithnjë u drejtohen objekteve të natyrës, një dialog i mbushur me betime, lutje, përgjërimë, kjo është gjuha e veprave të sentimentalistëve tanë, naïve përgjithësish ashtu siç është edhe thurja e subjekteve që ngrihen hera-herës (novelat e Gramenos e romani «Lulja e Kujtimit» e F. Postolit) mbi

ndodhi të jashtëzakonshme, mbi rastësitë e të papriturat e shumta. Ditari bëhet një nga format e preferuara të ndërtimit të subjektit (tregimet e Helenaut e romani «Sikur t’isha djalë» i H. Stërmillit). Narracioni është i shtruar e i thjeshtë, digresioni thuajse nuk përdoret fare, ashtu siç mungon gati krejt edhe monologu i brendshëm, sigurisht, po të përjashtojmë romanin «Sikur t’isha djalë».

Ndjenja e peizazhit është më e gjallë tek Helenau e H. Stërmilli, ajo harmonizohet gjithnjë me jetën e personazheve, e cila duke qenë e trishtuar e melankolike, hera-herës me drama të thella, gjen tek vjeshta e dimri mjediset që i shkojnë më fort pér shtat. Po plasticiteti, aq i nevojshëm pér krijimin e peizazhit, nuk zotërohet si duhet prej tyre, siç nuk zotërohen përgjithësisht aftësitë e përshkrimit të mjediseve.

Nuk është aspak befasuese që këto tipare stilistike të prozës sonë humbasin thuajse krejt në veprën e Migjenit e N. Bulkës. Mënyra si e kuptionin ata funksionin e letërsisë dhe pozitat botëkuptimore e shoqërore që pasqyronin në krijimtari, kërkonin prej tyre një prozë plot nerv e gjallëri që nuk zgjatej në përshkrime, po kërkonte përgjithësimin e fuqishëm, që nuk priej pas hovit të ndjenjave, po ndiqte logjikën e ashpër jetësore.

Prandaj proza, e Migjenit është gjithnjë e ngjeshur në mendim, me nëntekst të fuqishëm, e shtruar në arsyetimet e sidomos te skicat, e aftë të zgjedhë detajin, e thellë në monologjet e brendshme të personazheve, e dhimbshme në përshkrimin e vuajtjes njerëzore, ironike e sarkastike në kritikën e saj. Të tilla tipare karakterizojnë edhe krijimet e N. Bulkës, të cilat, duke qenë se mbartin edhe mjafit elemente stilistike të llojeve letrare të gazetarisë, kanë veçorinë të shtrojnë menjëherë problemin, të prekin shpejt anët komike e paradoksale të dukurive, të shprehin patosin kritik jo aq përmes një note tragjike që bie në sy te proza e Migjenit, po më fort përmes ironisë herë buzagaze e herë therëse. Po pér shkak të natyrës së llojeve me të cilat u mor, N. Bulka vetëm se i skicon personazhet e tij, ashtu siç vepron edhe Migjeni, në prozën e shkurtër. Me këto personazhe nuk mund të ndodhë ndryshe, ndërsa tek novelat Migjeni krijon karaktere shumë më të plota. Në to ai nuk ndalet gjatë në imtësitë e mjediseve, po i zbërthen personazhet përmes monologut të brendshëm, dialogu përshkrimit të kursyer, e megjithatë magjistrat, të reagimeve të

tyre ndaj situatave shpirtërore që kalojnë, të rënda e tragjike në më të shumtën e rasteve, po edhe komike në raste më të rralla.

Trajtat e shtruara, të drejtpërdrejta, të të treguarit e të ligjérimit që filluan të përpunohen në prozën sentimentaliste, u rishfaqën në tregimet dhe novelat e M. Kutelit, të cilat, në pjesën më të madhe të tyre, si e vumë në dukje, janë romantike dhe jepen shumë pas bukurisë së natyrës, shfaqjeve të etnografizmit, të përshkruara me një gjuhë shumë të pasur në fjalor e frazeologji populllore<sup>1</sup>. Këto tipare proza e M. Kutelit i zuan edhe në disa krijime realiste, të cilat shquhen edhe për detajin e zgjedhur me mjeshtëri, dialogun e gjallë e të natyrshëm dhe zbulimin e veçorive psikologjike e morale e të karaktereve sociale që ka përfytyruar.

Sigurisht, këto të pakta shënimë nuk mund të zbulojnë të gjitha proceset e ndërlikuara të evoluimit të stileve në drejtimet e ndryshme letrare, të shtresave e strukturave të tyre. Ato vetëm plotësojnë, në një masë ende të kufizuar, zgjidhjet që u janë dhënë në kapitujt e tjera, disa çeshtjeve të drejtimeve kryesore të historisë së letërsisë shqiptare.

---

1) Shih më hollësisht: **Historia e letërsisë shqiptare**, Tiranë 1983, f. 540.

## DISA PËRFUNDIME

Po të rrokej në një vështrim tërësor zhvillimi i drejtimeve në historinë e letërsisë sonë, do të arrihej në këtë përfundim të parë: romantizmi ishte pa dyshim drejtimi që arriti të konsolidohej, i vetëm e sundues, në epokën e tij; ai shfaqi më shumë tipare të thella, u shtri në një kohë të gjatë, krijoi një sasi më të madhe veprash të niveleve të larta artistike. Romantikët rilindës përpunuani karakteristikat kryesore të letërsisë së re shqipe, fisionominë e saj kombëtare e popullore, qëndrimet e hapta demokratike e iluministe, ata nisën të zhvillojnë shumë nga gjinitë e llojet e letërsisë, krijimtaria e tyre hodhi themelët e gjuhës shqipe. Tek veprat e shkrimtarëve romantikë u shfaqën premisat e drejtimeve të mëvonshme të letërsisë sonë; ndër to do të gjenden nismëtarët e realizmit e ndikimet nga drejtimet pasromantike evropiane; disa anë të frysës së tyre u dhanë brendinë sentimentaliste hapave të para të prozës sonë.

Romantizmi, sidomos në poezinë arbëreshe, njoju më dendur takimet me letërsinë evropiane e njëkohësisht mbeti origjinal, madje edhe në afëritë thelbësore me dukurinë simotër të vendeve të tjera.

Romantikëve tanë dhe krijimtarisë së tyre u takoi të ishin njëherazi edhe ndër pionierët e mendimit të ri filozofik shqiptar. Në rrethanat e viteve të Rilindjes Kombëtare, kur mendimi filozofik e shoqëror nuk kishte ende një jetë të veçantë dhe mbetej i përhapur më shumë në organet e shtypit, të cilat kishin lexues të kufizuar në numër, poezia e romantikëve tanë, sidomos ajo e Naim Frashërit, mori përsipër të shpjerë në popull, me një gjuhë artistike të kuptueshme për të, idetë më të përparuara të kohës. Për këtë arsyen vepra e disa prej shkrimtarëve më të shquar të Rilindjes, ishte jo vetëm shprese e shumë veçorive të drejimit romantik, po edhe bartëse ndimit iluminist.<sup>1</sup>

Naim Frashëri e të tjerë romantikë shqiptarë kishin tek idetë iluministe një mbështetje të fuqishme për krijimin e patosit romantik të poezisë së tyre. Prandaj në shumë prej krijimeve të tyre synimet politike edukative janë të drejtپerdrejta; nga ana tjetër nuk ishte e rastit që mjaft nga romantikët tanë qenë edhe gazetarë, shkencëtarë, folkloristë, hartues tekstesh mësimore etj. sigurisht, nuk është vendi të merrimi me hollësitë e mendimit iluminist, që u shpreh, në një masë të madhe nëpërmjet poezisë së Rilindjes; këtu do theksuar se në krijimtarinë e atyre viteve ky mendim nuk shkonte ndesh me fryshtën e përgjithshme romantike e më pas sentimentaliste të letërsisë. Filozofia e letërsisë së Rilindjes, e lindur dhe e zhvilluar kryesisht si shprehje e luftës për çlirimin kombëtar, ishte në shumë drejtime filozofia e besimit dhe e optimizmit, filozofia e perspektivës, e një të ardhmje më të mirë për shoqërinë shqiptare. Ka qenë një karakteristikë origjinale e romantizmit shqiptar, harmonizimi i fryshtës së përgjithshme të tij me idetë iluministe, të cilat letërsia romantike në vende të tjera sidomos të Evropës perëndimore i pasqyroj më fort në kritiken që pësuan pas Revolucionit borgjez francez.

Kthimi në historinë e Shqipërisë, sidomos te epoka e Gjergj Kastriotit, përbënte më të parën prirje romantike të krijimtarisë së De Radës, Darës e Naimit me shokë. Duke ndjekur një nga tiparet më të rëndësishme të drejtimit romanticist, letërsia e Rilindjes përpunonte veçori të sajat për formësimin e tij. Te e kaluara shkrimitarët tanë shihnin argumentin themelor të afirmimit të kombit shqiptar. Nëpërmjet saj romantikët tanë përparimtarë fryshtëzonin krenarinë e ligjshme kombëtare, aq të domosdoshme për arritjen e lirisë së Atdheut, pa synuar kurrsesi të ngjallin ndjenja shoviniste, krejtësisht të huaja për ta. Ideatorë politikë të së ardhshmes së atdheut të tyre, ata e dinin se Shqipëria e kishte të nevojshme të jetonte në harmoni me fqinjët; humanistë të mëdhenj, ata urrenin shovinizmin si një shfaqje antihumanitare; iluministë të bindur, ata nuk mund të pajtoheshin me verbërinë shoviniste, që i shpinte bartësit e tyre në prehrin e fuqive të huaja. Shovinizmi i Gjergj Fishtës ishte një dukuri krejt e izoluar në letërsinë e viteve të Rilindjes, ndërsa në periudhën që pasoi, ai përbënte një nga tiparet e romantizmit regresist.

Në histori romantikët shqiptarë gjenin kohërat e lavdëshme, njerëzit e vërtetë, pastërtinë dhe bukurinë e shqiptarëve, shoqërinë e drejtë, humane. Mendimi dhe krijimi romantik në përgjithësi, kur evokonte historinë, kryesisht mesjetën, shtyhej

nga synime të tjera filozofiko-morale dhe estetike; në njëren anë, nën ndikimin e Rusoit, i kundërvihet moralit borgjez, më anë tjetër, realizonte pikëpamjen e njohur estetike, sipas së cilës e bukura duhet gjetur në çdo kohë, në çdo vend, se ajo nuk ka në themel harmoninë, po përkundrazi, kontrastin e shpërpjesëtimin. Shkrimtarët tanë, sigurisht, qenë të ndjerëshëm ndaj brendisë etike që kërkonte romantizmi në të kaluarën. Ata, veçanërisht Naimi, i donin virtytet jo vetëm si humanistë të shquar, po në radhë të parë si cilësi të atdhetarit shqiptar, të flaktë në luftën për lirinë e të emancipuar në çdo pikëpamje. Ndërkao, qëllimet estetike që realizonte romantizmi evropian, kur merrej me periudhat e shkuara historike, nuk mund të linin gjurmë në krijimtarinë e shkrimtarëve tanë, e cila lindi si romantike pa u paraprirë nga vepra të natyrës klasiciste, për pasojë, pa qenë nevoja për të kundërshtuar platformën e tyre estetike.

Angazhimi i thellë pas çështjes kombëtare, më e qenësishmjë karakteristikë e romantizmit shqiptar, u ka dhënë ngjyrën e vet edhe tipareve të tjera të tij. Heronjtë lirikë ëndërrimtarë të zjarrtë të lirisë së atdheut. Pse ëndërrrojnë pikërisht për këtë liri, e se janë bartës të idesë kombëtare, heronjtë e Naimit me shokë, në shumë anë, qëndrojnë larg turës «frymë të pikëllimit botëror»<sup>1</sup> për krijimin e së cilës ka ndikuar shumë poezia e Bajronit. Sigurisht, heroi i Naimit e i poetëve të tjerë është hera-herës i trishtuar e melankolik, mundohet nga çaste fataliteti e rënije shpirtërore, harrohet pas fuqisë ndikuese të bukurisë, të cilën, në ndonjë rast, e konsideron edhe si mundësi të vetme të përsosjes morale të njerëzve. Heronjtë e romantikëve arbëreshë gjithashu kalojnë një jetë të pasionuar e të mundimshme; ata lektisen pas dashurisë e bukurisë së natyrës, janë shumë të ndjeshëm e hera herës kontradiktore në qëndrimet e tyre. Po poetët arbëreshë, Naimi e Çajupi, Asdreni në periudhën e parë të krijimtarisë, Mjeda në disa nga poemat e veta, transmetonin një botë shpirtërore që realizonte në mënyrën më intensive e më të shumanshme që mund të realizohej në ato kohëra, mendimin atdhetar, të gërshetuar me qëndrime të hapta demokratike. I ashtuquajturi «bajronizëm», kuptuar si mendësi e jashtëzakonshme në pasionet e kotnradiktat e saj, nuk la gjur-

1) Shih: R. Qosja, Kontinuitetë, Prishtinë 1972, f. 17.

më në frymën e poezië së Naimit me shokë. Edhe krijimtaria e romantikëve arbëreshë mbeti përgjithësisht larg tij; vetëm në raste të veçanta të poezië së Jeronim De Radës, tek figura e Bozdar Stresit, hera-herës edhe tek heroï lirik i Serëmbes, janë përvjuar karakteristika të tilla shpirtërore, që kujtojnë lehtë tiparet e heroit tipik romantik. Ashtu si përgjithësisht romantikët, shkrimtarët rilindës shihnin tek dashuria një nga ndjenjat më të thella humane, mundësinë e afirmimit të lirisë dhe personalitetit të njeriut. Po ndërkaq, nuk mund të mos bjerë në sy se, romantikët tanë përparimtarë, aq fort të angazhuar pas çështjes kombëtare, u mjaftuan vetëm me të tilla qëndrime, pa e shndërruar ndjenjën e harrimin pas saj në shenjat më të para të njeriut të vërtetë, në të vetmet udhërrëfyese të jetës së tij, siç ndodhë zakonisht me romantikët evropianë, të cilët nëpërmjet ndjenjës i kundërviheshin jo vetëm moralit borgjez, po edhe estetikës klasiciste, që kërkonte nga heronjtë e vet të udhëhiqeshin gjithnjë prej «arsyes» e të triumfonin mbi pasionin.

Në pajtim më prirjet më të njoitura të romantizmit, letërsia e Rilindjes i kushtoi vëmendje të veçantë përshkrimit të natyrës. Të gjithë poetët e asaj kohe ishin shumë të afërt ndaj saj. Po ndërsa romantikët evropianë e adhuronin natyrën si vendin që u siguronte vetminë e lakmuar e më së shpeshti si mjedisin që kishte forcë të jashtëzakonshme ndikuese për krijimin e njeriut me bótë të pasur e moral të pastër, romantikët tanë të nisur nga mendimi patriotik e të mërguar siç qenë, i vështruan bukuritë e natyrës në radhë të parë si bukuritë e trojeve të të parëve, si bukuritë e Atdheut që duhej cliruar. Sigurisht, predispozicioni i veçantë ndaj natyrës në poezinë e Rilindjes ka edhe arsyë të tjera, të cilat tashmë janë vënë në dukje. Me gjithë nuancat që kanë nga njëri autor tek tjetri, shkaqet që i shtynë romantikët tanë drejt natyrës janë pak a shumë të njëjtë. Nami dallon midis tyre si poeti që qëndron më pranë burimeve e domethënies filozofike të kësaj prirjeje romantike; ai gjeti në të edhe një mënyrë të përshtatshme për të shprehur pikëpamjet e tij panteiste.

Studiuësi i njojur kosovar R. Qosja ka tërhequr vëmendjen për një fakt vërtet të njojur, po që mban në vetvete një dallim tjetër të rëndësishëm të krijimtarisë së romantizmit shqiptar. «Prej romantikëve të shquar evropianë, — shkruan ai. — Viktor Hygo, për shembull, veçmas kishte fatin e tij të jetonte afro njëzet vjet në mërgim, larg atdheut të vet, kurse prej rilindësve tanë, pjesa më e madhe ose kanë jetuar vite të tëra, ose kanë

**mbetur përgjithmonë në dhe të huaj, duke mos e parë asnjeherë atdheun e vet në ditët e pleqërisë**<sup>1</sup>. Të ndodhur përpara problemit kombëtar e duke jetuar në mërgim, romantikët tanë nuk kishin asnje arsyet e ndiqnin në praktikën e tyre krijuar ekzotikën, një ndër vëçoritë më karakteristike të drejtimit romantik. Disa anë të brendisë së veprave të tyre, të cilat mund të kujtojnë ekzotikën, kanë shkaqe të ndryshme; në rastin e poezisë së Jeronim De Radës ato mund të jenë, gjër në një farë mase, ndikime të romantizmit evropian, kurse në krijimtarinë e Naim Frashërit kanë të bëjnë me shtresat e kulturës orientale që i përbante formimi i tij. Në të tjera raste këto anë burojnë vetëm nga tema historike e trajtuar shumë prej romantikëve rilindës; realizimi artistik i saj kërkonte, për shkaqe të njohura, subjekte të tillë që s'mund të mënjanonin mjedise e personazhe joshqiptare.

Qëndrimet që kanë mbajtur shkrimitarët tanë të Rilindjes ndaj rolit të poetit e krijimtarisë së tij në jetën shoqërore ngjajnë të janë të afërtë me pikëpamjet romantike në përgjithësi. Me përashtime të rralla, ata i kanë shprehur këto qëndrime në mënyrë të tèrthortë përmes vjershave të vçanta («Fjalët e Qiririt» e Naimit, «Naim Frashëri» e Çajupit etj.). De Rada e Naimi janë të bindur se poeti me jetën e veprën e tij gjendet vazhdëmisht në të gjitha shqetësimet e popullit, se ai është udhëheqës shpirtëror i tij, se atij i takon të shohë në të ardhmen. Pranë këtyre pikëpamjeve ishte sigurisht Asdreni, kur pranonte lidhjet e ngushta të poezisë me politikën, po ashtu edhe Çajupi kur ngrinte aq lart figurën e Naim Frashërit. Krijimet «Bukuria e vjershës» dhe «Vjershëtori» të Shirokës janë gjithashtu mjaft shprehëse<sup>2</sup> për të treguar se koncepti romantik mbi poetin dhe poezinë ishte shumë i përhapur e vërtet i ngulitur në vitet e Rilindjes. Brendia mistike e pikëpamjeve romantike për poetin e frymëzimin e tij haset në trajta latente më parë tek De Rada e më pas tek Asdreni, ndërsa tek Lazgush Poradeci ajo është mjaft e dukshme dhe e thellë. Idealist në konceptet e veta filozofike, Lazgushi i mbahet fort mendimit se frymëzimi ka një natyrë hyjnore, se nëpërmjet tij krijuesi shfaqet si i zgjedhuri i divinititetit.

1) Shih: R. Qosja, **Kontinuitete**, Prishtinë 1972, fq. 17.

2) Shih më hollësisht: **Historia e letërsisë shqiptare**, Tiranë 1983, f. 366.

\* \* \*

Simbioza e drejtimeve letrare, veçanërisht në vitet 1912-1934, është një tjetër përfundim i gjërë ku shpien vështrimet e përgjithshme mbi to. Ajo është krejt e dukshme në dy pikë-pamje; së pari, drejtimet letrare jetojnë krasa njëri-tjetrit, po edhe duke u kundërvënë ndërmjet tyre; së dyti, në disa raste veprat e të njëjtit shkrimtar u takojnë drejtimeve të ndryshme letrare.

Sidoqë e luajti rolin e vet gjatë Rilindjes Kombëtare, romantizmi nuk u shua në kohërat e mëvona; ai vazhdoi të jetonte si drejtim përparimtar në krijime të Lazgush Poradecit e të fitojë nota të qarta revolucionare në poezinë e Migjenit e të disa shkrimtarëve të tjera të viteve '30. Por siç ka ndodhur përgjithësisht me të, mbijetesë e romantizmit, edhe në historinë e letërsisë sonë, pati shumë arsyesh komplekse, të cilat u përcaktuan nga një varg arsyesh shoqërore e historiko-letrare, ku sigurisht dallon diferencimi i thellë i shkrimtarëve në angazhimet e tyre politiko-sociale.

Drejtimet romantikoide të letërsisë shqiptare, simbolizmi dhe paçnasi, në letërsinë shqipe erdhën, më fort në trajtë ndikimesh, të cilat tek poezia e Asdrenit dhe e L. Poradecit u bënë të mundura prej faktorësh socialë, letrarë e biografikë. Tek Dhimitër S. Shuteriqi, që botoi vëllimet «*Këngët e rinisë së parë*» (1935) dhe «*Kangë*» (1936) ndikimet simboliste<sup>1</sup> ishin pasojë e leximeve të një krijuesi fare të ri që sapo hynte në botën komplekse të letërsisë. E megjithatë këto shfaqje përvijuan një pasojë formaliste, që mbeti në trajta latente; ajo nuk arriti të mbartë karakteristikat kryesore as në krijimtarinë e Asdrenit e Lazgush Poradecit, ku gjithsesi u duk më dendur.

Po nuk ndodhi kështu me romantizmin regresiv; pas vitit 1912, ai u zgjerua në shtjellat e letërsisë së kohës në veprat e Fishtës, Z. Skiroit, E. Koliqit etj., i nxitur nga botëkuptimet fetaroklerikaliste, nga psikologjia e inteligjencies borgjeze, nga synime politike reaksionare e antishqiptare.

Një shfaqje krejtësisht anakronike ishte epigonizmi i tragedive të E. Haxhiademit, që ndoqi modelet e klasicizmit. I panevojshëm edhe në vitet e Rilindjes, klasicizmi mund të vinte më pas në letrat shqipe vetëm si përpjekje konformiste

1) Shih më hollësisht: **Historia e letërsisë shqiptare**, Tiranë 1983, f. 581.

për të himnizuar rendin e vendosur. Kjo dukuri, e mbartur nga një shkrimtar mediokër, mbeti i izoluar, pa jehonë dhe u harrua shpejt.

Në shumë nga tiparet e veta, posaçërisht me natyrën e vet thellësish demokratike, romantizmi përparimtar krijoi premissa, të cilat, në kushte të tjera historiko-shoqërore, shpunë në lindjen e drejtimit realist. Ai ishte thuajse i njëkohshëm me krijimtarinë sentimentaliste, po sigurisht la gjurmë më të thella në rrjedhat e letërsisë. Realizmi ishte drejtimi i parë që nisi të përpunojë platformën e vet estetike, me të cilën i doli ndesh krijimtarisë romantizante e sentimentalizuese. E trajtuar vetëm pjesërisht nga romantizmi rilindës, problematika shoqërore zgjerohet mjaft në prozën e realistëve tanë, Migjenit e N. Bulkës. Nëpërmjet saj realizmi thelloi më tej traditën demokratike të romantizmit e sentimentalizmit dhe arriti disa rezultate në pasqyrimin artistik të fenomeneve shoqërore e shkaqeve të tyre lëvizëse.

Përmes këtyre proceseve, në vitet 1912-1939, dallohen në qartë dukuri që e polarizonin letërsinë në dy kahje të kundërtë për nga brendia e tyre. Prandaj simbioza e drejtimeve, për të cilën bëhet fjalë, duhet kuptuar jo si bashkëjetësë, me këmbime të ndërsjellta, po vetëm si zhvillime të njëkohshme fenomenesh krejt të ndryshme në shumë pikëpamje.

Në rast se mund të flitet për simbiozë në kuptimin e parë të termit, atëherë ajo do shikuar në krijimtarinë e autorëve të veçantë. Realizmi i komedive të Çajupit u përgatit e u ushqye edhe nga thekset materialiste, qëndrimet e qarta anti-klerikaliste e antifeudale dhe simpatitë e thella demokratike, të përpunuara prej krijimtarisë së tij poetike, përgjithësisht romantike. Realizmi i prozës së Migjenit ishte pasojë logjike e patosit kritik të poeziës që ai la, e cila në shumë krijime të saj mbetej romantike, se synonte një jetë tjetër më të mirë e më të drejtë kryesisht përmes përfytyrimesh vegimtare, se përbante dramën e thellë të individit që s'pajtohej kurrsesi me shoqërinë e mjediset ku jetonte.

Shfaqjet e parnasit e të simbolizmit në krijimtarinë e Asdrenit janë pasojë e mundshme e frymës romantike të saj; ato u ravijëzuan kur poeti u shkëput ngajeta e vendit të tij, u mbyll në vetvete, kur nisi të kërkonte frymëzimin më shumë në leximet e poeziës së huaj.

Kalimi i shpejtë i shoqërisë shqiptare nga çështja kombëtare në probleme të tjera, social-klasore, veçoritë e letërsisë si lloj i artit, gjendja e zhvillimit të prozës dhe dramaturgjisë

janë ndër shkaqet kryesore, të cilat bënë të mundur që në vitet 1912-1939 historia e letërsisë shqipe të njohë një ngjeshje drejtimesh, prirjesht e dukurish më të veçanta. Ajo nuk mund të ruante më karakterin pak a shumë «homogen», që binte në sy në periudhën e Rilindjes; «heterogeniteti» i saj në kohërat që erdhën më pas ishte i pritur e i natyrshëm. Dukuritë sporadike të klasicizmit, të parnasit e të simbolizmit, të shpërndarë brenda pak vitesh, nuk mund të shpien në përfundimin se letërsia ecte nëpër një amalgamë drejtimesh nga më të ndryshmet. Tendencat më të thella e më të qarta të proceseve historiko-letrare shkonin nga romantizmi përparimtar tek realizmi, i cili për një kohë u parapri e më pas bashkëjetoi me sentimentalizmin. Megjithëse epoka që e thirri dhe e krijoj romantizmin u kapërcye, roli i tij në letrat shqipe, si e vumë në dukje, nuk përfundoi. Romantizmi përparimtar ishte i nevojshëm pas Shpalljes së Pavarësisë, sepse letërsia do të vazhdonte të kërkonte me këmbëngulje ndryshime, që tanë kishin të bënë fort me jetën sociale; ajo do të vazhdonte të përfytyronte një tjetër shoqëri shqiptare, më të drejtë e më njërezo. Sidomos në poezi shkrimitarët nuk do t'i ndaheshin ëndërrimit të shqetësuar e të angazhuar pas një ideali, i cili mund të ishte ende subjektiv dhe i paqartë, po megjithatë i jepte krijimtarisë patos të fuqishëm romantik revolucionar. Ky ideal ishte fort i gjallë në poezinë e Migjenit e të poetëve të tjerë të viteve '30, që sapo kishin nisur udhën e krijimtarisë.

Dukuritë sentimentaliste të një pjese të prozës së asaj kohe nuk mund të kuptohen dot pa mohimin e moralit regresiv feudalo-klerikal, pa bindjen e ngulitur se tanë duhej një mënyrë e re e organizimit të marrëdhënieve etike në shoqërinë shqiptare.

Në rrethanat që u krijuan pas ngritjes së shtetit shqiptar, shumë shtresa të borgjezisë dhe sidomos të mikroborgjezisë nisen të ndjejnë e të shprehin nevojën e domosdoshme për ndryshime në jetën shoqërore e në mendësitë e kohës. Por, megjithëse po kuptohej gjithnjë e më fort natyra thellësisht reaksionare e feudalizmit, nuk po arrihej të mposhtej ndikimi i tij ende i fuqishëm. Në mendimin përparimtar të kohës, kundërshtimi ndaj parësisë feudale akoma nuk gjente dot mundësi të tjera për t'u shprehur, veç patosit sentimentalist që shihte tek vegjëlia njeriun e ndjeshëm e delikat, si burimin e harmonisë e drejtësisë shoqërore. Prandaj letërsia shqipe e viteve '20-'30, pas gjasash, do të kalonte pa tjetër përmes përvit

vojës sentimentaliste, e cila shfaqej në ato kohëra edhe si praktikë që kërkohej prej fillimeve të prozës sonë. Pikërisht për këto arsyen, në rrjedhat e letërsisë sonë nuk ishte sentimentalizmi që i hapi udhë romantizmit, po përkundrazi romantizmi, me disa tipare të vetat, në kushte të tjera historiko-shoqërore, bëri të mundur krijimet sentimentaliste. Megjithëse i përligjur në kohën e vet, sentimentalizmi në përgjithësi nuk mundi të përtërijë vlerat që krijuan romantikët tanë përparimtarë. Sigurisht në disa anë, veçanërisht në pasqyrimin e disa tipareve të shtresave të ndryshme shoqërore, ai i shpuri më tej rezultatet e letërsisë të Rilindjes dhe, nga kjo pikëpamje, u dha dorë edhe zhvillimeve të mëvonshme realiste të saj. Po të përjashtohet romani «Sikur t'isha djalë» i H. Stërmillit, shumë nga veprat e Ndoc Nikajt e Gramenos me shokë, të prira pas subjektesh intrigue, kthesash e zgjidhjesh të papritura e naive, të lektisura pas ndjenjës së dashurisë, nuk shkëlqyen për forcë mendimi, për analiza të thelluara psikologjike të botës shpirtërore të personazheve që krijuan, për nivele të larta artistike në përgjithësi. Një Serafinë e një Bozdar, një hero lirik, si ai i poezisë së Naimit, me përsiatjet e tij të vazdueshme, mendimtar i pasionuar e natyrë ndjenjëhollë, një temperament i vrullshëm kritik ai i heroit të poezisë së Çajupit, nuk gjenden në prozën sentimentaliste. Sigurisht, këto dallime nuk mund të shpjegohen dot vetëm me shkaqe të brendshme letrare, me fillimet e prozës së gjatë e me kufizimet individuale të talenteve që e lëvruan në dekadat e para të shekullit XX. Pikëpamjet sociale që synonin të transmetonin sentimentalistët tanë, sidoqë me thekse të qarta demokratike, ruanin në shumë krijime të tyre një esencë të qartë «paqtimi», «harmonie» që kërkohej gjithnjë në rrafshin moral e që ishte shpesh prej burimi fetar. Të tilla pikëpamje mbanin zakonisht shtresat mikroborgjeze, të cilat shpirtërisht nuk pajtoheshin me plagët e realitetit shoqëror, po njëkohësisht ishin të paafta të gjenin zgjidhje radikale për to. Prandaj ishte e zakonshme që veprat sentimentaliste, përmes vuajtjes e trishtimit melodramatik, të binin në pozita fataliteti, iluzioniste e reformiste. Do të duhej të vinin qëndrimet e inteligjencies demokratike përparimtare të ndikuara nga mendimi materialist, që letërsia në prozën e një Migjeni, të mënjanonte çdo lloj iluzioni, që fataliteti e skepticizmi pa u shmangur krejtësisht nga bota subjektive e shkrimitarëve, të shiheshin edhe si pjellë e gjendjes ekonomiko-sociale të kohës, që mund dhe duhej të kapërcehej jo përmes afrimit mirëdashës «panhuman», po përkun-

drazi, nëpërmjet ndeshjeve e luftërave midis njerëzve të shtresa e klasave antagonistë shoqërore, ku letërsia do të luante rolin e vet plotësishët të angazhuar. Ishte e natyrshme që pikëpamje si këto, të mos pranonin më në praktikën krijuar personazhe, psikologjia e të cilëve dominohej shpesh vetëm nga dashuria (novelat e Gramenos, disa tregime të Helenaut), po përkundrazi, të synonin të realizonin karaktere që mendonin, ndienin e silleshin sipas një logjike të brendshme objektive, të përcaktuar nga mjediset jetësore, nga pozita e tyre shoqërore e ekonomike (novelat e Migjenit, skicat e N. Bulkës, disa nga krijimet e M. Kutelit etj.). Për të tillë pikëpamje, të cilat e shihnin jetën në raporte të komplikuara shkakësore, ishte e domosdoshme që në krijimtarinë letrare, të ndërtoheshin subjekte, të cilat kërkonin në radhë të parë vërtetësinë bindëse dhe jo dramën afektuoze; ngjarjet më të shpeshta të jetës së përditshme dhe jo ndodhi të veçanta, ku fatet e njerëzve përcaktoheshin nga rastësitë e të papriturat; tipizimin e së përgjithshmes dhe jo ekzaltimeve e gjendjeve shpirtërore tepër të mprehta e të jashtëzakonshme. Krijimtaria që ndoqi këto synime hoqi dorë, sigurisht, nga disa mjete shprehëse të përpunuara nga romantizmi e sidomos sentimentalizmi. Emfaza do të shfaqejet vetëm në disa skica e pamflete dhe do t'ia linte vendin një fraze të shtruar, që transmetonte drejtëpërdrejtë e objektivisht ngjarjet, mendimin e botën shpirtërore në prozën tregimtare. Ironia dhe satira po edhe grotesku, në pajtim me patosin kritik të shumë krijimeve, bëhen gjithnjë e më të pranishme e mënjanojnë të shprehurit, që me figuracionin e vet të ngarkuar po jo shumë të thellë e hera-herës letraresk, kërkonte të qe sa më prekës për lexuesin.

Në këto shtigje i hapte udhën vetes krijimtaria realiste, që erdhi në letrat shqipe si kërkësë e jetës shpirtërore të vendit, e cila në kahjet e saj përparimtare, synonte të zbulonte shkaqet komplekse të padrejtësisë shoqërore e, nëpërmjet tyre, të argumentonte aq sa mundte e ashtu si mundte, domosdosh-mërinë e transformimeve rrënjosore të gjendjes social-ekonomike, social-psikologjike, po edhe politike të vendit.

Drejtimi realist në historinë e letërsisë sonë nuk e pati të lehtë të njihte zhvillime të gjera e të vrullshme. Sigurisht, atij nuk i munguan aspak talentet e fuqishme; po ashtu, shumë karakteristika të frysës romantike të letërsisë së Rilindjes Kombëtare përbën një truall fort të qëndrueshëm ku mund të mbështeteshin, siç u mbështetën, prirjet realiste. Po ndërsa për lulëzimin e romantizmit ndihmonin shumë faktorë pol,

tiko-shoqërorë, realizmi përkundrazi, pengohej mjaft nga prapambetja e theksuar e të gjitha anëve të jetës së vendit, nga trajtat ende rudimentare të kapitalizmit, nga sundimi i regresit që bartej prej feudalizmit e monarkisë. Për shumë arsyё romantizmi shqiptar gjente tek poezia, tek kjo gjini që kudo ka lindur më parë, formën më të përshtatshme të shprehjes së vet; ndërsa realizmit i duhej proza tregimtare, e cila në ato vite ishte në häpat e parë. Romantizmi përparimtar shtrihet në afro një shekull, ai vazhdoi të jetonte edhe pas vitiit 1912, kurse realizmit iu desh të shfaqte tiparet dhe mundësitë e veta në një kohë shumë të shkurtër, në afro dy dekada; në këtë kushte ishte e natyrshme që numri i shkrimtarëve romantikë të qe më i madh nga ai i realistëve. Prandaj, për të gjitha këto arsyё historia e letërsisë shqipe nuk do gjykuar kurssesi nga shkalla e formësimit të realizmit, ajo do vlerësuar se me gjithatë arriti ta ndiente thellë nevojën e këtij drejtimi dhe ta përvijonte në mënyrë mjaft të qëndrueshme, të krijonte një traditë të fuqishme që do të shpihej shumë më përparrë prej realizmit socialist, të lindur gjatë Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare e të konsoliduar në epokën e ndërtimit socialist.

## RESUME

La première tâche de l'*histoire de la littérature d'un peuple* est, assurément, d'étudier et de situer dans son temps la vie et l'œuvre des auteurs qui ont créé cette littérature, considérés chronologiquement et en étroite relation avec les circonstances historico-sociales et idéologico-culturelles qui en ont déterminé le contenu. A côté de cette conception, qui s'est muée en tradition et qui a résisté à l'action du temps, d'autres pratiques édifient l'*histoire de la littérature* sur l'étude de la naissance et du développement de ses traits essentiels dans le cours du temps, de ses idées et de ses thèmes les plus importants, des genres et des types élaborés par elle, etc. Quoi qu'il en soit, une histoire de la littérature ne saurait être complète si elle ne parvient pas à mettre en lumière et à généraliser les aspects communs et les différences fondamentales entre les positions idéelles et esthétiques prises par ses auteurs pour rendre sur un plan artistique les problèmes fondamentaux de leur temps. Les circonstances politiques et sociales d'une période historique déterminée suscitent inévitablement chez les écrivains des attitudes conceptuelles approchantes ou opposées, des appréciations variées des événements et des hommes, des conceptions esthétiques similaires ou au contraire différentes, des pratiques créatrices qui peuvent avoir des traits communs ou être fort distinctes les unes des autres. Aussi est-il indispensable que l'*histoire de la littérature* soit accompagnée de larges regards sur les traits qui rassemblent ou divisent les œuvres littéraires en groupes particuliers.

Nombre de théoriciens et d'historiens de la littérature,

*qui la conçoivent comme la représentation artistique de la vie sociale, continuent encore de discuter des notions qui qualifient ces phénomènes, dans lesquels ils distinguent, d'une part, le courant, où ils englobent toutes les créations qui appréhendent la vie sociale à partir d'attitudes conceptuelles identiques ou similaires et, partant, traitent plus ou moins de la même problématique idéelle, et, d'autre part, l'école, qui se forme aussi sur la base de l'élaboration esthétique des conceptions philosophiques et sociales d'un courant déterminé.*

*La pensée esthétique dans notre pays a commencé à se développer relativement tard. Malgré tout, nous nous en tiendrons au terme d'«école littéraire», car les points de contact et les tendances communes dans les attitudes philosophiques, les émotions esthétiques et les modes de représentation artistique dans la production d'un groupe d'écrivains, contacts et tendances conditionnés par des circonstances historiques et sociales déterminées, se manifestent en tant que tels, qu'ils soient ou non élaborés en théorie.*

*Cet essai ne se fixe pas pour but de réaliser une analyse complète de l'oeuvre de tous les écrivains des époques historiques qu'il traite. Un pareil travail aurait pu difficilement être affronté et déborderait même le cadre du propos principal de celui-ci, qui est de réaliser une synthèse. Les similitudes dans la thématique, dans les problèmes posés et dans la manière de les résoudre, les affinités dans les vues politiques et les attitudes conceptuelles des auteurs, autrement dit les éléments qui constituent l'esprit général des œuvres, groupés historiquement dans les principales écoles littéraires, seront l'objet essentiel de cette étude, qui traitera aussi, dans une certaine mesure, à chaque fois que cela paraîtra nécessaire, d'aspects concernant la forme des œuvres.*

*Assurément, l'appartenance de l'oeuvre d'un écrivain des années de notre Renaissance nationale, et de la période qui suivit, aux diverses écoles n'a jamais été déterminée nettement, de l'école successive ne sont tranchées comme avec un couperet. Mais cela ne veut pas dire que la relativité des limites auteur ou de la création littéraire d'une période donnée; cette relativité atteste à sa manière les difficultés à surmonter pour le développement du problème traité et, d'autre part, impose des modifications dans la méthode suivie dans le cours même de ce travail.*

Dans les chapitres consacrés à la littérature albanaise d'Italie la synthèse occupe une plus large place. Il en va de même des phénomènes sentimentalistes et réalistes de notre littérature. Ce travail s'arrête en particulier sur certains autres représentants de la période de notre Renaissance nationale, et revêt un caractère plus analytique pour deux raisons: la première, parce que, comparée à la poésie des Albanais d'Italie, leur oeuvre élargit sensiblement les motifs et soulève plus de questions à éclaircir; deuxièmement, parce que l'oeuvre de certains des poètes de cette époque, bien que restant fidèle en général à une école, comporte en même temps des tendances nettement apparentées à d'autres. Par ailleurs, le romantisme, qui prédomina au cours de notre Renaissance nationale, continua de se manifester avec beaucoup de vigueur, mais naturellement en revêtant de nouveaux traits, dans l'oeuvre de certains auteurs des années 20 et 30.

Cet essai étudie la majeure partie de la production littéraire de la période allant de 1836 à 1939. Il n'a laissé en dehors de ses limites que quelques œuvres, relativement peu nombreuses, qui ne sont pas encore connues comme il conviendrait, ou qui ne présentent pas une importance particulière pour un tableau d'ensemble des écoles dans l'histoire de notre littérature.

En tant que premier ouvrage de cette nature, le travail que nous présentons reste assurément un essai qui ne peut être exempt de lacunes et d'insuffisances de diverses natures. Quoi qu'il en soit, s'il est parvenu à poser quelques questions réellement essentielles des courants historico-littéraires et à les résoudre, fût-ce en partie, nous espérons qu'il n'aura pas été inutile.

Bien entendu, les écoles littéraires auxquelles appartiennent les œuvres des écrivains qui sont entrés dans la tradition, ont depuis longtemps été définies par notre historiographie. De temps à autre, elle s'est efforcée de brosser des tableaux synthétiques de leurs traits et de leurs voies de développement. Mais si l'on excepte quelques études du Pr Rexhep Qosja, et surtout son œuvre «Histoire de la littérature albanaise — le Romantisme», publiée à Prishtina en 1984, les autres travaux, jusqu'ici rares, ont visé à ébaucher les particularités d'une des écoles de notre littérature, en premier lieu du romantisme, qui reste le phénomène le plus étudié. S'agissant de travaux d'ampleur réduite, de communications et d'articles scientifiques, ils n'ont naturellement énoncé que quel-

ques thèses qui attendent d'être développées et argumentées.

Les autres écoles de notre littérature sont traitées de façon bien plus restreinte, au passage, au long de l'examen des œuvres de tel ou tel écrivain. Assurément, le réalisme a attiré l'attention des chercheurs, mais souvent sa manifestation est identifiée à l'extension de la thématique sociale et de l'esprit critique dans la littérature évoluée postérieure à la proclamation de l'Indépendance.

D'autre part, les études menées jusqu'à ce jour ne sont pas consacrées autant qu'il aurait convenu aux écoles littéraires en tant que phénomènes d'ensemble complexes, qui rapprochent les œuvres de divers écrivains tout en mettant en relief leurs différences. Le cheminement des écoles, de même que les rapports et les différences qui les caractérisent ont été seulement ébauchés sans faire l'objet d'une analyse d'ensemble. C'est ce que l'on observe entre autres dans le texte de l'*«Histoire de la littérature albanaise»*, publiée par l'Institut de Linguistique et de Littérature en 1983, laquelle ne consacre que quelques paragraphes aux questions concernant les écoles qui se sont manifestées dans le cours même du développement de la littérature albanaise attachée à la tradition.

C'est pourquoi nous avons estimé que l'historiographie albanaise a pour devoir d'étudier de près les écoles littéraires, à leur naissance, à leur formation et à leur disparition. Assurément, les problèmes qui émergent dans des études de cette nature sont multiples et fort complexes, ils ne peuvent être résolus de manière exhaustive par une monographie; cela nécessiterait un travail de longues années de plusieurs historiens de la littérature.

\* \* \*

I. Dans les regards jetés sur les diverses périodes historiques, on s'est surtout attaché à rendre les principales tendances de l'évolution politique et sociale sur laquelle repose l'apparition de certains traits communs au contenu des créations littéraires, l'élaboration d'attitudes idéologiques et esthétiques approchantes, qui ont entraîné des similitudes dans les modes de représentation artistique de la réalité.

II. Le romantisme des Albanais d'Italie est traité dans les chapitres: «La Grande époque et son évocation»; «Le héros, protagoniste de la tragédie albanaise du XV<sup>e</sup> siècle, porteur de l'idée nationale, de méditations et de sentiments profonds»; «Les territoires de nos ancêtres et leur nature». Considérés dans leur ensemble, ces chapitres visent, à travers des comparaisons avec des phénomènes correspondants de la littérature européenne, à mettre en lumière leurs affinités et leurs différences, à découvrir les traits originaux du romantisme dans la littérature albanaise d'Italie. Dans ces chapitres l'accent est mis sur la conception selon laquelle le romantisme des Albanais d'Italie, dans tous les éléments de son contenu, a exprimé au premier chef l'idée nationale; c'est aussi la raison pour laquelle, dans ses contacts naturels avec le romantisme européen, il a acquis des caractéristiques spécifiques, qui se manifestent en premier lieu dans le traitement intensif des thèmes historiques et dans la représentation d'un héros dont l'univers spirituel est surtout déterminé par le profond patriotisme, ainsi que dans l'exclusion du subjectivisme poussé à l'extrême et de ses conséquences sur le fond, propres à la création romantique. Le romantisme des Albanais d'Italie, au même titre que toute la littérature de la Renaissance nationale albanaise, est né en tant qu'expression de la lutte pour l'indépendance; ses traits sont tous déterminés par son engagement politique. C'est pourquoi l'évocation de l'histoire, pour nos romantiques, avant d'être la négation de la vie de leur époque, glorifie la liberté à reconquérir; c'est pour cela aussi que la nature, plus que théâtre de la solitude tant chantée par les romantiques européens, était, pour nos écrivains, la source des beautés incomparables de la patrie. D'autres caractéristiques de la création romantique européenne n'ont pas laissé de traces profondes dans l'œuvre des romantiques de notre Renaissance nationale. Il en a été ainsi de ce que l'on appelait le «mal du siècle», de l'exotisme et de la diffusion de l'influence de la poésie de Byron, alors très sensible dans la littérature romantique européenne.

III. Un parallèle, si rapide soit-il, entre l'œuvre poétique de Naim Frashëri et l'école romantique dans ses principaux

traits fait ressortir entre elles de nombreuses et importantes différences. Ce parallèle occupe la première partie du chapitre consacré à son oeuvre. Par la suite, sont abordés les traits fondamentaux qui confèrent à la poésie de Naim Frashëri des particularités originales dans le cadre de son inspiration romantique. Dans ce chapitre on a eu pour propos d'étayer le plus largement possible la thèse selon laquelle Naim Frashëri dans son oeuvre a surtout élaboré, parmi les différents traits de l'école romantique, ceux qui offraient les meilleures possibilités de représenter les efforts des promoteurs de notre Renaissance pour conquérir l'indépendance politique du pays et instaurer un ordre démocratique et avancé. C'est la raison fondamentale pour laquelle dans la poésie de Naim Frashëri est esquissé plus clairement que partout ailleurs un trait original de l'ensemble du romantisme albanais, son harmonisation avec les idées des lumières, que la littérature romantique européenne refléta en général dans la crise que ces idées connurent après la Révolution bourgeoise française. Aussi l'oeuvre de Naim Frashëri laisse-t-elle de côté la tristesse et l'amertume propres au romantisme; elle se distingue au contraire par ses sentiments optimistes, comme la confiance allègre, l'enthousiasme à l'égard des beautés naturelles de la patrie et surtout des vertus des simples gens d'Albanie, ceux des temps passés comme ceux de l'époque du poète.

La poésie de Naim Frashëri se rapproche du romantisme non pas tant par l'extraordinaire, le dramatique, la mélancolie, l'exotisme et d'autres traits de ce genre, que par le rêve d'une Albanie libre et avancée, par la glorification de la raison, de la beauté et de l'humanisme, en tant que voies qui conduiraient à la création d'une société véritablement humaine, tant souhaitée par les romantiques.

\* \* \*

IV. Dans l'histoire de la littérature albanaise, la production de Çajupi comporte des œuvres qui appartiennent à diverses écoles littéraires. En tant que telle, elle est examinée aussi dans le chapitre consacré au classicisme et surtout dans celui qui étudie la naissance du réalisme. En outre, un chapitre particulier a pour objet d'enrichir les arguments soutenant le caractère généralement romantique de sa poésie, qui, du fait qu'elle traite fréquemment de thèmes sociaux, a parfois été jugée réaliste.

La poésie de Çajupi est restée romantique, car, conformément à l'esprit général de la littérature de la Renaissance albanaise, elle voulait un culte à l'histoire et à la nature de l'Albanie, aux vertus de ses compatriotes, elle sollicitait avec passion un rapide changement du statut politique de son pays. Çajupi reste romantique dans sa poésie même lorsqu'il identifie le bonheur seulement à l'amour, lorsqu'il considère l'univers des démunis comme le seul qui conserve une véritable pureté morale, lorsqu'il s'attriste sincèrement sur le monde et la vie, qui à ses yeux étaient dominés par le mal, etc.

\* \* \*

V. L'oeuvre d'Asdren est trop complexe pour qu'il soit possible de lui assigner une place dans une école littéraire. S'étendant sur un espace de temps relativement long, elle a connu des changements importants dans ses éléments fondamentaux. Tout en portant un jugement sur ses poésies de contenu réaliste, que notre historiographie littéraire a étudiées depuis longtemps, ce travail s'attache à découvrir, outre les traits romantiques de la poésie d'Asdren, les causes sociales et historico-littéraires, qui ont rendu possible l'apparition des influences du symbolisme et de l'école parnassienne dans la seconde période de sa création.

Les grands changements qu'a connus dans son contenu la poésie d'Asdren, de sa première à sa seconde période, s'expliquent par la profonde désillusion du poète face à l'évolution politique de l'Albanie dans les années qui suivirent la Proclamation de l'Indépendance, par sa rupture personnelle d'avec la vie du pays, par le caractère idéaliste de sa vision du monde et surtout par le fait que, dans son oeuvre, il s'est tenu aux positions d'un intellectuel démocrate petit-bourgeois. Certes, dans le mouvement national le rôle de la petite-bourgeoisie est généralement progressiste, et il demeura tel dans le mouvement démocratique qui conduisit à la Révolution démocratique bourgeoise de 1924. Cependant, l'échec de cette révolution rejeta la petite-bourgeoisie dans la passivité, dans la recherche de solutions fondées sur un «humanisme panhumain» sur la «raison pure» et la «morale sans tache», sur la religion et la charité chrétiennes, enfin sur la beauté en soi recherchée non seulement comme un objet de l'art, mais souvent aussi comme la seule possibilité de perfectionnement moral de l'humanité.

\* \* \*

VI. L'oeuvre de Mjeda comporte-t-elle des éléments qui aient contribué à promouvoir le passage de la littérature albanaise du romantisme au réalisme? C'est là aussi une des questions sur laquelle cette étude a porté son attention. L'auteur s'en tient au jugement selon lequel cette œuvre, dans les grandes lignes, est, de par son contenu, romantique.

Les accents réalistes dans le poème «Le rêve de la vie», son œuvre la plus importante, ne parviennent pas à en altérer, dans les grandes lignes, l'essence généralement romantique. Mjeda ne s'attacha pas à montrer les conditions sociales qui conduisaient à des destins comme celui du personnage principal du poème. La nature généralement romantique de sa poésie est plus sensible dans d'autres de ses œuvres. Par ailleurs, dans «Scodra» et «Lissus» se retrouvent les influences de la littérature classique, qui se manifestent dans l'habit poétique très raffiné, dans un travail du style des plus minutieux et dans une forme disciplinée à l'extrême. Les influences du classicisme dans l'œuvre de Mjeda sont naturelles, et même attendues.

Il ne pouvait en être autrement dans le cas d'un écrivain comme lui, un prêtre instruit dans des écoles qui accordaient à la rhétorique classique un rôle prépondérant dans la formation des jeunes. Néanmoins, la poésie de Mjeda doit être appréciée en ce que, tout en étant tant soit peu attirée par les modèles classiques, elle a, dépassant les sources de sa formation, suivi les traces du romantisme.

\* \* \*

VII. Ce travail ne s'est pas fixé pour but de découvrir sous tous ses aspects le fond de la poésie de Lazgush Poradeci. Il s'est seulement attaché à déterminer le plan de l'école littéraire auquel appartient cette poésie. L'œuvre de Lasgush Poradeci présente de nombreux traits qui conduisent à conclure à son essence romantique, bien qu'elle comporte aussi, tout comme la poésie d'Asdren, des créations s'inspirant des écoles post-romantiques, symboliste et parnassienne.

L'auteur a souligné la tendance la plus évidente de cette poésie, son message humain et progressiste. Dans la conception du poète, ce message reste souvent abstrait et émaillé de con-

traditions. Il fait de la beauté un élément d'origine divine, le seul moyen d'ennoblissement moral de l'humanité. Quoi qu'il en soit, il a enrichi sensiblement les émotions romantiques dans les lettres albanaises.

VIII. *L'histoire de la littérature albanaise a connu aussi des éléments propres au romantisme réactionnaire. Cette étude explique les causes de sa naissance et les traits qu'il a revêtus dans l'oeuvre des écrivains qui en ont été les porteurs: Zef Schirò, dans une part de son oeuvre, et surtout Gjergj Fishta et Ernest Koliqi.*

Analysant la poésie de Zef Schirò, l'auteur relève que le contenu politique de certaines de ses œuvres était en opposition avec le pathos fondamental du romantisme de notre Renaissance nationale, qui demandait une Albanie libre et indépendante. Ce romantisme pouvait permettre des attitudes par ments aspects contradictoires dans la conception du monde des écrivains, il pouvait admettre une imagination incertaine, comme celle qui ressort dans les écrits de Schirò, mais il ne pouvait en aucune manière pactiser avec des vues qui demandaient le remplacement de l'ancienne occupation par un protectorat, fût-ce de type nouveau.

Opportuniste jusqu'à la moelle, s'étant toujours montré prêt à vendre ceux qui l'achetaient en couvrant ses agissements d'un voile de patriotisme, Gjergj Fishta, par son œuvre, causa de graves torts au mouvement de notre Renaissance et, par la suite, au mouvement démocratique dans notre pays.

Poète de la sacristie, théocrate convaincu, Fishta eut tôt fait de se détacher de l'essence du romantisme albanaise. Avec Koliqi ils chantèrent l'état d'arriération des montagnards albanaise, les dépeignant comme des êtres qui ne manifestaient leur vitalité que dans la défense de leur coutumier avec un entêtement fanatique et une haine invétérée de la civilisation.

Ces vues étaient naturelles et bienvenues pour l'intelligentsia cléricale, elles l'étaient aussi pour la mentalité de certaines couches de l'intelligentsia bourgeoise, qui ayant accepté au cours du régime zoguiste l'hégémonie de la féodalité, rêvait de préserver le statu quo et s'y employait de toutes les manières, finissant même dans le giron du fascisme, comme le firent Fishta et Koliqi.

\* \* \*

IX. Certaines œuvres classiques de Cajupi et de Grameno furent le résultat des efforts, assurément peu heureux, de ces auteurs pour développer le genre de la tragédie. Entretemps, Ethem Haxhiademi, dans les années 20 et 30, suivit avec persévérance les modèles des grands tragiques classiques français. Il ne faut pas s'étonner de l'affection particulière de cet écrivain foncièrement conformiste pour une école dont la littérature albanaise n'avait pas ressenti l'attrait même auparavant. La plupart de ses tragédies ont été écrites et publiées durant la monarchie zoguiste, qui s'efforça, bien entendu, d'entretenir l'illusion que la royauté était la forme d'Etat la plus avancée et qui convenait le mieux à l'Albanie. Mais, de même que la monarchie de Zogu n'était qu'une caricature de l'absolutisme, l'œuvre d'E. Haxhiademi n'était qu'une copie risible de la fameuse tragédie classique. Dans l'ensemble des développements littéraires de ces années-là elle constituait un anachronisme absolument injustifié, comme était anachronique le régime monarchique de Zogu. Si Ethem Haxhiademi inclina vers le classicisme c'est qu'il y trouvait une nette nuance conformiste. Toutefois, les plumes qui avaient cultivé la célèbre tragédie classique étaient si puissantes qu'elles dépassèrent la faiblesse des conceptions politiques, idéologiques et esthétiques dont elles s'inspiraient. E. Haxhiademi, au contraire, resta un imitateur dilettante, qui fit siennes certaines règles de la structure de cette tragédie et s'attela à une tâche bien trop pesante pour ses épaules. Le coup le plus rude que le temps inflige à ce genre d'écrivains est l'oubli complet. C'est le sort qu'ont subi les écrits de Haxhiademi, qui n'ont laissé aucune trace dans l'histoire de la littérature albanaise.

\* \* \*

X. Beaucoup d'aspects des commencements de notre prose posent la question: la littérature albanaise dans son évolution historique a-t-elle connu aussi l'école sentimentaliste? Dans l'affirmative, il faut expliquer aussi pourquoi le sentimentalisme est apparu dans l'histoire de notre littérature comme un phénomène postromantique, à la différence du sentimentalisme de la littérature européenne, qui prépara le romantisme

et, précisément pour cette raison, a été qualifié par certains hommes d'étude de préromantisme?

Le chapitre intitulé «le Sentimentalisme dans l'histoire de la littérature albanaise» s'occupe de ces problèmes.

L'auteur s'en est tenu au point de vue selon lequel la littérature albanaise, dans son évolution historique, a élaboré à sa manière l'école sentimentaliste, qui se manifeste dans les dernières années de la Renaissance albanaise et dans la période postérieure, celle où s'affirment plus nettement les tendances démocratiques et l'attitude antiféodale des forces progressistes de la société du pays. Ces tendances, très sensibles auparavant déjà, se ravivent beaucoup précisément à cette époque et c'est la raison pour laquelle le sentimentalisme dans la littérature albanaise s'est présenté comme un phénomène postromantique et n'a pas suivi l'ordre chronologique des littératures de l'Europe occidentale. Le romantisme albanaise est la création des poètes; quant à la prose, encore privée de tradition, il lui fallait, dans son évolution, passer par le sentimentalisme.

\* \* \*

XI. Quelles furent les caractéristiques du romantisme albanaise, et dans une certaine mesure celles du sentimentalisme qui créèrent le terrain propice au passage de la littérature progressiste des années '30 aux positions du réalisme? Quels traits acquit cette nouvelle école. A quel point réussit-elle à se consolider? Ces questions sont traitées dans le chapitre intitulé «Du romantisme aux courants du réalisme». Partant de la conception matérialiste selon laquelle les modifications dans la vie économique et sociale déterminent l'évolution de la vision du monde des écrivains et leurs pratiques créatrices, ce chapitre vise à mettre en relief la continuité dialectique de la tradition démocratique et révolutionnaire de l'histoire de la littérature albanaise, sans entrer dans une analyse détaillée d'oeuvres particulières, par ailleurs déjà faite, mais à travers un effort pour synthétiser les processus dès lors accomplis. Le profond engagement dans le traitement des questions vitales de l'époque, les attitudes démocratiques déclarées, les vues philosophiques progressistes, la clarté de l'expression artistique et d'autres traits du romantisme de notre Renaissance nationale, dans les conditions historiques créées à la

suite de la Proclamation de l'indépendance et de la consolidation de l'Etat albanais, s'accentuent et acquièrent un nouveau contenu dans l'oeuvre de Migjeni et de ses émules, qui dépeignirent la vie dans sa complexité économique et sociale, et l'homme de ces années-là comme un produit de cette complexité, comme un caractère social. C'est la thèse essentielle qui est développée, avec arguments à l'appui, dans ce chapitre, l'un des plus vastes de cette étude.

La naissance et la structuration du réalisme dans les lettres albanaises se sont heurtées à de multiples obstacles de caractère social et littéraire. La bourgeoisie, dont la domination a conditionné l'épanouissement de ce courant, ne parvint pas à se consolider en Albanie comme une classe hégémonique dans la vie politique et sociale des années 1912-1939.

Dans les pays où il émergea, le réalisme s'affirma avec toutes ses valeurs, avant tout dans la prose. Or, l'époque de notre Renaissance nationale sollicita au premier chef la contribution des poètes. En ces années-là, la poésie, avec ses particularités, pouvait influer sur l'attitude spirituelle du peuple de façon plus marquée que tout autre genre littéraire, et même que toute autre activité intellectuelle. Aussi comprend-on bien que le romantisme de notre Renaissance n'ait pas visé et, nécessairement, ne soit pas parvenu à créer une vaste tradition dans le développement des différents genres de prose.

L'esprit général de la prose sentimentaliste fut rejeté et dépassé par les écrivains réalistes, qui, de toute manière, furent très sensibles au stade encore infantile de la prose, qui limita leurs possibilités de rendre plus complètement et profondément la vie sociale de leur temps.

\* \* \*

XII. Un regard d'ensemble sur l'évolution des écoles dans l'histoire de notre littérature, conduit à cette première conclusion: le romantisme fut sans conteste la seule école qui réussit à se consolider, et cela de façon prépondérante, à son époque; il se caractérisa de façon plus marquée et plus variée, s'étendit sur une plus longue période et inspira un plus grand nombre d'oeuvres de qualité. Les romantiques de notre Renaissance nationale élaborèrent les principaux traits de la nouvelle littérature albanaise, sa physionomie nationale et po-

pulaire, les positions ouvertement démocratiques et fidèles à l'esprit des lumières; ils s'attachèrent à développer plusieurs des divers genres et types de littérature; ils jetèrent par leurs œuvres les fondements de la langue littéraire albanaise. Les productions de nos écrivains romantiques comportent également les prémisses des écoles postérieures de notre littérature. C'est parmi eux que se trouveront les initiateurs du réalisme, et ils ne seront pas insensibles aux influences des écoles post-romantiques d'Europe. Par certains aspects, leur inspiration infusera un contenu sentimentaliste à notre prose naissante.

Le romantisme, surtout dans la poésie des Albanais d'Italie, eut des points de rencontre plus fréquents avec la littérature européenne mais en restant original même dans ses affinités essentielles avec le phénomène analogue dans les autres pays.

A nos romantiques et à leur œuvre échut le sort d'être à la fois les pionniers de la nouvelle pensée philosophique albanaise. Dans les circonstances de notre mouvement de Renaissance nationale, alors que la pensée philosophique et sociale n'avait pas encore une vie à soi et était surtout diffusée dans les organes de presse encore peu lus, la poésie de nos romantiques, surtout celle de Naim Frashëri, prit en charge de porter dans le peuple, dans une langue artistique qui lui était intelligible, les idées les plus avancées de l'époque. C'est pourquoi l'œuvre de certains des écrivains les plus éminents de notre Renaissance, tout en comportant beaucoup de traits de l'école romantique, s'était faite le véhicule de la pensée des lumières. Naim Frashëri<sup>1</sup> et d'autres romantiques albanais trouvaient dans les idées des lumières un puissant appui pour la création du pathos romantique de leur poésie. C'est pourquoi dans beaucoup de leurs œuvres les desseins politiques et éducatifs apparaissent directement; au reste, ce n'est pas par hasard que nombre de nos romantiques furent aussi journalistes, savants folkloristes, rédacteurs de manuels scolaires, etc. Assurément, il n'y a pas lieu de nous occuper ici des détails de la pensée des lumières qui se manifesta notablement à travers la poésie de notre Renaissance nationale; il convient seulement de souligner que dans les œuvres de ces années-là cette pensée ne se heurtait pas à l'esprit général

---

1) Voir, Dh. Shuteriqi, **Naim Frashëri**, Tirana, 1982, p. 213.

*romantique, puis sentimentaliste, de notre littérature. La philosophie de la littérature de notre Renaissance, qui a vu le jour et s'est développée principalement en tant qu'expression de la lutte pour la libération nationale, était, sous maints aspects, une philosophie de confiance et d'optimisme, une philosophie projetée vers l'avenir, vers un avenir meilleur pour la société albanaise. Le romantisme albanaise avait pour trait original l'harmonisation de son esprit général avec les idées des lumières, que la littérature romantique, dans d'autres pays, surtout d'Europe occidentale, refléta plus dans la crise que ces idées connurent après la Révolution bourgeoise française.*

*Le retour à l'histoire de l'Albanie, surtout à l'époque de Georges Kastriote Skanderbeg, représentait la toute première tendance romantique de l'œuvre de Rada, Dara, Naim Frashëri et consorts. Tout en restant fidèle à un des traits les plus importants de l'école romantique, la littérature de notre Renaissance nationale élaborait les particularités qui conféraient à cette école sa forme originale. Nos écrivains découvraient dans le passé l'argument fondamental de l'affirmation de la nation albanaise; ils y trouvaient les temps glorieux, les hommes vrais, la pureté et la beauté des Albanais, une société humaine juste. La pensée et la création romantiques en général, lorsqu'elles évoquaient l'histoire, principalement le Moyen Age, étaient animées d'autres aspirations philosophiques, morales et esthétiques; d'une part, sous l'influence de Rousseau, elles s'opposaient à la morale bourgeoise, d'autre part, elles traduisaient dans la réalité la conception esthétique connue, selon laquelle le beau doit être recherché dans toute époque et dans tout pays, qu'il n'est pas fondé sur l'harmonie, mais au contraire, sur le contraste, les disproportions. Nos écrivains étaient naturellement sensibles au contenu éthique que le romantisme recherchait dans le passé, et tous, Naim Frashëri en particulier, étaient attachés aux vertus non seulement en tant qu'humanistes éminents, mais avant tout comme patriotes albanais, ardemment engagés dans la lutte pour la liberté et l'emancipation à tous égards. Tout à la fois, les fins esthétiques que se proposait le romantisme européen, lorsqu'il traitait de périodes historiques passées, ne pouvaient marquer l'œuvre de nos écrivains, celle-ci étant née romantique sans avoir été précédée par des œuvres de nature classique, partant, sans qu'il lui eût été nécessaire de s'opposer à leurs principes esthétiques.*

L'engagement sans réserve pour la cause nationale, caractéristique essentielle du romantisme albanais, a transmis aussi son coloris à ses autres traits. Les héros lyriques de Naim Frashëri, De Rada, Dara, Çajupi, Asdren, etc. rêvent avec feu de la liberté de la patrie et c'est justement parce qu'ils rêvent de cette liberté et qu'ils sont les porteurs de l'idée nationale, que les héros de Naim Frashëri et de ses compagnons rejettent par beaucoup d'aspects l'égocentrisme prononcé, cette «tristesse universelle»<sup>1)</sup> que la poésie de Byron avait tant alimentée. Assurément, le héros de Naim Frashëri et de nos autres poètes, est parfois triste, mélancolique, il est frappé par la fatalité et a des moments d'abattement, il se laisse entraîner par la puissance de la beauté, que dans certains cas il considère comme la seule possibilité de perfectionnement moral de l'homme. Les héros des romantiques albanais d'Italie vivent eux aussi une vie passionnée et éprouvante; ils sont la proie de l'amour et de la beauté de la nature, très sensibles et parfois contradictoires dans leurs attitudes. Mais les poètes albanais d'Italie, Naim Frashëri, Çajupi, Asdreni dans la première période de sa création, Mjeda dans certains de ses poèmes, transmettaient un monde spirituel qui irradiait le plus intensément et complètement possible pour leur époque la pensée patriotique, associée à des positions ouvertement démocratiques. Ce qu'on appelait le «byronisme», entendu comme un mode de pensée exceptionnel dans ses passions et ses contradictions, ne marqua pas l'esprit de la poésie de Naim Frashëri et consorts. La création des romantiques albanais d'Italie en demeura elle aussi éloignée; c'est seulement dans des cas particuliers de la poésie de Hiéronyme de Rada, dans la figure de Bozdar Stres, parfois aussi chez le héros lyrique de Zef Serembe, que sont ébauchés des états d'âme qui évoquent les traits du héros typique romantique. Tout comme les romantiques en général, les écrivains de notre Renaissance voyaient dans l'amour un des sentiments humains les plus profonds, la possibilité de l'affirmation de la liberté et de la personnalité. Mais, en même temps, on ne peut pas ne pas être frappé par le fait que nos romantiques progressistes, si fortement engagés dans la lutte pour la cause nationale, s'en tinrent, quant à l'amour, à ce stade, sans faire de l'abandon à ce sentiment l'une des premières marques de l'homme vrai, le seul guide de sa vie, à l'instar, en général, des romantiques

---

1) Voir R. Qosja, Kontinuitete, Prishtina, 1972, p. 17.

européens, lesquels, au nom de ce sentiment, s'étaient dressés non seulement contre la morale bourgeoise mais aussi contre l'esthétique classique, qui demandait à ses héros de se guider sur la «raison» sans céder à la passion.

Conformément aux tendances les plus connues du romantisme, la littérature de notre Renaissance nationale attacha une attention particulière à la peinture de la nature. Tous les poètes de ce temps-là en sont fort proches. Mais alors que de nombreux romantiques de la littérature européenne adoraient la nature comme le lieu qui leur assurait la solitude tant convoitée et, plus souvent, comme le milieu qui possédait le pouvoir extraordinaire de contribuer à la formation d'un homme d'une grande richesse spirituelle et d'une extrême pureté, nos romantiques, eux, dominés par la pensée de la patrie et exilés comme ils l'étaient, voyaient dans les beautés de la nature avant tout les beautés des lieux de leurs ancêtres, les beautés de la Patrie à libérer. Assurément l'inclination particulière de la poésie de notre Renaissance vers la nature tient aussi à d'autres raisons, qui ont désormais été mises en lumière. En dépit des nuances que l'on relève d'un auteur à l'autre, les causes qui ont poussé nos romantiques vers la nature sont plus ou moins similaires. Naim Frashëri se distingue parmi eux comme le poète le plus proche des sources de la signification philosophique de cette tendance romantique; il y trouve aussi une manière appropriée d'exprimer ses vues panthéistes.

L'homme de lettres bien connu de Kosove, R. Qosja, a attiré l'attention sur un fait, certes notoire, mais qui comporte en soi une autre distinction importante propre au romantisme albanais. «Parmi les éminents romantiques européens, écrit-il, Victor Hugo, par exemple, eut, seul, le destin de vivre vingt ans en exil, loin de son pays, alors que les promoteurs de notre Renaissance, eux, ont pour la plupart vécu soit de longues années soit constamment en terre étrangère, sans jamais voir leur patrie durant leurs vieux jours». <sup>1)</sup> Confrontés au problème national et vivant en exil, nos romantiques n'avaient aucune raison d'adopter dans leur pratique créatrice l'exotisme, un des traits les plus caractéristiques de l'école romantique. Si dans certains aspects du contenu de leurs œuvres on trouve quelque élément exotique, c'est pour des raisons diverses; dans le cas de la poésie de Rada, ils peuvent être

1) Voir R. Qosja, Kontinuitete, Prishtina, 1972, p. 17.

dus dans une certaine mesure à l'influence du romantisme européen, alors que dans l'oeuvre de Naim Frashëri elles tiennent aux traces laissées par la culture orientale que comportait sa formation. Dans d'autres cas, ces aspects dérivent seulement du thème historique traité par les romantiques de notre Renaissance; son réalisme artistique même requérait, pour des raisons que l'on sait, des sujets qui ne pouvaient écarter des milieux et des personnages non albanais.

Les attitudes qu'ont adoptées les écrivains de notre Renaissance à propos du rôle du poète et de son oeuvre dans la vie sociale semblent se rapprocher des vues romantiques dans leur ensemble. A de rares exceptions près, ils ont manifesté ces attitudes indirectement, à travers des poèmes particuliers («Les propos de la chandelle» de Naim Frashëri, «Naim Frashëri» de Çajupi, etc.) De Rada et Naim Frashëri sont convaincus que le poète, par sa vie et son oeuvre, participe constamment à tous les soucis du peuple, qu'il est son guide spirituel, et qu'il lui appartient de regarder vers l'avenir. Assurément, Asdren est proche de ces vues lorsqu'il admet les étroits liens qui unissent la poésie et la politique, tout comme Çajupi, lorsqu'il exalte la figure de Naim Frashëri. Les œuvres «Beauté de la poésie» et «Le Poète» de Shiroka illustrent aussi fort, bien<sup>1)</sup> que la conception romantique du poète et de la poésie était très répandue et fortement ancrée durant notre Renaissance nationale. Le contenu mystique des vues romantiques sur le poète et son inspiration se rencontre sous une forme latente d'abord chez De Rada puis, plus tard, chez Asdren, alors que chez Poradeci il est très manifeste et profond. Idéaliste dans ses convictions philosophiques, Lasgush Poradeci est convaincu que l'inspiration est de nature divine, qu'à travers elle le créateur apparaît comme l'élu de la divinité.

La symbiose des écoles littéraires, particulièrement dans les années 1912-1939, est une autre conclusion générale à laquelle conduit leur étude. Elle est très apparente dans deux conceptions: la première: les écoles littéraires vivent côté à côté mais aussi en opposition entre elles; la seconde: dans certains cas les œuvres d'un même écrivain appartiennent à des écoles littéraires différentes.

Bien qu'il ait surtout joué son rôle durant la Renaissance nationale, le romantisme ne s'éteignit pas dans les périodes qui suivirent; il survécut comme école progressiste dans des

1) Voir plus en détail: Historia e letërsisë shqiptare, Tirana, 1983, p. 366.

œuvres de *Lasgush Poradeci* et fit retentir des notes nettement révolutionnaires dans la poésie de *Migjeni* et de certains autres écrivains des années '30. Mais comme cela s'est généralement produit en ce qui le concerne, la survie du romantisme, dans l'histoire de notre littérature également, a tenu à des causes très complexes, déterminées par une suite de circonstances sociales et historico-littéraires, où ressort naturellement une profonde différenciation des écrivains dans leurs engagements politiques et sociaux.

Les écoles postromantiques de la littérature européenne, le symbolisme et le Parnasse, se sont surtout manifestées dans la littérature albanaise sous forme d'influences, qui, dans la poésie d'*Asdren* et de *L. Poradeci*, ont été rendues possibles par des facteurs sociaux, littéraires et biographiques. Néanmoins, ces phénomènes ont déterminé une tendance formaliste, qui est restée à l'état latent; elle ne parvint à porter ses traits essentiels ni dans l'œuvre d'*Asdren* ni dans celle de *Lasgush Poradeci*, chez laquelle elle apparait malgré tout plus fréquemment.

Il en a été différemment du romantisme régressif d'après 1912, qui se répandit dans les courants de la littérature de l'époque à travers les œuvres de *Fishta*, *Z. Schirò*, *E. Koliqi*, etc., encouragé par les conceptions du monde religieuse et cléricale, par la mentalité de l'intelligentsia bourgeoise, et les visées réactionnaires et antialbanaises des grandes puissances.

Inutile déjà dans les années de la Renaissance nationale, le classicisme pouvait apparaître par la suite dans les lettres albanoises seulement comme une tentative conformiste de glorifier le régime établi. Ce phénomène, qui trouva pour le servir un écrivain médiocre comme *E. Haxhiademi*, demeura, ainsi que nous l'avons indiqué, isolé et n'eut aucun écho.

Surtout par ses traits propres, et particulièrement par sa nature profondément démocratique, le romantisme progressiste créa les prémisses qui, dans de nouvelles conditions historiques et sociales, devaient engendrer l'école réaliste. Il fut presque contemporain des œuvres sentimentalistes, mais, assurément, laissa des traces bien plus profondes dans l'évolution de la littérature. Le réalisme était la première école qui élabora sa propre plate-forme esthétique, par laquelle il s'opposa à la création de tendance romantique et sentimentaliste. Traitée, en partie seulement, dans l'optique du romantisme de notre Renaissance, la problématique sociale s'amplifie considérablement dans la prose de nos réalisateurs, comme *Migjeni* et *N. Bulka*. A travers elle, le réalisme accentue la tradition

démocratique du romantisme et du sentimentalisme pour atteindre certains résultats dans la représentation artistique de la vie sociale et de ses causes motrices.

A travers ces processus, dans les années 1912-1939, se faisaient jour clairement des phénomènes qui polarisaient la littérature dans deux sens opposés quant à leur contenu. C'est pourquoi la symbiose des écoles évoquée dans cette étude, doit être entendue non pas comme une coexistence faite d'échanges réciproques, mais seulement comme le développement simultané de phénomènes fort différents à maints égards.

Si l'on peut parler de symbiose dans le sens premier du terme, elle doit être recherchée dans l'œuvre d'auteurs particuliers; le réalisme des comédies de Cajupi fut à la fois préparé et alimenté par les accents matérialistes, par les attitudes nettement anticléricales et antiféodales ainsi que par les profondes sympathies démocratiques, que l'on relève dans son œuvre poétique, généralement, romantique. Le réalisme de la prose de Migjeni fut la conséquence logique du pathos critique de la poésie qu'il laissa, et qui, dans beaucoup de ses œuvres, n'en demeure pas moins romantique, en ce qu'elle tend principalement à travers des visions de l'imagination, à une vie meilleure et plus juste, car elle contient en soi le drame profond de l'individu qui ne pactise jamais avec la société et le milieu où il vit.

Les éléments parnassiens et symbolistes dans l'œuvre d'Asdren sont des conséquences possibles de son inspiration romantique, qui se dessinèrent lorsque le poète se détacha de la vie de son pays pour se replier sur lui-même, et se mit à rechercher son inspiration surtout dans ses lectures de poésie étrangère.

Le passage rapide de la société albanaise de la question nationale à d'autres problèmes, sociaux et de classe, les particularités de la littérature en tant que type d'art, le stade de développement de la prose et de la dramaturgie sont au nombre des causes principales qui rendirent possible, dès les années 1912-1930, le mélange d'écoles, de tendances et de phénomènes plus particuliers, que connaît la littérature albanaise. Elle ne pouvait conserver son caractère relativement «homogène», qui frappait à l'époque de notre Renaissance; son «hérogénéité» dans les temps qui suivirent était naturelle et attendue. Les phénomènes sporadiques du classicisme, du Parnasse et du symbolisme, qui se diffusèrent en quelques années, ne doivent cependant pas conduire à la conclusion que

la littérature avançait à travers un amalgame d'écoles des plus diverses. La tendance la plus profonde et la plus claire des processus historico-littéraires était le passage du romantisme progressiste au réalisme, qui, pendant un temps, fut précédé par le sentimentalisme, puis coexista avec lui. Bien que l'époque qui appela et créa le romantisme eût été dépassée, son rôle dans les lettres albanaises, comme nous l'avons relevé, ne s'arrêta pas là. Le romantisme progressiste conservait sa raison d'être après la Proclamation de l'Indépendance, car la littérature continuerait de rechercher obstinément des changements, qui touchaient maintenant davantage la vie sociale; elle continuerait de dépeindre une autre société albanaise, plus juste et plus humaine. Surtout en poésie, les écrivains n'abandonneraient pas leur rêve inquiet et attaché à un idéal, qui pouvait être encore subjectif et confus, mais qui conférait à leur création un puissant pathos romantique révolutionnaire. Cet idéal est très vivace dans la poésie de Migjeni et des autres poètes des années 30, qui en étaient au début de leur oeuvre.

Les phénomènes sentimentalistes d'une partie de la prose de cette époque ne peuvent être compris sans la négation de la morale régressive féodale-cléricale, sans la conviction ancrée qu'une forme d'organisation des relations éthiques était maintenant nécessaire dans la société albanaise.

Dans les circonstances qui se créèrent après la fondation de l'Etat albanais, plusieurs couches de la bourgeoisie et surtout de la petite-bourgeoisie se mirent à sentir et à exprimer la nécessité impérieuse de changements dans la vie sociale et dans la mentalité de l'époque. Mais, malgré la prise de conscience toujours plus nette de la nature foncièrement réactionnaire du féodalisme, son influence restait toujours puissante et ne pouvait encore être neutralisée. Dans la pensée progressive de l'époque, l'opposition à la couche dominante féodale ne trouvait pas d'autres possibilités de s'exprimer, à part l'émotion sentimentaliste, qui voyait chez les petites gens l'homme sensible et délicat, source de l'harmonie et de la justice sociales. Aussi la littérature albanaise des années 20-30 devait-elle nécessairement passer par l'expérience sentimentaliste, qui se manifestait aussi à l'époque comme une pratique requise par les commencements de notre prose. C'est précisément pour ces raisons que, dans l'évolution de notre littérature, ce n'est pas le sentimentalisme qui fraya la voie au romantisme, mais au contraire le romantisme, avec certains de ses

traits, qui, dans d'autres conditions historiques et sociales, rendit possible les œuvres sentimentalistes. Bien que justifié pour son époque, le sentimentalisme en général ne parvint pas à renouveler les valeurs créées par nos romantiques progressistes. Certes, à certains égards; en particulier dans la représentation des traits psychologiques des diverses couches sociales, il porta plus avant les acquis de la littérature de notre Renaissance et, de ce point de vue, contribua à sa future évolution dans le sens du réalisme. Si l'on excepte le roman «Si j'étais un garçon» de H. Stërmilli, beaucoup d'œuvres de Ndoc Nikaj, Grameno et de leurs compagnons, enclines à traiter de sujets aux intrigues compliquées et à rebondissements, avec des dénouements imprévus et naïfs, dominés par un amour simpliste, n'ont pas brillé par la force de la pensée, par l'analyse psychologique approfondie du monde spirituel des personnages, ni en général par l'élévation du niveau artistique. Un Seraphin et un Bozdar, un héros lyrique comme celui de la poésie de Naim Frashëri avec ses méditations continues, penseur passionné et nature raffinée, un tempérament plein de fougue critique comme celui du héros de la poésie de Çajupi, ne se retrouvent pas dans la prose sentimentaliste. Certes, ces différences ne s'expliquent pas seulement par des raisons littéraires intérieures, par le fait que la prose longue en était à ses commencements, ni par les limitations individuelles des talents qui la pratiquèrent dans les premières décennies du XX<sup>e</sup> siècle. Les vues sociales que nos sentimentalistes visaient à transmettre, encore qu'avec des accents nettement démocratiques, conservaient dans beaucoup de leurs créations une note fort nette de «réconciliation», d'«harmonie», qui étaient recherchées toujours sur le plan moral et souvent d'origine religieuse. Ces vues étaient généralement celles des couches petites-bourgeoises, qui, tout en ne pactisant pas spirituellement avec les plaies de la réalité sociale, étaient néanmoins incapables d'y trouver des solutions radicales. Aussi, bien souvent, les œuvres sentimentalistes dominées par la souffrance et la tristesse mélodramatique, versent-elles dans le fatalisme, l'illusion et l'esprit réformiste. C'est seulement avec la venue de l'intelligentsia démocratique progressiste, influencée par la pensée matérialiste, que la littérature, dans la prose d'un Migjeni, écarte toute sorte d'illusion, que la fatalité et le scepticisme, sans être détachés complètement du monde subjectif des écrivains, sont considérés aussi comme le produit de la situation économique et sociale de l'époque, qui pouvait et devait être dépassée non point à travers un rap-

prochement conciliant, «panhumain», mais au contraire à travers les heurts et les combats entre hommes de couches et de classes sociales antagonistes, où la littérature jouerait son rôle pleinement engagé. Il était naturel que des vues pareilles n'admettent plus dans leur pratique créatrice des personnages dont la psychologie était souvent dominée par l'amour (les nouvelles de Grameno, certains récits d'Helena), mais qu'elles conduisent au contraire à la peinture de caractères, qui pensent, sentent et se comportent suivant une logique intérieure objective, déterminée par le milieu vital, par leur position sociale et économique (les nouvelles de Migjeni, les croquis de N. Bulka, certaines œuvres de M. Kuteli, etc.) Pour de telles conceptions, qui voyaient la vie dans ses rapports complexes de causalité, il était indispensable que la création littéraire recherchât dans les sujets traités avant tout la véracité convaincante et non pas le drame affectif; des faits courants de la vie quotidienne et non pas des événements singuliers où le destin des hommes est fixé par le hasard et l'imprévu; la typification du fondamental, et non pas l'exaltation d'états d'âme d'une particulière et exceptionnelle acuité. La création qui tendit à ces objectifs renonça évidemment à certains moyens d'expression élaborés par le romantisme et surtout le sentimentalisme. L'emphase n'apparaîtrait que dans quelques croquis et pamphlets pour céder la place à une phrase bien organisée, qui transmettrait directement et objectivement les événements, la pensée et l'univers spirituel dans la prose narrative. Dans beaucoup d'œuvres, l'ironie, la satire, mais aussi le grotesque, combinés à la passion critique sont toujours plus présents et excluent le mode d'expression à l'imagerie très chargée mais peu profonde et parfois littérairement affectée, qui tendait à toucher le plus possible le lecteur.

C'est par ces chemins que se fraya sa voie la production réaliste, qui apparut dans les lettres albanaises en tant qu'exigence de la vie spirituelle du pays, une exigence qui, par ses orientations progressistes, visait à mettre à nu les raisons complexes de l'injustice sociale et, à travers elles, à démontrer, autant et comme elle le pouvait, la nécessité de transformations radicales de la situation socio-économique, socio-psychologique, mais aussi politique du pays.

Dans l'histoire de notre littérature il ne fut pas facile à l'école réaliste de connaître un fougueux et large essor. Certes, elle ne manqua pas de puissants talents; de même, beaucoup de caractéristiques de l'esprit romantique de la littérature de

notre Renaissance nationale constituaient un terrain très solide sur lequel les tendances réalistes pouvaient s'appuyer, comme elles le firent effectivement. Mais alors que la floraison du romantisme fut soutenue par de nombreux facteurs politiques et sociaux, le réalisme, au contraire, était considérablement entravé dans son essor par l'arriération prononcée de tous les aspects de la vie du pays, par les traits encore rudimentaires du capitalisme naissant, par la prépondérance de l'esprit régressif, dont le féodalisme et la monarchie étaient les porteurs. Pour beaucoup de raisons, le romantisme albanais trouvait dans la poésie, ce genre qui est partout apparu le premier, la forme la plus appropriée à son expression, alors que le réalisme se vit contraint de manifester ses traits et ses possibilités en un temps beaucoup plus bref, quelque deux décennies; dans ces conditions, il était naturel que les écrivains romantiques fussent plus nombreux que les réalistes. Ce sont là autant de raisons pour lesquelles l'histoire de la littérature albanaise ne doit en aucune manière être jugée sur le stade de cristallisation du réalisme; elle doit être félicitée pour avoir, malgré tout, senti profondément la nécessité de cette école, pour l'avoir définie de manière très solide, et créé une puissante tradition, qui devait être menée plus avant par le réalisme socialiste, né au cours de la Lutte antifasciste de libération nationale et consolidé à l'époque de l'édification socialiste.

## LITERATURA KRYESORE;

1. **KARL MARKS, FREDERIK ENGELS**, Mbi letërsinë dhe artin, I, II, Tiranë, 1976.
2. **ENVER HOXHA**, Raporte e Fjalime 1967-1968, Tiranë 1969.
3. **ENVER HOXHA**, Mbi letërsinë dhe artin, Tiranë 1977.
4. **ENVER HOXHA**, Për shkencën, I, II, Tiranë 1985.

- \* \* \*
1. Historia e Shqipërisë, vell. II, III. Botim i Institutit të Historisë, Tiranë 1984.
  2. Historia e letërsisë shqipe, II, Tiranë 1959.
  3. Historia e letërsisë shqiptare, Botim i Institutit të Gjuhësisë e letërsisë, Tiranë 1983.

### 1. Bihiku, K.,

2. » »,

3. » »,

Rrymat ideore e artistike dhe gjinitë e letërsisë shqipe që nga fundi i shek. XVII e gjer në ditët tona, «Studime filologjike» 1967/1. Aleks Stavre Drenova, studim hyrës në vëprën letrare të Asdrenit, Botim i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, Tiranë 1976. Probleme letrare, Tiranë 1974.

4. Çabej, E., Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe, Tiranë 1936.
5. » , Disa karaktere të poezisë së De Radës, «Drita», 6.XII.1964.
6. » , Romantizmi në Evropën Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare-dorëshkrim.
7. » , Studime gjuhësore V, Prishtinë 1975.
8. Dado, F., Andon Zako Çajupi, Jeta dhe vepra, Tiranë 1982.
9. » , Mbi veprën letrare të A. Z. Çajupit, Vepra letrare, Tiranë 1984.
10. Dorsa, V., Sugli albanesi, Ricerche e Pensieri, Napoli 1847.
11. Gualtieri, V., Girolamo de Rada, poeta albanese, Palermo 1930.
12. Gurakuqi, M., Autore dhe probleme të letërsisë përparimtare e shqipe të viteve '30, Tiranë 1966.
13. » , Mbi veprën poetike të Mqedës, Tiranë 1980.
14. Gjika, Th., Mihal Grameno novelist, Studime filologjike 1980/4.
15. Fortino, J. K., Parathënie në botimin e «Brisandi Lletixja e Ulladhenit» të F. Santorit, Kozencë 1977.
16. Hamiti, S., Parathënie në botimin «Vdekja e Nositit» të L. Poradecit, Prishtinë 1978.
17. Jorgaqi, N., Antalogjia e mendimit estetik shqiptar (1504-1944) Tiranë 1979.
18. » , Parathënie në veprën letrare të Haki Stërmillit, Tiranë 1982.
19. Kabo, I., «Kënga e sprasme e Balës» dhe disa tipare të romantizmit të letërsisë arbëreshe, në «Gjuha, letërsia dhe historia në shkollë» 1966.
20. Kastrati, J., Kolë Mirdita, «Trëndafila që s'çelin pér ne» Tiranë 1959.
21. Kodra, K., Vepra poetike e Zef Serembes, Tiranë 1975.
22. » , Disa veçori të romantizmit të De Radës, «Studime filologjike» 1980/2.
23. Koka, V., Rrymat e mendimit politiko-shoqëror në Shqipëri në vitet '30 të shek. XX, Tiranë 1985.
24. Lanson, G., Histoire de la littérature française remaniée et complétée pour la période 1850-1950 par P. Tuffrau Paris 1957.

25. **Marchiano, M.**, L'Albania e l'opera di Girolamo de Rada, Tra-ni, 1902.
26. **Qosja, R.**, Dialogje me shkrimtarë, Prishtinë 1968.
27. " " , Kontinuitete, Prishtinë 1972.
28. " " , Asdreni, jeta dhe vepra e tij, Prishtinë 1972.
29. " " , Naim Frashëri, Vepra, Prishtinë 1978.
30. " " , Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, Pri-shtinë 1984.
31. **Shapillo, D.**, Dukuri dhe vepra letrare, Tiranë 1974.
32. **Shuteriqi, DH. S.**, Historia e letërsisë shqipe, Tiranë 1958.
33. " " , Nëpër shekuj letrarë, Tiranë 1973.
34. " " , Naim Frashëri, Tiranë 1982.
35. " " , Naim Frashëri, Vepra të zgjedhura, Tiranë 1982.
36. **Tieghem, P. (van)**, Le romantisme dans la littérature européenne, Paris 1969.
37. **Uçi, A.**, Mitologjia, folklori, letërsia, Tiranë 1982.
38. " " , Simbolika mitologjike dhe realizmi në poe-zinë e F. S. Nolit, «Drita», 31.1.1982.
39. **Xhaxhiu, M.**, Kritikë e studime letrare, Tiranë 1975.
40. " " , Parathënje në botimin e veprës letrare të N. Bulkës, Tiranë, 1980.
41. **Xholli, Z.**, Humanizmi i Naim Frashërit dhe mësimet e tij morale, «Nëntori», 1971/5.

## LITERATURA E KONSULTUAR

1. **Abraham, P., Despe R.**, Manuel d'histoire littéraire de la France, t. IV (1), IV (2), V. Paris 1972, 1973, 1974.
2. **Bala, V.**, Migjeni — Portret monografi, Tiranë 1972.
3. **Berisha, L.**, Mistifikimi letrar dhe letërsia shqiptare e Rilindjes. Gjurmime albanologjike 1975/5.
4. **Brahimi, R.**, Parimet krijuese të De Radës, «Jeronim de Rada», Tiranë 1965.
5. **Bulo, J.**, Studimet e sotme shqiptare mbi Naim Fra-shërin, Studime filologjike 1971/2.
6. " " , Mbi disa probleme të studimit të letërsisë sonë të Rilindjes, «Drita», 8 dhe 15.XII.1968.
7. **Çabej, R.**, Vatra dhe bota në poezinë e De Radës, «Jero-nim de Rada», Tiranë 1965.

8. Favre, I., Lumières et romantisme, Paris 1980.
9. Kadare, I., Duke lexuar Milosaon, «Jeronim de Rada, Tiranë 1965.
10. Kastrati, J., Jeronim de Rada (jeta dhe vepra), Tiranë 1979.
11. Kodra, K., Figura e Skënderbeut në krijimtarinë e de Radës, Studime filologjike 1967/4.
12. " " , Problematika dhe veçori të formës te poema «Një pasqyrë e jetës njerëzore», Studime filologjike 1975/4.
13. Pichois, C., Littérature française — Le romantisme II, Paris 1979.
14. Qosja, R., Prej tipologjisë deri te periodizimi, Prishtinë 1979.
15. Sanctis, F. de, Saggi e scritti critici e vari, vol. VI, Milano 1938.
16. Saulnier, V. L., La littérature française du siècle classique, p.u.f. 1977.
17. Schiro, G. (Junior), Storia della litteratura albanese, Milano 1959.
18. Stratiko, A., Manuale di letteratura albanese, Milano, 1896
19. Shuteriqi, DH. S., Gjurmime letorraine, Tiranë 1974
20. " " , Autorë dhe tekste, Tiranë 1977
21. Tieghem, Ph. (van), Les grandes doctrines littéraires en France Paris 1963.
22. Uçi, A., «Parimet e estetikës» e Jeronim de Radës — dokumente i rëndësishëm estetik i Rilindjes sonë Kombëtare, Probleme të estetikës, Tiranë 1976.
23. Tieghem, Ph. (van), Le romantisme français, p.u.f. 1979.
24. Varfi, A., Rreth ideve politiko-shoqërore të Jeronim de Radës, Jeronim de Rada, Tiranë 1965.
25. " " , Gavril Dara, poet demokrat revolucionar, Nëntori, 1976/4.
26. Xholi, Z., Naim Frashëri (jeta dhe idetë), Tiranë 1962.
27. " " , Shënime rreth panteizmit të Naimit, Nëntori 1985/10.

### VEPRAT KRYESORE:

1. Asdreni, Vepra, I, II. Botim i Institutit të Gjuhësise e të Letërsisë, Tiranë 1976, 1980.
2. Asllani, A., Vidi vidi pëllumbeshë, Hanko Halla (përga-

- titur nga R. Ibrahim, parathënia prej tij), Tiranë 1980.
3. Bulka, N.,  
4. Cepa, K.,  
5. Cajupi, A. Z.,  
6. " ", ,  
7. Dara, G. (I riu),  
8. De Rada, J.,  
9. " ", ,  
10. " ", ,  
11. " ", ,  
12. " ", ,  
13. " ", ,  
14. " ", ,  
15. " ", ,  
16. " ", ,  
17. Grameno, M.,  
18. " ", ,  
19. Gurakuqi, L.,  
20. Haxhiademi, E.,  
21. " ", ,  
22. " ", ,  
23. " ", ,  
24. " ", ,  
25. " ", ,  
26. " ", ,  
27. Fishta, Gj.,  
28. " ", ,  
29. " ", ,  
30. " ", ,
- Vepra letrare I, II (Parathënia prej M. Xha-xhiut) Tiranë 1980.  
 Kolana «Poezia shqipe», Tiranë 1975.  
 Vepra (përgatitur nga Dh. S. Shuteriqi, parathënia prej tij), Tiranë 1957.  
 Vepra letrare (përgatitur nga F. Dado, parathënia prej saj), Tiranë 1984.  
 Kënga e sprasme e Balës (përgatitur në shqipen e sotme nga Sh. Demiraj), Tiranë 1965.  
 Principi di estetica, Napoli 1861.  
 Lettera di Girolamo De Rada al Sig. D. Giovan Stamile, Cosenca 1865.  
 Rapaodie d'un poema albanese, Firence, 1866.  
 Poesie albanesi v. 2, Corigliano Calabro 1872.  
 Poesie albanesi v. 4, Corigiano Calabro 1873.  
 Poesie albanesi v. 6, Scanderbecou i pafaan, Napoli 1884.  
 Këngët e Milosaos, përshtatur në shqipen e sotme nga Dh. S. Shuteriqi, Tiranë, 1964.  
 Serafine Topia, përshtatur në shqipen e sotme nga A. Varfi, Tiranë 1971.  
 Vepra letrare 1, 2 Tiranë 1987.  
 Antikat kombëtare (përgatitur nga P. Tako, parathënia prej tij), Tiranë 1974.  
 Vepra 1-2 (Përgatitur nga Y. Bytyçi, parathënia prej tij), Prishtinë 1979.  
 Vepra të zgjedhura (Përgatitur nga M. Gurakuqi, parathënia prej tij), Tiranë 1955.  
 Abeli, Elbasan 1930.  
 Akili, Tiranë 1931.  
 Aleksandri, Tiranë 1931.  
 Ulisi, Tiranë 1931.  
 Pirrua, Tiranë 1934.  
 Skënderbeu, Tiranë 1935.  
 Diomedi, Tiranë 1936.  
 Mrizi i zanave, Shkodër 1925.  
 Vallja e Parrizit, Shkodër 1925.  
 Anzat e Parnasit, Shkodër 1928.  
 Lahuta e Malcis, Shkodër 1931.

31. Frashëri, N.,  
Vepra 1-5 (Përgatitur nga R. Qosja, parathënia prej tij) Prishtinë 1978.
32. " " ,  
Vepra të zgjedhura I, II, Botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH (Përgatitur nga F. Agalliu, parathënia prej Dh. S. Shuteriqit), Tiranë 1980.
33. Koliqi, E.,  
Hija e maleve, Zara 1929.
34. " " ,  
Gjurmët e stinëve, Tiranë 1933.
35. " " ,  
Tregtar flamujsh, Tiranë 1935.
36. Marko, P.,  
Horizonti, Tiranë 1959.
37. Migjeni ,  
Veprat (Përgatitur nga S. Luarasi, përathënia prej tij), Tiranë 1961.
38. " " ,  
Veprat 1-4, Prishtinë 1980.
39. Mirdita, K.,  
Trëndafila që s'celin për ne, (përgatitur nga J. Kastrati, parathënia prej tij), Tiranë 1959.
40. Mjeda, N.,  
Juvenilja dhe vepra të tjera (Përgatitur nga M. Gurakuqi, parathënia prej tij), Tiranë 1964.
41. Mosi, H.,  
Zani i Atdheut (përgatitur nga F. Ndocaj, parathënia prej tij), Tiranë 1960.
42. Musaraj, Sh.,  
Vepra letrare I, Tiranë 1979.
43. Nikaj, N.,  
Shkodra e rrethueme, Bukurusha (përgatitur nga R. Brahimi, parathënia prej tij), Tiranë 1961.
44. Noli, F. S.,  
Vepra, botuar nën kujdesin e Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë 1987.
45. Pasko, Dh.,  
Ago Jakupi e të tjera rrëfime, Tiranë 1934.
46. " " ,  
Netë shqiptare, Bukuresht 1938.
47. Poradeci, L.,  
Vdekja e Nositit (Përgatitur nga S. Hamiti, parathënia prej tij) Prishtinë 1978.
48. Prenushi, V.,  
Gjeth' e lule, Shkodër 1924.
49. Santori, F. A.,  
Il canzoniera albanese (përgatitur nga F. Solano, pasthënia prej tij), Quaderni di «Zjarrri», 1975.
50. " " ,  
Brisandi Lletixja e Ulladheni (përgatitur nga J. K. Fortino, parathënia prej tij) Kozencë 1977.
51. Schiro, G.,  
Kënkat e luftës, Palermo 1987.
52. " " ,  
Mili e Hadhia, Palermo 1900.
53. " " ,  
Te dheu i huaj, Palermo 1940.
54. Serembe, Z.,  
Vjershë, A cura, con prefazione e note dell' Cosme Serembe, Milano 1926.
55. " " ,  
Vjersha, përshtatur në gjuhën shqipe nga Ziaudin Kodra, Tiranë 1962.

56. Siliqi, R.,  
57. Spasse, S.,  
58. Stafa, Q.,  
59. Stërmilli, N.,  
60. Shiroka, F.,  
61. Shuteriqi Dh. S.,  
62. " ",  
63. Varsi, A.,

Vepra të zgjedhura (përgatitur nga Dh. Fu-llani, parathënia prej tij), Tiranë 1956  
Vepra letrare I, Tiranë 1980.  
Qortimet e vjeshtës (Përgatitur nga N. Jorgaqi, parathënia prej tij), Tiranë 1969.  
Vepra letrare I, Tiranë 1982.  
Zani i zemrës (Përgatitur nga V. Balaj e J. Kastrati, parathënie prej tyre), Tiranë 1958.  
Kangët e rinisë së parë, Korçë 1935.  
Kangë, Korçë 1936.  
Në zgjim, Tiranë 1962.

180  
360  
240

---

810  
300

---

510  
265  
-300

### TRYEZA E LËNDËS

1. Hyrje .....	3
2. Vështrim mbi periudhat historike .....	9
3. Zhvillimet romantike në historinë e letërsisë shqipe .....	23
— Moti i madh dhe evokimi i tij në letërsinë arbëreshe .....	26
— Heroi protagonist i tragjedisë shqiptare të shekullit XV, bartës i ideve kombëtare, i përsiatjeve dhe ndjenjave të thella. ....	37
— Trojet e të parëve dhe natyra e tyre .....	62
— Origjinaliteti i romantizmit së poezisë së Naimit. ....	74
— Brendia romantike e poezisë së Çajupit. ....	96
4. Çështje të diskutueshme të drejtimeve letrare .....	107
— Poezia e Asdrenit .....	107
— Poezia e Ndre Mqedës .....	118
— Lazgush Poradeci, një poet pasromantik .....	131
5. Shfaqje të romantizmit reaksionar .....	142
6. Dukuri klasiciste .....	153
7. Sentimentalizmi në historinë e letërsisë shqipe .....	161
8. Nga romantizmi, rrjedhave të realizmit .....	179
9. Aspekte të evoluimit të stilit në drejtimet letrare .....	211
10. Disa përfundime .....	220
11. Résumé .....	231
12. Literatura .....	254